

BIBLIOTËRA

3JH-31

A 14

**ALI ABDIHOXHA**

**VILA NË  
PERIFERI**  
roman





## PROLOG 1

Ishte koha..

Ndoshta do të jetë e nevojshme të themi se edhe atëherë, si gjithmonë, asgjë nuk qëndronte në vend. Në botë vazhdimisht ndryshonin lartësitë e maleve e të kolltukëve, ndryshonin sëmundjet, thellësitë e deteve, të dhënat e shkencës, historia e popujve, kufijtë, tregjet e zonat e influencës, jeta e fronet, çdo gjë ndryshonte, evoluonte. Diku aeroplanët kalonin për herë të parë oqeanë; diku vazhdonin të faleshin pesë herë në ditë; diku shkruhej se nënat e sulltanëve kishin qenë çerkezet e bukura skllave, që bliheshin nëpër pazaret e Perandorisë Osmane dhe se shumë herë edhe babai i këtyre sulltanëve ishte i panjohur; diku pritej zbritja e antikrishtit në tokë, që do të shoqërohej me dukjen e një komete të re; diku stërvite-

shin për të bërë harakiri; diku shkurtoheshin fundet e flokët e grave dhe zgjateshin flokët e basetat e burrave; binin e ngriheshin kabinete, mbi poltronat e vjetra uleshin njerëz të rinj; lindnin e rrëzoheshin mbretërit dhe rriteshin menjëherë «republikat», që për mirësjellje «ruanin» statusquotë dhe interesat e të gjitha klasave, himnizonin paqen, qetësinë dhe «idetë e reja», që mbronin regjimet e vjetra.

Në Evropë, ndërsa mbyteshin me gjak revoltat e klasës punëtore e të mbarë vegjëlisë, së cilës llogoret e Luftës së Parë Botërore, premtimet e demagogjitë imperia-liste dhe euforitë shoviniste nuk i kishin sjellë asgjë tjetër, përveç deziluzioneve, përveç vdekjeve, gjymtimeve fizike e morale, — po në këtë Evropë bëheshin edhe shpikje, zhvillohej teknika e shkenca, në sallonet luksoze ishte vënë në rend të ditës spiritizmi, vallëzimi i duarve, i tavolinave dhe i shpirtrave. Që bërë modë të flitej për veprimet e pandërgjegjshme të froidizmit, për breznitë e humbura, për skepticizmin e pesimizmin e Artur Schopenhauerit, të cilit, si filozof veteran, që kishte mbyllur sytë vitin e fundit të shekullit XIX, i bëheshin nderimet më të mëdha. E po në këtë batak të turbull përparonin idetë e pasuesve të Niçes, që ngrinin në pedestal mitin e individualizmit, hyjnizimin e Mbinjeriut (me shkronjë të madhe) dhe gjithë të tjerët shpallëshin të pafuqishëm e të destinuar vetëm për t'u gjunjëzuar. Kështu do të dilte figura e një diktatori, (ish-tetar i ushtrisë së Kajzerit, i përkëdheluri i borgjezisë gjermane, krijuesi i partisë nacional-socialiste, që s'do të kishte asgjë të përbashkët me socializmin), i cili e kishte bërë zakon të rrëmihte tokën me majën e këpucëve, të mbante kokën mënjane e ta shikonte botën nga një prizëm i shtrembër. Por, duke e shikuar shtrembër, ai betohej se do ta drejtonte këtë botë me anën e një embleme, që s'ishte veçse kryqi i thyer i një kulti të lashtë indian, tashmë ngritur nga ai në simbol i gjakut të «pastër» arian. Dhe ky (mbi) njeri, duke pranuar me modesti se njerëzit nuk i kishte bërë ai, pretendonte se në vallen e luftës për pushtet, ai po bënte kohën në të cilën ata jetonin.



Ishte koha... kur në një kontinent tjetër përtej Atlantikut kishin ndodhur e po ndodhnin gjithashtu *origjinalitete* të papërsëritshme, ku gjestet normale propagandoheshin si veprime përrallore, dhe përraloret si normale. Tashmë edhe në këtë kontinent kishte kaluar koha e armëpushimit të Luftës së Parë Botërore. Krahas *frikës së kuqe*, që ndalonte përdorimin e flamurëve të kuq e që të huajt ngado që të vinin i quante bolshevikë, në Amerikë zuri të zbrëthente kthetrat e tij histerizmi i seksit. Ai nxitej e shoqërohej nga qindra gazeta e revista, nëpër faqet e rubrikat e të cilave instruktohej rinia si të thyente çdo traditë e të gjitha traditat, si të bënte dashuri, si të merrej me aventura e bëma seksuale dhe, të gjitha këto, medoemos, përmes ritmeve moderne të xhazit e përmes avullimeve të alkoolit «ilegal». Pastaj u erdhi koha shtimit të radhëve të kapuçëve të bardhë të organizatës raciste të Ku-Kluks-Klanit antinegër e antiçifut, që bridhnin rrugëve e skutave, me pishtarë në dorë, e që nën etiketën e mbrojtësit të amerikanizmit në përgjithësi, persekutonin forcat revolucionare e demokratike. Pas histerizmit seksual, nisi rrugën e vet histerizmi ndaj parasë. E mbiqajtur *shoqëria e konsumit*, Amerika shpalli *botërisht* se nuk kishte më vend për njerëzit e dobët e të varfër, ajo shpalli se vlera e njerëzve matej me vlerën e fitimeve. Kështu mbi mpleksjen e kësaj tabuje të vjetër, por me etiketë të re, një ditë gangsterët, që së shpejti do të bëheshin zotërit e vendit, zbrazen pistoletat e para nëpër rrugët e Çikagos...

Ishte koha... kur politikanët, që e kishin bërë zakon të flitnin nën zë, pa i shqyer buzët (moda e buzëve të vogla), kishin nxjerrë sërish në pah pakënaqësitë e vjetra e të reja. Gjermania, që ishte mundur para dhjetë vjetësh, ankohej kundër Francës e Polonisë (pretendime territoriale) dhe farkëtonte heshtën e saj të vjetër, maja e së cilës shkonte deri në kufijtë aziatikë. **Drang nach Osten**. Vërshimi drejt Lindjes. **La spinta verso l'Oriente**, që do të huazohej nga Benito Musolini, i cili kishte filluar të hidhte parullat për «Italinë e madhe» ose «për rivendosjen e Perandorisë Romake».



Si përgjigje të këtyre kërcënimeve, ministrat e borgjezisë fshinin buzët me shamitë e bardha dhe ua kishte qejfi të jepnin sentencat në gjuhën e filozofisë së skolastikës latine: **Contra factum non datur argumentum**, përballë fakteve asnjë argument nuk ka vlerë. Dhe ishin mësuar të merrnin përgjigje po në atë gjuhë: **Non possumus**, nuk mundemi. E, për t'i lënë bisedat të hapura, shtonin me mirësjellje e me zë të ëmbël: **Plus ultra**, më tej.

Por... ndërkaq prapa krahëve të tyre, prapa «mirësjelljeve e zërave të ëmbël», mpriheshin armët e betejave të reja, ajri mbushej me erë baruti që prodhohej nga industritë e mëdha, të cilat u jepnin çeliquevë formën e topave e të predhave, formën e pushkëve e të tankeve, të kryqëzorëve, të aeroplanëve e të njëqind armëve të tjera. Të gjitha këto ndodhnin në një kohë, kur kapitalit botëror, duke arritur nivelin e paraluftës, kishin filluar t'i dridheshin sërish gjunjët nga simptomat e para të verdhëzës; kur po mpriheshin kthetrat e një krize të re, troku i së cilës dëgjohej si zhurmat e largëta në një kishë bosh. Kurse borgjezia, që e kishte bërë zakon të trembej nga hija e vet, që kishte frikë të jetonte, që kishte frikë të vdiste, vraponte nëpër faltore dhe për të gjitha këto, ishte sadiste, i pëlqenin perversiteti dhe cinizmi, i pëlqente të botonte me shkronja të mëdha, se popujt ishin të lumtur dhe jetonin në paqe, paçka se në të njëjtën kohë vazhdonin shfrytëzimi dhe revoltat, vazhdonin utopitë më optimiste dhe deziluzionet më të pamëshirshme, vazhdonin kërcënimet midis shteteve e mosmarrëveshjet midis klasave... Paçka se diku më larg, në kontinente të tjera, si bie fjala në Afrikën Jugore, tributë e shumta të bushmenëve shkonin drejt zhdokjes, ose pakësohej popullsia e Afrikës Ekuatoriale dhe e ish-Kongos Belge. E pse? Për fajin e diamanteve, sigurisht, për fajin e uranimit e të kobaltit, por edhe të kauçukut, që mblidhej nga lëkurëzinjtë pikë e nga një pikë për metropolet e mëdha të kapitalit.... Paçka se edhe Azia arrinte rekorde të reja në përqindjet e vdekjeve nga uria, rekorde në shtimin e numrit të rikshave, që tërhiqnin me karrocet e tyre kaskat e kolonizatorëve të bardhë. Paçka... se shoqëritë koncesionare kishin pushtuar pasuri-



të e Amerikës Latine dhe, të mbështetura nga klikat në fuqi, digjnin me zjarr çdo protestë të banorëve të varfër. Po-o-o-r jeta vazhdonte dhe kudo botohej me shkronja të mëdha, se «popujt ishin të lumtur dhe jetonin në paqe».

Ishte koha... kur statusquoja kapitaliste ishte prishur tashmë, kur në Rusi ishin përmbysur carët dhe kishte ardhur në fuqi proletariati, duke rrëzuar kështu teorinë oportuniste të Bernshtajnit, të Kautskit e të gjithë Internacionales së Dytë dhe vendin e saj tashmë e kishte zënë revolucioni i Karl Marksit, i cili nuk pranonte të futej si kapitull i ri në librin e vjetër të evolucionizmit. Prandaj njëra palë e pagëzoi atë revolucion si absurditetin më të madh të historisë, pala tjetër e quajti një thyerje, një krisje, një përmbysje, që kishte sjellë fundin e një bote dhe fillimin e një tjetre, që kishte rrëzuar poshtë përjetësinë e shpallur me bujë të sistemit kapitalist dhe përkundrazi, kishte shpallur të ardhmen e socializmit me shigjetën drejt komunizmit. Dhe kështu, më i madhi «absurditet historik» vazhdonte jetën dhe punën e vet, duke u endur si «fantazmë» nëpër botë herë këtu, herë atje, duke çarë «kordonin sanitar» me fraza të shkurtra e fare të thjeshta, si bie fjala «të shtunat komuniste», ose me fotografinë e një burri që thirrej shkurt Lenin. Ca kohë më vonë po kjo «fantazmë» zuri të shfaqej me terma të tjera edhe më të thjeshta, por më të panjohur e më të çuditshëm: Plani i elektrifikimit të Rusisë, plani ekonomik unik shtetëror, ndërtimi i bazave të ekonomisë socialiste, aleanca e punëtorëve dhe e fshatarëve, shteti proletar ose diktatura e proletariatit.

Po Shqipëria... Shqipëria çfarë bënte në këtë kohë?... Sigurisht... sigurisht... Shqipëria e kishte kaluar kohën e paleolitit, por edhe të neolitit, bile edhe të bronzit e të hekurit, që njihet si epoka e tretë në historinë e lashtë të njerëzimit. E po të bëjmë një kapërcim të madh, ajo kishte fituar jo vetëm pavarësinë, por nuk kishte mbetur prapa as në fushën e diplomacisë: ishin firmuar dy paktet e miqësisë e të sigurimit italo-shqiptar, kishte hequr përkrenaren e mesjetës, i kishte falur ose dorëzuar me bujari botës së jashtme pjesë të ndrysh-



me të organizmit të saj dhe bota e jashtme shpejtoi ta quante Shqipërinë një shtet të ri, modern.

Ishte koha, kur «Banka Kombëtare» e sapongritur, megjithëse ushqehet në truallin shqiptar, frytet e saj i derdhte në Palazzo Venezia të Romës: ishte koha kur Shqipëria merrte huara nga grupet financiare italiane me emrin **Societa per lo Sviluppo Economico del Albania** — SVEA, Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë, kur tokën shqiptare e detyronin të shpaloste gjirin e fshehtë e të hidhte kurorë me dhëndurrë të huaj. Por një ditë, këta dhëndurrë u bënë aq të shumtë, sa «e mjera Shqipëri» asnjëherë nuk mundi t'ua mësonte përmendësh emrat, po të mos ekzistonin dokumentet dhe aktet e martesave, që ruhen me xhelozë edhe sot e kësaj dite në arkivat botërore. **Anglo-Persian Oil Company** — Shoqëria Anglo-Persiane e Vajgurit, **Ferrovie dello Stato Italiano** — Hekurudhat e Shtetit Italian, **Azienda Italiana Petroli Albania** — Ndërmarrja Italiane e Vajgurit të Shqipërisë (AIPA), **Societa Italiana delle Miniere di Seleniza** — Shoqëria Italiane e Minerave të Bitumit të Selenicës (SIMSA), **Standard Oil C of Nev York** — Shoqëria Vajgurore Standard e Nju-Jorkut, **Syndicat Franco-Albania** — Sindikati Franko-Shqiptar, **Sindacato Italiano Giacimenti Minerari Albania** — Sindikati Italian i Shtresave Minerare Shqiptare, ca **EIAA** e ca **SAPIA** (ndërmarrje bujqësore italiane) e përsëri amerikane, angleze e gjermane, që u pëlqente bukuria e pyjeve shqiptare, që mahniteshin nga ngjyra e naftës shqiptare, që dëfreheshin nga blerimi i fushave të virgjra shqiptare dhe që për hir të kësaj bukurie e për hir të kësaj virgjërie, nuk lejonin që këtë vend ta përdhoste tymi i zi i fabrikave dhe ta çante thika e traktorëve... Jo, sigurisht... sigurisht..., nuk ishte më koha e paleolitit, e neolitit, as e bronzit dhe e hekurit... E tillë kohë ishte për Shqipërinë, kur mallrat e huaja pushtonin tregjet e vendit, ndërsa shqiptarët ishin të detyruar të mos hiqnin dorë nga metodat e punës artizanale që kishin trashëguar, as nga parmenda e drurit. Kishte ardhur ndonjë doktor, që çante lunga e jepte kini-na, po priftërinjtë dhe hoxhallarët vazhdonin të trembnin



djajtë e të mblidhnin xhindet. Ishte koha kur miti me shkencën jetonin pranë e pranë, kur flitej që gratë të hiqnin çarçafin, por lejohej që fytyrat t'i mbulonin me perçe më të trashë, kur flitej të ngrinin napën mbi vetulla, po nxitej që ferexhetë t'i zgjatnin deri në fund të këmbëve. Ishte koha kur kalemxhinjtë i kishin kthyer kurrizin die-llit, ishin gjunjëzuar para hënës dhe i thurnin himne monarkisë.

Ja, e tillë ishte gjendja atë ditë, kur në cepin e një sheshi të qytetit N, që mbledhur një turmë gati njëqind vetash dhe ai që ishte në ballë të saj lexonte me zë të tingëlleshëm:

*Me rastin që sot, më 7 qershor 1928, mblidhen në Tiranë të dyja dhomat legjislative, dhoma e deputetëve dhe senati për të rishikuar statutin, dëshirojmë të shprehim se Republika Shqiptare e përmbushi misionin e saj historik...*

Sheshi ku bëhej mitingu patrullohej nga xhandarët Kika, një burrë i gjatë gati dy metra dhe Jonuzi, streha e kapelës së të cilit nuk arrinte as supin e tjetrit. Prej më se një gjysmë ore këta dy xhandarë nuk e kishin prishur hapin, kur befasi u doli përpara Murroja, që ishte më i madhi e më i fuqishmi nga të gjithë qentë e pazarit dhe zuri të ecte ngadalë, si një i papunë profesionist.

— Ik, Murro, se na pengon, — i tha xhandar Kika. — Ik, se jemi në detyrë!

*... Tue pamë se kudo rrotull Shqipërisë së lashtë shkëlqejnë kunorat e mbretëve e të perandorëve, ne dëshirojmë që Shqipëria jonë e dashtun të mos mbetet prapa shoqeve të veta, ne dëshirojmë që Republika të kthehet në Monarki... dhe vendin e presidentit të...*

Prapa xhandarëve dëgjoheshin thonjtë e nofullat e lukunisë së qenve që rrëmonin plehrat e karrocës së bashkisë. Karrocieri, si në një rit të zakonshëm që përsëritej çdo ditë, vërviti kamxhikun dhe qentë u shpërndanë pa kuisur, në heshtje, sikur kryenin edhe ata një rit të zakonshëm, ritin e vrapit pa qëllim e pa kuptim. Por Murroja, jo, ai nuk shkoj pas qenve të tjerë, ai mbeti aty para këmbëve të xhandarëve, duke i penguar me të ecurën e tij të ngadalshme. Nuk dihet si e qysh, por dihet se edhe



Hana, që tërhiqte karrocën e bashkisë, ndërsa shikonte Murron të hidhte vështrime prej qelqi e të fuste hundët kudo, edhe kjo Hanë zuri të tregonte shenja shqetësimi. Përplasi potkonjtë e çliruar, qëndroi dhe, në pamundësi për ta mbajtur kokën lart, e uli gati në tokë. (Kemi harruar të themi se Hana ishte ose mund të ishte pela më e dobët e botës!)

*...Që statuti i ri t'u përshtatet dëshirave shekullore të popullit shqiptar për të ringjallur dhe restaurue fronin lavdiplotë të Kastriotëve dhe për të vendosun mbi te prijësin e madh, absolut, sovran, august...*

— Matufi! — shau xhandar Kika, duke treguar Murron, që vazhdonte të nuhaste e të fuste hundët kudo. — Paska harruar ku ka fshehur kockën! — Shikoi nga karrocieri. — Memë, ta mbash Hanën për kapistre e të mos lëvizësh derisa të mbarojnë ata! — xhandar Kika tregoi me dorë njerëzit e mitingut.

— Si urdhëron, zotrote!

Pyeti Kika:

— Po Murroja ç'dreqin ka që fut hundët nëpër brimat e mureve?

— Ka zënë të plakët, zotëri! — tha Mema.

— Ik, Murro! — i briti prapë xhandar Kika, po Murroja s'bëri asnjë gjest të tepërt, sikur ajo të mos kishte qenë një britmë, por një hiç, një asgjë, bile ai e shikoi Kikën me ca sy të ftohtë e të pakënaqur (gjithmonë prej qelqi) dhe me atë qetësinë e tij të çuditshme, vazhdoi të kërkonte kockën e humbur.

Atje në cep të sheshit ra trumbeta, si për t'u dhënë rëndësi fjalëve të atij që lexonte telegramin para njëqind burrave:

*... Shqipnia, fati i Shqipnisë po buzëqesh me flatra, me flamurin kuqezi të Skënderbeut, me flamurin kuqezi të...*

Qentë, që me sa duket, kur janë të uritur, e kanë kujtesën të shkurtër, u lëshuan sërish si Niagarë e vogël, të gjithë grumbull drejt sheshit me një polifoni të lehurash të atillë, sa edhe Hana, që tashmë po bënte pushimin e



saj me qafën e hollë të varur poshtë, denjoi të sforcohej e të çonte kokën.

Kësaj radhe tyta e dyfekut të xhandar Kikës mori flakë. Plumbi kishte zënë një kone fare të vogël, që mbe-ti me të katra këmbët përpjetë. Pasi një heshtje dhe trumbeta ra prapë:

*...Populli i qytetit tonë të lashtë e patriot asht mbledhun sot në këtë shesh dhe me anën e këtij telegrami u lutet dhomës së deputetëve dhe senatit t'i dhurojë këtij populli një kunorë nga ma të bukurat që mund të ketë kjo botë, t'i gatueje Shqipnisë një mbret të ri si rinia e lirisë sonë, një mbret të fortë si shkambinjte e patundshëm të maleve toa...*

Murroja, që ishte i madh sa një ari, me këmbët tërë lesh e me leshin e trupit të zi, gjithmonë të gjatë e si të lagur, gjithmonë plot rrodhe e kokrra balte, befasi i ndërpreu kërkimet e kockës së humbur (sipas hamendjes dhe përvojës së Kikës) dhe pati mirësinë t'i hidhte një sy turmës që bubërronte e thërriste në cepin tjetër të sheshit: «Rroftë, rroftë e qoftë!» Pastaj një çast më vonë u ul në bisht, shkundi hutimin nga turiri, hapi gojën me jar-gët deri në tokë, përveshi buzët dhe lëshoi një hungërimë të llahtarshme.

Këtu ndodhi ai, çasti fatal, të cilit i dha shkas një piskamë e mprehtë e dikujt:

— Murroja-a-a, u tërbua Murroja-a-a!

Kaq u desh. Nuk mund të përshkruhet ajo që ndo-dhi në atë shesh, por megjithatë, për t'i dhënë lexuesit njëfarë përfytyrimi, është e drejtë të themi, se disa nga burrat e mitingut, të cilët një çast më parë kërkonin që Shqipëria të bëhej me mbret, vunë krah dhe s'dihet nga e si fluturuan, të tjerë monarkistë shtangën në vend si shtyllat e Herakliut në Gjibraltar, kurse të tjerë akoma u drodhën dhe u rrëzuan nga pesha e rëndë e... frikës.

Dhe telegrami nuk u lexua deri në fund, bile as u dërgua, sepse Tirana, për të mos ngjallur valë të parakoh-shme zemërimi nga ana e popullit, ishte e mendimit që shpallja e monarkisë të mbahej akoma sekret. Bile, duan të thonë, ajo u bëri edhe vërejtjet e rastit nismëtarëve të

mitingut... Po, për të mos u larguar nga tema, ndoshta duhet të themi, se pas gjithë këtyre që kishin ngjarë e po ngjanin në botë e në Shqipëri, civilizimi, përpjekja dhe lufta dukej sikur e kishin harruar krejt qytetin N, i cili në një çast të historisë njerëzore mezi mundi të mblidhte edhe ai njëqind burra për t'i kërkuar parlamentit shqiptar *një mbret të ri e të fortë si vetë shkambinjtë tanë...* E kështu, vitet shkonin e vinin, shkëmbenin e zëvendësonin njëri-tjetrin, njerëzit lindnin e vdisnin dhe pas trazirave të fundit, pas shtypjes së atij, që ishte bërë zakon të quhej thjesht Revolucion, dukej sikur edhe për qytetin N, si për gjithë Shqipërinë, koha s'kishte asnjë rëndësi dhe pjesa tjetër e botës, që besohej se ishte më e madhe, as që futej në llogaritë e tij. Kështu dukej, sikur jeta ishte kthyer prapë në shtratin e vjetër me të gjithë plotfuqishmërinë e saj, që s'njihte lëvizje, që s'njihte ndryshime dhe asgjë tjetër s'njihte... Por, në të vërtetë kjo nuk ishte veçse ajo që trumbetohej, veçse ajo që dukej me sy, sepse...



# I

Agimi kishte rënë dhe hijet e natës ishin larguar. Kur Mentar Dika doli në verandë dhe hodhi vështrimin në kopsht ose në atë pjesë të oborrit, që e kishin bërë zakon ta quanin kopsht, gjethet e arrës së madhe mblidhnin rrezet e pjerrëta të diellit dhe secila nga ato dukej sikur ndizej nga një flakë e hollë, transparente, që ishte e ftohtë dhe e bukur si argjend, që i jepte arrës një pamje përrallore e që Mentarit i kishte mbetur në mendje që nga vitet e fëmijërisë. Por... kjo bukuri do ta kishte jetën fare të shkurtër. Mjaftonte të lëviznin pak rrezet e diellit dhe cipa e ndritshme e mjaft e hollë e argjendit, që kishte mbështjellë arrën, do të zhdukej si me magji, flaka do të shuhej dhe arra do të merrte pamjen e saj të vërtetë,



që s'do të ishte aq e bukur, po për Mentarin do të bëhej më e afërt, më e butë, më e ngrohtë, më atë gjelbërim të errët e me atë aromë pak të hidhur, pa të cilat atij i dukej se nuk do të ishte rritur.

Një çast më vonë arra e humbi vërtet shkëlqimin e saj përrallor, ndërsa Mentari Dika, pa e kuptuar as vetë, kishte zbritur shkallët e verandës.

Duke ecur përmes oborrit, dëgjoi zhurmën e autobusit (ose të atij që mund të quhej autobus), i cili do të nisej nga sheshi i bashkisë për të çuar udhëtarët e parë në Tiranë dhe që do të mbërrinte te lulishtja, prapa bashkisë së kryeqytetit vetëm në mesditë. Nga bashkia në bashki...

Pas pak Mentari Dika filloi të ndreqte pjesët e shembura të murit, përtej të cilit tringëllonin zilet e bagëtive. Barinjët e qytetit e kishin bërë zakon t'i lëshonin tufat në fillim rrotull varosheve që rrethonin vilën e Dikëve, pastaj t'i hidhnin tutje përroit, shpateve e zabeleve. Këto tringëllima ishin muzika e parë për Dikët dhe sinjali i parë që paralajmëronte se kishte mbaruar edhe një natë dhe kishte aguar një mëngjes i ri.

Autobusi lëshoi gulçimet e fundit dhe, padashur, Mentari Dika mendoi se ndoshta shumica e udhëtarëve shkonin në Tiranë të ankoheshin për hallet që u kishin rënë e për padrejtësitë që u ishin bërë.

Ndërsa vendoste gurët në pjesët e shembura të murit, ai më shumë e ndjeu sesa e dëgjoi praninë e të birit aty poshtë që kërceu matanë i turpëruar, sepse e kishte lëshuar të voglin në bishtin e lopatës, sikur aty të ishte i vetmi vend i mundshëm për të bërë ujin. I ati e shikoi Gimmin me seriozitet, por buzët e tij të shtrënguara tregonin se i qeshej përbrenda.

— S'është mirë aty! — qortoi ai.

Leta, edhe ajo kishte arritur rrëzë murit, thithte gishtin dhe vështronte të atin në heshtje. Megjithëse Mentari bënte sikur nuk shikonte nga të vegjlit, atij nuk i shpëtonte asnjë lëvizje e tyre, sado e vogël që të ishte. Ata vazhdonin të qëndronin rrëzë murit, ta vështronin nga poshtë, me sytë e sapohapur nga gjumi, dhe heshtnin me



një heshtje të pafajshme. Buzët i kishin të thara, ballin e faqet pa gjak dhe pamjen të uritur.

Ja, tashti, mendoi ai, do të hapin gojën, do të qajnë, do të kërkojnë, do të përsëritin të njëjtën gjë, të njëjtën fjalë. Por ata nuk folën një copë herë, veç vështrimin e kishin tepër të përqendruar e këmbëngulës.

— Çfarë doni? — bëri pikërisht atë pyetje që s'duhej ta bënte Mentari.

Fëmijët nuk lëvizën as qepallat.

— Pse më shikoni ashtu? — pyeti prapë ai.

M-m-m, dhia.

Ë-ë-ë, keci.

Nga hajati i mbeturinave të shtëpisë me çardak e me gemer, dhia shikonte fëmijët me sytë e ngushtë gurëkali në të verdhë dhe tundte kokën si t'u kërkonte diçka. Keci, që ishte i bukur si gjithë kecat e vegjël e që i kishte këmbët akoma të dobëta (dhia e kishte lindur me vonesë), afroi turinjte te duart e Letës, nuhati dhe befas kërcëu matanë: ë-ë-ë.

— Këputni ca bisqe për dhinë e xha Telit! — u tha Mentari.

— Unë sh'e dua ash babin, ash xha Telin, — tha Leta. Ajo thithi gishtin dhe qau mbytur. — Ata sh'na japin bukë, ashgjë sh'na japin! — E qara e Letës u kthye në vaj.

— Pusho! — i bërtiti Gimi me vetulla të ngrysura si i ati.

— Sh'dua!

Mentar Dika lëshoi mistrinë mbi mur, zbriti shkallët, i zuri fëmijët për dore, u fut në dhomën e gjumit dhe i veshi. Ngjitur, në kuzhinë dëgjoheshin hapat e së shoqes, pastaj një palë duar që kruanin në magjen gati boshe. Ai i mori për dore të dy fëmijët dhe, kur zbriti shkallët e verandës, thirri:

— Daklea!

Ajo doli në verandë. Në fytyrën e saj, që ishte një fytyrë e zbehtë, por e ngrohtë, fytyrë e një gruaje që kishte mbetur gjithmonë pak fëmijë, u duk një buzëqeshje e turbullt, që e detyroi Mentar Dikën të mendonte se bukuria e Dakleas ishte e fshehtë si e margaritarëve,

7410  
80034



që nuk e shohin kurrë dritën e diellit, sepse guacka që i mban është zhytur në thellësitë e oqeanëve.

— Unë po dal! — dhe tregoi me sy fëmijët.

Te porta e rëndë e vilës ai ktheu kokën prapa, por të shoqen nuk e pa më as të shkallët e verandës, as në dritare. Me të vegjlit për dore, eci përmes varoshit, ku dëgjoheshin këmborët, por edhe dhëmbët e bagëtive që këputnin pupat e barit të përzhitur nga dielli. Atje në fund të varoshit, ku fillonin rrugicat e para të lagjes periferike, zigzaget e të cilave të çonin drejt qendrës së qytetit, Mentar Dika e ktheu sërish kokën prapa, kësaj radhe jo për të parë të shoqen, por vilën, mbeturinat e shtëpisë së vjetër dhe murin që i rrethonte ato. Dhe tek shikonte ato konture të vjetra e të reja, sepse iu kujtua thënia e një shoku: «Kjo vilë e kjo shtëpi gërmadhë sikur janë ndërtuar për luftë!» Dhe vërtet, ato qëndronin mbi varoshet rrotull si luftanijet mbi dallgët e deteve.

Por që të bëhen të tilla, duhen ndrequr të gjitha pjesët e shëmbura të mureve, duhet ndrequr edhe çardaku, që u jep tamam pamjen e një kryqëzori, mendoi ai si me të qeshur dhe përsëri dyshoi, se ky mendim nuk ishte krejt i pavetëdijshëm...

Rrezet e diellit u ranë në sy.

— Leta, hiqe gishtin nga goja! — e qortoi Gimi me tonin e të atit.

— Babi, unë e ushqej me lugë të madhe kukullën, — tha Leta.

— Ajo e ka gojën të vogël, — tha Gimi.

— Sh'dua ta ushqej me lugë të vogël!

— Leta, hiqe gishtin nga goja, — e qortoi i ati.

Leta qau.

— Po qave, babi s'të jep bukë! — e kërcënoi Gimi.

Ajo qau më shumë.

Në qartësinë e drithëruar të mëngjesit, shtëpitë, dyqanet, ndërtesat e tjera kishin zbuluar profilin e tyre të vjetër dhe cipa e pluhurit, që i vishte, i bënte të shëmbëllenin me fytyrën e pudrosur të një plake.

Edhe qyteti N, si të gjitha qytetet e asaj kohe, e kishte qendrën e vet, tek e cila mund të shkoje duke kaluar më



parë nëpër disa rrugë të ngushta e plot zigzage, ndonjëra prej tyre jo fare e ngushtë e jo fare e shtrembër, se qyteti N nuk ishte pa një rrugë të drejtë e pa një rrugë të gjerë). Pastaj do të kaloje nëpër disa sheshe, diku do të dëgjoje edhe muzikën e bakërxhinjve, të kovaçeve e të njëqind zanateve të tjera e, pasi... Më në fund do të arrije qendrën e qytetit, që nuk shquhej gati për asgjë nga shumica e qendrave të qyteteve të tjera.

Edhe Mentar Dika, me dy fëmijët për dore, këtë rrugë ishte duke bërë atë mëngjes korriku.

Në mes të kësaj qendre kishte një rrap të madh e të vjetër me degë shumë, i cili hapej dhe bënte hije si strehë e si çadër. Aty kishte gjallëri, zëra e zhurmë, dyqane të tregtarëve të mëdhenj, kishte edhe çertexhinj, që shitnin mallrat e tyre mbi tezga të hapura, kishte tenda laramane për të mbrojtur vitrinat nga dielli, bakëj me përparëse, që mbanin erë djathë, gjizë, vaj, uthull, piper e turshi dhe prapë britma reklamash, dhe prapë mallra të ekspozuara, nga gjilpërat, te këmborët e bagëtive e deri te stofrat më të shtrenjta angleze. Kishte edhe karroca e të qeshura karrocierësh, zëra të bukur apo të privuar nga çdo emfazë, këngë kafenesh e ç'nuk kishte tjetër në qytetin N, sidomos në qendër e në afërsi të saj. Kishte edhe një shatërvan, nga gurgjet e të cilit rridhte vazhdimisht ujë, se qyteti N ujin e kishte me shumicë, e kishte edhe të mirë, të pastër e të ftohtë. Ndodhte që në këtë shatërvan të notonin rosa e pata, që dilnin nga oborret e shtëpive tërë madhështi e tërë ga-ga-ga, që ecnin ngadalë, me kokën lart e me vështrimin larg dhe nuk ishin ato që u hapnin rrugë kalimtarëve, por ishin kalimtarët, që mënjanoheshin trotuarëve dhe prisnin sa të kalonin zonjat e bardha me patokët e rosakët në krye...

Edhe Mentar Dika me dy fëmijët për dore bëri si të tjerët: u hapi rrugë patave e rosave dhe pastaj shkoi më tej.

Pikërisht në këtë qytet, oriental me truall evropian, një ditë që dëgjuar një zhurmë sa e çuditshme, aq edhe e panjohur, një zhurmë e re ose moderne, siç e kishte



quajtur dikush. U tha se këtë zhurmë, që buronte si nga toka e që ngrihej me zukatje drithërake, e bënte centrali elektrik, instaluar diku në hyrje të qytetit. Megjithatë shtyllat dhe fenerët e vajgurit nuk u hoqën menjëherë, nuk u hoqën as më vonë dhe kjo ka arsyet e veta. Në fillim dritat u vendosën vetëm në ndonjë hotel të ri, në prefekturë, në bashki e në ndonjë zyrë tjetër, te kullat e pashës (që ishte një) e të bejlerëve (që ishin shumë), në shtëpinë e prefektit e në ndonjë dyqan tregtari të madh. Pak më vonë u ngritën ca shtylla dhe u vendosën llamba vetëm në rrugët kresore. Por, megjithëse kishte kaluar më se një vit, qyteti N ndriçohej edhe me central elektrik, edhe me fenerë. Ca thoshin se centrali ishte i vogël, të tjerë thoshin se ishte i... vjetër. Në të vërtetë askush nuk e dinte si ishte ai, por të paktën të gjithë e shikonin se gati tri herë në javë centrali, befas, ndërpriste zukatjen drithërake, hidhte ca fishkëllima të mbytura quf-quf-quf..., të ngjashme me ato të një mëllenje squpverdhë... dhe heshtte. Atëherë pajtimtarët e bashkisë, pasi i kishin lënë një copë herë në errësirë të plotë rrugët kryesore, vraponin për të ndezur fenerët, që ishin vendosur mbi disa shtylla hekuri më të shkurtra se shtyllat e elektrikut.

Edhe atë mëngjes që Mentar Dika ecte me dy fëmijët për dore, dritat elektrike duhej të ishin fikur gjatë natës, sepse jo më kot pajtimtarët vraponin për të shuar fenerët. Pastaj Mentar Dika që i detyruar të shkëputej nga mendimet e veta e të përqendrohej në fjalët e tellallit:

*...Pasi kaluan afatet dhe debitori nuk iu përgjigj pagesës, kreditori, Veniamin Silli Çeku, në bazë të vendimit të dhjetë korrikut një mijë e nëntëqind e njëzet e tetë të kryesisë së përmbarimit të qytetit, nxjerr në ankand për t'u shitur shtëpinë e zotit Iftimi Iftimiut me katër dhoma e një oborr...*

Mentar Dika e dëgjonte me vëmendje të tepruar tellallin (dhe kjo ka arsyet e veta). Gimi, gjithashtu, dëgjonte serioz si i ati, Leta thithte gishtin lll-llu-llu dhe shikonte të atin, si të shikonte majën e një mali. Pastaj u nisën. Mentari i pari, Gimi pas Mentarit, Leta pas Gimit.



## II

Gimi lëvizi një karrige.

— Ulu këtu, babi, — tha ai.

Era e fortë e pilafit i kishte rënë menjëherë në hundë Mentar Dikës. Dhe po atë çast këmbët gati i lëvizën në drejtim të fëmijëve. Uria e kishte thyer, ai ishte gati t'i bindej stomakut për çdo gjë. Të hante një herë, pa le të vdiste pastaj.

— Babi!

— Po, Gimi! — foli ai me gjuhën e trashë e me një zë që i doli çuditërisht i panjohur.

— Hajde këtu, babi!

Por ai nuk lëvizi për aq kohë sa e ndjeu veten të mbërthyer nga kriza e urisë. I kishte ndodhur edhe herë të tjera të pushtohej nga kjo krizë. Dhe si herët e tjera, më në fund, ajo i kaloi dhe tashti ai mund të fliste, mund të dëgjonte, mund të lëvizte. Kur u bind se era e pilafit nuk e turbullonte aq, atëherë ai nisi vështrimin atje ku qëndronte Folta Papi. Folta, që kishte parë të uleshin fëmijët, nuk deshë të shikonte nga Mentar Dika, por me duar të kryqëzuara mbi gjoks, shikonte xhamat e përtej xhamave, rrugën, si të shikonte fundin e botës.

... Këtu e tetë vjet më parë Folta Papit i vdiq i shoqi, duke e lënë me dy djem, njërin gjashtëmbëdhjetë vjeç (Kristin), tjetrin dymbëdhjetë (Kolën). Pas varrimit e pas të gjitha zakoneve të tjera të vdekjes, në mëngjesin e ditës së katërt doli nga shtëpia dhe, duke befasuar e çuditur një botë të tërë, çeli restorantin e vogël. Folta Papi ishte akçeshë e zonja, po aq sa kishte qenë akçi i shoqi. Kështu, restoranti me pesë tavolina nuk u mbyll dhe myshterinjtë nuk u larguan. Kjo ndodhi kur Folta kishte mbushur të pesëdhjetat. E gjatë, e drejtë, e veshur gjithmonë me të zeza, me fytyrën të bardhë, ku shquheshin akoma shenjat e një bukurie të dikurshme, ajo njihej në tërë qytetin si



një grua e ashpër, me sjellje prej burri, e ngrysur dhe e zhytur në punët e në mendimet e veta. E tillë ishte edhe atë mëngjes dhe ja pse Mentar Dika nuk deshi të çapitej, para se të shikonte nga ajo, para se të kuptonte gjendjen e saj shpirtërore. Ç'është e vërteta, ai nuk e kishte pasur ndër mend të kthehej aty, po fëmijët, me të parë restorantin e vogël, vrapuan dhe u ulën në tavolinën më të afërt.

Meqë Folta s'kishte ndër mend ta hiqte vështrimin nga xhamat (nga fundi i botës) e meqë fëmijët e shikonin Mentarin në sy, duke treguar se po e humbisnin durimin, më në fund ai lëvizi këmbët. Edhe mënyra e të ecurit mbi rrasat prej guri, si të kishte përpara një pengesë të pakapërcyeshme, të cilën e shikonin vetëm sytë e tij, tregonte qartë se ai ishte nën pushtetin e dyshimeve e të dyzimeve të shumta. Ishte pikërisht kjo gjendje e papërcaktuar që e tregonte Mentar Dikën më të vrarë e më të madh për të tridhjetë e pesë vjetët që kishte, por edhe më të pavendosur e më të lëkundur.

— Ulu, babi, — tha prapë Gimi dhe, nga gëzimi se ishte afruar çasti që do të hanin, fërkoj duart si një i madh.

Mentar Dika u ul. Por, si më parë, pamja dhe qëndrimi i tij lëkundeshin e ngurronin. Tashti e tërë qenia i qe bërë e pandjeshme ndaj gjithë atyre erëzave të këndshme gjellësh që ngriheshin nga tenxheret. Befas dëgjoi hapat e Foltës prapa kurrizit. Ndjeu edhe heshtjen e saj fare pranë. Ngriti kokën. Atëherë sytë e tij të kaltër të çelët, si uji i një cekëtine u fundosën në vështrimin e ashpër, gati të egër të asaj gruaje, fytyra e së cilës iu duk sikur kishte marrë pamjen e gjellëve, formën e tenxhereve, erën e beharnave. U vështruan një çast dhe ai çast i vetëm, ai vështrim i vetëm sikur qenë mjaft për të kuptuar nga njëri-tjetri diçka më shumë se ajo që dukej në sipërfaqe, diçka tjetër, akoma të padukshme, që endej diku në thellësi të qenies së tyre.

— Oj prapë! — u çudit Folta Papi. Zërin ajo e kishte si trupin, të fortë, e kishte bas, po sado të fortë e sado bas, fundja, zë gruaje ishte.



— Prapë — tha Mentar Dika me inat të përmbajtur dhe, si u kujtua se Folta Papi nuk i kishte asnjë faj, u mundua t'i buzëqeshte, por kjo mbeti vetëm një përpyekje, sepse fytyra e tij e ftohtë, si e ngrirë, pak thatime e pak e verdhë dhe e dobësuar, e re akoma, por e çarë nga rrudha të holla, që i mblidheshin xhufkë në cepat e syve, sikur ishte aty për të dëshmuar se buzëqeshja që bërë gati e huaj për të.

Ky shkëmbim i kursyer fjalësh, sikur e kishte futur në mendime Folta Papin, po megjithatë ajo vazhdonte të ishte e ashpër si një mbretëreshë në poltronën e vet.

— Zoti Mentar, si kështu, në asnjë punë nuk duan të të pranojnë? — pyeti basi i Foltës.

— Në asnjë!

— Të zësh një punë private, zoti Mentar. Ti mund të ndreqësh topa, e pse të mos ndreqësh mullinj kafeje, ta zëmë?

— As punë si argat nuk ka! — i ra shkurt ai.

Mentar Dika kishte ulur prapë kokën dhe sytë. Ai shikonte diku poshtë këmbëve të veta, sikur kjo të ishte diçka krejt e domosdoshme dhe e pashmangshme. Por atë çast ndjeu një dhimbje të lehtë koke, ose më mirë të themi, pati vetëm një parandjenjë, se dhimbja do t'i vinte paretjetër dhe këtë ai e kuptonte nga pesha e akullt që po i rëndonte qepallat.

Fëmijët, që ishin tepër të uritur, shikonin herë të atin, herë Foltën (kur shikonin Foltën, pamja e tyre të kujtonte harabelat e trembur) dhe prisnin me gojë gjysmë të hapur, thujse ishin gati të qanin, gati të thërritnin, se nuk ishin ulur aty për të dëgjuar fjalë e biseda, po për të ngrënë.

Pas pak në restorantin e vogël u dëgjuan hapat e rëndë të Foltës, që largoheshin me një trokëllimë të çartallosur. Ajo u kishte vënë këpucëve pafta hekuri — dhe ato, të çliruara, cingërinin si potkonjtë e Hanës që tërhiqte karrocën e bashkisë.

Pastaj Folta qëndroi prapa tenxhereve, ashtu siç dinte të qëndronte ajo: e gjatë, e drejtë, e bardhë, e zezë. Kry-



qëzoi duart në gjoks, ngriti sytë dhe i hodhi në rrugë, si t'i hidhte në fund të botës.

Mentar Dika, tashmë i dorëzuar, priste që fëmijët të shqiptonin sërish po atë fjalë, fjalën bukë, së cilës ai i qe trembur që në mëngjes.

Befas, Folta Papi zuri dy pjata menjëherë, ngriti kapakun e një tenxhereje dhe filloi t'i mbushte me pilaf. Lëvizjet e saj ishin aq të pavullnetshme, të paurdhëruara, thujse, ashtu siç i kishte kapur dhe mbushur pjatat, ashtu do t'i zbraste e do t'i përmbyste në vendin e tyre. Por jo. Hapat — potkonjtë e çliruar të Hanës — cingërinë mbi rrasat e restorantit dhe pas pak dy të vegjlit, pa thënë asnjë fjalë, kërrusën kokat e zunë të hanin. Tashti ata hanin në mënyrë fare të zakonshme, pa pasthirrma, pa shprehur gëzim ose shqetësim. Hanin. Veç hanin shpejt. Gimi qëndronte si një i madh. Aq ishte dobësuar, sa kur përtypej i lëviznin veshët. Kur kishte mbaruar gjysmën e pjatës, u kujtua për të atin dhe pyeti:

— Babi, po ti pse nuk ha?

Pamja e Mentarit, që ishte tepër e përhumbur, sikur u përqendrua. Tha me buzët e çara:

— Më vonë! — dhe aty për aty ia pati qejfi të mendonte se ndoshta nuk ishte e vërtetë që së shpejti mund t'i fillonte dhimbja e kokës.

Pa mbaruar mirë këtë mendim, Mentar Dika ndjeu prapa kurrizit hijen e rëndë e të gjatë të Folta Papit. Kur ajo i vuri përpara pjatën, ai pati një të dridhur, i dha trupit prapa, sikur në pjatë të mos kishte pilaf, por gjarpër me helm.

Tha Folta:

— Ti, çfarë?

— Jo... asgjë! — tha Mentar Dika. — Nuk më hahet... nuk kam...

— E di, — tha Folta dhe i vuri lugën në anë të pjatës. — Paratë më vonë. Tashti ha, — dhe e shtrëngoi në bërryl si nënë e si motër e madhe, kurse fëmijëve u hodhi një vështrim të ngrohtë.

Mentar Dika ngriti kokën ngadalë, ngriti edhe qepallat aq sa iu desh ta shikonte Foltën në sytë e zez. Prapë ndjeu afërsi dhe pyeti:

— Ç'ka ndonjë lajm nga Kristi?

— Si ushtarët, — tha ajo. — Pas gjashtë muajsh lirohet dhe...

— Dhe?

— S'di ku do të punojë Kristi im kur të lirohet!

— Ai sikur punonte me ty në restorant?

— Kam frikë për Kristin!

— Ç'frikë?

— Nuk e ka me qejf restorantin, — tha ajo. — Nuk ka me qejf asnjë lloj pune. Nuk përmblihet!

— Them se, kur të kthehet nga ushtria, do të përmblihet!

Folta u mbush me frymë. Me këtë frymëmarrje ajo plotësoi shqetësimin dhe mallin që kishte për Kristin. Tha:

— Djalin e dytë, Kolën e kam të urtë. Pa mbushur mirë njëzet vjeç, ka zënë të bëjë mure!

Kur Folta u kthye në vendin e saj pas banakut, Mentari Dika qëndroi gjatë në heshtje, pa e shikuar pjatën, pa e prekur lugën me dorë. Pastaj tha:

— Po ti, Gimi, do edhe pak pilaf? — I hodhi dy lugë. Edhe dy lugë të tjera Letës. — Si the, ti, Gimi, do edhe një lugë? — I hodhi edhe dy të tjera. Shikoi nga Leta. — Edhe ti, Leta. — Me duart që i dridheshin paksa, mbushi për vete një gotë ujë dhe e piu deri në fund. Pastaj hëngri dy lugët e fundit që i mbetën dhe po bëhej gati të ngrihej, kur mbi kokë ndjeu sërish hijen e gjatë e të rëndë të Folta Papit, e cila as e shikoi as i tha gjë, por i vuri përpara një pjatë tjetër me pilaf.

Pas disa minutash zëri i Gimit tingëlloi i gëzuar:

— Babi, ne mbaruam! — Tashti ai rrinte prapë si i madh. Veshët e tij nuk lëviznin më.

Leta zuri t'i binte pjatës me lugë dhe këndoi e lum-



tur. Ajo këndoi për një flutur, për mamin, për një kec... për kecin e xha Telit që kishin në shtëpi.

Pastaj të vegjlit u ngritën.

Si në fillim, Folta dhe Mentari fundosën shikimin në sytë e njëri-tjetrit. Folta s'kishte shkollë, ajo s'dinte të shkruante, s'kishte as laps as fletore, po kishte një teleshir, kishte dhe një copë dërrasë. Mentari Dika priti që ajo të kapte teleshirin e të hiqte vizat, siç kishte bërë dy javë më parë, po në vend që të bënte këtë, ajo i foli me zë konspirativ:

— Kujdes, zoti Mentari. Që kur u hyri miza për ta bërë Shqipërinë me mbret, lajthitën fare, si Murroja! — Tha prapë: — Do të të ndihmoja më shumë, po kjo krizë i bën njerëzit të skuqen në fytyrë. Megjithatë, kur ta kesh pisk, fëmijët m'i dërgo këtu. Dhe mos të të vijë keq për plaçkat, shit aq sa të jetë e nevojshme, aq sa të kapërcesh lumin!

— E çojmë si e çojmë, — tha ai. — Gjithmonë bëhet shkak diçka, që të mos vdesim nga uria!

Me gjithë hutimin e lehtë, që nuk i ishte ndarë ditët e fundit, Mentari Dika vuri re se tashti Folta nuk qëndronte më e ngrirë para tij, si në fillim, dhe kjo gjë i pëlqeu. Por kjo nuk ia lehtësoi aspak ndjesinë se së shpejti do t'i fillonte dhimbja e kokës. Ai u përpoq të mendonte për diçka tjetër, më shpresëdhënëse e më të gëzuar, u përpoq t'i bënte qejfin vetes se ndoshta atë ditë do të kishte fat më shumë se ditët e tjera, mund të gjente edhe ndonjë punë, po të gjitha këto mendime e këto dëshira sikur ia forcuan ndjesinë për dhimbjen e kokës, ose të paktën e bënë të provonte shenjat e para të saj, e cila zakonisht i fillonte prapa, pastaj i pushtonte ballin, derisa ia kthente qepallat në dy copa akulli.

Fëmijët dolën me zhurmë në trotuar dhe pritën të atin që t'i merrte për dore. Kurse Folta u ngul pas banakut të tenxhereve, ku zienin gjellët e drekës, kryqëzoi duart mbi gjoks dhe hodhi sytë në rrugë...



### III

Hasan Manga ngriti kokën që, duke e pasur tepër të madhe, tepër të rëndë e të palëvizshme, të kujtonte kokën e një hyjnie të lashtë. Prej hyjnie të lashtë ishte edhe pamja e tij me atë fytyrë kockë-gjerë, me mollëza të dala, me mjekër të rregullt e me sy të thellë, gati të padukshëm, që premtonin urtësi dhe paqe të përjetshme. Por, me të ngritur vështrimin drejt Mentar Dikës, sytë i morën një shkëlqim të sëmurë, pikërisht atë shprehje të zbrazët e të lëngëzuar, që është karakteristike për qentë e plakur, ndërsa e tërë fizionomia e tij të dukej sikur ndodhej aty për të dëshmuar lodhjen e brendshme dhe madhësh-tinë e jashtme të rendit të vjetër, gjë që e nxiti Mentar Dikën ta krahasonte me një ndërtesë bosh, të vjetër, gati në të shembur. Me sytë e plakur, Hasan Manga e vësh-troi tjetrin një copë herë, ashtu siç mund të vështrojmë një njeri që na bëhet se dikur e kemi njohur, diku jemi ndeshur a takuar me të...

— Hasan efendi, eja në vete! — thoshte njëri nga burrat, i zhytur deri në gjunjë në rremën e ujit. Pranë tij qëndronin nja pesë fshatarë të tjerë, edhe ata me kazma e lopata në duar.

Aty përballë qëndronte Hasan Manga, veshur me kostum veror e me kësulë, që në dritën e zbehtë të hënës së prerë dukej si njollë e zezë, e madhe, se të mëdha ishin edhe koka, edhe kësula e Hasan Mangës. Ai bëri një shenjë në drejtim të qehallarëve që e rrethonin dhe ata hoqën pushkët nga supi, kurse fshatarët ngritën kazmat e lopatat.

— Eja në vete, Hasan efendi! — thirri ai me këmbët e zhytyra në ujë.

— Kjo rremë është pronë e pashës! — tha Hasan Manga.



— Le të vijë vetë pasha këtu të bisedojmë! — tha ai me këmbët në ujë.

— S'të mjaftoj unë, i dërguari i tij? — briti Hasan Manga me një zë që kishte jehonë këmbore. — S'të mjafton që këtë rremë e ka hapur pasha?!

— Por me krahët e këtyrë! — foli nga bregu tjetër i rremës Mentar Dika. Ai dhe ushtarët prapa tij mezi mbusheshin me frymë; për të arritur në kohë ata kishin arritur deri aty gati me vrap.

Kësula e madhe dhe e zezë e Hasan Mangës lëvizti nëpër errësirën e pikuar me argjendin e zbehtë të hënës dhe, kur pupëza e saj qe kthyer përballë Mentarit, atëherë pyeti:

— Kush je ti?

— S'ka rëndësi kush jam unë! — tha Mentar Dika.

— Për një vijë uji kërkon të na marrë të tretën! — tha një fshatar.

— Ose dy mexhite për çdo dynym! — tha një tjetër.

— Mua ma ka prerë fare! — tha një i tretë. — Po më thahet misri.

Mentar Dika (nga bregu tjetër):

— Do t'i thuash pashës, se iku koha e feudalizmës. Ne nuk luftuam që ai të shtypë e të shfrytëzojë fshatarët si më parë.

— Edhe ti, more djalë...

— S'jam djalë, por oficer i Revolucionit Demokratik! Ra një heshtje.

— Më ngadalë, politikanët nuk rrëmbehen! — Në zërin prej këmbore të Hasan Mangës kishte tingëlluar një optimizëm i verbër, që kishte vazhduar deri në fund të atij debati.

— Zonjës së pashës i hahet vetëm mish berri! — tha fshatari i parë me këmbët në ujë. — Po kur ne i dhamë mish pule, ajo tha se ne bejlerët e pashallarët, që ju kemi shtypur me qindra vjet, prapëseprapë po ne do t'ju shtypim.

— S'është e udhës të merreni këtu me zonjën e pashës! — tha Hasan Manga.

Mentar Dika (nga bregu tjetër):

— Duhet ta keni të qartë se të drejtat tuaja morën fund që në qershor të këtij viti. Po kështu edhe të drejtat e ujit. Secili mund të njomë me radhë arat e mbjella pa ndonjë shpërblim.

Hasan Manga (nga bregu tjetër):

— Më thuaj, zoti oficer, rastësisht u ndodhët këtu? — pyeti ai me zërin e këmborës dhe me sytë tek ushtarët.

— Jo! — tha Mentari Dika. — Erdha për të të thënë të kthehesh menjëherë dhe, po nuk u binde, do të të procedoj!

Pas dy minutash Hasan Manga bashkë me qehallarët u kishin hipur kuajve dhe potkonjtë rrahën tokën e tharë tutje në errësirat e natës...

Për një çast sytë e Hasan Mangës u larguan nga fytyra e Mentari Dikës. Ai pyeti me zërin që pas katër vjetësh e kishte humbur tingullin e këmborës e që tashti gërvishte si teli i një violine në një dorë të pastërvitur:

— Kush je?

— Mentari Dika!

Hasan Manga tundi kokën (bashkë me të iu tundën edhe palat e gushës) dhe ngriti sytë në tavan. Me këtë qëndrim ai të linte përshtypjen se u përkiste atyre njerëzve që vuajnë vazhdimisht nga mania sikur orë e çast kanë lënë diçka mangët, sikur kanë harruar një gjë që s'duhej ta harronin, por që nuk u kujtohet kurrë, sado që përpigën e sado që vrasin mendjen nga mëngjesi në mbrëmje e nga dita në ditë.

— Mentari Dika, ë-ë-ë! — tha ai.

Sytë e Hasan Mangës vazhdonin të shikonin tavanin. Befas sikur u qartësuan dhe ai recitoi me shpoti të dukshme:

*«Trim tribun i vegjëlisë.. tmerr, panik i mizorisë!*

Mentari Dikës iu bë sikur katër vjetët nuk kishin kaluar, por qenë kthyer dhe ashtu, të kthyer prapë, zgjatnin gjymtyrët për ta zënë për gryke.

— T'i biem shkurt, zoti Dika. Për ty s'ka punë. S'ka es'do të ketë kurrë! — Mentari Dikës i bëri përshtypje e folura e tjetrit me buzët gati të mbyllura dhe po atë



përshtypje i bëri edhe valëvitja e palave të gushës, si t'i qenë varur në to aksionet e sipërmarrjet e shumta që ai kishte kudo. Tha prapë: — As mos të të mbetet peng që u takove me mua. Edhe sekretari im këtë përgjigje do të të jepte. E shikon këtë listë? Emri yt është i pari, i dënuar me papunësi!

Mentar Dika nuk shikoi nga lista. Tashti në objekti-  
vin e syve të tij kishin rënë ca miza dheu këmbëgjata  
e me gunga, që ecnin nëpër parvazin e dritares prapa  
shpatullave të Hasan Mangës, si një varg beduinësh dhe  
gamilesh në shkretëtirat arabike. Hasan Manga priti më  
kot që Mentar Dika të shikonte listën. Më në fund, i  
pakënaqur, e vendosi atë në cep të tavolinës. Me gjithë  
përpjekjen që bëri, dora e tij e madhe e leshtore u drodh,  
lista u drodh, dhe karrigia rënkoj.

— Mirë që je gjallë, — tha ai. — Mirë që i shpëtove  
hakmarrjes sonë. Pam, Bajram Currit në Shpellën e Dra-  
gobisë. E ndërta Gurakuqi, *Vigan liberatori*, hante plum-  
bin në Bari nga hasmi i vet, presidenti ynë shpartallonte  
me dorë të sigurt folenë e komunizmit në zemër të Tiranës.  
Dhe pas gjithë këtyre ndodhive, me keqardhje ne vëmë  
re se ti s'ke vënë fare mend. Gjashtë muaj pasi të kemi  
amnistuar, koha na dha një mësim të mirë. Sjellja dhe qën-  
drimi yt na treguan se paskemi qenë të butë, se paskemi  
pasë zënë të flinim mbi dafina! — Befas sytë e plakur të  
Hasan Mangës u ndezën nga një flakë e re zemërimi, rru-  
dhat iu bënë më të thella, buzët e varura iu mblodhën dhe  
tashti koka e tij e madhe në vend që të të kujtonte hyjninë  
e lashtë, që kthyer në parodi të saj, e ngjashme me një  
vare të rëndë.

Mentar Dikës, padashur, iu përzie në stomak. Kjo u  
bë shkak që t'i kujtonte edhe goditjet e para të dhimbjes  
prapa kokës, ndonëse akoma të dobëta.

— Një takam njerëzish i prishi shija e keqe. Ajo i  
çoi në rrugë të shtrembër e në krim. Ajo i bëri përkra-  
hës të reformave, i ngriti kundër së drejtës së pronës.  
I bëri të rrezikshëm. Njerëzit si ti nuk pranuan të fute-  
shin të paktën në Partinë Nacional-Demokrate, as në  
Partinë Radikal-Demokrate, të cilat dita-ditës po afro-



heshin me zotërit e tokës dhe po i kthenin kurrizin fantazmës, që erdhi në fuqi pas shpatullave të njëfarë biçimsëzi të quajtur Fan Noli. Shumë nga ju i qëndruan besnikë organizatës «Bashkimi», luftuan në Berat kundër formimit të Partisë Liberale dhe, si skllëvër të opingës, e nisën luftën kundër qeverisë së tokës me batalionin e vullnetarëve të «Bashkimit» nga Vlora, derisa u futën në Tiranë në atë qershor të zi të vitit një mijë e nëntëqind e njëzet e katër.

...Nga larg Tirana dukej e gjelbër, e qetë dhe e fjetur, sikur ajo luftë që bëhej në kodra të mos kishte fare lidhje me fatin e saj. Nëntoger Mentar Dika vraponte në krye të kompanisë së vet, pa e zbratur pushkën.

— Shtjer! — i tha shoku.

Forcat qeveritare, që komandoheshin nga Ahmet Zogu, kishin zënë të zbrapseshin. Tirana e qeverisë feudale po dorëzohej. Ishin minutat e fundit, ishin çastet e fundit të fitores së kryengritësve, po Mentar Dika ecte drejt armikut, pa e zbratur pushkën dhe të dukej sikur diçka përpiqej të përgjonte në rrëmujën e luftës.

— Shtjer! — i përsëriti shoku. — Mos kërkon të vdesësh kot?

Mentar Dika vrapoi aty ku dëgjohej një e qarë e çuditshme. Pranë një kaçubeje ai pa të shtrirë e të gjakosur një fshatar, pranë fshatarit një teke që mbushej nga gryka dhe më pranë një fëmijë dhjetë e dymbëdhjetëvjeçar, që qante dhe i lutej të atit të ngrihej, i lutej të ecte edhe pak, Tirana ishte afër. I ati, një fshatar akoma i ri, i parruar e tërë arna, i thoshte të birit të mos qante, përpiqej ta qetësonte me krahun e shëndoshë dhe prapë i thoshte të mos qante, por ai qante me një vaj të ngjeshur, që s'njihte të çara e që ndilte trishtim e shqetësim.

— Mos qaj, — iu lut edhe Mentari djalit të vogël.

Ai, me ta parë, e zuri Mentar Dikën nga cepi i xhaketës dhe i tha:

— Ngrije tatën! Ne duhet të shkojmë të parët në Tiranë. Kështu thoshte tata, të parët. Po të vonohemi, tapitë ndahen dhe mbetemi pa tokë. Kështu thoshte tata!



Mentar Dika e shikoi të voglin me vëmendje dhe vu-ri re se fytyra e tij ishte plakur para kohe.

— Mos qaj, në për tokën luftojmë! — tha Mentari Dika.

Fshatari i ri, me sytë në agoni, ngriti njërën dorë, të shëndoshën, e shtrëngoi paksa në krah Mentari Dikën dhe vdiq. I vogli nisi përsëri vajin e tij të ngjeshur, pa të çara...

— Kush qan? — briti Hasan Manga. Për herë të parë u ngrit në këmbë, hapi derën dhe shikoi i mërzhitur njerëzit që prisnin jashtë. Të largohen këta fëmijë!

Mentari Dika, që s'ishte shkëputur akoma tërësisht nga skena e vdekjes së fshatarit të ri dhe nga e qara e dy-mbëdhjetëvjeçarit, ndërhyri pikërisht në çastin e fundit:

— Janë fëmijët e mi!

Vetëm kur shqiptoi këto fjalë, ai ndjeu dhe kuptoi se nuk kishte folur, po gati kishte shtirë, gati kishte zbratur një revole mu aty në zyrat e drejtorisë së shoqërisë SITA. Ndërsa vaji i Letës, që ndoshta qante për të pestën herë atë paradite, e nxiste Mentari Dikën të bënte diçka që të mos ishte e zakonshme. Ai tashti nuk e dinte, në kishte kujtuar më parë vajin e djalit në kodrat e Tiranës, apo ishte e qara e Letës, që e kishte kthyer në ato vite të kaluara.

— Janë fëmijët e mi! — briti sërish Mentari Dika, duke ndier t'i ftohej fytyra e t'i mpiksej gjaku. Ai desh ta zbuste pak zemërimin, po sa më shumë që bënte përpjekje, aq më shumë i mpiksej gjaku. Përballë Mentari Dikës, jo më pak i çuditur dhe jo më pak i hakërryer, qëndronte Hasan Manga, tashti jo si një ndërtesë e vjetër, boshe e gati në të shembur, po si një mal i lashtë, i gërryer nga koha e nga ujërat, i rënduar dhe i sfilitur, por akoma i fortë dhe masiv. As koka e madhe e hyjnisë, as buzët e mbyllura shpotitëse, as sytë e thellë e befasi të ndezur nuk bënë lëvizjen më të vogël. Pastaj dy burrat hodhën vështrimin ngadalë rreth e rrotull, derisa sytë e tyre u takuan si dy projektore në qiell. Një çast më vonë Mentari Dika u kthye nga të vegjlit dhe pyeti:



— Gimi, çfarë i bëre?  
— Asgjë, babi. I thashë të vërtetën!  
— Ç'të vërtetë?  
— Sot që hëngre mëngjes, i thashë, nuk do të hash drekë!

Gjatë bisedës së Mentarit me Gimin, Leta e kishte ulur plot një oktavë timbrin e vajit. Kështu edhe qante, edhe dëgjonte.

— Leta, pusho, babi do të të japë të hash edhe drekë!  
— tha Mentari.

Vaji i Letës u kthye në ngashërime të mbytura, po shpatullat e saj vazhdonin të dridheshin si më parë. Futi gishtin në gojë dhe shikoi të atin, si të shikonte majën e një mali.

— Tashti shkoni në shtëpi, — u tha Mentari.

Të tjerët, gati njëzet veta, të rinj, burra e pleq, që prisnin në heshtje përpara derës, që pinin duhan, që ecnin lart e poshtë, gjatë kësaj skene — skenës së Hasan Mangës me Mentari Dikën dhe këtij të fundit me fëmijët — kishin ngrirë aty si korale në një det me dallgë, në pozicione të ndryshme, me gjatësi e madhësi të ndryshme. Ata lëvizën dhe morën jetë vetëm kur Hasan Manga u zhduk prapa derës.

— Hë-ë-ë, kështu pra! — tha si me vete Hasan Manga, që ishte kthyer ngadalë në vendin e vet: — Kështu, pra-a-a! — Ai ngriti ngadalë qepallat e kuqe për të parë Mentari Dikën. Pamja e tij, ndonëse e lodhur dhe e drobitur për jetë, ishte e kënaqur.

— Fëmijët!.. Fëmijët!... — Tha prapë: — Nuk të kuptoj ç'njeri je. Është krim të mos bësh fëmijë, por është më krim t'i bësh e të mos dish t'i rritësh, ose t'i rritësh të mjerë. E ke menduar ç'fat i pret me një baba të tillë?... E pse, mos shpreson ti se do të të ndihmojë ndokush? Askush, mori fund zemërgjerësia ndaj armiqtve të qeverisë sonë. Morën fund të gjitha! Ka mbetur vetëm një gjë që mund të të ndihmojë: të nënshkruash një deklaratë, ku të thuash se Revolucioni i Vitit Një mijë e Nëntëqind e Njëzet e Katër ishte një gabim i rëndë i të gjithë atyre që e përkrahën. Do të shkruash gjithashtu se gjatë këtyre



katër vjetve, Republika Shqiptare, me president shkëlqesinë e tij Ahmet Zogun, ka kryer vepra të mëdha për lavdinë e Shqipërisë. Vetëm atëherë do të mund të gjesh jo vetëm punë, por ndoshta do të fitosh përsëri kapelën, çizmet, dorezat, tokëzën dhe këmbaçin e oficerit. Kësaj radhe kapiten. Mundet edhe major. — Pas një heshtjeje të shkurtër, aq sa iu desh të mbushte me frymë mushkëritë e lodhura, Hasan Manga vazhdoi: — Ne i japim rëndësi deklaratës sate. Ti je djali i një patrioti të njohur.

Mentar Dika heshtte. Ai ishte mësuar të heshtte prej vitesh. Dhe padashur sytë e tij shikonin përsëri varganin e mizave në parvazin e dritares — gamilet dhe beduinët në shkretëtirat arabike — që s'dihej për ç'arsye ishin shqetësuar, kishin shpejtuar hapin, duke krijuar rrëmujë në ecejakun e tyre përballë njëra-tjetrës.

— Unë të këshilloj që ta shkruash sa më shpejt deklaratën e pendimit. Kjo është një detyrë që të përket ta bësh ti dhe është një shërbim që i bën vetes. Ti e di fare mirë që s'je i vetëm në këtë rrugë. Sa oficerë, pikërisht nga ata që, për fat të keq, u bënë me revolucionin, jo më vonë se pas gjashtë muajsh, domethënë ditën e përmbysjes së Nolit, e pritën Zogun me dashamirësi në Priskë e në Tiranë dhe u vunë përsëri në shërbim të tij.

Pas këtyre fjalëve Hasan Manga kishte heshtur. Sytë e tij kishin filluar të dyshonin se tjetri nuk do të pranonte, nuk do t'i nënshtrohej dëshirës së tyre. Kurse Mentari Dika, nga ana e tij, sa herë që e kuptonte se të tjerët ia kishin marrë mendimin para se ta thoshte vetë, fitonte një qetësi të patundur dhe këtë e shprehte duke lëmuar mustaqet e shkurtra me pulpat e gishtave. Po kishte ardhur çasti të fliste.

— Pra, Hasan efendi, ju doni që unë të nënshkruaj një deklaratë në shtyp?! — pyeti Mentari Dika me një zë fals, pak të hollë e pak qesharak, me zë ironizues, por tepër të maskuar.

— Po, — tha Hasan Manga me seriozitet.

— Jo, një deklaratë të tillë unë nuk do ta nënshkruaj kurrë! — Kësaj radhe ai kishte folur me zërin e tij të natyreshëm.



Pas kësaj përgjigjeje, aty përpara Mentar Dikës, figura e Hasan Mangës zuri të shfryhej, siç shfryhet një tollombace fëmijësh. Dhe kjo ndodhte se ishte plak i sflitur Hasan Manga; se i gjithë ky takim dhe përfundimi i tij negativ e kishte lodhur së tepërmi; se tendosja kishte qenë e madhe. Tashti ai jetonte fazën e dobësimit të mëtejshëm të reflekseve, e dobësimit të mëtejshëm të ndjeshmërisë. Mentar Dika vuri re se shqisat e Hasan Mangës po e humbisnin komunikimin, ato po jetonin më vete, të parura, secila nga ato kishte filluar të mbyllej në guackën e agonisë. Por, si t'i trembej pikërisht agonisë, Hasan Manga shpejtoi e tha:

— Nuk të kuptoj ç'njeri je!

Mentar Dika e shikoi me ngulm Hasan Mangën dhe sytë e tij të kaltër e të ngrysur u dukën si dy thika të drejtuara në ballin e tjetrit.

— Të ka mbetur edhe një shans për të dalë nga fatkeqësia!

— Çfarë shansi? — pyeti Mentar Dika, por s'qe nevoja të priste përgjigje, sepse Hasan Manga kishte nxjerrë nga sirtari një gazetë të Revolucionit, e kishte vënë në cep të tavolinës dhe tha:

— Lexoje këtë!

Duke ndier bredhërimën e mornicave të ftohta nëpër trup, ai njohu letrën e hapur që i kishte dërguar Qeverisë Demokratike të Fan Nolit katër vjet më parë e që ishte botuar në gazetën e qytetit N. Gazeta ishte zhubrosur. por nuk ishte grisur.

— Pse duhet ta lexoj pikërisht unë? — pyeti duke shikuar jo atë, po gazetën.

— Lexoje, pastaj të them! — foli me pamje të zbutur Hasan Manga. — Por lexoje me zë, se dua ta dëgjoj edhe një herë!

Ndoshta pas një minute ose më pak se një minutë, Mentar Dika mundi ta mblidhte veten e të fshihte shqetësimin e turbullimin që i kishte shkaktuar kërkesa e Hasan Mangës. Për t'u treguar gjakftohtë e për të mos lënë asnjë dyshim, ai ngriti gazetën dhe lexoi:



Nuk kuptohet, përse duhet të rrimë me duar të kryqëzuara. Pika e parë e programit të qeverisë mbi spastrimin e nëpunësve nuk ka filluar të zbatohet akoma. Duhet ditur se këtu, prej shërbëtorit e pasvanit e deri te nëpunësi më i lartë, kanë qenë gati të gjithë në dispozicion të urdhrit të bejlerëve, të pashallarëve e të njerëzve të tyre. Pse Hasan Manga, që ishte krahu i djathtë i pashës dhe i partizanëve të Ahmet Zogut, është lënë i lirë? Mos po shkon prapë favoritizma? Prapë duhet t'i lemë të lirë këta shkaktarë të vëllavrasjes dhe armiq të demokracisë? Tre muaj pas Revolucionit kombëtar, që fshiu qeverinë feudale, filizat e hidhur po rriten prapë si hitrat. Ç'bën guvernata? Pse nuk i realizon principet ideale dhe sociale që çuan në këmbë popullin? Pse ka mbetur në mes të rrugës?

Përse nuk e zbatojmë programin demokratik qeveritar për çrrënjosjen e feudalizmit? Çrrënjosja e feudalizmit është një konditë themelore për qytetërimin e Shqipërisë. Klasa e feudalëve s'ka të drejtë të rrojë më. Në të kundërtën, do të kryejmë një krim të rëndë ndaj historisë shqiptare. Nuk kanë kaluar veçse pak muaj pas fitores së kryengritjes dhe në rrethet e ndryshme filiuat të dëgjohen fjalët «legalitet», «oportunizëm politik», të cilat kanë një tingëllim të çuditshëm pas mundit e gjakut që derdhi populli. Pashallarët e bejlerët vazhdojnë të kërkojnë punë angari nga fshatarët, të mbajnë si pronë të tyre vijat e ujit etj., ndërsa tregtarët e dhjetarët nxjerrin fitime në kurriz të popullit.

Mblidhen nënshkrime dhe i bëhet telegram qeverisë për t'iu lutur që Tajar bej Toja të mbetet prefekt i qytetit tonë. Pse vallë përkrahësit e feudalizmit dhe pseudodemokratët duan ta mbajnë prefekt Tajar bej Tojen? Qeveria kombëtare e



dalë nga gjiri i nacionalizmës demokrate, duhet ta zbatojë vendimin e dhënë dhe të mos merret me këso kërkesash të pavend e të palogjikshme. Jemi të mendimit t'i pritët rruga invazionit të nëpunësve me porosi në xhep, siç ndodhte në kohët e mallkuara të qeverisë feudale e tradhtarë. E vërteta është se të gjitha degët e administratës sonë kanë nevojë për ndërrime radikale dhe këto ndërrime duhen bërë pa vonësë, sistematikisht, por në luftë kundër akraallëkut dhe abuzimeve. Pse u jepet bursë për jashtë shtetit djemve të dy të pasurve? Njëri ka blerë një çiflig dy mijë napolona, tjetri është me çiflig e ka dy rroga me të birin. Edhe sa kohë do të vazhdojmë me miqësira e tarafe s'i në kohën e Zogollit, që sot shëtit me automobil në Evropë dhe armatoset nga guvernat e huaja?...

Mentar Dikës i kujtohej se paragrafin e fundit për studentët e për Ahmet Zogollin ia kishte thënë Daklea. I kujtohej gjithashtu se të nesërmen e botimit të kësaj letre Hasan Manga kishte trokitur në redaksinë e qytetit N, ku u ndodh rastësisht edhe Mentari. Ky zotëri, i veshur gjithmonë me kostum të çelur veror, duke u përpjekur të tregohej tepër i arsyeshëm, deshi të dinte se kush fshihej pas pseudonimit «Topi» dhe, kur nuk e mësoi dot se kush ishte letërshkruesi, këshilloi me tonin e tij të arsyeshëm:

— Vërinë gishtin kokës, mos bëni zullume!

Mentar Dika nuk e kishte lëshuar akoma gazetën nga duart, kur dëgjoi zërin lutës të Hasan Mangës:

— Po të më gjesh kush e ka shkruar këtë letër, menjëherë do të të siguroj një punë të mirë!

Në çastin e parë Mentari Dika, i përfshirë nga zemërimi e nga sedra e luftëtarit të vitit 1924, mendoi t'i tregonte të vërtetën. Po befas u përmbajt: ai kishte parë kokën e rëndë të Hasan Mangës, që s'te kujtonte më thjeshtë kokën e madhe të një hyjnie të lashtë, por kokën e prapë të Makiavelit vetë. Një nga ato mizat këmbëgjata



— që kësaj radhe ngjante vetëm me një beduin — kish-te zënë vend në majën e veshit të Hasan Mangës dhe, e ngritur kas, dukej si rojë e shqetësuar dhe vigjilente e tribusë së saj. Hasan Manga ndjeu gudulisje, kroi veshin dhe atëherë miza rojë vigjilente përfundoi në disa copa, të cilat Hasan Manga i spastroi nga pulpat e gishtave me një të fryrë të bulçive.

— Nuk e di, nuk e gjej dot kush e ka shkruar këtë artikull! — tha Mentar Dika e, meqë nuk dinte të gënjen-te, iu duk sikur tjetri do t'ia lexonte gënjeshtrenë në sy, por sakaq ai e kishte kapërcyer pragun e dhomës, i shoqëruar nga vështrimi i heshtur i njëzet e ca burrave, të cilëve shërbëtori i Hasan Mangës po u thoshte se prisnin kot: në zyrat e Shoqërisë SITA nuk kishte asnjë vend të lirë, as për rojë, siç ishte hapur fjala.

Kur e pa se kishte mbetur vetëm, Hasan Manga, që tashmë kishte zbritur në gjendjen e tij të zakonshme — simbol i zvetënimit të forcës dhe i regjimit të vjetër — zgjati dorën e madhe leshtore dhe zuri receptorin e telefonit...

— Po ç'qëndrim mban, ç'thotë? — pyeti prefekti me të dëgjuar emrin e Mentar Dikës.

— Nuk flet shumë!

— Tjetër?

— I pëlqen të tallet pak me kërkesën tonë, po sigurisht këtë e bën me shumë kujdes. Është dhëlpër e madhe!

— Po neve na duhet ta detyrojmë Mentar Dikën të nënshkruajë deklaratën, ta poshtërojmë në sy të të gjithë simpatizantëve dhe përkrahësve të tij.

— Ai...

— Dëgjo këtu, — e ndërpreu me inat prefekti, — nga të dhënat që kemi për të e nga sjellja e tij, duke qënë dritar gjithmonë larg nesh, gjatë këtyre muajve pas ampapajtuësëm. Hëpërhë situata nuk është në favorin e tij, hëpërhë ai nuk mund të bëjë më shumë se kaq, veçse të qëndrojë larg nesh e të refuzojë kërkesat tona. Por po të vijmë të tjera kohë, ai do të bëhet menjëherë i rre-



zikshëm. Me autoritetin e derës patriotike e me qëndrimin e tij, që u kujton njerëzve Revolucionin që përmbysëm tre vjet e gjysmë më parë, ai do të bëhet shkak të tërheqë përsëri njerëz të tjerë pas vetes. Ja si shtrohet çështja: ose ta gjunjëzohmë, ose ta zhdukim. Rrugë tjetër s'ka. E kupton ti, Hasan efendi, ç'të them unë? Sidomos tashti që përgatitemi të ndryshojmë formën e regjimit, autoriteti i Presidentit duhet të jetë i pacënueshëm. E mos më telefono herë tjetër për të më thënë se ai s'dëshiron të futet në brazdën tonë. Udhëzimet i keni marrë një herë e përgjithmonë. Bjeruni me topuz të madh. Gjyqi politik që do të hapet këto ditë, do t'i tmerrojë të gjithë ata që mund t'u shkojë mendja të ngrenë edhe një gisht të vetëm kundër nesh!

— Alo-o, zoti prefekt! — mezi foli i përulur Hasan Manga.

Po «zoti prefekt» nuk u përgjigj më.

Disa minuta më vonë Hasan Manga thirri:

— F-e-e-etah!

Te pragu u duk fytyra e gjerë e shërbëtorit.

— Urdhëro, Hasan efendi!

— Fetah, dua të të pyes për një gjë!

— Këtu më ke, efendi! — dhe hapi këmbët Fetahu, si për të bërë duel.

— Rri dhe vras mendjen, ku mund ta kem dëgjuar zërin e Mentar Dikës por, sado që përpiqem, s'është e mundur të më kujtohet.

Sytë e plakur të efendiut e të shërbëtorit u fundosën në ujërat e turbullta të njëri-tjetrit, derisa më në fund Fetahu tha:

— Këtu do ta kesh dëgjuar, Hasan efendi!

— Jo pra, jo, se ku e kam dëgjuar, — tha Hasan Manga, që kishte marrë sërish pamjen e atij njeriu, i cili vuan tërë jetën nga mania se duhet të kujtojë diçka të harruar, por që s'e kujton kurrë. Edhe atëherë kur ajo «diçka» është gati t'i shfaqet para syve, atij prapë i rrëshqet nga kujtesa, kurse mania rritet e rritet...

— Ku ta kem dëgjuar atë zë?! — tha prapë Hasan Manga.



Fetahu ra në mendime (të thella).

— Në ëndërr do ta kesh dëgjuar, Hasan efendi! — tha ai.

Në fillim Hasan Manga e shikoi me bindje (mund që ta kishte dëgjuar në ëndërr), por pas pak e shikoi edhe me dëshpërim, sepse ai e dinte që, po të mos e kishtë dëgjuar në ëndërr, prapëseprapë nuk do t'i kujtohej kurrë se ku mund ta kishte dëgjuar atë zë, zërin e Mentari Dikës.

## IV

Kur doli Mentari nga zyra e Hasan Mangës, dielli, që ishte ngritur lart, digjte si saç. Rrudhi sytë nga përthyerja e rrezeve mbi kalldrëm, nxori nga xhepi pakon e aspirinave, gëlltiti një tabletë dhe vazhdoi rrugën, duke e harruar hëpërhë dhimbjen e kokës. Gjithçka që ndodhi në zyrën e Hasan Mangës, gjithçka që dëgjoji atje, e kishte shtrënguar Mentari Dikën në grykë dhe ai e kishte ndier veten po aq keq, sa kur e arrestuan, kur e nxorën në gjyq, ku ai dëgjoji se duhej të kalonte dymbëdhjetë vjet të mirë në një burg të lagësht e të ftohtë. Por, në qoftë se kjo nuk e lëkundte vendimin e tij për të mos iu nënshtruar atyre, të paktën i kujtonte prapë dhimbjen e kokës, e cila, megjithëse nuk i kishte dalë akoma në ballë, ishte bërë ose po bëhej e plotfuqishme diku në një pikë aty prapa zverkut.

Në rrugën e gjerë ai pa policët e bashkisë që shpallnin e ngjitnin shpallje në çdo shtyllë elektrikë. Pa edhe patrulla xhandarësh, që ecnin të ngrysur, me rripin e zi nën mjekër e me bajoneta të mbërthyera. Vetvetiu qyteti sikur kishte ngrirë, zhurmat ishin shuar, zërat



ishin ulur, hapat ishin ngadalësuar dhe çdo gjë, çdo njeri, çdo rrugë e çdo ndërtesë sikur kishte marrë pamjen e një pikëpyetjeje të madhe. Pastaj njerëzit filluan të grumbulloheshin rreth shtyllave, pranë mureve e qepenave, ku ishin ngjitur shpalljet, boja e të cilave ishte akoma e patharë mirë.

Gjëja e parë që i ra në sy Mentari Dikës në ato shpallje, ishte fjala *rebel*, pastaj emri *Genci Boga*, fotografia e Gencit, shifra 2000 franga, teksti që fliste për një trazirë rrëzë Maleve të Shqipërisë dhe që akuzonte Gencin Bogen si prishës të qetësisë së kombit.

Sytë gjysmë të mbyllur të Mentari Dikës bënë një trajektorë nga gerrat e mëdha e të zeza, te fotografia, te shuma 2000 franga. Më në fund ai u largua nga shpallja, duke thënë me vete: «Diçka po ndodh... Diçka po lëviz». Nuk pati bërë as njëzet hapa, kur u gjend përballë një të papriture tjetër. Në sfondin e ca pemëve të nemitura shquheshin dy kufoma, sytë e të cilave, gjysmë të hapur, dukej sikur hidhnin vështrime pa domethënie e pa qëllim.

*Kështu do ta pësojnë të gjithë ata armiq...* Mentari Dika nuk deshë ta lexonte deri në fund. Këto shpallje s'ishin as të parat as të vetmet dhe përmbajtja e tyre dihej prej kohësh. Por në të ikur i tërhoqën vëmendjen rreshtat e fundit, ku shkruhej se në të gjithë prefekturën N shpallej gjendje e jashtëzakonshme dhe u ndalohej qytetarëve çarkullimi pas orës dhjetë të mbrëmjes, u ndalohej gjithashtu gjatë ditës të ecnin më tepër se dy veta bashkë.

Duke qëndruar aty, ai kishte ndier menjëherë se midis tij dhe kufomave, midis tij dhe shpalljeve, ashtu sikurse se midis tij dhe Genci Bogës, kishte një lidhje, kishte mendime të pashprehura dhe diçka e fshehtë i rrëshqiti përmbrenda. Pas kësaj së fshehte, Mentari Dika drejtoi trupin dhe ngrii sytë. Po atë çast iu bë sikur dikush e goditi me grusht prapa kokës. Ja ajo, tha me vete, erdhi më në fund, dhimbja. Nxori pakon dhe qëlliti një aspirinë të dytë.

Pak më vonë vuri re se rrotull dy të vranëve ishin mbledhur shumë njerëz. Po megjithatë një heshtje e çuditshme dhe e plotë kishte rënë kudo, thuajse midis tyre



ishte futur kosa e mprehtë e vdekjes. Mentar Dika ndjeu si i shkuan të rrëqethura nëpër kurriz dhe po atë çast, duke gjykuar nga lloji i heshtjes, mendoi se njerëzit ishin mësuar me këto vdekje, ishin mësuar të përfytyronin edhe veten në vendin e kufomave.

Ai u afrua më pranë të vrarëve dhe në njërin nga ata njohu komandantin e forcave vullnetare, që ishte bërë zakon të thirrej Veterani i Luftës e që kishte qenë mësues autodidakt i shkollës shqipe në kohën e sulltan Hamidit, pastaj komit, pastaj thjesht plak e veteran, pastaj i organizatës «Atdheu» të Avni Rustemit e pas mbylljes së kësaj organizate nga Ahmet Zogu, anëtar i shoqërisë «Bashkimi». Me këtë veteran Mentar Dikën e lidhnin shumë kujtime, që ai nuk mund t'i harronte kurrë...

*...Në ditët e para të qershori 1924, Veterani i Luftës e kishte hedhur në betejë batalionin e vullnetarëve. Pas një përpjekjeje të ashpër, i përkrahur edhe nga kompania e Mentar Dikës, ai i theu forcat qeveritare dhe u fut fitimtar në qytetin N.*

*Atë ditë i gjithë fshati kishte zbritur në qytet. Dhe i gjithë qyteti kishte dalë në rrugë. Të çliruar nga zgjedha e qeverisë feudale, njerëzit ishin të qeshur, restorantet dhe kafenetë nuk mund të përballonin vërshimin e klientëve që festonin fitoren e madhe. Nëpër sheshe e nëpër kryqëzime rrugësh u hapën tezga e baraka që shitnin ushqime të gatshme për t'u ardhur në ndihmë sidomos fshatarëve. Gjallëri të jashtëzakonshme kishte në klubin e organizatës «Bashkimi», që ishte një nga klubet më aktive e që për këtë ishte përgëzuar edhe nga Avni Rustemi vetë. Oborri i klubit, shkallët, hajati ishin plot me vullnetarë, që hynin e dilnin e që kërkonin të marshonin sa më parë për Tiranë. Aty nga pasditja Veterani i Luftës, duke i treguar Mentar Dikës dorën e plagosur, i tha:*

*— Mentar, shkruaj një telegram, ku të shprehim besnikërinë ndaj qeverisë së Revolucionit.*

*— Tirana nuk është çliruar akoma dhe as qeveria nuk është formuar, — i tha Mentar Dika.*



— E di, por unë dua që, kur të sulmoj Tiranën, telegramin ta kem me vete!

Një gjysmë ore më vonë, Veterani i Luftës, pasi u foli mijëra njerëzve për këtë festë të madhe (ai e quajti në mënyrë të veçantë, festë të fshatarit e të tokës), lexoi telegramin me zë të dridhur:

**Populli i qytetit tonë bëri sot një mbledhje të madhe e një demonstracion dhe, pasi manifestoi shpëtimin e vet nga vuajtjet e feudalizmit, shfaqti besimin e tij të plotë e direkt kundrejt qeverisë së re të Revolucionit dhe u zotua se gjithmonë do të jetë shtylla më e shëndoshë e përkrahjes për zbatimin e programit qeveritar!**

Pastaj Veterani i Luftës e palosi telegramin dhe e futi me kujdes në gjë. Shikoi batalionin e vullnetarëve dhe kompaninë me ushtarë të Mentar Dikës, shikoi andej nga ishte Tirana dhe thirri:

— Forca të Revolucionit, para marsh!

Të shoqëruar nga tingujt e bandës muzikore të qytetit, nga britmat dhe thirrjet luftarake të popullsisë, forcat e Revolucionit, që zgjateshin e fryheshin vazhdimisht nga vullnetarët e rinj, mezi çanë përmes qytetit dhe morën rrugën drejt kështjellës së fundit të feudalizmit.

Kështu kishte filluar.

Me kujtimet në fytyrë, në sy e në buzë, tashti vështrimi i Mentar Dikës ishte ngulur sërish te kufoma e Veteranit të Luftës, veçanërisht tek ajo e çara e vjetër në buzën e sipërme.

... Këmbëkryq mbi një gur, me gunën mbi supet, ai dukej si një kullë e lashtë kështjelle, djegur e nxirë nga betejat. Të tjerët ishin ulur rrotull tij, thujse kishin dashur të formonin bedenat e kështjellës.

Mentar Dika gjeti një shteg në atë mur bedenash, qëndroi përballë Veteranit të Luftës dhe tha:



— Ngrihu!

Ai e shikoi me sytë e vjetër.

— Të ikim! — tha Mentari Dika. — Është vonë. U mundëm!

Veterani i Luftës shtrembëroi fytyrën dhe nga e çara e buzës së sipërme iu dukën dhëmbët e gjakosur. Mentari Dika pa se nga sytë e tij rrodhën dy pika lot, që hapën vraga përmes zhubrave të faqeve. Të tjerët, kur panë lotët e Veteranit, lëvizën shpatullat, si të kishin lëvizur muret e kështjellës.

Veterani i Luftës goditi me grusht tokën e ngrirë, u hodh në këmbë dhe ulëriu:

— Këtu mban erë tradhti. Pse na lanë kështu, pse nuk na thirrën me kohë?!

Pas këtyre fjalëve ai ishte zverdhur, sytë i ishën nxirë dhe kishte marrë pamjen e kufomës së vet, hedhur tashti në sfondin e atyre pemëve të nemitura.

Kështu kishte mbaruar.

Befas u dëgjua një klithmë e thekshme. Fytyra e skuqur dhe e fryrë e fshatares që kishte klithur, u fry dhe u skuq më shumë. Gruaja mori vrap, u shpëtoi xhandarëve dhe ra mbi kufomën tjetër, ngjitur me atë të Veteranit të Luftës.

Mentari Dika u largua nga kufomat po me atë shprehje të zemëruar e të dhimbsur në fytyrë, në sy e në buzë. Në degët e pemëve të nemitura një zog ia hodhi cicërimës njëtonëshe. Kënga e këtij zogu e shoqëroi gjatë Mentari Dikën. Por, duke e dëgjuar vazhdimisht në të njëjtën notë — të paktën atij kështu i dukej — kënga e humbi kuptimin e rëndësinë e vet, ajo humbi edhe melodinë, u bë e mërzitshme, si një fjalë e përsëritur shumë herë. Pastaj u bashkuan të gjitha, cicërimat e zogut, klithmat e gruas, britmat e xhandarëve... Pastaj Mentari Dika kaloi pranë ndërtesës së ish-klubit «Bashkimi», që ishte kthyer në depo bulmeti të një bakalli të madh. Por, sado e përdhosur, sado e vjetër si gërmadhë, për Mentari Dikën ajo ishte përmendore e një kohe që s'do të harrohej kurrë.



— Zoti Mentar! — dëgjoji ai një zë të butë e përkëdhelës prapa krahëve.

Mentar Dika qëndroi, por kokën nuk e ktheu menjëherë. Nuk e ktheu as më vonë. Ishte i zemëruar për gjithë sa kishin ndodhur atë ditë. Por edhe zëri që e thirri nuk i kishte pëlqyer. Edhe koka i dhimbte. Edhe rrezet e diellit i vritnin sytë. Ndërkaq i doli përpara një burrë i gjatë, prandaj dukej krejt e natyrshme që edhe strehën e kapelës ta kishte të gjerë.

— Vij nga zoti Veniamin Çeku. Ai të pret në hotel «Venecia».

Mentar Dika hapi pak këmbët si për të mbajtur ekulibrin dhe tha, pa e fshehur zemërimin për këtë ftesë:

— Mirë, po shkoj!

## V

Kurse koka me flokë gështenjë të errët e Veniamin Çekut nuk ngjante me të Hasan Mangës, nuk ngjante me të një hyjnie të lashtë, por me kokat rafaëliane dhe ai, si të ishte i ndërgjegjshëm për këtë, e anoi hijshëm kokën e bukur, duke thënë:

— Ja pse të thirra, zoti Mentar, — dhe hodhi vështrimin drejt tij, si drejt një vendi të zbrazur. — Për të të paralajmëruar të thirra!

Mentar Dika, si për të përballuar vështrimin mospërfillës të tjetrit, ngrysi vetullat dhe heshti.

— Dhjetë vjet më parë ti kishe nevojë për<sup>^</sup>paratë e mia, — vazhdoi Veniamin Çeku. — Kur të vdiq yt



atë, ti ishe në vitin e dytë të akademisë dhe mbete pa asnjë kacidhe. Unë të numërova drang, pesëdhjetë napolona flori, që bëjnë një mijë franga ari dhe në sajë të parave të mia u bëre oficer. Tjetër punë se pastaj të shkoi rrokopujë dhe ja, si u katandise. Ç'kërkon më nga unë? — këto tha ai dhe pastaj thirri:

— Sinjorina Adelaida!

Veniamin Çeku porositi dopiokumelin e dytë. Kamerierja ia solli në tabaka. Ai e shikoi kamerieren në sy, i etur për diçka misterioze. Ajo, që e kishte ndier atë vështrim, hapi sytë ngadalë dhe po ngadalë valëviti thekët e qerpikëve, që i mbante gjysmë të mbyllur. Ai e ngriti gotën nga tabakaja, ia bëri me shenjë që të priste, e rrëkëlëu menjëherë, e shikoi me ngulm, kësaj radhe jo në fytyrë, por diku një pëllëmbë më poshtë. Si e hipnotizuar nga vështrimi i syve të sinjor Çekut, sinjorina Adelaida ngriti lart sferat e vogla të gjinjve. Ai vuri gotën mbi tabaka dhe lëvizi gishtin: «Ik».

Kamerierja iku duke kërcitur thembrat e duke përthyer belin, e bindur, se sinjor Çeku aty e kishte mbërthyer vështrimin, në belin e saj të hollë e tepër elastik.

— Dhe ti shpreson se ata do të gjejnë një punë për ty?! — pyeti e zgjati krahun Veniamin Çeku si nga ana e prefekturës, si nga ana e bashkisë së qytetit. — Komedi gënjeshtresh të bukura e plot shkëlqim! — Ai nuk i kishte shqiptuar këto fjalë pa ton oratorie. — Ç'punë do të të gjejnë? Sa para do të marrësh nga ajo punë?

Mentar Dika kishte mbetur në këmbë, i rrethuar nga mendimet dhe nga heshtja e vet.

— Zoti Mentar, — foli gati me ton të ashpër Veniamin Çeku, që me këmishën sportive të kujtonte më shumë se një fajdexhi, një djalosh Perëndimi, që i pëlqen kotësia, që i pëlqen ta kalojë jetën nëpër qejfe dhe orgjira. — Ti bën mirë që nuk më lutesh. Lutjet më kanë bërë gjithmonë nervoz. Njerëzit i vë në lëvizje vetëm frika dhe hija e saj. Bile njerëzit dhe qeveritë humbasin pikërisht atëherë, kur fillojnë të bëjnë lëshime. Erdhi pra koha që edhe unë të veproj, të zbatoj ligjet në fuqi, pa bërë

SA, M. I.

shkollës c. ...  
T. ...



asnjë lëshim. Si i thonë fjalës, kurrë dhe pastaj kurrë! – Veniamin Çeku po jetonte ato çaste, kur e gjithë qenia e tij përfshihej nga mania e frazave të mëdha bombastike. Shtoi: – Së pari, kjo do të ishte marrëzi, së dyti, marrëzi, së treti, marrëzi! – Të folurit luksoz kishte arrihur pikën më të lartë. Pas kësaj pike, u ndeh një heshtje e pas heshtjes, befas, ai tha me ton krejt të natyrshëm: – Dëgjo, zoti Mentar, vërtet jemi moshatarë dhe, me sa më kujtohet, kemi qenë edhe shokë fëmijërie, po koha na ndau nga njëri-tjetri. Yt atë, si dhe gjyshi yt, derisa Shqipëria qe e robëruar nga turqit, gjithë çfarë kishin i bënë pluhur e hi pas librave dhe abetareve shqipe. Për këtë unë u heq kapelën dhe ua kam zili. Ai imi, në vend të librave blinte toka e vreshta, blinte shtëpi e dyqane dhe paratë që i tepronin i vendoste në bankat e Zvicrës. Më vonë, yt atë nuk hoqi dorë nga zakoni i tij, kursente si qeni dhe të dërgoi ty në Itali për studime ushtarake. Kishte qejf të të bënte oficer, të mbroje Atdheun, se Atdheu ynë, thoshte ai, është sulmuar gjithmonë nga Fuqitë e Mëdha e kështu me radhë eccetera, eccetera, e të tjera, e të tjera. Edhe për këtë unë i heq kapelën. Unë ty të ndihmova, po vetë nuk mbarova dot për drejtësi dhe as avokat nuk u bëra. Siç më shikon, zura këmbën e tim eti dhe nuk mund të mburrem si patriot, megjithëse askujt nuk i kam bërë keq dhe as kam për t'i bërë. *Ad libitum* thoshte latini, jetoj sipas qejfit dhe nuk jam as kozmopolit, as pagan si shumë të tjerë, kam vetëm një Atdhe, Shqipërinë dhe vetëm një perëndi, paranë. Kjo do të thotë, se edhe unë e dua Atdheun, por jo i varfër. Kurse ti, nuk e mohoj, e do Atdheun, ndoshta edhe më shumë se unë, por e ke dashur gjithmonë si axhami. A s'të shkoi mendja për një çast se të gjithë këta bejlerë, pashallarë e bajraktarë, zotërinë e agallarë nuk do ta duronin zgjedhën e së ashtuquajturës Qeveri Demokratike të Revolucionit famëkeq?... Ja si e pësove. Tre vjet burg. E pastaj të falën tri të katërtat e dënimit. E pse të amnistuan? Për të të lënë pa punë, ty që ie artilier me akademi? E di ti që s'ie veçse një amebë, kurse rrotull teje lëvrijnë peshkaqenë e tetëkëmbësh të panumërt? I di ti këto



gjëra? — nguli këmbë ai. — E di ti se Ahmet Zogu është betuar të luftojë derisa idetë e reja të zhduken fare?

Fytyra kockëvogël dhe simpatike e Mentar Dikës ishte errësuar, ishte rënduar dhe ishte zverdhur. Ajo ishte bërë e padepërtueshme, siç na duket bronzi në bustet e lashtësisë

— Po ju, zoti Veniamin, — foli ai me zë të ulët e të butë, — ju me çfarë e krahasoni veten, me peshkaqenët apo me tetëkëmbëshit?

Pas këtyre fjalëve, të thëna si rastësisht e si miqësisht, Veniamin Çeku mori një pamje si të kishte dëgjuar një instrument muzikor të shkurdisur.

— Ka edhe natë, zoti Mentar. Errësirë. Vetëm gjinkalla, që lind në orën dhjetë paradite dhe pëlçet në orën pesë pasdite, nuk di ç'është nata dhe errësira. Njeriu po. Ai duhet të kërrusë kokën e të pranojë fatin.

Në kafenenë e hotel «Venecias» hynin e dilnin myshterinj që pinin një gazoz në këmbë, që uleshin dhe porositnin kafe, konjak apo raki. Në dy tavolina të qoshes luanin poker. Luanin edhe biliardo. Herë-herë dëgjohej rrokullisja dhe përplasja e gurëve. Karambol. Dikush i vinte rrotull (i bënte korte, po të flasim me gjuhën e hotel «Venecias») sinjorina Adelaidës. E ulte pranë, i përkëdhelte duart e vogla e të bardha, ajo qeshte dhe hidhte vështrime provokuese. Sa herë që zhvilloheshin skena të tilla Veniamin Çeku, që ndiente turbullirë të pamposhtur, ndiente gjithashtu domosdoshmëri për ta shkëputur Adelaidën nga protektorati i fjetrit.

— Sinjorina! — jehoi zëri i Veniaminit nëpër ato të çara të rralla të të qeshurit të Adelaidës.

Ishte dopiokumeli i katërt, ishte edhe minuta e dytë e heshtjes dhe e zemërimit, tashmë jo vetëm kundër Mentar Dikës, por edhe kundër atij biçim tregtari, që i vinte rrotull Adelaidës. Në minutën e tretë të heshtjes, kur Adelaida ishte shkëputur nga tregtari, Veniamin Çeku kishte rifituar qetësinë e mëparshme dhe befas, fytyra e tij u duk sikur u mbush me një mendim të madh. Ngriti kokën ngadalë, si të kishte frikë se mos i fluturonte mendimi, e shikoi drejt në sy Mentar Dikën dhe tha:



— Ulu, zoti Mentar!

Mentar Dika nuk deshi të ulej.

— Ulu, ulu, — iu lut tjetri, duke vënë në përdorim atë pjesë të zërit, që ishte tepër intime.

Pas një heshtjeje e pas një ngurrimi të shkurtër, Mentar Dika u ul në karrigen përballë me atë pamje e me atë lëvizje, që zakonisht ulen njerëzit pranë një kufome. Dhe e shikoi në sy.

— Një konjak, dopiokumel?

Për pak Mentar Dika deshi t'i thoshte se ishte i pangrënë, por në një të dhjetën e çastit u përmbajt: ai nuk dëshironte t'i jepte Veniamin Çekut një kënaqësi të tillë. Tha:

— Jo!

Pas kësaj «jo»-je, fytyra e Mentar Dikës sikur zbuloi të gjithë lodhjen e kohëve të fundit.

Veniamin Çeku, i cili s'ishte nga ata, që mund t'i shpëtonin pamje të tilla dhe që e kishte të qartë se Mentar Dika kishte rënë ngushtë, pasi i hodhi disa vështrime, që të kujtonin një shpend grabitqar, tha:

— Epo mirë, si të duash. Edhe unë, kur s'më pihet, sado që më luten, nuk e marr mundimin të pi. Le të futemi në temë! — Me të thënë fjalën e fundit, zëri i Veniamin Çekut u bë më i ulët, u bë konspirativ. — Do të shtrëngohen vazhdimisht darët, zoti Mentar. Gjatë fushatës për t'u bërë mbret, Ahmet Zogolli do të përpiqet të ngrejë prestigjin e vet, do të përpiqet të vendosë qetësi të plotë kudo e në çdo gjë. Midis shumë masave të tjera, ai ka urdhëruar të mos i jepet punë asnjë pjesëmarrësi të Revolucionit të Njëzetekatrës, që dyshohet se nuk ka hequr dorë nga idetë e tij. Kurse lidhur me ty, ata gjuajnë rastin t'u dalësh në shteg e t'u lëshosh një dokument pendimi! — Që nga ky çast Veniamini u tregua më i afërt me Mentarin. Bile afroi edhe karrigen nga ai, thithi cigaren, fshehu kokën rafaeline pas fjollave të tymit dhe e shikoi Mentar Dikën siç shikojmë një njeri, tek i cili kemi besim të plotë.

— Kështu pra, i ke të humbura shpresat për të gjetur



punë nga ata turkoshakë, që e kanë shpallur veten mbar-tës të përparimit, baballarë të kombit, që bërtasin sikur vetëm ata paskëshin derdhur gjakun për lirinë e Shqipërisë! — Veniamin Çeku thithi prapë cigaren dhe bashkë me tymin lëshoi edhe këto fjalë: — Unë jam i mendimit se, pikërisht nën hijen e Ahmet Zogut, ka ardhur koha që ne të gjithë së bashku të marrim shembull nga Perëndimi, nga Italia fashiste. Vetëm fashizmi mund të jetë e ardhmja e Shqipërisë. E po të bëhesh ti me mua, ti që vjen nga një derë e vjetër patriotike, e po të bëjmë edhe disa të tjerë, atëherë unë e ti e ata të tjerët do të jemi bërthama e grupit të parë fashist në qytetin tonë dhe më vonë bërthama e partisë fashiste shqiptare! — thithi cigaren. — Nuk them të më japësh përgjigje tashti. Tashti je i tronditur. E gjithë kjo tingëllon krejt papritmas për ty. Shko në shtëpi, mendohu, bisedoje me gruan dhe, kur të duash, nesër ose pas një jave, eja, se mua këtu më gjen gjithmonë. Ki mëshirë për fëmijët, shpëto vilën!

Mentar Dika, si më parë, mbeti me trupin të kërrusur mbi tavolinë, duke u përpjekur të përmbante urrejtjen që provonte ndaj Veniamin Çekut. Ai e dinte se në këto raste rrudhat anës syve i bëheshin më të theksuara, ndërsa fytyra e verdhë dhe e vrrarë, në vend që t'i zverdhëj e t'i vritej më shumë, i merrte ngjyrën e bronzit të lashtë. Me gjithë kushtet e pakënaqshme të këtij takimi, megjithëse e dinte se Veniamin Çeku s'do t'i bënte asnjë lëshim, prapëseprapë ai nuk ishte penduar që kishte ardhur këtu. Ai e merrte me mend se lufta do të ishte e gjatë por, që të mos tërhiqej asnjëherë nga ajo, duhej ta ndiente e ta prekte vazhdimisht këtë botë të prapë. Vështroi klientët e tjerë të lokalit që pinin ose luanin kartash dhe befaz e ndjeu veten një kundër të gjithëve, kundër të gjithë atyre njerëzve që dukeshin dhe ishin të lumtur nga jeta. Edhe kjo ndjesi i dha kënaqësi Mentar Dikës. Një kundër të gjithëve. Shokët e tij nuk ishin këtu. Hëpërhë ata ishin shpërndarë. Ata i kishte shpërndarë përmbysja e Revolucionit. Ata ndiqeshin e persekutoheshin. Disa edhe kishin emigruar. Por... sa do të zgjaste kjo gjendje? Sa? Një jetë të tërë? Sigurisht jo! Do të vinin kohë të tjera, përsëri



populli do të ngrihej dhe ata do të bashkoheshin përsëri, donin apo s'donin zotërinjtë e këtij lokali.

— Kështu, pra, zoti Mentar, — e ndërpreu zëri i ngroh-të i Veniamin Çekut. — Mendohu dhe pastaj... — Ai kish-te heshtur. Diçka kishte parandier, diçka kishte kuptuar nga vështrimi e nga pamja e tjetrit.

Mentar Dika lëmoi me gishta mustaqet e shkurtra, gjë që, siç e kemi thënë, e bënte sa herë që të tjerët ia merrnin mendimin para se ta shprehte.

— Jo! — tha pas pak me lehtësi, sikur kjo «jo» të ishte thënë për një gjë fare të vogël e pa rëndësi.

Veniamin Çeku e shikoi Mentar Dikën si të kishte përpara ekzemplarin e fundit të një kafshe të çuditshme. Tha:

— Pse jo?

— Jo!

— Ti edhe ke studiuar në Itali!

— E pastaj?

— Mendohu, zoti Mentar. Je fare vetëm. Këtë mos e harro. Askush s'të afrohet. Askush s'të ndihmon. Populli e ka humbur me kohë besimin se mund të kthehet përsëri revolucionin juaj. Mund t'i vijë keq, mund t'i shikojë me dhimbsuri njerëzit si ti, por ç'i ka mbetur për të bërë? Asgjë! Partitë tuaja morën fund. Njerëzit gjithashtu. Venterani i Luftës, siç e kishit bërë zakon ta quanit, e që ishte një nga të fundit, u palos në dhé. Ata që kapërcyen kufirin atëherë, se ç'kanë formuar ca organizata e komite-te, por ç'mund të bëjnë atje, duke qenë jashtë atdheut? Kryesorja duhej të ishte këtu brenda, po këtu ju s'keni asgjë në vijë. Shumica e shokëve tuaj janë akoma nëpër burgje. Disa nga ata janë bërë me kohë me Zogun. Disa u amnistuan, siç u amnistove edhe ti. Po ç'e do, vërtet të lirë, por të lidhur si ariu me zinxhirë dhe s'keni as bukë të hani. Më thuaj tashti, a s'ka ardhur koha t'i vësh gishtin kokës, të heqësh dorë nga idetë e revolucionit tuaj dhe të bashkohesh me idetë që të prozoj unë?

Heshtje.

— Ti s'je as në gjendje të më thuash, pse jo?

— Sepse jam i bindur se çdo gjë do të ringjallet!



— Edhe po u ringjall, prapë këtë fat do të pësojë!  
— Do të ringjallet jo vetëm duke korrigjuar gabimet e mëparshme, por edhe me forcë më të madhe.

— Me cilët? — ngriti zërin Veniamin Çeku dhe shikoi rrotull. Por askush nuk i dëgjonte e nuk i përgjonte.  
— Mos ndoshta me atë Genc Bogën, për kokën e të cilit japin njëqind napolona? — Prapë shikoi rrotull. — Dhe kur do të ndodhë kjo ringjallje, zoti Mentar?

Këtë nuk e dinte Mentar Dika, as mund ta përcaktonte, po megjithatë kaltërsia e syve të tij nuk u turbullua.

— Ty të duhet të jetosh sot që je i ri, — vazhdoi Veniamin Çeku me notat më intime të zërit të vet. — Ti ke nevojë për mirëqenie pikërisht sot, që ke grua, që ke fëmijë për të rritur. Përndryshe kjo që bën ti s'është veçse idealizëm i kotë, altruizëm, të cilin bota e ditëve tona e shikon me ironi. Tashiti zgjidh e merr, i thonë një fjale. Ata kërkojnë nga ti një gjest legal pendimi, një kredo, një deklaratë, ku të mohosh edhe vetveten. Unë kërkoj të përqafosh idetë e fashizmit. Rrugë tjetër s'ka. Një nga të dyja. Zgjidh e merr!

— Dhe që të dyja palët në emër të derës patriotike!  
— tha Mentari me zë të ulët, por tashmë pa e fshehur inatin.

— Atëherë më vjen keq, zoti Mentar, më vjen shumë keq për ty, besomë, janë ligjet që më detyrojnë të veproj!

Jeta e oficerit, sado e shkurtër që kishte qenë, i kishte ngulur Mentar Dikës disa aksioma, që padashur i qenë kthyer në zakone. Ja njëri nga ata: po e fillove sulmin, edhe sikur të pendohesh, nuk duhet të kthehesh kurrë në mes të rrugës, sepse në këtë rast humbjet do të jenë më të mëdha. Mund dhe duhet të kthehesh vetëm atëherë, kur të shfaqet rreziku i rrethimit, por Veniamin Çeku s'ishte nga ata që ndiqte taktikat e rrethimit, të cilat kërkojnë kohë dhe durim. Ai ishte për beteja të shpejta e për fitime të lehta. Prandaj, Mentar Dika, që e kishte filluar këtë sulm, nuk bëri asnjë përpjekje për ta përmbajtur inatin. Tha:

— Dëgjo, zoti Veniamin! — zëri i tij ishte fare i ulët



dhe fare i qetë në dukje. — Nuk do të jesh gjithmonë i fortë siç je sot. Kohët do të ndryshojnë. Brezitetë na arrijnë, mbështeten gjithmonë në anën tonë të mirë dhe pastaj pohojnë faqe mesh pavarësinë e tyre, botën e tyre. Dhe në botën e tyre, një njeri si ti, me një jetë të vogël e me kokën bosh s'do të ketë vend. Merre edhe vilën time, hajde, ç'pret?

Edhe pasi i kishte thënë këto fjalë, Mentar Dika nuk lëvizi. Ai sikur dëshironte të shikonte efektin që do të bënin ato te bashkëbiseduesi. Vetullat i kishin rënë të palëvizshme mbi kaltërsinë e çelët të syve. Flokët gështenjë dukeshin, si zakonisht, të qetë, të shtruar. Së fundi, buzëqeshi me buzëqeshjen inatçore, që nuk ia ndryshonte shprehjen e fytyrës dhe prapë nuk lëvizi.

Veniamin Çeku e kishte ndier menjëherë se zëri i debitorit kishte transmetuar gjithë helmin dhe zemërimin, mbledhur prej vitesh në shpirtin e tij. Kishte mbetur disi i stepur dhe disi i hutuar, por pak më vonë e pa të arsyeshme të mos e bënte veten dhe të fliste:

— Kot të paskam pritur kaq vjet e t'i kam shtyrë kaq herë këstet e borxhit. Tashti, dëgjo! Më parë do të të sekuestroj ç'të ka mbetur në vilë. Këtë do ta bëj për të më paguar të paktën këstin e dytë, që duhej të ma kishe paguar këtu e pesë vjet të shkuar. Pas këtij afati, do t'i vijë radha vilës sate të shkretë e fatkeqe. Ajo do të ketë një fat të ndryshëm nga tri radhët e para. Unë nuk do ta djeg, siç e dogjën të huajt, por do t'i bëj një nder më të madh, do ta nxjerr në ankand dhe do ta shes.

Sakaq Mentar Dika kishte hedhur një hap prapa dhe përsëri i kishte buzëqeshur me atë buzëqeshjen e rëndë inatçore. I nxitur nga kjo buzëqeshje e përsëritur, nuk dihej akoma ç'do të nxirrte nga goja Veniamin Çeku, po të mos e kishte penguar Adelaida, e cila qëndronte qetësisht pranë tavolinës së rivalit dhe ai (rivali), duke admiruar elegancën e saj delikate, diçka i thoshte me zë të ulët, ndërsa Adelaida pranonte, duke tundur kokën e vogël prej qengji.

— Adelaida! — thirrë Veniamin Çeku, duke harruar



për një çast fashizmin, vilën, të zotin e vilës e gjithçka tjetër. — Një dopiokumell!

Kur ngriti sytë, ai vuri re se debitori ishte zbrapsur gati për t'u larguar. Kishte ardhur, pra, fundi i takimit, fundi i sulmit, fundi i shansit për të humbur ose për të fituar një fashist të ri. Tashti pamja e Veniamin Çekut (plus këmisha katrore), s'të kujtonin më djaloshin pa halle të tipit perëndimor. Ky ndryshim, që kishte ndodhur aq mrekullisht në pak çaste, befas edhe kokës së tij rafaeliane i kishte dhënë pamjen e personazheve të Shekspirit, kur ato jetojnë aktin e fundit të tragjedisë. Mentar Dika, që i vinte re të gjitha, kishte mbajtur çapin dhe prishte akoma.

— Dëgjo ti, — tha ai me inat të fshehtë. — Unë di edhe shumë gjëra të tjera për ty. Mos vallë ti pandeh se fashizmi i ka hedhur rrënjët vetëm në hotel «Venecia»? Gabohesh rëndë. Por t'i lëmë llafet e tepërta. Unë di që edhe xhandari më i fundit, bile edhe patrulla e qenve, Kika dhe Jonuzi, janë porositur për të të turpëruar. Dhe për çfarë thua ti? Edhe për një lek, po t'u jepet rasti. Për hiçmosgjë. Kjo është porosia. Për hiçmosgjë. Ja pse të thirra sot, sepse e di që je duke jetuar çaste kritike...

— Kombinacion i bukur midis fashistëve dhe turkoshakëve, zoti Veniamin Çeku!

— Mos më ndërpre, — foli ashpër Veniamin Çeku. — Nëse s'bëhesh fashist, ja ku po ta them unë, do ta pësosh më keq! Të gjithë ju të revolucionit do të detyroheni një ditë të bëni si gjeneralët e Napoleonit, të cilët u futën në shërbim të Lui Filipit dhe ai i hodhi kundër punëtorëve të Lionit. Disa nga ju janë futur me kohë në këtë rrugë, tashti do t'ju vijë radha të gjithëve, që t'u shërbeni turkoshakëve dhe të ngrini shpatën kundër atyre, me të cilët bëtë revolucionin katër vjet më parë.

Pasoi një heshtje.

— Po tashti, — tha Mentar Dika, — a më lejon mua të të bëj një pyetje?

— Ç'pret akoma?

— Të jep gëzim kjo jetë, zoti Veniamin?

— Shumë, bile!



— Edhe këto mendime?

— Ti thua të sakrifikosh tërë jetën? — iu përgjigj pyetjes me pyetje Veniamin Çeku.

Mentar Dika nuk foli më, por i zbrapsur, siç ishte, bëri një prapakthehu të atillë, që tregonte se e kishte tepruar duke ndenjur gjatë aty.

Veniamin Çeku, pasi e ndoqi me sy debitorin, derisa ai u zhduk prapa derës së kafenesë, u kthye nga të njëjtit e të panjohurit, që mbushnin tavolinat, që luanin kartash e që grindeshin me fjalë dhe gati thirri:

— Ç'më rrini si shpirtra të humbur, që presin për të hyrë në ferr?!

## VI

Me të dalë nga hotel «Venecia», Mentar Dika e ndjeu veten më se të lodhur e më se të shushatur. I bëhej sikur qyteti ishte mbuluar me mjegull të dendur dhe vetëm vonë u kujtua se ajo mjegull s'ishte veçse në kokën e tij të rënduar e të pushtuar nga dhimbja, që tashmë i qe shfaqur si një krisje në mes të ballit.

Tek po kthehej në vilë, në këndin e një rruge, i ngadalësoi padashur hapat dhe vështoi në brendësi të një lokali të vogël, ku më 17 gusht do të votohej për zgjedhësit e dytë, të cilët pastaj do të zgjidhnin deputetët për në Asamblenë Kushtetuese. Do të ishte kjo Asamble që do ta shpallte Shqipërinë monarki, do të caktonte mbretin dhe do t'i vinte kurorën. Në vitrinën e këtij lokali ishte varur fotografia e kandidatit për deputet dhe Men-



tar Dika kishte njohur menjëherë fytyrën e pashës D. Ky pasha, që në të vërtetë i kishte sytë të goposur midis dhjamërave të fytyrës, në fotografi dukej më i pashëm e më i qeshur. Po sado që retushuesi i Tiranës i kishte dhënë pashës D vështrimin e një shenjtori të përdëllyer, sado që ishte përpjekur ta kthente në sinonim e në simbol të virtytit e të mirësisë, prapëseprapë e gjithë fizionomia e plakur e pashës ishte aty si për të dëshmuar se pashallëqet po jetonin ditët e fundit në Shqipëri. Po do të mbeteshin bejlerët, që ishin të shumtë, që mund t'i takoje në çdo dhjetë metra e që kishin pushtuar parlamentin prej vjetësh me radhë. Ja, për të çuar këtë pashë e këta bejlerë në Asamble, kujtonte Mentar Dika zgjedhjet e kaluara, do të fillonte fushata e mashtrimeve, e lajkave, e premtimeve, e shpërblimeve dhe e blerjes së votave, e kërcënimeve, e rrahjeve dhe e një mijë dallavereve të tjera. Kurse më 17 gusht, shtypi do të shkruante për suksesin e zgjedhjeve, për vullnetin e lirë e mençurinë popullore, për t'u lënë vend pastaj fjalëve e frazave plot shkëlqim, kur zgjedhësit e dytë do të jepnin votat e tyre për deputetët. Këto kujtoi e përfytyroi Mentar Dika, kërrusi kokën për të fshehur zemërimin dhe hodhi hapin drejt vilës, gjithmonë duke pasur kujdes, por edhe kureshtje se cila do të ishte ajo rrodhe që duhej t'i ishte ngjitur prapa, sepse ai nuk ishte axhami që të mos e merrte me mend se në këtë situatë organet sekrete do t'i kishin shumëfishuar spiunët dhe ata do të ishin vënë me kohë në gjurmët e tij.

Fundja, ndërsa ecte ashtu i vetmuar, me diellin mbi kokë, me mjegullnajën brenda në kokë, me dhimbjen në ballë, ai mendoi të mos e prishte gjakun, të mos e lëshonte veten. Kjo ishte kryesore hëpërhë. Duke menduar këstu, në një qoshe rruge gati u ndesh hundë me hundë me njeriun me të zeza, që ishte dukur në qytet ditët e fundit. Flitej se ky njeri merrej me studimin e shtëpive të vjetra, me gdhendjet, me musandrat e sergjenët, me tavanet, xhamitë e kishat, me kullën e sahatit, me portikët e portalët e kalasë e deri me gurët e braktisur e të harruar të varrezave. Ca e quanin arkitekt, ca his-



torian, ca arkeolog. Në buzët e tij do të gjendej gjithmonë një cigare, që i varej përjetë e shuar e në duart e tij do të gjendej gjithmonë një antikë, një relik, vlera e të cilit kuptohej nga kujdesi i madh që ai tregonte tek e mbante. Kësaj radhe ai kishte nën sqetull një copë tavani të gdhendur, por gjëja që kishte rënë më shumë në sy ishte kostumi i tij i zi, të cilin ai s'e kishte hequr asnjë ditë. Ishte edhe papioni në këmbishën e bardhë. Papion mbanin vetëm prefekti, kryetari i bashkisë dhe një i huaj, që flitej se do të emërohej drejtor i kurseve të gjuhës italishte. I katërti ishte ky, arkitekti, historiani, arkeologu. Në fakt vendin e katërt do ta kishte pasë zënë një kamerier i sapokthyer nga Amerika, por elita e kishte parë të çuditshëm këtë gjest — gjestin e një kamerieri — kishte ndërhyrë dhe kamerieri që detyruar të hiqte papionin, por jo kostumin e zi. Kështu që, i panjohuri ynë mbeti i pesti për nga kostumi i zi dhe i katërti person i nderuar për nga papioni.

Të befasuar pra nga kjo ndeshje hundë më hundë, të dy ata, Mentar Dika dhe kostunziu u përshëndetën me një buzëqeshje të pashfaqur, por që u nënkuptua në çipat e buzëve të tyre.

Në të hyrë të varoshit ai ngriti kokën dhe shikoi shpalljen majë një huri, ngulur aty që në kohët e fëmijërisë së tij. Përsëri shkronjat e zeza: *rebel*. Përsëri teksti: *prishës i qetësisë së kombit*. Fotografia e Genc Bogës dhe 2000 frëngat. Mentari qëndroi një copë herë i përhumbar, diçka mëndoi, diçka tha akoma me vete, diçka iu duk sikur vendosi. Pastaj, i lodhur e me vulën e shqetësimeve në fytyrë, kapërceu pragun e portës së rëndë të vilës dhe eci nëpër rrugicën e oborrit shtruar me kalldrëm.

Në xhamat e vilës dielli i korrikut shkëlqente me pasqyrime që të vritnin sytë. Nga oborri me lule dhe nga pjesa tjetër me pemë, që e kishin bërë zakon ta quanin kopsht, shpërndahej një frymëmarrje e qetë dhe të dukej sikur vila notonte në ekstazë midis avullimeve dhe aromave që ngriheshin nga toka. Ishte mesditë dhe bënte vapë, zogjtë kishin heshtur, s'ishte kohë e fluturimeve, ndërsa qielli dukej i verdhë, i mjegulluar, fare bosh.



Mentar Dika zbërtheu xhaketën, zbërtheu edhe këmishën, ndjeu erën e djersës së vet dhe i pëlqeu. I pëlqeu edhe era gati e pandjeshme e arrës së madhe në fund të kopshtit, që lëshonte një si athëtitirë të këndshme. Disa degë të saj, që shtriheshin mbi gjërmadhat e shtëpisë së vjetër me çardak e me qemer, ishin tharë përjetë dhe, sado që kishin kaluar shumë vite, ai nuk kishte dashur t'i priste ato degë...

...Për herë të parë shtëpia ishte djegur në vitin 1882 me ferman të valiut turk. Më vonë, mbi gjërmadhat e saj ishte ngritur një shtëpi e re, ku ai kishte kaluar fëmijërinë. Ndërsa kolovitej nën degët e arrës së madhe, Mentari i vogël i buzëqeshte së ëmës, që kishte qenë një grua e fuqishme, me llërë të përveshura (e tillë i qe tiposur ajo), por që e shtynte lehtë kolovajzën, se kishte frikën e djalit të vetëm. Aty qe rritur ai. Dhe kur mbushi të shtatëmbëdhjetat, një ditë të nxehtë vere, si kjo e sotmja, në vitin 1910, në oborr vërshuan xhonturqit, kërkuan të atin, që kishte dalë përsëri maleve dhe e dogjën shtëpinë për herë të dytë, pa i lënë të nxirrnin jashtë as edhe një plaçkë të vetme. Atë ditë ishin përcëlluar e tharë përgjithmonë edhe degët e ulëta të arrës së madhe, që për Mentar Dikën kishin marrë kuptimin e një relikti natyror. Pastaj Shqipëria fitoi pavarësinë, por shpejt erdhën të tjera kohë, erdhi furtuna e Luftës së Parë Botërore dhe në fund, pikërisht ditët e fundit, para se të tërhiqeshin mbeturinat e agresorëve, dogjën për herë të tretë shtëpinë e Dikëve, ngritur mbi gjërmadhat e vjetra. Tashti shtëpisë së vjetër i kishin mbetur në këmbë pothuaj vetëm çardaku me qemerin, si dëshmi të fundit kundër rrebesheve të të huajve. Vila e tanishme ishte e katërta brenda katër dekadave dhe ishte më e bukur se tri të parat. Në të vërtetë ajo kishte diçka më tepër se shtëpitë e zakonshme të qytetit dhe shumë më pak se shtëpitë e mëdha të agallarëve, pa zënë në gojë haremet e sarajet e bejlerëve. Ishin pesë shkallët, ishte edhe veranda me xhama, që mund të quhej edhe sallon edhe paradhomë, të cilat përbënin atë të re që kishte ajo shtëpi e që mësuesit, nxënësit, fqinjët, të njohurit e dashamirët që kishin ndihmuar me para e me

punë krahu, si shpërblim të patriotizmit të hershëm të asaj dere, e kishin pagëzuar me emrin vilë.

...Por, më vonë, të tjerë armiq u shfaqën kundër vilës e kundër Dikëve... Duke përfytyruar vezullimin e lig të syve të Hasan Mangës e propozimin e Veniamin Çekut për t'u bërë fashist, padashur Mentar Dika recitoi gati me zë:

*Dif dragoi i Dragobisë,  
Trim tribun i vegjëlisë!*

Në verandë u dëgjua zhurmë. Ai fshehu mendimet e shqetësuara dhe u përpoq të bëhej Mentar i zakonshëm, por... befas, e ndjeu veten të penguar nga Daklea, që e priste buzë shkallëve me një mijë pikëpyetje në sy.

Larg, prapa çatisë së vilës, nën qiellin e verdhë, të mjegulluar dhe fare bosh, plepat e gjatë e të hollë rresh-toheshin si kolona të një tempulli të lashtë. Kjo që pamja e fundit dhe përshtypja e fundit, para se ai të ngjitej në verandë.

## VII

Kolë Papi, që e kishte lënë punën e që kishte ardhur aty me mistri në dorë, ishte një djalë rreth të njëzetave, me mustaqe të sapodirsura, me flokë të verdhë, të gjatë, nëpër të cilët i ngatërroheshin copa të thara llaçi dhe gëlqereje. Fytyrën e kishte të dobët dhe vështrimin të mirë, të butë e të ëmbël, se Kola s'ishte i ngrysur si e ëma, Folta Papi, por ishte krenar si ajo, i gjatë



dhe i drejtë si ajo dhe, tek qëndronte para shpalljes, me duart të kryqëzuara mbi gjoks, të kujtonte Foltën pas banakut, e prapë, si Folta pas banakut, shikonte shpalljen, si të shikonte fundin e botës. Ai lexoi këtu e atje disa shpallje të tjera, si të provonte nëse ishin të njëjta, shikoi edhe dy kufomat pranë sheshit të bashkisë dhe pastaj u largua me hapin e rëndë të Foltës drejt restorantit të vogël.

Folta Papi, pasi dëgjoi nga i biri ç'kishte ndodhur, mbylli restorantin dhe zuri të ngulej para çdo shtylle, çdo tezge, çdo qepeni e muri, kudo që kishte shpallje. Qëndronte një copë herë me duart të kryqëzuara mbi gjoks dhe, meqë s'dinte të lexonte, shikonte vetëm fotografinë e Genc Bogës. Ajo i ra qytetit anekënd, së fundi shkoi edhe atje ku ishin hedhur dy kufomat, qëndroi pak, pastaj, duke u çapitur me hapin prej burri e me cingërimën e paftave të çliruara të këpucëve (si të Hanës), mori rrugën drejt kazermave.

— Dua të takohem me komandantin e madh! — tha ajo.

Roja thirri togerin. Një toger i ri dhe i qeshur, që këndonte nëpër dhëmbë e që kënga i ngeci në buzë kur u gjend te porta e jashtme.

— Unë jam Folta Papi, jam e ëma e Krist Papit!

— Në këtë kazermë nuk ka Krist Pap! — tha ai.

— Gjashtë muaj më parë e solla vetë këtu tim bir, bashkë me tim nip, Genc Bogën, për kokën e të cilit ju jepni dy mijë franga.

Gëzimi u shua nga fytyra e togerit, bashkë me të edhe murmurima e fishkëllima e këngës midis dhëmbëve. Por nuk ishte i keq togeri, nuk ishte i ngrysur. Tha prapë:

— Këtu s'ka Krist Pap!

— E di!

— Çfarë di?

— Që s'është këtu!

— Atëherë pse e kërkon këtu?

— Ju vetë e keni çuar në repartir rrëzë Maleve të Shqipes!

— Ah, qenka atje! Atëherë jo unë, kapiteni e ka çuar.

— Ku është kapiteni?

Me ta quajtur të mbaruar bisedën me Folta Papi, fytyra e togerit u bë prapë e qeshur dhe kënga si murmurimë e si fishkëllimë iu gjallërua sërish nëpër dhëmbë e nëpër buzë. Ktheu kokën nga roja:

— Lajmëro kapitenin!

Por as ai nuk e kishte shqiptuar akoma rrokjen e fundit dhe as roja, që për instinkt të uniformës, nuk e kishte vënë akoma dorën në rripin e xhaketës për ta rregulluar para se të nisej për te kapiteni, kur Folta Papi e kishte kapërcyer portën e kazermës dhe, me hapin e saj të rëndë prej burri, po ecte përtej.

— Ta ndalojmë, zoti toger?

Togeri, që tashmë e kishte shndërruar këngën thjesht në fishkëllimë (për të shprehur çudinë), e ndërpreu për një çast dhe tha:

— Hallexheshë... Por të paktën shko t'i tregosh zyrën e kapitenit.

Kështu, disa minuta më vonë, Folta Papi u gjend në një zyrë as të vogël as të madhe, që s'kishte brenda veçse një tavolinë, dy karrige, në njërën nga të cilat ishte ulur një oficer me uniformë dalëboje.

— Zoti kapiten?! — tha Folta Papi.

Kapiteni, që po shtinte fall me letra e që çdo lëvizje e çdo shfaqje të letrave e shoqëronte me gurgullima fjalësh të mbytura e të pakuptueshme, i hodhi një vështrim të shpejtë Foltës, i bëri shenjë me duart e ngjallura, si t'i thoshte: «Prit pak!» dhe vazhdoi të hidhte letra mbi tavolinë, gjithë duke murmuritur gjysma fjalësh, gjithë duke prodhuar gurgullima grykësore. Një çast mbeti në mëdyshje, me sa dukej falli ishte bërë i vështirë dhe i pashpjegueshëm, ngriti sytë dhe pyeti:

— Ç'të sollti këtu, moj zonjë?

— Nipi dhe djali që i kam të dy ushtarë!

— Fol atëherë!

— Genc Boga, ai i shpalljes, është nipi im!

Kapiteni ngriti supet: ç'të të them! Po megjithatë Folta pyeti:



— Çfarë ka bërë?

— Nuk di gjë! — tha ai me supet përpjetë.

Folta u besoi atyre supeve.

— Po do të jetë bërë luftë, — tha ajo, — përderisa kanë vënë edhe dy të vrarë në qytet!

— Po-o-o, — e zgjati pa të keq kapiteni. — Luftë u bë. E bëri xhandarmëria. Mori edhe kompaninë tonë, që e kemi rrëzë Maleve të Shqipës, por unë vetëm kaq di!

— Po për tim bir, çfarë dini?

— Si e quajnë?

— Krist Papi!

Kapiteni u mendua pak, pastaj tha:

— Nuk di gjë! — dhe supet lart.

Folta prapë u besoi atyre supeve. (Më shumë supeve se fjalëve).

— Po kush e di? — pyeti ajo.

Dora e ngjallur e kapitenit u ngrit dhe gishti tregues shënoi një drejtim përballë korridorit.

— Majori, — tha ai, — majori mund ta dijë!

Folta s'e bëri të gjatë, i ktheu kurrizin kapitenit dhe doli në korridor. Por aty i ndezi belaja. Nënoficeri që rrinte te dera e majorit, ishte një burrë i vrazhdë, që s'të shikonte fare në sy.

— Prit sa ta lajmëroj, — tha ai. U fut brenda dhe doli shpejt. — Prit aty! — gati hungëri.

Herë-herë Folta jepte shenja padurimi. Nënoficeri shpjegoi pa e shikuar në sy:

— Mos u mërzit, moj ti, nënë, se majori ka detyruar prefektin dora vetë të presë më se një orë këtu!

— E-e-ej! — u çudit Folta. Edhe asaj s'para ia kishte qejfi ta shikonte në sy nënoficerin e vrazhdë.

— Po ti ç'bën këtu? — pyeti ajo.

— Jam ordinancë.

— Aha, unë kujtova se je rojë! — tha ajo dhe me dy hapa arriti derën e zyrës së majorit. Kur nënoficeri thirrri, kur ai u fut brenda prapa saj, tashmë Folta ishte para majorit dhe majori, pas një ngurrimi të vogël, ia bëri me dorë ordinancës të dilte jashtë.

Majori duhej të ishte një burrë shumë i gjatë, për-

derisa koka e tij, megjithëse i ulur, gati barabitej me kokën e Foltës që ishte në këmbë. I veshur pastër, me flokët të ndarë në mes me shteg të drejtë e të krehur me kujdes, majori ishte edhe i pashëm, edhe më i ri se kapiteni që shtinte fall, por shumë më i moshuar se togeri që kryente shërbimin te porta. Hoqi vështrimin nga ajo dhe vazhdoi të shkruante. Kur shkruante, anonte kokën, nxirrte pak majën e gjuhës dhe e kafshonte lehtë. Dhe shkroi gjatë. Pastaj lexoi me vete atë që shkroi. Pastaj i tha Foltës të ulej, Folta nuk u ul, por hodhi një hap tjetër përpara.

— Kam ardhur...

Majori e ndërpreu me lëvizjen e dorës së madhe dhe vazhdoi të shkruante. Pastaj prapë e lexoi atë që shkroi, e palosi, i ra ziles që kishte një tingull si zile cjapi dhe, kur hyri ai që quhej ordinancë (e jo rojë), e porositi t'ia shkruante në pesë kopje. Ordinanca shikoi me habi e me çudi gruan e veshur me të zeza, pastaj u tërhoq.

Një copë herë majori trupmadh vuri nëpër vendet e veta penën bishtgjatë, shishen e bojës, një paketë cigaresh, i çoi përsëri atje ku kishin qenë pak më parë, shikoi pjerrtas sipërfaqen e tavolinës, i fryu, e fshiu dikë me pëllëmbë të dorës, pastaj foli me ton prej zotërie:

— Çfarë kërkon nga unë, zonjë?

— Genc Boga i shpalljes është nipi im!

— Shëndoshë qoftë atje ku është! — foli majori me ton mospërfillës.

— Dua të di, çfarë ka bërë!?

— Njohe ndonjërin prej kufomave?

— Veteranin e Luftës e njohin edhe fëmijët!

— Ja, atë deshi të shpëtonte nipi yt, por...

Folta priti në heshtje.

— ... edhe nipi yt atë rrugë ka nisur! — plotësoi majori me ton të atillë, që tregonte se biseda midis tyre kishte marrë fund.

— Dua të di edhe për Krist Papin, — tha Folta, — që është ushtar me nipin tim!

— Ç'e ke ti Krist Papin?

— E kam djalë!



Busti i madh i majorit sikur kërceu përpjetë. Pastaj u qetësua dhe pyeti:

— Po ç'ke dëgjuar për djalin tënd?

— Jam në merak se mos i ka ndodhur gjë. Përderisa Veterani i Luftës u vra, përderisa nipi im doli firar, diçka ndodhi atje, diçka mund t'i ketë ndodhur edhe djalit tim!

Majori, që kishte një zakon të mirë, zakonin e kundërt me të ordinancës (ky i fundit s'të shikonte kurrë në sy), pa e hequr vështrimin nga fytyra e bardhë e Foltës, u mendua një copë herë. Përsëri, pa e hequr vështrimin nga ajo, afroi një dosje të zezë, i hapi kapakun dhe, duke kërkuar me pulpat e gishtave, ngriti prej aty një letër të vogël në formë katrore, të cilën, pasi e lexoi me vetulla të ngritura, tha me tonin e tij tmerrësisht asnjanes:

— Krist Papi, zonjë, ka qenë pak i sëmurë. E kemi shtruar në Spitalin Ushtarak të Tiranës. Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar!

— Mos është plagosur? — pyeti jo pa hidhërim Folta.

— Jo, zonjë! — u përgjigj qetë majori. — Së shpejti do të të kthehet në shtëpi me leje!

U shikuan për të fundit herë, duke lyer njëri-tjetrin me dyshimet e rastit dhe, si ta kishin bërë me fjalë, majori kërrusi kokën në tavolinë për të vazhduar punët e tij «të mëdha», Folta Papi u rrotullua mbi thembra për të dalë jashtë zyrës, jashtë oborrit dhe jashtë kazermës dhe, duke u çapitur me hapin prej burri e me cingërimën e pafatave të çliruara, u kthye në restorant.

Myshterinjtë që gjeti në trotuar (ndonjë nëpunës, ndonjë beqar plak a të ri, ndonjë kalimtar të rastit), i pyeti:

— Mua më prisni?

— Po! u përgjigjën ata.

U shërbeu pa thënë asnjë fjalë, u mori paratë, i futi në qeskën që e mbante të varur në qafë, kryqëzoi duart në gjoks dhe shikoi në rrugë, si të shikonte fundin e botës.

## VIII

Daklea uli fitilin e llambës.

— S'kemi veçse një të gatuar miell dhe një trastë me kallinj misri, — tha ajo. Vetullat e saj lëviznin çuditërisht mbi ballë, si dy qenie të vogla e të pafuqishme, që kanë humbur rrugën. Kurse Mentarit, tek e shikonte të tillë, ia kishte qejfi të mos i fliste fare për takimin e për bisedën me Hasan Mangën e me Veniamin Çekun. Dhe as për shpalljen që dënonte Genc Bogën. As për Veteranin e Luftës. Të gjitha këto kishin të bënin me realitetin, kurse ai qe bindur nga dita në ditë se ky lloj realiteti Dekleas i duhej fshehur, ose të paktën i duhej veshur me një cipë të hollë: nga dëshpërimet e njëpasnjëshme ajo parapëlqente më shumë të jetonte në buzë të iluzioneve.

Mentari e ndjeu se kishte ardhur një çast kur Daklea, e shtrirë aty pranë, priste përgjigje. Në të vërtetë, ai dëshironte t'i thoshte diçka që të ishte... shpresëdhënëse por, që të ishte e tillë, ajo duhej të ishte patjetër e gënjesh-tërt.

— Mentari, a më dëgjove çfarë të thashë?

Në këndin tjetër të dhomës ngrihej si pëshpërimë frymëmarrja e qetë e fëmijëve që flinin.

— Të shesim makinën qepëse! — tha befasi Mentari.

Instinktivisht të dy kthyen kokën nga makina «Singer» në qoshe të dhomës, që mezi ndriçohej pak nga llamba me fitil të ulur.

— Makinën?

— Është e vetmja gjë me njëfarë vlere që na ka mbetur, kurse kamata për borxhin është rritur shumë, — tha Mentari. — Veniamin Çeku mund ta shesë vilën në ankand kur t'i dojë qejfi!

Daklea u zverdh dhe u duk e plakur dhjetë vjet mënjëherë: fytyra sikur iu zbërthye brenda një çasti, si nga



dora e një kirurgu zemërlig. Dhe e gjithë qenia e saj dukej e mjerë, e pafuqishme, e mundur...

Heshtja që vazhdoi gjatë, sikur i kujtoi Mentarit dhimbjen e kokës që i kishte filluar në orët e para të mëngjesit, pikërisht në restorantin e Folta Papit. Po tashti ajo po i jepte goditjet e fundit, po bëhej e plotfuqishme, po i pushtonte qepallat, që i kishte të ftohta si dy copa akulli.

— Vilën të na shesë Veniamin Çeku?

— Po! — tha ai.

Daklea u kthye në krahun tjetër dhe befas qau mbytur, me dënesë, me ngashërim.

— Mos qaj, Daklea, mos qaj, Dakle, Dati, Daklush, Dake! — iu lut Mentari.

Emrat e saj, të shkurtuar me përkëdheli, sikur mbetën pezull pa kuptim.

— Hasan Manga më kërkoi një deklaratë, — tha prapë Mentari, — ku të mësoj revolucionin që bëme!

— Ashtu?!

— Përndryshe s'do të ketë kurrë punë për mua!

Tha Daklea:

— Jemi të humbur, Mentari! — dhe e shikoi të shoqin me frikë, me dëshpërim, por edhe me turp, edhe me një zjarr, që i ndizej diku në thellësi të bebëzave, nga shkëndijimet e fshehura të të cilave buronin një mijë pikëpyetje.

Të shtrirë në dyshek, gjithnjë pranë njëri-tjetrit, ata mbetën ashtu të heshtur, si dy qenie që diçka i ndante dhe diçka i bashkonte.

— Dua të të them edhe një gjë, — tha Mentari me zë të ulët, por të vendosur.

— Mos është fjala për trazirën rrëzë Maleve të Shqipësi?

— Po, — tha Mentari. — Bile edhe te varoshi para portës sonë kanë varur shpallje me fotografinë e tij!

— E lexova!

Përtej kornizës së dritares dukej qielli me yje. Po nga ajo kornizë u futën deri në dhomë hapat e njohur të patrullës, që ishin akoma të largëta, akoma të mbytura. Ngrohtësia e natës së korrikut, lyer me dritën metalike të

hënës, sikur u jepte atyre një kumbim të mistershëm. Kur arritën te porta e vilës, si zakonisht, hapat qëndruan pak. E, si zakonisht, kjo heshtje ishte e rëndë, ishte torturuese. Daklea shtrëngoi dorën e Mentarit dhe Mentari vuri re se dora e saj dridhej. Pastaj hapat ndoqën rrugën e përnatshme, djathtas, përsëri djathtas, duke përshkuar një gjysmë harku gjatë mureve që rrethonin vilën dhe konturet e shtëpisë me çardak e me qemer, derisa trokitën gjithnjë thellë e më thellë.

Tha Mentari:

— Unë do të lidhem me Genc Bogën me anën e xha Telit e të Lato Morinës!

Daklea, që deri tashti e kishte mbajtur të ulur fitilin e llambës, me të dëgjuar fjalët e fundit të Mentarit, bëri të kundërtën, e ngriti dhe u duk sikur harroi të merrte frymë. Fytyra e saj, që ruante akoma diçka nga bukuria femijërore, u shndërrua në maskë gipsi, lyer me bojë të verdhë.

— Mund të ketë nevojë për ndihmën tonë, — vazhdoi Mentari.

— Po sikur ta diktojnë? — pyeti Daklea.

— Atëherë do të bëjmë luftë! — tha Mentari, si të kishte thënë: «Atëherë do të bredhim!» — Dhe pas pak, duke ndier tronditjen e Dakleas, (këtë të fundit e kishte tradhtuar frymëmarrja), ai shtoi: — Po ne tërë jetën luftë kemi bërë!

Kur shuan llambën dhe mbyllën sytë për të fjetur, Daklea e kuptoi se nuk do ta zinte gjumi menjëherë.

Por as Mentari s'kishte gjumë. Tashmë atë e kishte mposhtur dhimbja e kokës, që e kishte dërgjur të pafuqishëm, që e kishte zbehur, që i kishte nxirë buzët dhe jeshiluar faqet.

Të nesërmen ai nuk qe në gjendje të thoshte në kishte fjetur dhe sa orë kishte fjetur, po ajo që mund të thoshte me siguri, ishin ëndrrat e njëpasnjëshme që kishte parë. U ngrit, u vesh dhe doli në oborr. Aty ndjeu zbërthimin e luleve, atë lëvizjen e fshehtë të degëve, të gjetheve e të gonxheve, kur ato drithërojnë e fërgëllojnë nga afshet e para të ditës. Pastaj dëgjoi këngën e vonuar e të përgjumur



të kandrrave, dëgjoi edhe zhurma të tjera të njohura dhe, siç e priste, e ndjeu veten në një botë të afërt, miqësore e të ngrohtë, në një botë që e grishte për buzëqeshje e që i kumtonte besim të plotë.

M-m-m, dhia.

Ë-ë-ë, keci.

— Mirëmëngjesi! — shakatoi Mentari dhe u ngjiti majë murit me mistri në dorë.

Kur ora e madhe e qytetit ra gjashtë herë, te sheshi para bashkisë u dëgjua zhurma e atij që mund të quhej autobus, i cili do të çonte udhëtarët e parë në Tiranë. Nga bashkia në bashki,

## IX

Teli Bashari u ra me gisht mustaqeve të thinjura, si të ishte kjo një gjë krejt e detyruar, para se të ulej në karrigen që i kishte afruar Daklea.

Llamba e vajgurit varur në mur, ndriçonte njëren faqe të Mentarit, faqen tjetër të Dakleas dhe të gjithë fytyrën e plakur të Telit, që ishte ulur përballë. Pas pak, përveç tre trupave të palëvizur rreth tavolinës, në faqen e murit u projektuan edhe dy kokat e fëmijëve: koka e Letës me flokë të gështenjë si të së ëmës dhe ajo me flokë të qethur e Gimit, kopje e vogël e kokës së Mentarit.

Teli Bashari shikoi njëherë rrotull, si për t'u siguruar nga ndonjë i huaj, pastaj buzëqeshi. Ai kishte një buzëqeshje, që, sado e vogël dhe e shkurtër të ishte, ia ndry-

shonte krejt fizionominë. Së fundi, vështrimi i tij u mblodh dhe ra mbi Dikët që kishte përballë.

— Keq, — tha ai. — Fshatrave s'ka më punë për mua. Në qytet s'më lënë për shkakun e taksave!

Pamja e Teli Basharit që rënduar menjëherë. Fytyra e tij, prerë nga rrudha në formë rombesh e kubikësh të vegjël, që ishin të panumërt, që jetonin secili për hesap të vet, të shkëputur nga njëri-tjetri e që në të njëjtën kohë përbënin një mozaik të vetëm, sa herë që kjo fytyrë rëndohej, të gjithë këta kubikë rombe e rrudha ç'ishin, shumëzoheshin si me magji, ndërsa lëkura i çahet si toka në kohën e thatësirave të mëdha.

Nën reflekset e kuqe të llambës, sytë kafe të çelët të Dakleas digjeshin.

— Në fshatra kishte lëvizje xhandarësh, — tha Teli, duke shikuar errësirën përtej dritares. — Ndjekin Genc Bogën!

Mentari e Daklea e shikonin me kureshtje. Teli fliste me frazat e tij të shkurtra. Ashtu kishte folur tërë jetën ai. Dhe tërë jetën politika kishte qenë gjëja me të cilën ishte marrë më pak. Nëse votonte për popullorët, këtë e bënte jo se kishte parë ndonjë të mirë nga ata, por sepse të paktën ishin njerëz që i shikonte me sy. Kurse bejlerëve të mëdhenj, që e kishin zakon t'i merrnin votat me kërcënime, as që ua njihte fytyrën, bile ai kishte dëgjuar se ata nuk jetonin në Shqipëri, dhe ktheheshin këtu vetëm në kohën e të tretave. Përveç fshatrave rreth qytetit N, që me torbën e këpucarit në krah i kishte shkelur pëllëmbë për pëllëmbë, Teli s'kishte pasur kurrë kureshtje të shkonte gjëkund tjetër. Kudo i dukej njëlloj. S'kishte pasur kurrë shokë të afërt, as miq të veçantë, por vetëm të njohur. Një jetë e heshur, një jetë e mbyllur si e shumë të tjerëve. I vetmi qëllim dhe gëzim i tij kishte qenë sigurimi i bukës së gojës. Po me Dikët ishte afruar, së pari, sepse ata e kishin lejuar të ngrinte një dhomë mbi themelet e shtëpisë së tyre të vjetër, e, së dyti, i kishte fqinjë, por ishin edhe njerëz të mirë e të ndershëm Dikët dhe si të tillë vuanin nga Ahmet Zogu, që ishte njeri i keq, që varte



e vriste, që kishte braktisur njerëzit e varfër e që në kohën e tij arat prodhonin më pak drith, vreshtat nuk jepnin rrush, tufat e bagëtive pakësosheshin e çdo gjë tjetër shkretuhej dita-ditës. Të gjitha këto të këqija kishin rrjedhur nga Ahmet Zogu, që përmbysi Fan Nolin, për të cilin xha Teli dëgjonte shpesh, se ishte burrë i mirë. Këtu mbaronte politika e xha Telit, pjesa tjetër e jetës dhe e mendimeve të tij, që ishte pjesa më e madhe, lidhej ngushtë me trastën e me çekiçin e këpucarit endacak. Por sonte, jo, sonte dukej që ishte interesuar edhe për politikë, prandaj vazhdoi:

— Dëgjova se Veterani i Luftës dhe fshatari që e strehonte kishin luftuar të rrethuar në një shpellë derisa ishin vvarë. Vetëm Genc Boga, që është gjallë e që ka gisht në këtë çështje, vetëm ai mund ta dijë të vërtetën si i zbuluan. Kurse Lato Morina më tha se do ta kërkonte Genc Bogën e do të dilte komit bashkë me të!  
— Kështu tha Teli dhe befas buzëqeshi hidhur, po sado të hidhur ta kishte buzëqeshjen, sado që rrudhat t'i thelloheshin më shumë, fytyra e tij mbetej gjithashtu fytyra e një plaku të urtë, të butë e të dashur.

Ata biseduan edhe hollësi të tjera për Veteranin e Luftës e për ngjarjen dhe gjendjen në fshatrat rrëzë Maleve të Shqipërisë. Pastaj Teli u foli për një trazirë tjetër në malësi, që kishte të bënte me një gjyq të vjetër, të cilin e kishte fituar me të padrejtë Hasan Manga dhe u kishte rrëmbyer malësorëve kullotat më të mira. Malësorët do ta apelonin vendimin, po Mentar Dika tha se përsëri nuk do të fitonin gjë, vetëm me pushkë, tha ai, mund t'u dilet atyre.

— Po këto fjalë kishte thënë edhe më plaku i malësorëve, me pushkë! — E ngriti zërin Teli Bashari. Pas këtij zëri të ngritur e pas fjalës pushkë, dhomën e pllakosi heshtja. Dhe Teli Bashari, si të kishte pritur pikërisht këtë heshtje, u ngrit ngadalë, duke thënë:

— Unë po shkoj, — po nuk kishte bërë as dy hapa, qëndroi menjëherë, si të qe kujtuar për dicka dhe nxori nga peshqiri, lidhur pas brezit, një gjysmë buke misri.

— Nga fshati, — tha duke e vënë në cep të tavolinës.



— Falemnderit!— tha Daklea.

— Kaq më teproi! — Rombet dhe kubikët sikur u shkoqën nga fytyra e tij, sikur u shpërndanë dhe ranë poshtë nëpër dysheme. Ai s'ishte mësuar ta falënderonin. — Lato Morina më tha se do t'ju ndihmojë me ç'të mundet!

Drita e hënës qe derdhur nëpër oborr, nëpër kopsht e mbi çatinë e dhomës së vetme të Telit, pranë arrës së madhe. Te shkallët e ulëta të vilës, ai bëri një pyetje që, si rregull, duhej ta kishte bërë në fillim:

— Ç'flitet për ty, Mentar?

— S'duan të më japin punë!

— Turpi u rëntë mbi kokë! — Rombet dhe kubikët sikur u ngritën nga toka dhe zunë sërish vendin e tyre në fytyrën e Telit, secili për hesap të vet.

Ndërsa e përcillnin përmes mbeturinave e gërma-dhave të shtëpisë me çardak e me qemer, qëndruan përpara dhisë dhe kecit. Keci hapi sytë e dremitur, të gjelbër e të pastër. Dhia përtypej krap-krap-krap dhe mund të thoshe se në të njëjtën kohë që përtypej edhe flinte.

Teli Bashari (duke shikuar nga dhia):

— Të paktën fëmijët t'i pinin qumështin, por e bëri të vonë kecin. Natën e mirë!

— Natën e mirë!

Teli Bashari u kërrus te deriçka dhe kaloi në oborrin e shtëpisë së vjetër, që ndahej nga vila me një mur të ulët. Pas pak silueta e plakut u fsheh në mjegullirat e hënës.

— Xha Teli! — thirri befaz Mentari. Përtej hapat e xha Telit qëndruan.

Daklea e ndoqi me sy të shoqin derisa ai humbi në hijet përtej arrës së madhe, ku ndodhej dhoma e Telit. Tashti ata do të bisedojnë për Lato Morinën e për Genc Bogën, mendoj ajo. Këtë të fundit Daklea kishte pasur rast ta shikonte vetëm një herë, në sallën e ankandit, gjashtë muaj më parë, kurse Laton e njihte fare mirë ajo, Laton e kishin mik të afërt e të besës...

... Shtëpia e Lato Morinës ndodhej buzë një pylli. Ajo ishte një shtëpi e vjetër, një mijë herë e nxirë nga bloza, një mijë herë e lyer dhe e djegur nga gëlqerja. Por ajo ishte buzë pyllit dhe në parvazin e dritares së vogël trokitnin



bisqet e trëndafilave të egër. Më tutje një lumë i qetë dhe përballë pyllit shtriheshin livadhe gati të pashkelura, si qilim më ngjyra shumë, ku zotëronte ngjyra e bardhë e luledhenve. Mentari me Daklean ishin si të dehur nga rinia, nga dashuria, nga aromat e pyllit, nga shushurima e lumit, nga ajri i fushave. Dhe nuk ndaheshin kurrë nga njëri-tjetri. Ajo çuditej sa shpejt i kishte dalë turpi, çuditej me lëvizjet që bënte kur zhvishej para Mentarit dhe shikonte trupin e vet aq të gjallë e të lakueshëm. Atëherë afërsia e faqeve të ndezura dhe vezullimi i fshehtë i syve të çelur të Mentarit, e mbushnin me dëshirë gjithë qenien e saj. Pastaj ata rrinin si në kllapi e në ekstazë, pa menduar për asgjë dhe këto ishin çastet që u pëlqenin më shumë se të gjitha çastet e tjera të jetës së tyre në fshat. Po këto qenë vetëm ditët e para dhe vetëm përshtypjet e para. Më vonë Daklea u mësua të shikonte vuajtjet e fshatarëve, që punonin shumë, që ishin të ngrysur, që ishin si njerëz e si hije dhe atje ajo kuptoi për herë të parë se jeta ishte e vështirë dhe duhej forcë e vullnet për ta përballuar. Megjithatë, magjia e muajit të mjaltit qëndroi mbi çdo realitet dhe dukej qartë se të dy ata kishin frikë ta shkatërronin atë botë. Po shtatori po afrohej, reparti i Mentarit do të niste stërvitjet në fushën e kazermës, kurse atë vit Daklea do të dilte për herë të parë para nxënësve me regjistër në dorë...

Atje pra, në shtëpinë e Lato Morinës kishte filluar jeta e vërtetë e Dakleas që pastaj, gjatë shtatë vjetve të tjerë do të mbushej me aq emocione dhe kujtime, të cilat ajo i rezervonte për t'i radhitur dikur në të ardhmen. Por tashmë, duke marrë me mend se çfarë bisedonte Mentari me xha Telin e se ç'kuptim kishte për jetën e tyre kjo bisedë, padashur Daklea u ul, si e shtypur nga një peshë e rëndë dhe priti, duke menduar shumë gjëra, që mund të fillonin nga Genc Boga, deri te fëmijët, të cilët flinin qetë, siç mund të flenë vetëm ata në një natë të ngrohtë vere. Pastaj ajo hodhi vështrimin nëpër kupën e qiellit, ku yjet xixëllonin e feksnin me dritën e tyre minerare. Disa nga yjet ndriçonin e dridheshin më shumë e më shumë se të tjerat, llapsnin si më të shuar, thua jse atje



lart frynin korrente të forta. Pa e hequr vështrimin nga qielli, befas Daklea pyeti me vete se ku mund të ndodhej atë natë Lato Morina, që do të kërkonte Genc Bogën e ku mund të ndodhej Genc Boga, që sigurisht ndiqej këmba-këmbës nga koshadhet e xhandarëve. Ajo e bëri disa herë këtë pyetje, e bëri me ngulm dhe vështrimin nuk e hoqi nga qielli, mu sikur Lato Morina dhe Genc Boga të gjendeshin midis yjeve, apo diku prapa e përtej tyre.

Ja kështu, në një natë vere, gati dhjetë vjet më parë, kur ajo sapo kishte shkelur në të tetëmbëdhjetat, ulur buzë hajatit bashkë me të ëmën, hidhte vështrimin nëpër qiell.

— Çfarë mendon? — e kishte pyetur e ëma.

— Kam dëgjuar se çdo vajzë ka yllin e vet në qiell. Thonë se, po ta gjejë atë yll, atëherë mund t'i plotësohen të gjitha dëshirat!

— Edhe ne kur ishim të reja kemi dëgjuar të flitej për këto yje! — kishte thënë e ëma dhe pastaj dora e saj i kishte shpupuritur flokët. Këtë shpupurisje Daklea e ndiente të gjallë e të ngrohtë edhe tashti dhe u desh të kalonin disa çaste që të kujtohej se Mentari ishte kthyer nga xha Teli, ishte ulur pranë saj dhe, në vend që t'i fliste, kishte zënë t'i shpupuriste flokët ngadalë e me dashuri si dikur e ëma.

Befas, në një kënd të qytetit, u dëgjuan krisma pushkësh. Nata u duk sikur e pushoi frymëmarrjen. Përpjekja reale ose imagjinare dukej shqetësuese dhe e dendur. Si ish-oficer i karrierës, Mentari Dika e merrte me mend se në këto raste ndodhte që xhandarët t'i push-tonte epidemia e dyshimeve dhe të shtinin kot, edhe po të lëvizte një degë e thatë, edhe po të zvarritej një breshkë, pa le pastaj një gomar, apo derr i egër...

Ndërsa krismat jehonin nëpër natë, Daklea u shtrëngua pas Mentarit dhe Mentari e mbajti po aq të shtrënguar pas vetes.

— Ndoshta ndjekin Genc Bogën, — tha ajo.

— Ndoshta! — tha Mentari.

Në kupën e qiellit hëna dhe yjet, pavarësisht nga krismat, shkëlqenin si më parë.



## NJERËZIT ME TË ZEZA

— ... ai, me dy fëmijët për dore, u fut në gjellëtoren e Folta Papit, takoi Hasan Mangën në zyrat e shoqërisë SITA, lexoi shpalljen për Genc Bogën, qëndroi pranë dy kufomave, takoi Veniamin Çekun në hotel «Venecia» dhe...

Për herë të parë gjatë asaj seance njeriu me të zeza, i ndriçuar tërthor nga një llambë e fshehur diku, bëri një rotullim të ngadalshëm të bustit dhe që nga lartësia e katedrës dukej sikur në vend të fytyrës kishte vënë një katërkëndësh kënddrejtë, në të cilin shquheshin dy të çara që, përveç simetrisë ku ishin ngulur, s'kishin asgjë tjetër të përbashkët me sytë. Prapa këtyre të çarave dhe anash katërkëndëshit (kënddrejtë) llapat e veshëve, të ndriçuara dobët, ngjanin me gremina të zhytura përjetësisht në errësirë. Balli, gjithashtu, gjysmë i errët, i dystë si pllakë, të kujtonte shkretëtirat, ku mund të lulëzojnë vetëm pedantizmi si dhe shumë izma të tjera, të gjitha izmat e botës.

Njeriu tjetër, gjithashtu me të zeza, që fliste poshtë dhe përballë katedrës, që mbante një zarf midis gishtave e që kishte zgjatur dorën, e mbajti frymën dhe për një çast e për të gjitha çastet e mëvonshme shëmbëlleu me një grumbull leckash të zeza e të mjera. Tha:

— **Signor colonnello,**<sup>1)</sup> në këtë relacion është gjykimi dhe mendimi im për ndjekjen e çështjes së Mentar Dikës! Ai me të zeza, që shikonte e dëgjonte nga katedra, me një dorë mori relacionin, me tjetrën fërkoji ngadalë


1) (it.) — zoti kolonel

mjekrën e gjatë me majucë, qimet e së cilës i zbritnin poshtë, të përthyera mbi gjoks.

Pas këtyre fjalëve, makina e shkrimit, që çukiste diku në dhomë, heshti. Dritat e fshehura u shuan. Njeriu nga katedra mbeti aty si një statujë e zezë e braktisur bodrumeve, kurse ai që kishte raportuar (grumbulli i leckave të zeza), u shkëput ngadalë nga errësira e dhomës dhe gjarpëroi nëpër një korridor edhe më të errët. Te dera e vogël prapa ndërtesës, silueta e tij, që tashmë mbante në dorë një si relik, u ndesh me një tjetër, që futej gjithashtu në heshtje, siç ishte futur edhe ai disa minuta më parë. Adelaida e re dhe e bukur e hotel «Veneçias» eci lehtë, duke tundur vithet, si ato macet e kënaqura e të velitura nga dashuritë e shumta, që fillojnë majë çative, por që përfundojnë skutave të errëta. Në çastin e shkëmbimit, dy siluetat u shikuan sy në sy, njëra tundi bishtin me agresivitetin e një maçoku, tjetra lëpiu buzët me ephendjelljet e një maceje.

Rreth kostumeve të tyre të zeza, drita e hënës e kishte humbur ngjyrën e argjendtë.





## PROLOG 2

Kryetari i gjyqit nguli vështrimin drejt stolit të të pandehurve, në mënyrë të atillë, sikur ata të ishin disa sende ose objekte që ai nuk i kishte parë kurrë më parë.

Tha:

— Ej, ju atje, zgjohuni!

Të pandehurit, megjithëse ishin të lodhur, nuk flinin, por mund që ndonjëri edhe dremiste. Ata sikur u shkurdën, ngritën kokat dhe secili, ngadalë e pa u ngutur, rrotulloi qafën dhe hodhi vështrimin drejt kryetarit.

Pas këtij gjesti të të pandehurve, fytyra e trashë dhe e kuqe e kryetarit u bë e butë, u bë e durueshme, u bë kështu sinonim i vetë gjykimit dhe i vetë drejtësisë. Tha (me zë të ulët):

— Unë dua t'ju gjykoj dhe t'ju jap vetëm dënimin



e merituar, asgjë më tepër, asgjë më pak. **Justicia est ars boni et aequi**, ka thënë latini, drejtësia është arti i së mirës dhe i barazisë. Po në qoftë se ju nuk flitni, në qoftë se ju do të vazhdoni të na gënjeni, sikur gjoja s'keni bërë asgjë e sikur gjoja nuk njiheni fare midis jush...

— As kemi bërë gjë, as njihemi, as ishim parë më parë! — (I pandehuri i pestë, sipas radhës.)

— ... po në qoftë se ju do të vazhdoni të na gënjeni se nuk keni pasur gjoja asnjë lidhje me të mërguarit shqiptarë...

— Nuk njoh asnjërin prej tyre! — (I pandehuri i katërt.)

— ... po në qoftë se ju do të vazhdoni të ngulni këmbë e të mos pranoni se vepronit sipas udhëzimeve të Federatës Komuniste të Ballkanit...

— Çka po thotë ky, bre? (I pandehuri i tretë.)

— ... po në qoftë se ju do të vazhdoni të mohoni, se në këtë situatë festive, kur i gjithë populli gëzon dhe përgatitet të votojë për deputetët e të presë me krahë hapur monarkinë, ju mbushnit armët për të vrarë kryetarin e republikës...

— Fakte, zoti kryetar, fakte! — (I pandehuri i dytë.)

— ... atëherë unë do të jem i detyruar të mos pranoj asnjë rrethanë lehtësuese dhe, midis plumbit e litarit, të zgjedh litarin...

— Zoti kryetar, të jeni pak më i njerëzishëm! — (I pandehuri i parë, i cili, në ndryshim nga të tjerët, kish-te pamje dhe ton ironik!)

Salla paksa u valëvit. Dhe mbi këtë valëvitje sikur fluturoi një ilaritet i lehtë dhe i përmbajtur. Megjithatë, xhandar Kika shikoi rrotull si të shikonte një fole mizash. Sateliti i tij, xhandar Jonuzi, që pak sa shquhej midis supeve e bërrylave të xhandarëve të tjerë, lëvizti si majmun i shqetësuar në kopshtin zoologjik.

Kryetari i ra ziles për të vendosur qetësinë dhe pikërisht në këtë çast, prokurori u ngrit ngadalë, si t'i kishin zënë ndryshk kyçet e këmbëve. Ai kishte një trup mesatar, të drejtë, shpatulla të gjera dhe ishte burrë i bukur. Ky burrë i bukur, pasi i hodhi një vështrim sallës,



që prej disa ditësh manifestonte hapur shenja pakënaqësie e që sot kishte filluar të kalonte edhe në ilaritete, pasi shikoi trupin gjykues, avokatët mbrojtës dhe pesë të pandehurit, për një apo më shumë se një çast qëndroi i pikëlluar... (sigurisht, për mjerimet që kishin pllakosur botën!) Pastaj, dalngadalë sytë i ndritën me një shikim të egër dhe në çastin tjetër, pasi bëri disa gjeste të stuhishme, shpërtheu:

— Ja, ky qimekuqi, — tregoi ai me dorë të pandehur in e tretë dhe ngriti nga tavolina ca letra për t'i gjetur emrin, po meqë u vonua e meqë ekzistonte rreziku se mund t'i fluturonin mendimet, i lëshoi letrat mbi tavolinë dhe kërcënoi me zë të fortë: — Ja ky, zoti kryetar e zotërinj gjyqtarë, është jo vetëm një komplotues, por edhe para katër vjetësh, në kohën e Revolucionit famëkeq, që ia nxiu faqen historisë së Shqipërisë, ka qenë anëtar i shoqërisë «Bashkimi» që në ditët e para të themelimit të saj.

Nuk ishte vështirë të kuptohej që i pandehuri i tretë (sipas radhës gjithmonë) dëgjonte me vëmendje, sepse ato që flitëshin aty i kalonin mundësitë e tij mendore, kulturore dhe politike.

— Ku i gjen, more zot, gjithë këto fjalë e gjithë këto rrena! — u çudit ai.

Kryetari: — I pandehur, do të të nxjerr jashtë nga gjyqi!

Avokati mbrojtës: — Zoti kryetar, nuk e pati me qëllim të keq. I pandehuri është kasap dhe nuk ka dëgjuar kurrë emra shoqërisë e partish!

Kryetari: — Ne disponojmë fakte, që ai, dora vetë, ka marrë pjesë në mbledhjet e fshehta, ku është vendosur të vritej kryetari i Republikës!

Avokati mbrojtës: Argumentet nuk janë akoma të plota.

Kryetari: — Zoti avokat, do të të gjobit me njëqind franga, sikur edhe një herë të vetme të flasësh broçkulla të tilla!

Avokati mbrojtës (i zverdhur): — Si urdhëron! — dhe u ul si hije.

Kryetari: — Kurse ky tjetri (shënoi me gisht të pan-



dehurin e pestë, që ishte një burrë pesëdhjetëvjeçar, me benevrekë të bardha e xhoke të zezë, me mustaqe të gjata e me qeleshe të gjatë, nën petkun e jashtëm, përpigjet jo vetëm të fshehë lidhjet e tij me Federatën Komuniste Ballkanike (ilaritet në sallë), por të fshehë edhe pjesëmarrjen e tij në grupin komplotues që ndodhet para jush.

I pandehuri e shikonte kryetarin sikur ky i fundit të kishte zbritur nga bota e çudirave.

Kryetari: — Ti, i pandehur, pesë muaj më parë, pikërisht më datë dhjetë mars një mijë e nëntëqind e njëzet e tetë je takuar me të pandehurin Selim Keçi (kryetari shënoi me gisht të pandehurin e parë që rrinte shtrembër në stol) dhe i ke thënë se duhet të armatoseni sa më shpejt...

I pandehuri i parë ia preu fjalën kryetarit me një ligjëratë më të gjatë se çdo herë tjetër:

— Dulla të më ketë folur mua për armë?! Paqë, zoti kryetar, paqë!

Kryetari: — Ç'është kjo paqë që kërkon ti? Seneka ka thënë **vivere militare...1)**

Por i pandehuri i parë, që ishte dispeptik kronik, e që rrinte shtrembër në stol, nuk kishte nge të dëgjonte deri në fund ç'kishte thënë Seneka. Ai kërceu në këmbë dhe vrapoi drejt derës së pasme. Edhe xhandari që i rrinte prapa, deshi apo nuk deshi, për të ruajtur pastërtinë e atmosferës, u detyrua të shkonte menjëherë pas tij.

Heshtje e tendosur. Si rregull pritej ndërhyrja e avokatit mbrojtës të të pandehurit të parë, prandaj edhe kryetari jo më kot shikoi nga tavolina e avokatëve. Por avokati nuk u ngrit. (Dihet: çdo rregull ka përjashtimet e veta.) Megjithatë kryetari prapë shpresonte se avokati do ta bënte ndërhyrjen e vet dhe dukej sheshit që ai mezi e priste atë çast, për të zbratur frazat e mëdha e plot efekt që kishte parapërgatitur e që do të përfundonin patjetër me dyqind franga gjobë. Por, në vend të avokatit, u dëgjua zëri i fortë i prokurorit:

---

1) (lat.) — Të rrosh, do të thotë të luftosh...



— Zoti kryetar, zotërinj gjyqtarë, jemi në momentet e fundit të këtij procesi. S'na duhet veçse *ultima ratio*.<sup>1)</sup> Para se të tërhiqeni për të marrë vendimin gjyqësor, dua t'ju kujtoj disa fakte dhe vetëm disa fakte. Duhet të keni parasysh se në bankën e të pandehurve kësaj radhe janë ulur pesë kriminelë të regjur, rrënjët e të cilëve shtrihen thellë e shkojnë larg në ha-pë-si-rat ndër-ko-mbë-ta-re. Mos harroni, zotërinj, se këta kriminelë përgatitshin për të vrarë atë njeri, që me duart e veta e shpëtoi kombin shqiptar nga kthetrat e Revolucionit famëkeq fanolist dhe qysh nga ajo ditë, si një amvisë e mirë, gatuan me mendjen e tij të ndritur lumturinë e këtij populli, trim e bujar. Çudi mund të dukej për Shqipërinë e djeshme jeta që po krijon sot ai, plot forma të reja, plot lëvizje, plot shkëlqim e tinguj të xhazeve nëpër sallonet e klasës së lartë. Sot Shqipëria po paguan haraçin e modës, po vesh frakun dhe kollaren, ndërsa brekushet e bardha me xhoken e zezë shpejt do të bëhen lëndë kujtimesh dhe pjesë të muzeut kombëtar. Po mbillet shija e jetës, po zhduken format e saj arkaike dhe në shpirtin e klasës më të përparuar, të klasës intelektuale po ndizet dashuria për ta shijuar sa më mirë këtë jetë të shkurtër. Pse jo? Sa kohë rron njeriu? Mesatarisht dyzet vjet. Pse atëherë të mos merren frytet më të mira që piqen në drurin e kulturës së sotme? *Carpi diem*, ka thënë poeti i lashtë nxirrja ditës frytin e saj. Çudia po zbret në realitet. Dhe asaj po ia hap rrugën shkopi magjik i kryetarit të nderuar të Republikës, shkëlqesisë së tij Ahmet Zogut, të cilin këta kriminelë deshën ta vritnin. Vetëm për këtë fakt, zoti kryetar e zotërinj gjyqtarë, kriminelët që ndodhen në bankën e të pandehurve, meritojnë dënimin me vdekje në litar.

— Po jeni tuj na prishë kot, bre zotnej! — (I pandehuri i tretë.)

Ah! Prokurori fluturoi i tëri përpjetë. Gjahu i kishte dalë në shteg dhe i kishte dhënë rastin të përdorte një

---

1) (lat.) — argumenti i fundit



nga molekulat e rralla të kulturës së tij profesionale.  
Tha:

— **Fiat justicia, pereat mundus!!**

Pas kësaj fraze prokurori kishte mbetur me supe të ngritura, me dy gishtat tregues drejt tavanit, e, po drejt tavanit shikonin sytë, fluturonin vetullat, qerpikët e gjatë (ishte i bukur prokurori) e deri flokët i kishin lëvizur dhe i ishin zgjatur drejt lartësive... të tavanit. Pastaj, dalngadalë, qenia e prokurorit, nën ndikimin e disa murmuritjeve të ftohta, të dyshimta e armiqësore të sallës, u shkreh dhe u kthye në konstruksionin e saj normal.

— Nuk kam mbaruar. Këta kriminelë, që llomotitën këtu për disa ditë, duke qenë në lidhje me emigrantët shqiptarë, s'mund të mos jenë veçse këlyshë të të vetë-quajturit Komitet Nacional Revolucionar, që sot ka marrë emrin famëkeq, Komiteti i Çlirimit Nacional. Por sidomos nëpërmjet lidhjeve të tyre me Federatën Komuniste Ballkanike, këta banditë të regjur e të rrezikshëm..

(I pandehuri i parë, d.m.th. ironiku prej natyre, d.m.th. dispeptiku kronik, kërceu prapë në këmbë dhe prapë vrapoi drejt derës së pasme. Drejt asaj dere vrapoi edhe xhandari.)

— ... deshën të dëmtonin rëndë emrin e Republikës Shqiptare dhe emrin e Kryetarit të saj. Tërthor, po të lejoheshin këta kriminelë të bënin punën e tyre, kjo donte të thoshte, që Republika jonë të kthehej në një vatër armiqësore kundër kësaj mbretërie (shigjeta e dorës drejt Italisë), kësaj mbretërie (shigjeta drejt Greqisë), apo (shigjeta drejt Jugosllavisë), apo kundër mbretërive të tjera (rropullisja e duarve skiconte Gadishullin Ballkanik, e pse jo, Evropën mbarë, apo mbretëritë e të gjithë botës, ku ishin e ku s'ishin.) Po drejtësia jonë e përmbysi gjendjen, ajo u tregoi gjithë monarkive se Shqipëria është vendi nga ku ato mbrohen dhe në të njëjtën kohë, fare së afërmi, do të tregojë se ajo do të

---

1) (lat.) — Drejtësi të bëhet, pa bota le të prishet!

bëhet edhe vetë një monarki e barabartë me të gjitha monarkitë e tjera të botës. I dëgjoni, zotërinj, muzikat? — Heshti një hop me njërin vesh të kthyer lart, sikur banda muzikore të ishte mbërthyer në tavan por, për fatin e tij «të keq», muzikat nuk u dëgjuan (ose ishin ndërprerë, ose era mund t'i kishte hedhur tingujt gjetiu), e megjithatë, ai nuk e bëri veten, bile bëri sikur i dëgjoi ato, bëri sikur i dëgjuan edhe të tjerët dhe, i kënaqur më tepër se kurrë, shtoi:

— Zotërinj, këta kriminelë i duhen dorëzuar sa më parë Radamentit<sup>1)</sup> dhe, duke marrë një vendim të këti-llë, edhe Femida<sup>2</sup> vetë do të mbetet e kënaqur. **La prosperita d'un paese, ha detto Musolini...**<sup>3)</sup> Befas prokurori e ndërpreu fjalën me një «shkathtësi» që i përkiste vetëm atij, dhe, me këtë ndërprerje, la të nënkuptoheshin dy arsye. E para, bëri sikur i qe ngacmuar një damar në grykë. E dyta, sikur ato fjalë që kishte nisur për të thënë në një gjuhë tjetër, ishin të parakohshme. Trupi gjykues le të pranonte **ab libitum**<sup>4)</sup> cilën të donte nga këto dy arsye. Sidoqoftë... i rëndësishëm ishte fakti që prokurori u ul dhe, pa rregulluar akoma palat e mantelit të zi, që ishte simbol i drejtësisë, sekretari i gjyqit i zgjati një gotë ujë, të cilën ai e refuzoi me mirësjellje.

Tingëlloi zilja. Trupi gjykues do të tërhiqej për të marrë vendimin, kurse dispeptik kroniku kërcëu për të tretën, a... për të pestën herë, po kjo s'ka rëndësi, sepse gjyqi po jetonte çastet e fundit....

---


1) Radamenti, mbret i Kretës, qe caktuar pas vdekjes gjykatës i ferrit (mitologjia greke).

2) perëndesha e drejtësisë, (mitologjia greke).

3) (it.) Lulëzimi i një vendi, ka thënë Musolini...

4) iat.) — sipas qejfit.





# I

Daklea u zgjua dhe thirri ngadalë përtej errësirës:

— Mentar, ku je?

— Jashtë!

— Pse u zgjove? — pyeti ajo me një lloj dyshimi.

— Po ti pse u zgjove? — pyeti edhe ai.

— Ndjeva mungesën tënde!

Ai u kthye dhe u shtri pranë saj.

— Mos ranë prapë pushkë? — pyeti ajo.

— Po!

Dëgjohej frymëmarrja e re dhe e qetë e fëmijëve që flinin.

Daklea, pasi u vërtit disa herë nëpër dyshek, ra përsëri në gjumë. Dikur ishte ajo që e vinte në gjumë Men-



tarin. Po kohët e fundit që lodhur mjaft. Uria dhe shqetësimet e kishin vrarë. Uria dhe fëmijët. Ajo fjeti, kurse Mentari, me shpresë se mos e zinte gjumi, filloi të numëronte deri më njëzet. Po më kot. Ja prapë, ajo, zhurma e dyshimtë. Sikur... dikush zvarritej, vazhdimisht, zvarritej në kopsht... në oborr... në shtëpinë e vjetër... Zvarritej kudo... në të gjitha anët..., Përtej murit. Në tokë. Në qiell... Mentari mbylli veshët me pëllëmbë, por nuk i mbylli plotësisht. Prapë i hoqi pëllëmbët vetëm sa për të dëgjuar... heshtjet e natës.

Te gërmadhat e shtëpisë së vjetër me çardak e me qemer vërriti keci. Vetëm një herë. Një herë iu përgjigj edhe dhia. Pastaj hapat. Zvarritja. Një si zë njeriu, një si klithmë e përgjumur shpendi. Dhe prapë hapat, që sikur vinin nga të gjitha anët. Duke iu bindur një shtytjeje, ai u ngrit prapë dhe doli te pragu. Pastaj në verandë. Pastaj zbriti në oborr. Megjithëse i bindur që këto zhurma s'ishin veçse halucinacione të gjendjes së tij të lodhur, ai shkoi deri në kopsht. Kur dëgjoji nga prapa këmbët e Dakleas, tashmë ai kishte parë hijen e dikujt që gulçonte, që ecte dhe pengohej nëpër errësirë. Pasi që afruar, ndjeu se i panjohuri mbante erë djersë, erë llucë, erë dheu, erë gjethi, erë bari e tërfili, erë pylli, erë nate me mjegull. U përpoq ta zinte për krahu, por tjetri kërceu një hap prapa dhe ngriti pushkën. Pastaj befas nxori një rënkim lodhjeje dhe kënaqësie bashkë, uli pushkën, theu gjunjët dhe gati humbi ndjenjat. Para se të binte në tokë, u duk sikur tha:

— S'mundem më, jam shumë i lodhur!

Pas pak Mentari dhe Daklea e vendosën midis pemëve, aty ku binin njolla të hënës së prerë. I panjohuri i ngriti qepallat ngadalë dhe Dikët vunë re se ai ishte duke i shikuar qetë dhe ftohtë. E, kur mbështeti kokën në tokë, kur fytyra iu zhyt në hijen e pemëve të kopshtit, kur nga ai s'mbeti veçse një trup i rreckosur, Dakleas padashur ia pati qefi të mendonte që ajo fytyrë të mos kishte qenë asnjëherë e vërtetë, të ishte vetëm një hije, vetëm një hiç, një asgjë.



— Është vrarë në ballë, i ecën gjak! — tha Mentari i kërrusur mbi të.

— S'kam gjë, — foli befaz një zë i thellë, por i ri. Ai kishte folur midis frymëmarrjeve që s'arrinin ta ngopin me ajër.

— Kush je ti? — pyeti Mentari, megjithëse tashmë diçka kishte filluar të merrte me mend.

Një çast më vonë Dakleas nuk i mbeti asnjë dyshim se qenia që shikonte s'ishte as hije, as hiç, por ishte një burrë, ose më saktë, një djalë, bile tepër i ri.

I panjohuri nuk u përgjigj menjëherë. Në vend të përgjigjes ai kërciti dhëmbët, thujse deshi t'i shkërmoqte.

— Është vrarë në ballë, i ecën gjak! — përsëriti Mentari. — Ta ngremë, ta çojmë në kuzhinë e ta pastrojmë!

Kur e ngritën, vunë re se ai ishte pak më i gjatë se Mentari dhe shumë më i gjatë se Daklea. Koka e saj mezi i arrinte te supi. Ai sikur erdhi në vete dhe shikonte herë njërin, herë tjetrin. Në sytë e tij kishte mjegull përzier me dritë hëne. Eci, i mbështetur në supet e të dyve. Sikur çalonte. Sikur i dhimbte beli. Sikur mezi e mbante kokën lart. Zhelet i kishte të lagura. Pushkën me baltë. Të gjitha këto dëshmonin se i panjohuri kishte ardhur nga ana e përroit dhe ishte zvarritur gjatë.

— Nuk kam marrë plagë plumbi, — tha, ndërsa tërhiqte hapin drejt vilës. — Më kanë grisur ferrat!

Daklea njomi një peshqir në kuzhinë dhe i pastroi fytyrën. Sapo uji i freskët i ra në ballë, ai hapi sytë.

— Mjegulla më shpëtoi!

Kur fytyra i qe pastruar, Mentari Dika tha:

— E mora me mend që do të ishe ti!

Vështrimi i tjetrit, si zakonisht, ishte i qetë dhe i ftohtë.

— Të njoha gati që në fillim, — tha Mentari, pasi e kishte mbledhur vetën. — Po desha të sigurohesha!

— Domethënë, njihem akoma! — foli tjetri me zërin e ri pozitiv. Tashti gulçimat e tij ishin bërë të rralla e të lehta.

Daklea nuk pyeti cili ishte. Ajo nuk deshi të tregojë



kureshtare. Po një shkëndijë e largët kishte zënë të ndriçonte kujtesën e saj. Sytë e tij gri, vetullat e holla në ballë të dystë, hunda e drejtë, flokët fare të shkurtër e fare të çelët, gati biondë, sikur po i kujtonin shpalljen që kishte parë në varosh, pas ngjarjes rrëzë Maleve të Shqipes.

Ai shtrëngoi nofullat dhe kërciti dhëmbët. Daklea ngriti fitilin e llambës. Fytyra e tij ishte e verdhë si vdekja, po sado e verdhë, sado e vdekur, ajo njihej. Rebeli i shpalljes. Genc Boga.

— Mjegulla më shpëtoi! — tha prapë ai dhe menjëherë pyeti: — Ku e kam pushkën?

— Ta kemi varur aty!

— Trastën?

— Ja dhe trasta!

Ndërkaq Daklea kishte ndezur zjarrin, kishte vënë kusinë, kishte sjellë ca rroba të vjetra të Mentarit. Tha:

— Të lahesh e të ndërrohesh! — Ajo sikur e kishte marrë pak veten.

Nga dritarja e hapur erdhën zhurma e jehona të largëta pushkësh. Po nga dritarja futej në kuzhinë era e luleve, e sidomos e trëndafilave, e barit, e vesës, e verës, e gushtit. Dhe ishin të forta, se të tilla janë ato gjatë natës.

Pasi u çlodh pak, Genc Boga hyri në radhën e të gjallëve. Veç fytyra e verdhë si vdekja, kishte mbetur e pandryshuar. Ai afroi trastën dhe numëroi fishekët.

— Më paska humbur një ballë fishekë!

— S'ka gjë, — tha Mentari. — Kam unë. Kam shumë!

Në gërvishtjet e fytyrës gjaku i qe mpiksurr.

— Sa keq! — tha Genci. — Po ku ta kem humbur?... Ishin shumë. Nuk shpresoja të ndeshesha me një gardh të tillë xhandarësh.

— A do të hash pak? — pyeti Mentari.

— Bukë me pak djathë, — shtoi Daklea, duke kujtuar aty për aty djathin që u pati lënë një javë më parë Teli Bashari për fëmijët e që ajo ua kishte kursyer.

— Jo, jam i lodhur, — tha ai. — Dua të fle!

— Ja, sa të lahesh e të ndërroresh, — foli Daklea.  
— Pastaj të hash e të flesh menjëherë!

— Ku do të fle? — pyeti ai.

— Kemi një vend të fshehtë, — tha Mentari.

— Ata e dinë që unë sonte vërtitesha rreth qytetit. Përfitova nga megjulla, u zvarrita ferrave, gati u ndesha me ta hundë më hundë, dy herë më diktuan, dy herë u humba dhe me vrap arrita deri këtu!

— Të kishe shkuar në pyll! — i shpëtoi Dakleas.

Mentari e shikoi të shoqen me qortim. Fytyra e saj kishte marrë pamjen e frikës, e cila, si pak më parë në kopsht, i ndillte dëshirën që ai të mos kishte ardhur fare këtu, që të ishte hije, të ishte hiçi i hijeve.

— Nga pylli të na lajmëroje dhe ne vinim të të ndihmonim, — shtoi ajo, si për të ndrequr gabimin që bëri.

— S'ka gjë, unë do të largohem shpejt, — tha Genci me sytë në tokë. — Kam ardhur për të biseduar me ju se ç'duhet të bëjmë në të ardhmen e për të mbaruar një punë në qytet. Pastaj do të më duhet të takohem me Lato Morinën. Mora vesh se ai më kërkonte. Edhe unë e kërkova, po nuk u takuam. Gjatë dhjetë ditëve të fundit xhandarët më janë qepur këmba-këmbës.

— Ti do të qëndrosh këtu sa të kesh nevojë, — tha Mentari Dika. — Midis mureve të shtëpisë së vjetër kemi një vend të fshehtë. Babai, me marifet dhe pa u kuptuar, ka lënë një boshllëk sa për të fjetur një njeri.

Ata heshtën prapë.

— Aty babai fshihte librat shqip, kur e ndiqnin turqit e turkoshakët! — foli pas pak Mentari me zërin të mbushur plot kujtime.

Genci e shikonte në sy. Sytë e tij gri kishin rënë në dilemë.

— Unë mund të iki, — tha prapë, duke shikuar nga Daklea. Ai nuk dukej i fyer. Përkundrazi, fliste thjesht dhe çiltër.

Daklea ishte zverdhur, po zëri i ri, i shtruar, i butë, i ëmbël e melodioz i tjetrit, kishte zënë t'i pëlqente.

— Të shikojmë ç'mund të bëjmë nesër, — tha Mentari. — Në qoftë se është fjala për të ikur në një vend



më të sigurt, do të ikësh, por unë nuk di vend më të fshehtë se aty midis mureve. Babai më thoshte se turqit e kishin kthyer përmbys të gjithë shtëpinë, por atë vend nuk e kishin gjetur asnjëherë.

— Mirë, — tha pas pak Genc Boga dhe u ngrit, po me t'u ngritur u lëkund.

Mentari shpejtoi ta mbante.

— Jo, — tha Genci.

— Të merren mendtë, — tha Mentari.

— Eci vetë!

— Je mjaft i lodhur!

— Mund të eci akoma!

— Si të duash... Po duhet ta dish se unë kisha një parandjenjë që ti do të vije një ditë tek unë. Bile, i kisha thënë edhe Teli Basharit të të kërkonte me anë të Lato Morinës, po ti erdhe vetë!

Genci e shikoi i çuditur. Një parandjenjë të tillë kishte pasur edhe ai që ditën e ngjarjes rrëzë Maleve të Shqipes.

— Nga ana ime kjo ishte siguri! — tha Genci. — Erdha se diçka duhet të bëjmë. Pa tjetër duhet të bëjmë diçka. S'duhet të rrimë asnjë ditë duarkryq!

Mentari shikoi Daklean. E shikoi si t'i thoshte: «Ai ka besim te ne!»

— Pushkën, — tha Genci.

— Pushkën lërma, se do ta pastroj unë!

— Unë s'mund të fle pa pushkë të pastruar, — tha Genci. — M'u bë zakoni ta pastroja çdo mbrëmje. E di ku? Në kasollen e një plake buzë një pylli. Xhandarët s'lanë gjë pa përmbysur, s'lanë fshat e pyll pa përqokur, por as që u shkante në mendje se unë kthehesha aty çdo natë!

— Aty ku do të flesh, ka dy pushkë dhe disa kaseta me fishekë. Ka edhe bomba dore. Ka edhe mitraloz.

Genc Boga vuri buzën në gaz. Në fytyrën e tij të verdhë si vdekja, ku, më së fundi, kishte filluar të lëvrinte jeta, zbardhën dhëmbët e ngjeshur. Tha padashur:

— Sa keq që më humbi një ballë fishekë!

Në zjarr u dëgjua valimi i ujit.

## II

Pasi u la, pasi hoqi zhelet dhe veshi një palë rroba të vjetra të Mentarit, por të pastra e të arnuara, Genc Boga u bë tjetër njeri. U bë djalë i fuqishëm, me pamje vërtet të butë, me baltë e sy si prej vajze, por i fuqishëm. Këtë ndjenjë ta ngallnin edhe flokët e tij, që i kishte të shkurtër e të verdhë, por të ashpër, edhe lëkura e zeshkët e fytyrës, gati ngjyrë ulliri.

— Eja të shkojmë në vendin e fshehtë dhe të bindesh se aty je i siguruar! — tha Mentari dhe mori nga divani një jastëk e dy velenxa, që u ndodhën aty e që kishin mbetur pa u shitur. Ai shikoi Daklean. — Fshesën për ta pastruar. — Shikoi nga Genci. — Por edhe vendin duhet ta matim, se je pak i gjatë!

Daklea mori fshesën, mori edhe një kandil të ndezur dhe shkoi prapa tyre. Ata ecnin në heshtje. Iu afruan shtëpisë së vjetër me çardak e me qemer, ku shtyllat e trarët krijojnë një labirint të tërë kryqëzimesh dhe hijesh, që pasonin e shkëmbenin njëra-tjetrën. Pastaj Daklea doli përpara. Ata ecnin pas saj. Hijet pas tyre. Pranë një muri të vjetër me gëlqere të rrëzuar, u skicuan figurat e dhisë dhe kecit, që shikonin me sytë e verdhë si në të gjelbër, të pastër e naivë. Aty rrotull zotëronte silueta e arrës së madhe. Kandrrat cërritnin me tinguj të ngrohtë të një nate gushti.

— Këndej ka ecur edhe babai, kur fshihte abetaret e gjuhës shqipe! — tha si me vete Mentari (me zërin të mbushur me kujtime.)

Pastaj u futën nën qemer. Aty hijet u shkrinë dhe u bashkuan me trupat e tyre. Edhe cërritja e kandrrave mbeti diku prapa, u bë e largët. Mentari ngriti një rrasë. Diku u rrokulisën guriçka. Ngriti edhe një tjetër. Përsëri guriçka, apo kakërdhi.



Zbritën një palë shkallë prej druri, të pluhurosura e me merimanga, por akoma të forta. Vendi i fshehtë ishte një dhomë e vogël: sa e gjerë, e gjatë dhe e lartë. Aty ishin dy pushkë, mitralozi, disa arka e kaseta me fishekë e me bomba dore. Kur Daklea shtroi velenxat, ata vunë re se këmbët e Gencit do të ciknin armët. Para se të shtrihej, Genc Boga tha:

— U bënë njëzet ditë që bëj gjumin e komitit!

— Si ndodhi gjithë ajo? — pyeti Mentari si pa të keq.

— Fare thjesht. Mua bashkë me kushëririn tim, Krist Papin, kapiteni i xhandarmërisë, Shaban Sinani, që kishte kërkuar ndihmën e ushtrisë, na caktoi të ruanim prapa shtëpisë. Të rrethuarit, dy gryka pushke, Veterani i Luftës, siç e thërritnin, dhe i zoti i Shtëpisë, bënë luftë nga balli dhe nga anët e konakëve. Andej ishin mundësitë të çanin rrethimin e të tërhiqeshin. Kurse prapa as kishte dritare, as kishte rrugë. Themelet e shtëpisë ngriheshin buzë një gremine, që natën dukej e thellë dhe e pjerrët si thikë e që as rrezet e hënës së plotë nuk e ndriçonin. — Genci u mbush me frymë, shikoi Mentarin, shikoi Daklean, shikoi kandilin që llapste, u mbush prapë me frymë dhe heshti. Mentari, Daklea, kandili shikuan anasjelltas Gencin dhe e shikuan drejt në buzë.

— Mos u ngut! — tha Mentari. — Çlodhu!

— E lëmë për nesër këtë bisedë! — tha Daklea, që e kishte kuptuar dobësinë dhe lodhjen e tij.

— Për nesër! — përsëriti Mentari.

— Jo, — tha Genci, — s'kam shumë gjëra për të trenguar. Ju e dini që babaj im ishte këpucar i varfër dhe i sëmurë nga veremi. Ai nuk luftoi me armë në dorë, ai vetëm shkoi prapa ushtrisë së Fan Nolit, për t'u ndrequr këpucët ushtarëve dhe vullnetarëve të Revolucionit. Atje mori një të ftohtë dhe vdiq pas gjashtë muajsh. Tashti, si thoni ju, a më përkiste mua të luftoja kundër Veteranit të Luftës, që ishte rrethuar nga forcat e xhandarmërisë të Kapiten Shaban Sinanit? — Shikoi nga Mentari e Daklea. — Kishim zënë një vend me Kristin, me Krist Papin, — shtoi mbiemrin, si për ta shquar nga të tjerët,



fundja ku ta dish përse e bëri këtë dhe bile e bëri si me inat. — Dhe vendosëm që t'u ndihmonim të rrethuarve. Ushtarët e tjerë të skuadrës sonë ishin shpërndarë gjatë greminës, po toka ishte e thyer, aq sa nuk e shikonim njëri-tjetrin. Papritur, vura re në dritën e hënës të lëvizin gurët e murit prapa shtëpisë. Pas një minute, apo pak më shumë, ishte hapur një brimë, prej nga doli një fshatar që e morëm me mend se duhej të ishte i zoti i shtëpisë. Pastaj ai tërhoqi tjetrin dhe, me ta nxjerrë jashtë, e hodhi në krahë. Unë u dola përballë dhe vura gishtin në buzë, që të më kuptonin menjëherë. A më besoni sa u trondita kur pashë fytyrën e gjakosur të Veteranit të Luftës, që mbështetej e pafuqishme në supin e të zotit të shtëpisë? Ata e kuptuan menjëherë qëllimin tim dhe i zoti i shtëpisë më tha ta merrja në krah të plagosurin, pasi ai vetë do të na udhëhiqte nëpër ca monopate të fshehta të greminës. Ashtu bëmë, i zoti i shtëpisë përpara, unë me Veteranin e Luftës pas tij e pas meje Krist Papi. — Genc Boga prapë heshti. Tashti fytyra e tij ishte ngrysur nga një zemërim i brendshëm. — Dolëm nga gremina, u futëm pyjeve, prapa nesh ngriheshin flakët e shtëpisë që digjej. Pas një ore dëgjua britma dhe të shtira. Po na ndiqnin. Atëherë i zoti i shtëpisë ma mori të plagosurin me dorë të sigurt, e hodhi në krah dhe më tha që të ndaheshim, të humbisnim gjurmët dhe kështu u ndamë, duke lënë të takoheshim pas pesë ditësh, diku aty rrotull, ku do të ndizeshin dy zjarre pranë e pranë. Meqë Kristi ishte i pasprovuar fshatrave, unë i dhashë adresat e katër fshatarëve, që do të ishin të gatshëm për ta ndihmuar, sepse të katër ata kishin marrë pjesë në Revolucion. Pastaj unë ika nga njëra anë dhe shtiva për t'i tërhequr xhandarët pas vetes. Krist Papi iku nga ana tjetër dhe shtiu gjithashtu, se edhe ai e pati simpatizuar Revolucionin. Kështu shkoi ajo natë. Dy pleqtë nuk i takova më. Pas pesë ditësh zjarret u ndezën dhe unë shkova atje, por... asgjë. As Krist Papin nuk e takova. Më vonë mora vesh se pleqtë i kishte rrethuar xhandarmëria pikërisht atë natë që ndezën zjarret. Më vonë dë-gjo-va se-e-e Krist Papi ishte shtruar në Spitalin Ushta-



rak të Tiranës Pastaj asgjë! — Ai ngriti sytë gri, i shikoi bashkëshortët me vëmendje, si t'u thoshte: «Kaq, mos më kërkoni më...!» — Kaq mund t'ju them hëpërhë. Sa për fatin e Veteranit të Luftës dhe të të zotit të shtëpisë, ju e dini, i keni parë të vrrarë në Sheshin e Pazarit. — Genc Boga e ndërpreu përsëri fjalën. Dukej qartë se ai ishte tepër i lodhur, por edhe sikur të kishte fuqi, nuk dëshironte të fliste më. Kishte mbështetur kokën në jastëk, kishte cikur këmbët e veta me këmbët e mitralozit dhe, me qepallat gjysmë të rrëzuara, shikonte i pafuqishëm jo Mentarin, jo Daklean, jo kandilin, por diku në mes të tyre e sipër tyre. Daklea e mbuloi me velenxë, se në atë birucë pa diell kishte ca freski e pa dyshim lagështi. Bashkëshortët, pasi shkëmbyen një vështrim kuptimplotë me njëri-tjetrin, u tërhoqën në heshtje, po kur po ngjiteshin nëpër shkallët, i ndaloi zëri i Genc Bogës, që ishte një zë i ri, pozitiv, por që tashti tingëllonte edhe i përfjetur:

— Unë nuk do të qëndroj shumë këtu. Dua vetëm të vendosim se ç'do të bëjmë, pastaj të takohem me Krist Papin. Por, që të takohem me të, duhet të pres sa të mbarojë gjendja e jashtëzakonshme që kanë shpallur. Natën e mirë!

— Natën e mirë!

Genc Boga dëgjoi hapat që u shuan mbi kokën e tij e po aty mbi kokën e tij dëgjoi kecin, ë-ë-ë, dëgjoi edhe zërin e dridhur të dhisë, m-m-m. Dëgjoi edhe ca zhurma të largëta, shoi kandilin dhe ra në gjumë para se të kishte lëshuar qepallat.



Kur u kthyen në dhomën e gjumit, Daklea ishte e heshtur dhe e menduar. Sytë e saj kafe të çelët, të ëmbël e të butë, shikonin përtej dritares terrin e natës që kacavirrej nëpër pemë. Shikonin edhe qiellin e rëndë e të zi, të ngopur me yje, që shtrihej si të kishte zbritur në tokë. Dhe, duke shikuar errësitat e natës, dukej sikur ata sy përpiqeshin të depërtonin në të fshehtat e heshtjeve e të zhurmave verore, që mund të ishin angullima qensh, krikëllima karrocash, zëra të largët që thërritnin, e deri zhurma e motoçikletës së vetme të qytetit N, e cila qe shfaqur bashkë me një të huaj, që thirrej shkurt: *instruktori*. Pse kishte ardhur këtu, çfarë *instruktori* ishte e me çfarë merrej, askush nuk e dinte mirë. Kishte zëra që thoshin se ishte inxhinier dhe se qeveria shqiptare e kishte pajtuar për disa ndërtime ushtarake tepër sekrete. Të tjerë thoshin se *instruktori* do të bëhej në fakt drejtori i ardhshëm i kurseve të gjuhës italishte, që pritej të hapeshin së shpejti. Zakonisht ndodhte që ky *instruktor*, gjatë ditës të futej nëpër zyrat e prefekturës e të bashkisë (kurrë në ndonjë zyrë tjetër) dhe vetëm rrallë shikohej të bridhte rrugëve. Sillej mirë me njerëzit, si babaxhan i vërtetë. Të shikonte me ngulm dhe ishte i gatshëm të të buzëqeshte e të të përshëndeste, mjafton ta shikoje në sy. Dinte vetëm dy fjalë shqip: «Tungjatjeta, zotëri!» Ishte një burrë trupmadh, me fytyrë të prerë kallëp si katërkëndësh kënddrejtë, që në vështrim të parë të bënte për të qeshur. Sado verë e vapë të ishte, për nga kostumi i zi konkurronte me tri a katër autoritetet e vendit, me njeriun tjetër me të zeza dhe me kamerierin e kthyer nga Amerika. Nganjëherë, prapa motoçikletës së tij njerëzit kishin parë Adelaidën e hotel «Venecias», po se ç'lidhje kishin ata të dy (veç që ishin nga i njëjti vend i huaj),



edhe kjo nuk dihej mirë. Sa herë që hipte në motor, zakonisht mbante një kasketë me strehë një pëllëmbë mbi ballë dhe ajo që s'mund të harrohej tek ai, ishte mjekra e gjatë, e zezë, maja e hollë e së cilës i përthyhej sipas teftikut të erës e sipas shpejtësisë së motorit.

Nëpër qytet qarkullonin edhe mjekëroshë ose jomjekëroshë të tjerë, të cilët vërtiteshin lart e poshtë, vinin e zhdukeshin, por që s'dihej me ç'punë merreshin, vetëm thuhej se edhe ata ishin *instruktorë* si kostumziu dhe vinin nga i njëjti vend i huaj. Ndonjëri nga ata vishesh me uniformë: në këtë rast bëhej fjalë për një *instruktor* në ushtri. Po të tjerët visheshin me rrobën e përgjithshme civile, e cila aq sa është e njohur, aq e bënte të panjohur profesionin e qëllimin e tyre.

Duke menduar padashur për këta njerëz të huaj, duke dëgjuar zhurmën e motorit në rrugë, që nata e verës e shumëfishonte, duke përfytyruar sidomos *instruktorin* misterioz me mjekër të zezë e me kostum të zi, Dakleas diçka i rëndoi në shpirt dhe padashur pshe-  
rëtiu.

— Ç'ke ndër mend të më thuash? — pyeti Mentari.

Në atë fiçe drite të argjendte, që hynte nga dritarja, Daklea shikoi fëmijët që flinin, shikoi prapë Mentarin me vështrim të lëkundur dhe me një gjest të matur, si t'i vinte turp, u afrua tek i shoqi.

— Kam frikë për Gencin e për të gjithë ne. Më duket sikur ai vend i fshehtë do të na sjellë një fatkeqësi të madhe! — tha ajo.

Mentari nuk i kishte pëlqyer kurrë që e shoqja të dëshironte diçka dhe ai të mos ia plotësonte, sepse dëshirat e saj kishin qenë gjithmonë të matura, por atë natë ai parandiente se Daklea do të dëshironte diçka të tepruar.

— Dake, është vonë, bisedojmë nesër!

Daklea nuk lëvizi, as tha gjë.

— Të flemë, — tha ai.

Ajo heshti.

— Po agon dhe ne s'kemi fjetur pothuaj fare!

— Unë prapë ashtu... sikur... — tha Daklea.



— Çfarë sikur? — pyeti ai si pa rëndësi.

— Vërtet nuk kundërshtova në kohën e duhur, që Genc Boga të mos vinte te ne, po tashti që erdhi, tashti që e shikoj me sy, kam frikë se do të na ndodhë një gjë e keqe.

Pas këtyre fjalëve ata kishin heshtur përsëri dhe secili ishte zhytur në mendimet e veta.

— Ke frikë? — pyeti befaz Mentari.

Ajo ktheu fytyrën nga ai dhe mbeti ashtu, si e zënë ngushtë. T'i thoshte «jo», kjo përgjigje nuk do të shprehte të vërtetën. T'i thoshte «po», edhe kjo mund të ishte vetëm diçka e përafërt me të vërtetën. Po meqë «jo»-në e kishte përjashtuar, atëherë u detyrua të thoshte:

— Ai do të na kuptojë!

Mentari nuk donte ta acaronte të shoqen. Nata dhe errësira gjithmonë të mbyllin në vetvete, mendonte ai. Kur të agonte, ndoshta gjendjen e re që kishte shkaktonuar ardhja e Genc Bogës në vilën e tyre, ajo do ta shikonte ndryshe.

— Çdo natë shikoj ëndrra të llahtarshme! — tha sërish Daklea me zë të lodhur. Nga mënyra si merrte frymë, Mentari e kuptoi se ajo ndodhej në buzë të vajtimeve.

— Natën e mirë! — tha ai me mirësjellje dhe i buzëqeshi, por, në atë çerek ndriçimi që hynte në dhomë, ajo nuk e pa buzëqeshjen e tij. — Të flemë, Dake. Vendimet e mëngjesit janë më të mençura, thotë një fjalë e urtë. Kam vënë re se drita e diellit t'i lehtëson brenгат.

Befaz Daklea ngriti kokën. Nga mënyra si e kishte ngritur, nënkuptohej se, më në fund, kishte gjetur mendimin që e shqetësonte dhe që ajo e kishte pritur gjatë e po aq gjatë kishte vuajtur derisa ta gjente. Tha:

— Po mund të jemi vetëm, Mentari!

— Edhe ti e di që s'jemi vetëm. Këtë unë e mësova që ditën e parë kur dola nga burgu. E harrove Ziqin? Harrove kur shkuam në shtëpinë e mikut tonë, ç'na tha



e motra? Njerëz të thjeshtë, një karrocier e një bahçevan, por ata janë populli që bëri Revolucionin!

Pas kësaj ndërhyrjeje të vendosur të Mentarit e pas shprehjes së këtij besimi të patundur, bisedat e tyre u ndërprejnë. Kur, më së fundi, Daklea e kuptoi se Mentarin e kishte zënë gjumi, u kthye në anën tjetër dhe mbylli sytë, duke u përpjekur të mos mendonte për asgjë. Po nuk dihet sa ndenji ashtu, as në gjumë as zgjuar, derisa u ngrit dhe doli në verandë. I bëhej sikur ndiente dhimbje nëpër të gjithë trupin e lodhur. Në të vërtetë ajo s'ishte në gjendje të thoshte, në i dhimbnin shpatullat, beli, gjoksi, apo krahët. Ajo ishte një dhimbje e papërcaktuar, që i kujtonte dhe i afronte pleqërinë. As tridhjetë vjeç nuk ishte Daklea. Dikur i qe dukur se nuk do të plakej aq shpejt, ajo edhe tashti s'besonte, por ato dhimbje nëpër trup, ato dhimbje të papërcaktuara... Kjo pleqëri e shpejtuar... që i kishte trokitur të nesërmen e përmbysjes së Revolucionit!

«Njerëz të thjeshtë, një karrocier e një bahçevan, por ata janë populli që bëri Revolucionin!»

Mjegulla sikur ishte shpërndarë, po megjithatë hëna e kishte humbur shkëlqimin. Po afrohej mëngjesi. Dakleas i kishin pëlqyer gjithmonë mëngjeset, kur errësitrat largohen, kur dritat zbresin nga lart, kur gjithçka duket e larë, e pastër, gjithçka duket e re, e freskët, zërat e zogjtë, çatitë dhe kulmet, pemët në kopsht, plepat, rrapet e shelgjet në përrua... Si e kishte pasë menduar Daklea jetën? Si duhej të ishte ajo? E si po e jetonin ata me të shoqin e me fëmijët? Si po e jetonin të tjerët?...

«Njerëz të thjeshtë, një karrocier e një bahçevan, por ata janë populli që bëri Revolucionin!»

Përsëri si disa net më parë, u ul buzë verandës dhe kaloi vështrimin nëpër qiellin me yje. Po kësaj radhe nuk kërkoi yllin e fatit, as Genc Bogën nuk e kërkoi midis tyre. Tashmë, Genc Boga ishte aty pranë, në bodrumin e gërmadhave të shtëpisë me çardak e me gemer dhe ishte mjaft i lodhur. Tashti ishishin ato që shikonin Daklean dhe jo vetëm e shikonin, por me vezu-



llimet e tyre dukej sikur i kumtonin mijëra pyetje e mijëra fjalë.

«Njerëz të thjeshtë, një bahçevan e një karrocier, por ata janë populli që bëri Revolucionin!»

... Tak-tuk-tak-tuk, karroca ecte përmes sheshit midis bashkisë dhe xhamisë së Tiranës. Nën strehën e në hajatin e xhamisë ishte shtrirë një turmë e shkalafitur, në mes të së cilës ndodhej kufoma e një fëmije. Kufomën e vogël e kishin mbuluar me rreckë të grisur dhe herë e shtynin në një anë, herë në tjetrën. Secili përpiquej t'i bënte vetes një copë vend për të fjetur. Ishte gati mesnatë. Se afër mesnatës i kishin liruar disa nga ish-oficerët e ushtrisë së Fan Nolit. Llambat e elektrikut u drodhën dhe u shuan.

— Kështu shuhen çdo natë! — tha karrocieri, — Centrali!

— Edhe te ne! — tha shkurt Daklea.

Nën strehën e errët të xhamisë tashti vetëm dëgjo-heshin zërat e të uriturve, që shtynin njëri-tjetrin për një copë vend.

— Deri nesër mund të vdesin të tjerë, fëmijë e pleq. Nesër, pa aquar, vjen karroca e bashkisë, i merr dhe i hedh në gropë, — tha karrocieri.

Pastaj u dëgjuan vetëm potkonjtë e kalit dhe... heshtje. Dukej sikur kryeqyteti që mpirë, që mbledhur kruspull nga të ftohtët, nga errësira, nga uria. Ishte kulmi i zisë.

Tha karrocieri:

— Pra, të liruan, zoti Mentar!

— Më liruan, — tha si i përhumbur Mentar Dika dhe shtrëngoi dorën e Dakleas.

— Tashti të duhet një fëmijë, — tha karrocieri.

— Kam një djalë e një vajzë! — tha Mentari dhe shikoi nga Daklea.

— Ho-ho-ho, — qeshi karrocieri. — Ç'gëzim i madh të pret, kur të arrish në shtëpi!

Trokëllima e potkonjve të kalit kishte diçka të vetmuar e diçka misterioze. Tirana kishte hedhur kra-



hëve lagështirën e ftohtë të dhjetorit. Nëpër telat e telefonit, era, si hark i padukshëm, ua merrte melodive të dimrit, që shpejt gllabëroheshin nga errësira 'e nga heshtja dhe atëherë mbetej përsëri trokëllima e vetmuar e misterioze, që bridhte nëpër natë me ritmin e potkonjve të kalit, tak-tuk-tak-tuk...

— Sa vjeç i ke?

— Djalin gjashtë, vajzën tri. Kur lindi vajza, unë isha në burg. E kam parë vetëm një herë përmes hekurave.

— Të paçim ymër!

— Falemnderit!

Pas pak:

— Duhet edhe një tjetër, — tha karrocieri. Silueta që ishte ulur në pupë, bëri një rrotullim dhe, nga pozicioni që mori, dukej qartë se po shikonte nga Daklea.

— Pastaj edhe një tjetër! — tha karrocieri.

Meqë askush s'iu përgjigj, meqë askush nuk e mbështeti e as e kundërshtoi dëshirën e tij, ai shtoi:

— Ne, fukaraja, duam shumë fëmijë!

Karrocieri ktheu prapë kokën dhe Mentarit iu duk sikur e shikoi me ngulm, sikur dontë të mësonte diçka, t'i nxirrte një fjalë, një të vërtetë. Ajo s'ishte kureshtje e thjeshtë. Ajo ishte diçka më tepër. Pyeti:

— Ç'do të bësh tashti, zoti Mentar?

— Asgjë!

— S'do të futesh në punë?

— Thua?

— Ndoshta të pranojnë, — tha me të butë karrocieri. — Ndoshta janë kënaqur që të mbajtën tre vjet në burg!

— Ndoshta... Por s'jam unë i kënaqur!

— Mund të të kthejnë në ushtri, — tha karrocieri.

— Nuk dua në ushtri, — tha prerë Mentar Dika.

— Thonë se disa nga oficerët e rinj do t'i kthejnë përsëri në ushtri. Kështu thonë!

Mentar Dika heshti.

— Flitet se ushtria ka nevojë për oficerë me shkollë, — tha karrocieri. — Sot në mëngjes, kur po çoja dy oficerë



të lartë në kazermë, dëgjova se disave nga ju do t'ju japin gradat që kishit. Me sa kuptova unë nga biseda midis tyre, Ahmet Zogut i paska hyrë qejfi ta bëjë ushtrinë si në Evropë, me shkollë...

— Moderne, — buzëqeshi Mentari Dika.

— Platësisht e drejtë, mod... thanë dy oficerët që kisha në karrocë! — Pastaj karrocieri u duk sikur ra në mendime dhe në fund lëshoi një psherëtimë të gjatë.

Në sfondin e zi të qiellit, Daklea shikonte të skicoheshin shpatullat e gjera të karrocierit, që kishin zënë gati të gjithë pupën dhe asaj i dukej tepër qesharake, që nga ai burrë mbi të dyzetat të dilte një psherëtimë e tillë. Bile të dukej e pabesueshme, gati paradoksale, që ai të psherëtinte në përgjithësi. Por ai psherëtiu prapë.

— Mua nuk më trazuan, — tha. — Një copë katundar i humbur, nuk ma varën, një vullnetar i revolucionit si qindra të tjerë. Nuk më trazuan!

Ky karrocier trupmadh, që e thërritnin shkurtimisht Ziq (për Ziqiri), i kujtonte Mentari Dikës një ngjarje që kishte ndodhur aty nga fundi i korrikut të vitit 1924, gati dy muaj pas fitores së Revolucionit, kur reparti i tij kishte marrë urdhër të shkonte gjatë rrugës Tiranë-Dibër, kundër bandave të armatosura të Ahmet Zogut, që sabotonin, që shkatërronin urat dhe prishnin telat e telegrafëve. Ditën e tretë ata patën rënë në gjurmë të bandave dhe po atë ditë zhvilluan ndeshjen e parë. Bashibozukët, që ishin të shumtë dhe të armatosur mirë, sulmuan me shpejtësi dhe Mentari Dika, për arsye taktike urdhëroi që të lëshoheshin pozicionet e para. Po plani i tij për t'u tërhequr e pastaj për t'i rrethuar, dështoi. Për këtë që bëre shkak njëri nga vullnetarët e kompanisë, pikërisht ky Ziq, që tashti kishte lënë fshatin dhe ishte bërë karrocier. Ky ish-vullnetar nuk lëvizi nga pozicioni, kur Mentari dha urdhër për tërheqje dhe vazhdoi të luftonte, duke shtirë, pa e kthyer kokën prapa, pa shikuar anash, pa lëvizur, si qenie pa jetë, pa veshë, pa sy, pa asgjë.

— Mund të vritesh! — i kishte thënë Mentari.

— Le të vritem, — qe përgjigjur Ziqi.

— Pse?



— Nuk zmbrapsem! — tha ai. — Po ta marrim prapë fuqinë ata, po të përmbysin Qeverinë e Tiranës, atëherë mua do të më vijë turp të kthehem në fshat.

Kështu kishte thënë vullnetari dhe kishte vazhduar të luftonte, të shtinte pa e kthyer kokën prapa, pa shikuar anëve... derisa Mentari Dika që i detyruar të anulonte urdhrin për tërheqje, të vazhdonte betejën dhe afër mbrëmjes banda e Zogut të tërhijej e shpartalluar...

— Nuk qenke kthyer në fshat, Ziq? — pyeti Mentari.

— E thashë qysh atëherë, zoti Mentari! — u përgjigj Ziqi. — Nuk u ktheva nga turpi. Do të thoshin bota, luftoi Ziqi, u mund dhe u kthye si karafil!

Karroca e kishte kaluar me kohë xhaminë, sahatin, hotelin e vjetër rrëzë sahatit dhe që futur në ca rrugë e rrugica plot zigzage. Feneri në pupë tundej. Karroca e vjetër krikëllinte. Qemerët e rrotave përplaseshin gurëve e gropave. Nata ishte e errët, e lagësht dhe e ftohtë. Dhjetor. 1927.

— Kjo kohë dhe ky muaj ishin tre vjet më parë, kur u thyem në Qafën e Priskës! — Nuk dihet sepse iu kujtua karrocierit ky mendim ndërmjetës, se pastaj vazhdoi bisedën ku e kishin lënë:

— Nuk më trazuan. Por ç'e dua këtë liri?... — zëri iu drodh dhe Daklea u bind se burri shpatullgjerrë që nga shëryer.

— Humbi Revolucioni ynë, — vazhdoi ai. — Nuk e morëm tokën, as unë, as shokët. As ti, zoti Mentari, nuk ia arrite qëllimit tënd. Të gjithë ju të rinjtë flitnit bukur, po nuk ia arritët qëllimit. Nuk di, nuk di ç'ndodhi atëherë. Shumë nga ata që na kishin shtypur, i patëm nëpër duar e nuk u dhamë dënimin që meritonin. Disa mbetën edhe prefektë, disa mbajtën edhe gradat që kishin. Nuk di, ç'ndodhi atëherë. Do të çlirohemi nga feudalët, thoshit ju, nga bejlerët e agallarët, që themi ne! — Karrocieri heshti. Dhe psherëtiu. — Po nuk u çliroam. Tashti ja, ti do të kthehesh në shtëpinë tënde, unë do të mbetem këtu. Kurse ai u bë i madh, president i thonë. Ti dhe unë asgjë. Po nuk e kam zili. Po ti, zoti Mentari, e ke zili?

— Jo, — tha Mentari, — nuk e kam zili.



Tha karrocieri:

— Çfarë zilie, kur njerëzit vdesin për bukë!... Zi e madhe. S'ka punë. S'ka pare. Pare kanë vetëm ata që shkojnë në ballon e bashkisë e në pallatin e presidentit.

Qëndruan dhe trokitën. Trokitën gjatë. Mentari e mbante mend mirë shtëpinë e mikut, të ish-ushtarit të revolucionit. Trokitën prapë. Pastaj trokiti Ziqi. Por ai trokiti fort. Dhe atje brenda u dëgjua një zë. Hapa. Llozi. Një grua me kandil.

— Unë jam e motra, — tha gruaja.

— Unë jam miku i tij!

— Mentari Dika? — pyeti gruaja.

— Po.

— Urdhëroni brenda. Mirë se na erdhët!

Kandili dridhej në duart e gruas si xixëllonjë e vetmuar.

— Mora vesh se do ta lironin!

— Po-o-o, — tha gruaja. — Sot isha tek ai në burg. Pas një jave, më tha.

Mentari i zgjati Ziqit hakun, por ai u zmbraps, e shikoi me sy të çapëlyer dhe tundi kokën me qortim. Pastaj iu afrua dhe i tha me zë të ulët:

— Unë këtu jam, zoti Mentari, po ta dojë puna, më çohaber dhe prapë pushkën në sup.

Pasi tha këto fjalë, u duk sikur Ziqi u ngurtësua, sikur u kthye në statujë. Atëherë Mentari e tërhoqi nga vetja dhe karrocieri i përqafoi të dy menjëherë, i përqafoi dhe i pushtoi fort, si të desh të mos ndahej nga ata. Daklea ndjeu t'i kërcitnin e t'i dhimbnin kockat. Çuditërisht, ai karrocier, që quhej shkurtimisht Ziq, që dukej aq i dobët, krahët i kishte akoma të fuqishëm.

Si u përshëndet edhe me gruan e shtëpisë, Ziqi u largua, kurse të tjerët hynë brenda.

Mentari njohu pikërisht dhomën, ku tre vjet më parë kishte fjetur me gjithë rroba e ku të nesërmen në mëngjes qe arrestuar...

Gruaja ndezi zjarrin, hodhi ca oriz mbi një teps, afroi kandilin dhe zuri ta pastronte.

— Jo, — tha Mentari. — Është vonë. Vetëm sa të flemë pak!



— Jo, — tha gruaja. — Ai më porositi që po të vijnë, sado vonë të jetë, t'u japësh për të ngrënë se, kur njeriu del nga burgu... — Ajo nuk e plotësoi, ose pse nuk i dha rëndësi, ose pse nuk deshi.

Daklea dhe Mentari u shikuan sy në sy. Atëherë Daklea u afrua dhe zuri të qëronte orizin bashkë me gruan. Motra e mikut ishte e re si Daklea, por ishte me të zeza. Kur Daklea e pyeti pse ishte veshur me të zeza, ajo tha:

— Burrin e kisha vullnetar të Revolucionit. Ma vranë armiqtë të nesërmen që arrestuan zotin Mentar dhe vëllanë tim. Burri im s'kishte të afërt. Që nga ajo kohë erdha për të banuar në shtëpinë time. Këtu kam tezgjahun.

Pas një heshtjeje të shkurtër, gruaja e re sikur nga-shëreu:

— Të zezat ne për burrat tanë! — Dhe pas pak shtoi: — Zoti Mentar, im vëlla, me sa vura re unë, kur e takova sot përmes hekurave, s'e ka hequr mendjen nga pushka. Mos do ta ndizni prapë luftën?

Mentari nuk u përgjigj menjëherë. Kjo pyetje, një orë pasi kishte dalë nga burgu, sikur e kishte zënë në befasi. Por pastaj tha:

— Prapë do ta fillojmë nga e para! — Tashti ai i kishte mbledhur mendimet. — Hekuri rrihet derisa është i nxehtë!

— Të zezat ne për burrat tanë!

Në mëngjes Dakleas nuk i kujtohej, në kishte fjetur apo jo, por i kujtohej që tërë natën veshët i kishin jehuar nga fjalët: Të zezat ne për burrat tanë!»

Me të aguar, gruaja e re i përcolli deri te porta, ku mbeti një copë herë. Sytë e saj thithën ndriçimet e para të dritës dhe ajo u duk më e fortë e më e gjallë se natën e kaluar.

(Të zezat ne për burrat tanë!)

Befas flokët e Dakleas u shpupurisën. Ata i shpupuriste një dorë e madhe eshtake, një dorë e ngrohtë dhe shumë e njohur.

— Deri kur do të marrin fund përkujdesjet e mia për ty? — foli me përkëdhelje e me zë të ulët Mentari, si për të mos prishur qetësinë që rrethonte natën, vilën dhe botën e tërë.

Si disa net më parë, Daklea mbështeti kokën në gjoksin e të shoqit dhe, ndërsa ai i shpupuriste flokët ngadalë e me ngrohtësi, ajo vuri re dritën e parë të mëngjesit, që ishte një dritë e dobët, gati e verdhë. Do të kemi një ditë të verdhë, mendoi dhe prapë i shkoi mendja te fytyra e sfilitur e Genc Bogës e te fytyra e Ziqit, te fjalët e fundit të tij, te vejusha veshur me të zeza, vëllai i së cilës pa dalë mirë nga burgu, mendjen e kishte pasur prapë te pushka...

## IV

Nga porta e hapur e vilës, një portë e rëndë prej llamarine, trashëguar e gjetur kushedi se ku e se kur, nga kjo portë, që midis dy qershive të linte përshtypjen e një skene bosh, një mëngjes u futën një grua e një burrë, të cilët mbetën një copë herë pa lëvizur e pa folur, si dy aktorë që kishin humbur tekstin e që prisnin zërin e suflerit t'ua kujtonte.

— Teze! — thirri Daklea e malluar.

Disa minuta më vonë tezja dhe burri i saj, Daklea dhe Mentari ishin ulur në verandë. Tezja ishte akoma e re, as dhjetë vjet më e madhe se Daklea, kështu që, të rritura bashkë, ato kishin mjaft kujtime të përafër-



ta. Vështrimi i qartë i syve të tezes, në kafe të ndezur, si të Dakleas, ishte i qetë dhe i vëmendshëm. Tek rrinte me kurriz nga qielli, me muzgun e mëngjesit mbi shpatulla, ajo shikonte fytyrën e së mbesës, si të nxirrte nga ajo fytyrë e ëmbël gati fëmijërore përgjigjet e të gjitha pyetjeve që kishin bërë sytë e saj të zgjuar. Tezja ishte pak e vrarë për moshën që kishte, ishte edhe tepër e menduar, bile, po të mos i shkëlqenin sytë si kandilat e pashuar të Jerusalemit, mund ta merrje lehtë për një grua pesëdhjetëvjeçare. Fëmijë s'kishte bërë, por dinte të përkujdesej për Daklean si nënë e vërtetë. Ajo ishte martuar këtu e dhjetë vjet me një tregtar fshati bregdetar dhe vinte rrallë me të shoqin në qytetin e lindjes, sa për t'u çmallur me të mbesën e me ndonjë farefis tjetër pastaj largoheshin të dy, duke thënë se duhej të hapnin dyqanin... myshterinjtë... etj. etj. Po kësaj radhe, duke hedhur vështrime të zgjuara nga veranda në paradhomë dhe duke bërë sikur nuk i jepte aq rëndësi gjendjes së vështirë, në të cilën kishin rënë Dikët, ajo tha që në fillim se nuk kishin ardhur për të ndenjtur, se kishin qenë diku në një farefis të burrit për një lindje e për një martesë dhe se me dëshirën e saj ishin kthyer aty vetëm për dy orë, pastaj do të niseshin menjëherë, sepse rruga ishte e largët dhe dyqani kishte mbetur i mbyllur për më se një javë. Tezja kishte një të folur të thjeshtë, bindës e me nur prej zonje të madhe. E po prej zonje të madhe hidhte herë pas here vështrime nga i shoqi, që më shumë heshtte se fliste, më shumë mendonte se dëgjonte. I shoqi, që mund të ishte rreth të pesëdhjetave, njihej dhe ishte njeri i mirë, zemërbardhë, i afruar, megjithëse kishte pamjen e një maçoku të ngjallur dhe arrogant.

Në pak kohë që ndenjën për vizitë, tezja gjeti rast t'i ankohej mënjanë së mbesës për tregtinë e të shoqit, që po shkonte gjithnjë më poshtë. Ndërsa Daklea nga ana e vet, i shpjegoi gjendjen në të cilën ndodheshin, pa ia zvogëluar të vërtetën në aspektin politik, por duke i mbuluar e duke i zbutur, aq sa ishte e mundur, vështirësitë ekonomike. Po Daklea e kuptoi menjëherë se



tezja i dinte të gjitha, kuptoi gjithashtu se vizita e tyre nuk ishte e rastit, se lindjet dhe martesat ishin një shpikje dhe se largimi i tyre i shpejtë bëhej për të mos i ndërlikuar gjërat në këtë situatë. Para se të largohe-shin, tezja i dha Dakleas dy dollarë, gjoja dhuratë për fëmijët e, sidomos për Gimin, që mund t'i duheshin pas disa ditësh për t'u regjistruar në klasën e parë të fillo-res e për të blerë librat e nevojshëm. Pastaj i tha hapur:

— Dëgjo, Daklea, sido që ta sjellë rasti, po e pe pisk, po t'u desh ti kesh krahët të lirë, dërgomë haber, të vij të të marr fëmijët. Unë fëmijë s'kam, por do t'i rrit si t'i kem të mitë. Zogolli nuk mund ta ketë të gjatë. Në krahinën tonë punëtorët, që nxjerrin naftë nga toka me puse të thella, janë ngritur në këmbë, bëjnë greva për padrejtësitë e për pagesat, që i kanë nëntë herë më të ulëta se të punëtorëve italianë. Edhe fshat-rat ziejnë nga varfëria, nga sëmundjet e sidomos nga zia e bukës. Ka edhe ndonjë komit që ka ikur maleve. Kështu fillon kjo, na thoshte një njeri i ditur në politi-kë. Një këtu e një atje, pastaj ngrihet përsëri populli dhe vjen përmbysja, se përndryshe, na tha ai, Shqipërinë e përllau fashizmi! — Këto tha tezja dhe pastaj u për-qafua me lot në sy me fëmijët, me Daklean e me Men-tarin.

Edhe burri i tezes, pasi bëri disa hapa nëpër varosh, futi duart në xhep, mbushi grushtin me monedha dhe ua ndau përgjysmë Letës e Gimit.

— Kur do të vini në dyqanin e xhaxhit? — pyeti ai.

Në mes të varoshit tezja përshëndeti edhe një herë me dorë dhe tha diçka nëpër dhëmbë, që nuk u kuptua, se mallëngjimi ia kishte shtrembëruar fytyrën dhe buzët.

Për një kohë të gjatë, edhe në ditët e mëpastajme Daklea vazhdoi të ndiente duart e buta të tezes, vësh-trimet e saj dashamirëse, zërin e ngrohtë prej nëne a prej motre më të madhe dhe fjalët e saj shpresëdhënëse.



## V

Kur ora e madhe e qytetit ra nëntë, te porta e vilës u dëgjua një trokitje e fortë. Menjëherë buzë verandës bënë ballë Daklea me dy fëmijët. Kishte ndodhur diçka. Një ngjarje e jashtëzakonshme. Ata që vinin për vizitë, vinin ndryshe dhe jo duke trokitur kështu.

Ndërkaq, Mentar Dika ishte qetësuar. Përderisa Genc Boga s'kishte arritur të zbriste në vendin e fshehtë, ai që vonuar me qëllim në hapjen e portës. Po kur dëgjoji zhurmën karakteristike që bënin shkallët e drunjtja, atëherë e hapi dhe në oborr u fut një nëpunës i përbarimit, i shoqëruar nga rreshteri i postës numër katër, Ago Agoja dhe nga një xhandar i ri, që quhej Shkëlqim.

— Sekuestrim! — tha shkurt përbaruesi plak, zoti Nazmi. — Ja urdhri! — dhe e shkundi si të shkundte ca thërrmija buke. Kur ngriti sytë, vuri re se heshtja, që ishte varur në fytyrat e bashkëshortëve Dikë, kishte marrë formën e një pikëçuditjeje. Përbaruesi, që dukej sikur donte t'i ndihmonte e t'i nxirrte sa më parë nga kjo gjendje, shtoi: — Atje, në hotel «Venecia», atje u nënshkrua. Zotëria e tij, Veniamin Çeku, atje e ka zyrën, pranë asaj bukuroshes, si i thonë... — Por, meqë iu duk se bashkëshortët nuk donin të dëgjonin asgjë nga ato që u thoshte ai, shtoi prapë: — Paralajmërimin jua kishte bërë vetë zoti Veniamin Çeku.

Për ata të dy emri i Veniamin Çekut përfaqësonte kreditorin, d.m.th. të ardhmen e vështirë e të errët. Për Gimin dhe Letën, të cilët gjithashtu kishin pasur rast ta dëgjonin këtë emër, përfaqësonte thjesht një kanosje, që merrte pamje përrallore, sepse mendja e tyre nuk arrinte ta përfytyronte. Leta kishte futur gishtin në gojë dhe dëgjohej tek e thithte: llu-llu-llu. Gimi qëndronte serioz e i menduar dhe dukej sikur thoshte me



përbuzje: «Posi, gjë e madhe shumë, Veniamin Çeku!»

Një minutë më vonë përmbaruesi ngjiti të pesë shkallët e vilës dhe tërhoqi një karrige buzë verandës, ku dielli sapo kishte rënë. Tashti që rrezet e rrihnin përballë, ngjyra e papërcaktuar e fytyrës së tij u bë si e një pergameni të zhubrosur. Nguli vështrimin në qiell, vështrimin e lodhur, të plakur, çuditërisht të mbushur me keqardhje për botën që e rrethonte dhe rënkoi nga kënaqësia që i shkaktonin rrezet e ngrohta të diellit.

Rreshter Ago Agoja, i cili ishte akoma me inat për portën që ia kishin hapur me vonesë, u fut rëndë-rëndë në sallonin e vilës. Pas tij shkoi si me pahir xhandari i ri.

— Zoti Nazmi, nga t'ia fillojmë? — pyeti rreshter Ago Agoja nga brenda.

— Nga të doni! — tha zoti Nazmi dhe pamja e tij u bë më se keqardhëse.

— Ashtu-u, ë-ë-ë?! — tha rreshteri.

Duhet thënë që në fillim, se rreshter Ago Agoja kishte një trup e një fytyrë të ngjallur e të qullët, thujse pa kocka, gjë që mund ta kishte burimin në faktin se ai vërtet një copë rreshter ishte, vërtet një komandant poste ishte, por ja që i pëlqente jeta sedentare dhe dinte ta bënte atë jetë. Por ato që të bënin më shumë përshtypje, ishin sytë e tij çuditërisht të madhësive të ndryshme dhe tepër të qartë e të ftohtë, si sy xhami. Bile, po të ishte vërejtës i hollë, do të vije re se në njërin sy ai kishte ligësi (më i vogli), në tjetrin padurim (më i madhi). E meqë nuk i kishte zbritur inati, të linte gjithashtu përshtypjen sikur vetëm me njërin sy (me të paduruarin) shikonte rreth e rrotull, kur tha:

— Mirë atëherë, po fillojmë!

Dy fëmijët ishin mbledhur në qoshe të dhomës prapa Dakleas.

Rreshter Ago Agoja hapi dollapin e rrobave.

— I paskeni fshehur të gjitha, ë? Prandaj e hapët me vonesë portën, që të fshihnit plaçkat. Por keni harruar se Ago Agos po i bien dhëmbët në këtë punë. Unë do ta përmbys vilën të gjithë derisa të gjej edhe gjil-



përën e fundit. — Tashmë, ndërsa fliste kështu kishte futur në veprim edhe syrin e vogël, të ligun, dinakun. — Jeni mbyllur si në kala. Edhe muret i keni ngritur si mure kalaje. Kurse plaçkat i keni fshehur, ë?! Ty të them, se ju gratë e keni zakon të merreni me këto punë!

Një tis i hollë trëndafili kishte veshur faqet e Dakleas dhe, midis këtij tisi, ajo ishte bërë më e bukur.

Xhandari i ri, të cilit kostumi i rrinte i ngushtë, me qafën e kuqe e të ngjallur si të një demi, e shikoi Daklean në mënyrë tinëzare, si çapkën i ndezur dhe, pasi lëpiu buzët, që edhe ato gati i pëlcitnin nga teftiku i gjakut, nxori nga dollapi disa rroba të vjetra dhe i lëshoi mbi dysheme. Pallto burri. Pallto gruaje. Këpuçë etj. etj. dhe i numëroi të gjitha ngadalë, se ngadalë i shkruante edhe rreshter Ago Agoja.

— Shumë të vjetra, — tha nga veranda nëpunësi plak i përmbarimit, zoti Nazmi. — As dy franga s'bëjnë të gjitha. Vazhdoni punën!

Daklea trembej e trishtohej gjithnjë më shumë: Mentari përpiquej të mbahej i qetë. Xhandari i ri hapi sirtarët e makinës qepëse.

— As gërshtë nuk paska! — tha. — Por ja, — dhe hodhi një kukull prej lecke.

Leta qau me të qarën e së ëmës, ku tingëllonin bashkë të gjitha nuancat, vaji, dënesa, ngashërimi.

— Pusho! — briti rreshteri, dhe, pasi nxori majën e lapsit nga goja, e drejtoi si revole drejt Letës.

Xhandari i ri mblodhi gjithë sa i ranë në sy: dyshekët e mbulesat, shqiti perdet e vietra, një palë papuçe të Dakleas, ndonjë rrangullinë tjetër dhe i hodhi në mes të dhomës.

— Vetëm këto janë plaçkat e gjumit? — pyeti rreshter Ago Agoja.

Heshtje.

— Do të kontrollojmë, — tha rreshteri. — Do të kontrollojmë edhe gërmadhat e shtëpisë së vjetër ku ai qeraxhiu Teli Bashari ka ngritur një tek dhomë. S'je në rrugë të mbarë, zoti Mentar, — vazhdoi rreshteri. — S'të vjen keq për fëmijët? A s'e shikon që u janë bërë fy-



tyrat sa një grosh? E pse?... Sepse i ati s'do që të nënshkruajë, ta zëmë, një deklaratë. Të kisha unë një vilë si kjo! — Heshti gjatë. — Për këtë vilë unë jam gati të jap kokën!

Xhandari i ri doli nga kuzhina me një trastë në dorë.

— Misër! — tha.

— Hidhe! — u bë nervoz rreshteri. — Kujtova se çfarë!

Kallëzit e misrit u shpërndanë nëpër dysheme.

— Dhe ankohesh për bukë, — tha rreshteri e me të thënë këtë fjalë, si ta kishte inatin me zotin Nazmi, hodhi shigjetën e pështymës pak mbi festën e tij të zezë prej cohe të shtrenjtë. Kur pështyma ra me zhurmë në shkallët e verandës, koka e zotit Nazmi sapo që tërhequr nga korniza e dritares.

Së fundi, xhandari i ri u kthye nga kuzhina me duart të mbushura me libra.

— Ç'janë këta? — pyeti rreshteri dhe bëri gati shkelmin.

— Ar! — tha me shaka zoti Nazmi. — Ar janë!

...Atëherë Daklea ishte gjashtë vjeçe, kur një natë të errët me shi babai që kthyer i lagur dhe një mik i shtëpisë e kishte pyetur:

— Çfarë ke aty, Sami?

— Ar! — kishte thënë i ati.

Nëna kishte vënë buzën në gaz.

— Zhvishu! — i kishte thënë të shoqit.

— Prit të nxjerr arin! — dhe nxori librat nga trasta.

— Ke ecur shumë!

— Shumë!

— Je lodhur shumë!

— Shumë!

— Turqit janë egërsuar!

— Si ujq të uritur.

Afërsisht këto mbante mend Daklea nga ajo natë. Bile këto ishin nga të paktat kujtime të fëmijërisë së saj. Nga të vetmet fraza e pamje. Më vonë asaj i kishin shpjeguar se atëherë, në kohën e turqve, i ati shkonte fshatrave



me libra shqip në krah për t'u mësuar njerëzve shkrim e këndim. Pastaj, kur qe rritur e kur ajo vetë shkonte në shkollë, në shtëpinë e tyre vinin rregullisht tri herë në javë gjithë ata burra, me flokë të thinjur, me mustaqe të gjata e më llulla në gojë, për të mësuar geramat e shqipes. I kujtohej Dakleas, se si i ati vërtitej midis shtëllungave të tymit me trupin e tij të vogël e të plakur dhe u jepte të gjithëve përgjigje. Nganjëherë thërriste Daklean, që tashmë po mbaronte filloren, t'u lexonte burrave vjer-sha. Ajo i njihte prej vjetësh ata libra, u dinte përmendsh titujt, ngjyrën e kopertinës, skicat e rralla, llojin e germa-ve, ndonjë faqe të grisur e të ngjitur me kujdes. Ata ishin i vetmi kujtim që i kishin lënë prindërit pas vdekjes.

— Këta janë libra, o derr, o Shkëlqim derri! — tha rreshter Ago Agoja me inat dhe e mbërtheu me syrin e madh, që ishte i paduruari.

— Ç'ti bëjmë? — pyeti xhandari i ri, i gatshëm për t'i lëshuar te këmbët e rreshterit, i cili sakaq kishte zgja-tur shkelmin.

— Mos i dëmto librat! — Pati diçka të veçantë në zërin e Dakleas, diçka urgjente e të frikshme, diçka të nderë e të dëshpëruar. Ajo sapo ishte kthyer nga bota e kujtimeve, në botën reale dhe, tek qëndronte ashtu e ngrirë, të linte përshtypjen sikur shikonte një gjë që të tjerët nuk e shikonin, nuk mund ta shikonin, nuk dinin ta shikonin.

— I ke lexuar këta libra? — pyeti Mentarin përmba-ruesi plak. (Me Daklean askush nuk bisedonte. Ajo ishte e denjë vetëm për t'iu nënshtruar vështrimeve të xhan-darit të ri.)

— I kam lexuar!

— Ç'libra janë? — Kësaj radhe pyetja e përmba-ruetit kishte rënë mbi xhandarin e ri.

— Na-na-naim Fra-fra-shëri!

Përmba-rueti pyeti prapë. Pyetja e tij u kuptua para se ta bënte.

— Lexo të tjerët.

— Të gjithë të Naim Frashërit! — i ra shkurt Mentari. Fytyra prej pergameni e përmba-ruetit u bë si t'i ki-



shin hedhur një dorë pluhur përsipër. Pluhur harrese. Ai po mendohej.

— Se ku e kam dëgjuar këtë emër, — tha i përhumbur.

— T'i hedhim në pus! — tha rreshteri më në fund.

Mentar Dika buzëqeshi me atë buzëqeshjen e tij inatçore, që nuk ia ndryshonte aspak shprehjen e fytyrës. (E vlen të themi se ky ishte një zakon i vjetër i tij, të cilin ai e bënte vetëm në vigjilje të ndodhive të rëndësishme si kjo e tanishmja, kur librat e Naim Frashërit mund të hidheshin në pus.)

— Naim Frashëri! — Fytyra e përmbaruesit të vjetër e kishte kapërcyer cakun e harresës, d.m.th. e kishte shkundur pluhurin nga pergameni i fytyrës. — Ah, po, po. A të kujtohet historia me Genc Bogën? — pyeti ai duke kthyer kokën nga Mentari. — Këtu e gjashtë muaj më parë...

— Një lek! — ua vuri çmimin librave zoti Nazmi. Dhe shtoi: — Veprat e Naim Frashërit!

— Një lek! — u dëgjua një zë nga fundi i sallës. Ndoshta nga kumbimi i zërit, që ishte një zë i ri, ndoshta nga kureshtja se kush do të ishte ai që do të harxhonte një lek për të blerë ca libra të vjetër, të gjithë sa ishin në sallë kthyen kokën prapa. Kureshtja dhe çudia u bënë më të mëdha, kur u bindën se ai që kishte folur, ishte këpucari i barakës, Genc Boga... Rreth trembëdhjetë vjet më parë, pikërisht ky Genc, s'dihet si ia mbushi mendjen të atit dhe në moshën dymbëdhjetëvjeçare qe regjistruar në klasën e parë të fillores. Pastaj ai mbaroi edhe dy vjet të shkollës qytetëse. Në pushimet e vitit të dytë i ati u sëmur nga tuberkulozi dhe Genc Boga u nda përgjithmonë nga shkolla: duhej të mbante me bukë veten, nënën dhe babanë e sëmurë, duhej të mbante në këmbë, sa të mos shembej, edhe shtëpinë me një dhomë gjumi e me një dhomë zjarri. Pastaj Revolucioni, pastaj vdekja e të atit, pastaj varrosja e së ëmës tre vjet më vonë. Kështu, në moshën njëzetegjashtëvjeçare dokumentat e Genc Bogës, që ishin regjistruar në protokollin e njerëzve «në ndihmë familjes», dolën nga raftet, u vendosën mbi tavolinën e she-



fit të rekrutimit, Gencit i dërguan lajmthirrjen për të kryer shërbimin ushtarak, i qethën kokën dhe ashtu me kokë të qethur ai u gjend në sallën e përbarimit, ku shiteshin në ankand plaçkat e Dikëve.

— Një lek! — thirri një herë përbaruesi. — Një lek!  
— thirri dy herë dhe ngriti lart çekiçin prej druri.

— Dy lekë! — u dëgjua një zë tjetër.

Genc Boga nuk i ngriti sytë për të shikuar atë që foli. Ai do t'i blinte edhe për katër lekë librat e Naim Frashërit, por tha:

— Tre lekë!

— Tre lekë! — thirri një herë përbaruesi. — Tre lekë! — thirri dy herë me çekiç të ngritur dhe kroi fytnin për thirrjen e fundit, por atë çast u dëgjua një tjetër zë:

— Gjashtë lekë!

Ai zë kishte ardhur nga një cep i sallës, ku dy zotërinj të rinj me favorite qëndronin pak si të veçuar nga të tjerët. Ky veçim, që dukej më se i domosdoshëm, sikur buronte edhe nga veshja e tyre e shtrenjtë, edhe nga pamja e tyre e jashtme. Njëri nga ata, ai më i gjati, e kishte kokën elegante, të rrumbullakët e të mbushur nga prapa, ishte brakicefal. Tjetri e kishte të ngushtë e të gjatë, dolikocefal, por me mënyrën e krehjes së flokëve dukej jo më pak simpatik se i pari. Shikonin me krenari sa herë pëshpëritnin, dhe ajo që pëshpëritnin, po ta gjykoje nga qëndrimi i tyre, duhej të ishte diçka për të qeshur, diçka përbuzëse, rrezja e së cilës i kapërcente përmasat e sallës ku ishin ekspozuar ato plaçka të vjetra e të mjera.

Përbaruesi kishte shtangur për një çast me shikimin plot mirënjohje e përlulje ndaj dy të rinjve, sidomos ndaj të gjatit (brakicefalit), pastaj tha:

— Hapni vend djalit të pashës!

Po meqë djali i pashës D refuzoi të afrohej, atëherë zoti Nazmi shpejtoi të thërriste:

— Gjashtë lekë! — një herë. — Gjashtë lekë! — dy herë. Në fillim të thirrjes së tretë përbaruesi ngriti çekiçin, por... e uli menjëherë, se në sallë u dëgjua prapë kumbimi i këndshëm i zërit të parë, i zërit të ri:



— Shtatë lekë!

— Dhjetë lekë! — tha djali i pashës D.

Nëpër sallë brodhi një uturimë, si të kishin fluturuar mbi kokat e njerëzve të gjitha mizat e rruzullit. Dhe të gjithë, si ta kishin bërë me fjalë, së pari shikuan djalin e pashës D, pastaj shokun e tij, pastaj vështrimi i turmës përshkoi një gjysmë rrethi dhe u fiksua në cepin tjetër të sallës, ku s'ishte vështirë të kuptoje, se Genc Boga po numëronte paratë, pa i nxjerrë duart nga xhepi.

— Dhjetë lekë! — thirri një herë përmbaruesi. — Dhjetë lekë! — thirri dy herë përmbaruesi.

Tha djali i pashës D (duke shikuar nga Genc Boga):

— Na ka bërë gjashtë a shtatë vjet shkollë e na flet për Revolucionin famëkeq, që nuk i paskësh fshirë nga faqja e dheut të gjithë bejlerët e pashallarët e që nuk u paskësh dhënë tokën bujqve! Apo pandeh ti, se nuk i marrim vesh ne?!

Mentar Dika kishte bërë një lëvizje të papërcaktuar, po Daklea e kishte përmbajtur, e kishte qetësuar. Pastaj, ai kishte shikuar nga Genc Boga, siç mund të shikojmë një krijesë të panjohur që e zbulojmë për herë të parë.

Befas, përmes turmës, që priste të blinte ndonjë cikërrimë, po që mund të ishte aty thjesht edhe për kurreshtje, çau me supe një grua afër të gjashtëdhjetave, e gjatë, e drejtë, e bardhë, e zezë. Ajo qëndroi përballë dy zotërinjve të rinj, por shikoi vetëm njërin nga ata, vetëm djalin e pashës D dhe vetëm atij i foli:

— Si shumë e zgjate gjuhën sot, zotrote! — Kaq tha Folta me basin e vet dhe eci, por në hapin e tretë qëndroi dhe tha prapë: — S'të ka mbetur gjë tjetër për të kaluar kohën, përveç këtij ankandi?

Gruaja me të zeza çau sërish përmes njerëzve dhe qëndroi përballë Genc Bogës.

— Ti, nip, eja pas meje!

Genci e shikoi nga lart tezen (ai ishte pak më i gjatë se ajo) dhe u duk qartë se nuk do të kishte guxim ta kundërshtonte.

— Zonja Foltë, mos ndërhyjni! — tha përmbaruesi plak. Ajo nuk e shikoi përmbaruesin, por tha:



— Ti, pusho, zoti Nazmi! — U kthye nga i nipi, po shikimin e hodhi nga librat, që ishin me formate të ndryshme, me ngjyra të ndryshme, me trashësi e kopertina të ndryshme. — Nuk them se libri është gjë e keqe, por them që ata dhjetë lekë ti mezi i ke kursyer.

Tha përmbaruesi:

— Zonja Foltë, mos ndërhyini!

— Ti, pusho, zoti Nazmi! — ia priti ajo përmbaruesit plak, fytyra e të cilit, tashmë, ishte bërë si një pergamen i grisur. — U kthye nga i nipi: — Ti, eja pas meje! — Hodhi vështrimin nga Mentar Dika: — Ata libra u bënë mollë sherri, zoti Mentar. Por fajet i ka kush i ka!

— Zonja Foltë, mos ndërhyini! — tha prapë përmbaruesi.

— Ti, pusho, zo-ti Naz-mi! — brumbulloi basi i saj.

Të pranishmit në sallë pinin duhan dhe zhbironin me sy herë djalin e pashës D, herë Genc Bogën, herë Folta Papin, herë Mentar Dikën dhe prisnin çfarë do të ndodhte dhe si do të përfundonte kjo histori. Mentar Dika shikoi me dashamirësi Folta Papin dhe i bindur se ajo dhe të gjithë të pranishmit e tjerë ia kishin kuptuar mendimet rebele, lëmoi ngadalë mustaqet e shkurtra pa thënë gjë.

Djali i pashës D, që në të vërtetë s'kishte pasur ndër mend t'i blinte librat dhe nuk i bleu, para se të largohej nga salla, tha:

— Ti, more Genc, që të kanë vënë emrin e një mbreti ilir, eja pasdite në klubin Bristol, të pimë një kafe bashkë! Eja!

— Pse kështu? — qëndroi e pyeti Folta.

Djali i pashës D, brakicefali, e hodhi vështrimin mbi kokën e Foltës, pastaj shënoi me gisht Genc Bogën. Tha:

— T'i tregojmë këtij zotërie se ç'është në gjendje të bëjë kundërrevolucionin! — Dhe duke u kthyer sërish nga Genc Boga, shtoi: — Mos harro, pasdite në klubin Bristol.

— Ai s'ka punë atje! — Kur tha këto fjalë, Folta Papi, që i kishte kthyer kurrizin me kohë djalit të pashës D, ecte përtej pragut të sallës dhe, e sigurt se të nipin e kishte prapa, nuk e ktheu kokën asnjëherë.



... Përmbaruesi afroi karrigen te dritarja, shikoi nga Mentari dhe tha:

— U erdhi përsëri radha librave të Naim Frashërit. Po mos kujto se do t'u ngrihet pjaca deri në dhjetë lekë. Ajo që ndodhi gjashtë muaj më parë s'qe veçse një tekë e djalit të pashës. Fundja, mund t'i kishte blerë Genc Boga, ai mistreci i shpalljes, po kush ishte ai burrë që guxonte të ngatërrohej me Folta Papin? Unë, ti, i nipi, djali i pashës, të gjithë ne, me nder zotërisë sate, u bëmë lakër përpara asaj xhadie, që më ecën si të ketë mbathur potkonj e jo këpucë.

— Ç'dreq njeri është ky Naim, që s'na ka folur kurrrë kapiten Sinani?! — pyeti xhandari i ri.

— Është bej, Naim bej Frashëri! — tha përmbaruesi, tashmë i shkundur krejtësisht nga pluhuri i harresës.

Rreshteri dhe xhandari i ri, pasi shikuan njëri-tjetrin, u zbutën.

Pastaj, xhandari i ri kaloi pranë Dakleas, i hodhi një vështrim të paturpshëm trupit, e sidomos belit të saj të hollë dhe hyri në kuzhinë. Pas pak doli prej andej me një llambë vajguri në njëren dorë e me një mbulesë tavoline në tjetrën. I vendosi, pa pyetur e pa shikuar njeri. Me llambat, me mbulesat e tavolinave, me kostumet e sendet e tjera shtëpiake nuk ishte si me librat, me këto sende, që ishte mësuar edhe në sekuestrimet e tjera, ai e ndiente veten me të dyja këmbët në tokë. Hyri e doli disa herë nga kuzhina, herë me tenxhere dhe tava, herë me perde e ndonjë tepsi. Sa herë hynte e dilte, shikonte Daklean dhe sytë i ndizeshin si të demit.

Së fundi, kur panë atë grumbull të vogël plaçkash, xhandarët e përmbaruesi sikur ranë në mendime.

— Pak! — tha i pari rreshter Ago Agoja. Doli, eci në verandë, pranë këmbëve të përmbaruesit plak, që s'ishte ngritur asnjëherë nga karrigia (ky i fundit shtrembëroi hundët dhe mënjanoi kokën nga era e rëndë si e qenit të plakur që la prapa trupi i rreshterit), kaloi anës oborrit dhe u fut në shtëpinë e vjetër me çardak e qemer, plot frikë e kujdes, duke shikuar rrotull, si të ruhej mos i binin mbi kokë muret dhe çatia.



Keci vërriti ë-ë-ë-të e tij hundore. Dhia lëshoi disa m-m-m të dridhura, rreshteri eci drejt qemerit. Prej atje pyeti:

— Dhia e Telit?

— Po, — u përgjigj i bindur zoti Nazmi, për të cilin flitej se e kishte të regjistruar në kokë gjithë pasurinë e qytetit N.

— Muri që të ndan me Telin, qenka shembur, ë?! — Po, — kësaj radhe u përgjigj Mentar Dika.

Rreshteri eci përsëri drejt qemerit.

Daklea shikoi të shoqin: Genc Boga: ja, ç'donte të thoshte ai shikim. Po tashti ishte vonë.

Ago Agoja qëndroi nën qemer, përplasi shkelmin mbi rrasën ku kishte vënë këmbët, ca guriçka apo ca kakërdhi ranë diku nëpër të çarat e rrasave, pastaj hesh-tje dhe përgjim.

Dikët u shikuan në sy. Po nuk lëvizën.

— Ç'ka këtu? — Meqë s'mori përgjigje, pyeti me inat: — Vetëm kakërdhi ka këtu?

Rreshteri qëndroi një çast pa vendosur ç'të bënte. Pamja e tij të linte përshtypjen sikur ndodhej buzë një hendeku. A ta kapërcente? Shkeli prapë disa kakërdhi, u bë nervoz, po nuk u largua. Shikonte rrotull me dyshim dhe dukej sikur diçka nuhaste.

— Nevojtorja është më poshtë! — tha me qetësi të shtirë Mentar Dika.

Ai e shikoi me inat dhe u zbraps, duke hedhur vësh-trimin prapa, si të kishte lënë aty diçka të dyshimtë. Para se të ngjitej nëpër shkallët e verandës, rreshter Ago Ago-ja qëndroi, i hodhi një sy vilës dhe tha befas:

— Të kisha unë një vilë si kjo! — Tha prapë: — Unë i ziu, që jap kokën për një vilë si kjo! Gati dy vjet me radhë na kishin rënë veshët rehat, kur, bam, ia pati rrëzë Maleve të Shqipes. E çfarë kërkojnë ata, e çfarë kërkon ti? Mbërthehu ore pas vilës, kështu të them unë, mblidhe mendjen! Të kisha unë një vilë si kjo!...

Kontrolli kishte mbaruar dhe Dikët morën frymë të çliruar. Megjithatë Daklea e ndjeu veten shumë të do-bësuar, gjë që vihej re sidomos në duart e saj drithërake.



Vështrimet e xhandarit të ri po bëheshin gjithnjë më të paturpshme. Sado që ajo ishte përpjekur të ruante gjakftohtësinë, sado që ishte përpjekur të bënte sikur nuk i kishte vënë re ato vështrime, më në fund, sytë e xhandarit i shëmbëllyen me dy çengela, që u zgjatën për ta kapur.

— Ah! — klithi Daklea, pikërisht atë çast, kur iu bë sikur rrobat i shkanë poshtë dhe trupi i mbeti çipllak.

Rreshter Ago Agoja u kthye në paradhomë dhe dyshemeja prej dërrase rënkoj nën peshën e trupit të tij të ngjallur.

— Zoti Nazmi, — iu drejtua përmbaruesit, — a të ikim?

— Asgjë s'ka mbetur, zoti Ago? — pyeti nga veranda përmbaruesi plak, me fytyrën e trupin në diell e me bishfin e syrit nga rreshteri, ose më mirë të themi, nga pëshlymat e rreshterit.

— Asgjë, zoti Nazmi! -- dhe befas shigjeta e pështymës fluturoi vërtet drejt kësulës së zotit Nazmi, por ky i fundit, i përgatitur me kohë, mundi t'i dredhonte.

Pas pak përmbaruesi plak u ngrit nga karrigia dhe u fut brenda. Sytë e tij të sprovuar vunë re menjëherë se në vilë s'kishte mbetur asgjë, përveç, ... rrezeve të diellit, që binin si njolla të arta në dysheme. (Fajet i kishin xhamat pa perde!) Ai i shikoi një copë herë ato rreze dhe në shikimin e tij kishte diçka të veçantë, diçka profesionale prej nëpunësi të përmbarimit, kishte zemërim dhe lakmi, që pikërisht ato rreze dielli nuk kishte as mundësi dhe as pushtet për t'i sekuestruar.

— Nuk është ar gjithçka që shkëlqen! — tha me vështrim te njollat e arta. Shikoi nga rreshteri. — Të ikim, zoti Ago! — dhe aty për aty pamja e tij u bë e butë e keqardhëse si më parë e si gjithmonë.

— Shkëlqim! — thirri rreshteri. — Hë, more derdimen, ç'u shastise sot? Shko merr karrocën!

Në dhomë kishte rrëmuje. Plaçkat ishin hedhur pa kujdes mbi dysheme. Nga njëra anë e tyre ishte Mentari, me sytë e çelët e të pastër si të cekëtinave, nga ana tjetër ishte Daklea, me flokët e rëndë që i binin mbi supe. Pranë saj qëndronte Gimi, që ngjante aq shumë me të atin,



si të ishte dublikatë e tij; ishte edhe Leta, që me gjithë ngjashmërinë me të ëmën, hëpërhë kjo gjë nuk mund të vihej re, sepse gjatë gjithë kohës së sekuestrimit ajo kishte qarë gati pa zë.

Përmbaruesi plak qëndroi te pragu dhe vështrimi i tij u ngul si turjelë në ballin e Mentarit.

— Zoti Mentar, — tha me zë të zbutur e të thellë. — Së shpejti në ankand. — Vështrimi i zotit Nazmi doli nga balli i Mentarit siç del një turjelë. — Mirupafshim, zoti Mentar! — dhe aty për aty, në mënyrë krejt të natyrshme, pamja e tij pësoi metamorfozën e zakonshme, që e tregonte gjithmonë të përvuajtur e gjithmonë të dhimbshëm për botën që e rrethonte.

Rreshter Ago Agoja, me syrin e madh, të paduruarin, shikonte xhandar Shkëlqimin tek po ngarkonte plaçkat bashkë me karrocierin, ndërsa me të voglin, të ligun, shikonte të zotët e vilës dhe vilën vetë. Nga fresku që i bënte gjoksit me palën e zbërthyer të xhaketës ushtarake, trupi i tij qelbej si trupi i një qeni të plakur. Por mbante edhe erë raki rreshter Agoja, tamam si fuçi e shpuar.

— Të kesh një vilë si kjo, vetëm të jesh budalla të moç bësh një deklaratë! — tha nëpër dhëmbë, si t'i përgjigjej një mendimi që nuk i hiqej nga koka.

## VI

Tërë atë mbrëmje, nga grumbulli i shtëpive rrotull varosheve shkëputeshin silueta që, duke mbajtur diçka nëpër duar, trokitnin lehtë e mbytur dhe, me t'u hapur

porta e vilës, zhdukeshin menjëherë prapa saj, përsë-  
ndetnin, thoshin ndonjë fjalë të mirë, lëshonin si pa rën-  
dësi një gotë a një mbulesë, një pjatë a një tenxhere e  
shumë sende të tjera shtëpiake dhe largoheshin para se  
të kthehej trokëllima e këpucëve me gozhdë të patrullës.  
Ata vinin një nga një, asnjëherë dy bashkë dhe nuk qën-  
dronin shumë, se ashtu duhej, ashtu e kërkonin koha dhe  
rregullat e pashkruara të fshehtësisë spontane. Kish-  
te edhe nga ata fqinjë, shumica gra, të cilat qëndronin  
më gjatë, shanin qeverinë për paturpësitë e për ligësitë që  
po bënte, pastaj largoheshin, duke lënë prapa vetes diçka  
që vlente më shumë se buka, djathi e lugët prej druri që  
mund të kishin sjellë.

E fundit fare erdhi plaka Deje, që ishte mbi të nën-  
tëdhjetat, që rrudhat e viteve ia kishin punuar e lesuar  
disa herë fytyrën e që ecte me duart prapa kryqeve, se  
pikërisht aty mbi shpinën e saj kishin ngritur folenë e  
tyre të gjitha llojet e reumatizmave, të vjetër e të rinj. Ajo  
erdhi pa asgjë në dorë, por bashkë me nënqeshjen e saj  
të topitur mbi buzët e holla, solli me vete edhe fjalët:

— Subhanë allah, mjaltë e qumësht!

Shikoi rrotull dhomën e boshatisur, shikoi edhe pesh-  
qeshet e fqinjeve të tjera dhe tha:

— Vakufi një herë e dy duron, po kur ta jep... Kjo  
shtëpi asht d'jegë tri herë për vatan, kjo asht vakuf!

Një çast më vonë plakës Deje sikur i rrodhën sytë  
poshtë faqeve, sikur iu zgjeruan edhe më shumë rrathët  
e murrme poshtë tyre. E zbehtë dhe e tretur, me xhunga  
rudhash në duar e në fytyrë, ndjeu t'i dridheshin leqet  
e gjunjëve dhe u ul drejt në dysheme, si të ulej në posti-  
qen e saj të përhershme e të përjetshme. Kur u ul, futi  
dorën në brez, nxori nga ushkuri i çitjaneve një xhezve,  
si të nxirrte një revole, nxori nga futa një letër me she-  
qer e një tjetër me kafe dhe tha me zërin, që s'e kishte as-  
pak të zbehtë e të tretur:

• — Nuse, na ban një kafe për inat të hasmit!

Biseda u çel. Plaka Deje, që ishte fqinja e tyre më  
e vjetër dhe që i kishte ushqyer gjithmonë me histori më  
të vjetra se veten, kur Daklea dhe Mentari e pyetën për  
shëndetin, u tha:



— Unë durova kur turku më mori sytë (i kishin vrarë të birin pesëdhjetë vjet më parë), e jo të pyes për vetullat. Nuk vdes unë, as dheu më tret, pa vu përpara xahilin e Tiranës. Mbramë, kur këndoï bufi, kukumjaçka dhe lehu qeni, iu luta zotit ta surdiste xahilin në xhehenem. atje e ka vendin ai, qi mos qoftë!

Shikoi prapë rrotull, rrufiti prapë kafen dhe tha:

— Mos u tremb, nuse, hoqëm ç'hoqëm nga turqit, por ne mbetëm, turqit e thyen qafën. Ymërgjati, kur ka me vete të drejtën, ymërshkurtën s'bahet kurrë!

Tha prapë, duke vënë filxhanin në dysheme, se plakës Deje i dridheshin duart dhe i derdhej kafja, po ta mbante gjatë në dorë:

— Kush kërkon t'i bajë gropën shoqit, bie vetë brenda! Dëgjoni mue, e zeza do ta presë gjithë këtë soj e sorollop. Hiç mos u dëshpëroni për laçkën e plaçkën që ju mori qafiri. Sytë e hapun kanë shpresë!

Kështu u pi ajo kafe me plakën Deje, kështu u bënë këto biseda e të tjera si këto, derisa aty nga mesnata u ngrit, duke u mbajtur pas Dakleas (kjo e fundit e kishte dashur gjithmonë plakën Deje) dhe iku ashtu siç erdhi, me duart prapa kryqeve, dhe e mbylli vizitën e bisedën e saj po me fjalët që e kishte hapur:

— Subhanë allah, mjaltë e qumësht!

Për shumë kohë, pasi ishte larguar plaka Deje, fytyrat e Dikëve, që atë natë e bënë gjumin me copa, mbetën të çelura nga një gëzim që u kishte ardhur jo nga larg, jo si në përralla, po nga grumbulli i shtëpive të vjetra, me të cilat i ndanin vetëm varoshet. Ashtu i zuri edhe mëngjesi, të çelur e të gëzuar.

Ecejaket e fshehta, vizitat e ndihmat e fqinjëve, të njohurve e të të afërmve vazhduan edhe natën tjetër, edhe natën e tretë dhe, kur ato shteruan, natën e katërt nëpër oborrin e vilës u dëgjua trokitja e disa hapave të njohur. U dëgjua më qartë edhe zëri i dridhur i dhisë dhe i kecit. Pastaj, hapat e njohur, të ngadalshëm, të kujdesshëm ecën përmes oborrit, ngjitën shkallët e verandës dhe qëndruan te pragu i paradhomës, aty ku ndriçonte llamba.



Teli Bashari përshëndeti me kokë e me fjalë, po fjalët i hëngri po vetë dhe nuk u morën vesh. Në njërën dorë mbante një bohçe që, duke gjykuar nga supi i anuar, duhej të kishte njëfarë peshe. Daklea u ngrit për t'i shkuar në ndihmë, po Teli u çapit deri në mes të paradhomës dhe e vuri mbi tavolinën e zhveshur, sajuar prej arkash të vjetra. Po me atë heshtje prej plaku, të cilit sado që të heshtë, i flet frymëmarrja e rënduar, zgjidhi bohçen, nxori një bukë gruri, pjekur në çerep, një bukë misri, gjithashtu çerepi, ca djathë të njomë, ca gjizë, domate, specia dhe së fundi një shishe raki, të cilën, kur e vuri në tavolinë, e përplasi pak, si për të nënvizuar praninë e saj, por edhe si për të thënë: «Të pimë njëherë sonte, pa nesër shohim e bëjmë!»

— Bukët dhe rakinë i keni nga Lato Morina! — tha ai.

Të tre ata, Genc Boga, Mentari e Daklea e shikonin në sy dhe dukej hapur se ardhja e Telit i kishte gëzuar shumë. Tashti ata donin të dinin ç'të reja u kishte sjellë ai nga fshatrat. Teli Bashari, që e merrte me mend këtë gjë, u ul po me ato lëvizje të ngadalshme dhe tha:

— Sapo u ktheva! — Shikoi nga Genci. — Lato Morina i ka marrë vesh të gjitha. Ia kishte treguar plaka e kassolles buzë pyllit. Por ai thotë se qyteti ka rreziqe, thotë që të kthehesh sa më shpejt. Kur të kthehesh, duhet ta lajmërosh nëpërmjet meje. Takimi, te Guri i Bardhë. Kështu më tha. Sa më shpejt. Te Guri i Bardhë.

— Latoja ka të drejtë. Do të kthehem sapo të kem mbaruar edhe një punë! — tha pas pak Genci dhe ra në mendime, si të bluante më mirë fjalët që i kishte dërguar Latoja nga fshati.

Xha Teli rrinte para tavolinës gjysmë i kërrusur, ashtu siç kishte ndenjur më se një gjysmë shekulli pa ndërprerje para kudhrës së këpuçëve. Fytyra e tij e prerë nga rombe e kubikë të vegjël, dukej e lodhur, si të mos ishte prej mishi e prej kocke, po prej balte, prej balte të tharë, që kishte marrë të krisura të thella e megjithëse e lodhur, përmes valles së rrudhave, ndihej një diçka e pakuptueshme akoma, një apo disa mendime që i flluskonin, që i



fluturonin nëpër fytyrë e që plaku nuk i kapte dot. Para se të fliste, ai shikoi prapë bashkëshortët Dikë dhe, kur pa fytyrat e tyre të çelura (ata e mirëpritnin gjithmonë Teli), atëherë edhe fytyra e plakut u çel, edhe ajo mori dritë e gjallëri.

— Jua paskan rrëmbyer të gjitha ç'kishit, ë?! — pyeti ai dhe në këtë pyetje kishte edhe keqardhje, edhe kërcënim. — I di të gjitha, m'i tha plaka Deje!

Nga dera e hapur e dhomës së gjumit dukeshin fëmijët që flinin mbi një dyshek mbuluar me çarçafë të bardhë e të hekurosur. (Fqinjët!)

— Do t'ju sjell edhe unë ndonjë gjë që ju mungon.

Teli Bashari heshti. Por në heshtjen e tij ndiheshin prapë po ato mendime që i flluskonin e që ai nuk i kapte dot.

— Moj nuse e bukur, ç'na e paske kyçur gojën sonte!  
— Këto fjalë ai i kishte thënë me solemnitet të vjetër prej plakut.

Daklea vetëm i buzëqeshi xha Telit, se edhe ajo prishte, si prisnin Mentari me Gencin, që ai t'u thoshte të rejat nga fshati.

— Mirë atëherë, po flas unë! — Ai shikoi shishen e rakisë që kishte vënë mbi tavolinë. — Thuaj Mentarit, më tha Lato Morina, të mos dëshpërohet. Prapë do të vijë koha, tha Latoja, kur do të mbliidhemi si në vitin një mijë e nëntëqind e njëzet e katër, dhe ishallah do të jemi më shumë e s'do të na e hajë më qeni shkopin. Kështu më tha Latoja dhe m'u lut ta pimë bashkë këtë shishe e ta kemi zemrën të bardhë.

Në heshtjen që ra pas këtyre fjalëve, u duk që secili ishte shkruirë me këtë heshtje të përgjithshme dhe, në të njëjtën kohë, secili ishte tërhequr dhe jetonte botën e tij të veçantë.

— Atëherë të pimë, — tha pas pak Daklea dhe u ngrit e u vuri nga një filxhan përpara. Kur ajo u solli pjatën me meze, domate, specë e djathë, xha Teli ngriti filxhanin e rakisë dhe tha:

— Brom!

— Brom, brom, brom, — thanë tre të tjerët.



Pasi kishin pirë gjysmën e shishes, pasi kishin fluturuar nga një bisedë në tjetrën dhe të gjithë ishin gjallëruar nën ndikimin e avujve të rakisë, Teli Bashari befas gjeti një nga ato mendimet që i flluskonin prej kohësh. Pëshpëriti:

— Më tha një mësues fshati, se Zogu paska hyrë në allishverish me fashizmin italian, derisa një ditë Shqipëria do të vihet e gjitha në arkand! — Teli Bashari e ngriti zërin, (zëri i tij ngrihej sa më shumë që rakia ulej në shishe). — Si thoni ju, të jetë e vërtetë kjo?

— Po, — tha prerë Mentar Dika. — Ai ka marrë e vazhdon të marrë miliona franga nga fashizmi!

Fytyra e Telit u rëndua më shumë dhe u duk sikur gjithë ato rrudha e pala, ato rombe e kubikë iu grumbulluan në çipat e buzëve, në mjekër e nën gushë, dhe atëherë ai shembëlleu me portretet imagjinare të një piktori, në penelin e të cilit qëndrojnë tipat dhe subjektet përrallore.

— Ah! — klithi pas pak. Si duket i qe kujtuar një nga mendimet e tjera të harruara. Nxori diçka nga xhepi, u hodhi një vështrim të gjithëve dhe asnjërit, e vuri mbi tavolinë atë «diçka», por me aq kujdes, sikur ajo që vuri, mund të zhdukej e, po të zhdukej ajo, ishte rrezik që toka të humbiste ekuilibrin. — Ma dha mësuesi. E dini çfarë shkruhet aty? Këpucarët e Vlorës i paskan kërkuar qeverisë t'u vihet një taks i rëndë këpucëve e çizmeve prej llastiku që vijnë nga Italia, se ato i kanë sjellë një dëm të madh punës sonë.

Teli Bashari heshti për aq kohë sa të tjerëve iu desh ta kalonin dorë më dorë copën e gazetës.

— E kam thënë unë, — vazhdoi ai, — këpucët e jashtme nuk janë më të mira se tonat, por vetëm që kanë lustër! — Këto fjalë ai i shqiptoi me ton të atillë, sikur në botë të mos kishte gjë tjetër, veçse këpucë. Prapë u shkund, si të kishte kapur edhe një nga harresat e tjera dhe, duke buzëqeshur, tha me shikim vetëm nga Genc Boga: — Kushedi, do të vijë një ditë që edhe ne të dy të bëjmë këpucë të reja e të mos merremi vetëm me mermetime, siç jemi marrë deri më sot, ti në baraken tën-



de, unë fshatrave e ferrave. Veç të vijë ajo ditë, po e di vetë unë sa të bukura do t'i bëj këpucët! — Shikoi nga Daklea. — Të parat këpucë do t'i bëj për ty! (Daklea i buzëqeshi.) Shikoi nga dera e hapur fëmijët që flinin. — Të dytat për Gimin e për Letën. — Shikoi Mentarin. — Edhe ty do të të bëj një palë!

Në fillim fjalët e xha Telit u pritën si ëndrrat e një plaku, pastaj si fjalët e një plaku dhe në çastin e fundit, kur i premtoi edhe Mentarit, befasi plasi një e qeshur, që luhatej midis gëzimeve e mallëngjimeve.

Po xha Teli, që ishte bërë çakërrqejf (tashmë rakia kishte rënë në fund të shishes), ia nisi një kënge me zë të ulët. Ai e kishte zakon të këndonte symbyllur, ndërsa kokën, që e varte pak mënjanë, e tundte lehtë, sipas ritmit të këngës. Dalngadalë Telin e pasoi i pari Genc Biga, që këndonte me gojë të mbyllur dhe me qepalla të rrëzuara, si të ishte ky një mjet për të përmbajtur veten. Po kur xha Teli ia nisi këngës së bilbilit, që kishte rënë në dashuri me fluturën, atëherë edhe Genc Boga këndoi me fjalë. Kurse këngës së Cene Kavajës nga Elbasani, që fill i vetëm luftoi kundër një tabori me xhandarë, bashkëshortët Dikë ia morën të dy menjëherë, sikur kjo këngë të kishte qenë çelësi që u zbërtheu zemrat. Pastaj ata kënduan edhe këngë të tjera. Mentari përplaste duart dhe nën ritmin e tyre Daklea këndonte si dikur, bukur, pa u sforcuar. Dora-dorës fytyra e xha Telit pësoi një metamorfozë të plotë, të çuditshme, ajo u rinua si për t'u kujtuar të tjerëve se dikur edhe Teli Bashari kishte qenë i ri si ata, pse jo, edhe i pashëm si ata.

Gimi dhe pas Gimit, Leta, u ngritën ndenjurr.

— Flini, — u tha Daklea.

Dhe nuk kënduan më. Vetëm aty nga mesi i natës, kur Teli ishte në të ikur, u duk qartë se fytyra e tij mundi të shkarkohej edhe nga harresa më e fundit. Ai u tha Dikëve se Lato Morina kishte mbledhur për ta një napolon dhe se napolonin ia kishte dhënë Bido Peshtit para një jave, kur Bidoja kishte shkuar fshatrave nëpër miq e myshterinj. Pasi tha këto fjalë, Teli hoqi këmbët zvarrë

përmes oborrit, si një dog, për të cilin është karakteristike humbja e ekuilibrit në moshë të thyer.

Kur mbetën vetëm, bashkëshortët Dikë kuptuan se rakia, këngët, bisedat i kishin bërë në qejf, u kishin turbulluar mendjen dhe kishte diçka të përbashkët midis gjendjes së tyre dhe natës së ngrohtë e të argjenduar të gushtit. Mentari, që nuk e duroi dot përcëllimën e atij zjarri, e ktheu Daklean me vërtik dhe e puthi. Në buzët e tyre kishte miqësi, kishte afërsi dhe shoqëri, kishte dashuri, që për muaj, javë e ditë me radhë qe grumbulluar, qe tulatur e që, së fundi, qe shkundur nga gjumi i gjatë. Të këtilla kishin qenë puthjet e tyre shtatë vjet më parë, kur ata ishin martuar. Atëherë ai ishte njëzet e shtatë vjeç, ajo njëzet. Atëherë Daklea kishte qenë vajzë e hedhur, e qeshur dhe e lumtur, kurse tashti Mentari s'mbante mend që kur ajo kishte qeshur. Tek qëndronin të përqaftuar, ai shikonte bulat e djersës në ballin e saj të shtrirë e të zverdhur dhe çuditej ku e gjente ai trup i hajthëm energjinë, ku e gjente ai mish anemik bukurinë. E shtrëngoi si atëherë në natën e parë të martesës dhe trupat e tyre u rrëzuan nga pesha e rëndë e dashurisë.

## VII

Befas, bota e heshtur, e lodhur dhe e mekur u prish në sytë e Mentari Dikës. Në fillim sikur lajthiti, sikur u çartallo. Pastaj u gjallërua, lëvizti, u ngrit dhe vrapoi atje ku një turmë e madhe me fshatarë e qytetarë thërriste, duke tundur trasta e thasë bosh, kosha e kanistra.



Gratë ecnin nëpër turmë me fëmijët të mpirë e gjysmë të zalisur, edhe ato me trasta e thasë bosh, me kosha e shporta në kokë e me qafën të futur midis shpatullave.

Edhe Mentari Dika kishte shkuar pas tyre si i magnetizuar. Ai ishte harruar në mendimet e veta, kur një dorë e fuqishme e mbërtheu për krahu dhe e tërhoqi në bren-dësi të një dyqani mishi. Të dy ata, Mentari dhe ai, që sa-po e kishte tërhequr, u shikuan gjatë.

— Ti jo, ti jo, zoti Mentari! — tha Habib kasapi nga Kosova. Ai ishte më i ri se Mentari, po në pamje dukej më i moshuar, sepse ishte trupmadh, kockëmadh e no-fullmadh. Mbante erë mish, përzier me erë qumësht, erë vathë e bagëti. — Me ty ndryshon puna. Aq duen ata, të të shohin midis tyne!

Heshtën gjatë, me një heshtje miqësore.

— Kështu mblidhen shpesh para depos së bereqetit dhe askush nuk di a ka bereqet në depo, apo asht bosh! — Habibi nga Kosova qëndroi me vështrim te turma dhe rrudhat e ballit, të nxira nga dielli, iu bënë më të thella, damarët në tëmtha iu frynë, ndërsa e bardha e syve i shkrepiti.

— Vazhdon zia e bukës, — tha Mentari, — megjithëse jemi në kohën e korrjeve e të shirjeve të grurit. E di ti, Habib, se shumica e fshatarëve kanë mbetur pa tokë, sepse një pjesë të tokës ua kanë rrëmbyer bejlerët, një pjesë ua kanë blerë fare lirë, dhe fundja, çerekun e tokave të Shqipërisë e kanë pushtuar shoqëritë e huaja që nxjerrin naftë e mademe të tjera!

Para depos së drithit, njerëzit, të veshur çuditërisht me rrobat e tyre të mira, vërtiteshin në një fantazmagori ngjyrash të bardha e të kuqe të shamive e të jelekëve të grave, mëngoreve, shallvareve e kofsharëve të burrave, kishte edhe xhupa shumëngjyrësh fëmijësh, edhe fanella leshi, se fëmijët hanin pak e ftoheshin shpejt, por, megjithatë, si fëmijët e çdo kohe e të çdo vendi, ata nuk merrnin vesh se ç'ndodhte, prandaj bënë edhe guga.

Mentari Dika shikonte grumbullin e njerëzve, që ecte si valë pa drejtim dhe mendonte se gjendja e tij dhe e familjes së tij s'ishte veçse një thërmijë e asaj urie të



madhe, që kishte përfshirë popullin kudo, në qytet e në fshat. Në fshat dhe më shumë.

Tha Habibi:

— Erdhëm nga Kosova në Shqipërinë e lirë në kohën e Qeverisë Demokratike të Revolucionit. Ishim mirë atëherë. Na dhanë një copë tokë për me ngritë një shtëpi. Ne ngritëm vetëm themelet, pastaj Revolucioni u përmbys, dhe mbi themelet tona, qeveria ndërtoi postën e katërt të xhandarmërisë! — Habibi heshti dhe sikur mbajti vesh një zhurmë të largët. Rrudhat e nxira të ballit iu thelluan, prapë i shkrepiti e bardha e syve dhe damarët në tëmtha iu frynë. Tha: — Tashti do të vijmë xhandarët... Ishim mirë atëherë. Nji cull i fqinjit na i këndonte përditë gazetat e Revolucionit. Haj, ç'kishte në ato gazeta! I babin për dy pare pashallarët e bejlerët. Të gjitha do të rregulloheshin, çdo gja do të zinte vendin e vet, por ç'e do... Kurse qeverisë së tanishme i ka hypë në kokë të mbledhë taksat e dhjetë vjetve. Ku asht ndigjue kjo?... A përnjimend, u tha tata im, po ne s'kemi as katër vjet që jemi ngulë këtu!... Njisoj, thanë ata, duhet të pagueni taksat e dhjetë vjetve, xhelep, taksë rruge e ç'janë ato të tjerat, he u rroftë nama e zezë. Edhe taksë tymi për çdo oxhak marrin!

Para depos së drithit fishkëllyen bilbilat e xhandarëve. Pastaj mbi kalldrëm rrahën patkonjtë e kuajve. Turma u pështjellua. Kuajt ishin të egër. Xhandarët vërtitnin kamxhikët dhe në këtë rrëmujë binin përtokë lëvere grash, qeleshe e xhoke burrash, rrokulliseshin shporta, koha e ndonjë fëmijë. Katër vjet më parë, përfytyroi Mentari, ishte po ky popull, që rrëzoi xhandarët nga kuajt dhe u fut në qytet.

— Pushka u vjen haqut këtyne! — tha Habibi nga Kosova.

Mentari e shikoi me takt Habibin, por e shikoi mirë, nga këmbët te koka. Me nofulla të shtrënguara e me vështrim të zemëruar, ai i kujtoi të atin, Faredinin, që flitej se, kur kishte shkuar në Kaçanik, me dy djemtë e rritur, që do t'i binin të dy në fushën e betejës, kishte marrë me vete edhe të voglin, Habibin, i cili aso kohe s'kishte qenë



veçse një picërrak dhjetëvjeçar. E ndërsa turma zbrapsee nën potkonjtë e kuajve, Mentari Dika, që e shikoi prapë me takt Habibin, befas e ndjeu veten njësh me të dhe i besoi plotësisht. Tha:

— Por do të vijë përsëri ajo ditë!

— He të lumtë goja, bre zoti Mentari!

— Nuk mund ta ketë të gjatë një regjim që i ka varë shpresat te kamxhiku!

Me mallëngjim të thellë, Habibi e zuri Mentarin për krahu, Mentari ndjeu dhimbje të këndshme, dashamirëse, shkaktuar nga forca miqësore e dorës së tjetrit dhe padashur iu gërshetuan përleshjet e mëdha të kohëve të Kaçanikut me betejat e Njëzetekatrës. E ndërsa dëgjon-te britmat e xhandarëve dhe thirrjet e zemëruara të turmës, Mentari Dikës iu bë sikur po jetonte një legjendë, jo të kaluar, as të tashme, por një legjendë që kërkonte me këmbëngulje të ardhmen. Tha:

— Ajo që ndodhi në kohën e Revolucionit tonë, Habibi, s'duhet të ndodhë më. Gjatë tre vjetve që isha në burg, unë kam menduar shumë për të gjitha këto. Ne arritëm t'i përmbysnim zotërit e këtyre depove, por s'ditëm ta mbanim fitoren. Disa gabime ne i vumë re që atëherë. Në të vërtetë, çfarë i dhamë ne popullit? Asgjë, as tokën, që ishte një nga pikat më të rëndësishme të programit të Qeverisë sonë Demokratike. Në disa qytete mbetën po ata prefektë që kishin qenë në qeveritë e vjetra, pa zënë në gojë nëpunësit e tjerë, e që të gjithë ata përgjërroheshin për Zogun, i cili armatosej jashtë e vërtitej rrotull kufijve tanë. Bile ne s'qemë të zotë të vinim re se disa autoritete, që s'kishin pasur asgjë të përbashkët me gjakun që derdhi populli në Revolucion, ishin ngritur deri në postet më të larta të qeverisë.

Pasoi një heshtje, gjatë së cilës fytyra e Mentari Dikës mezi përballonte dëshpërimin e vjetër dhe zemërimin e ri, që i shkaktonte britmat e xhandarëve në sheshin para depove të drithit, ndërsa Habibi nga Kosova ishte kthyer i tëri në sy e veshë për të dëgjuar ç'do t'i thoshte akoma Mentari Dika.

— E di pse ndodhi kjo? — vazhdoi Mentari. — Sepse

ne u treguam të butë dhe të pavendosur. Sepse lejuam të na gënjenin. Nuk qemë të zotë të shikonim veprimtarinë e secilit, por u besuam fjalëve dhe rrobave të tyre. Në të vërtetë ata flitnin për demokracinë, po shpirti u qante për Shqipërinë e bejlerëve dhe të bajraktarëve. Dhe ç'ndodhi? Me të ardhur në fuqi Zogu, i gadoi gati të gjithë. Disave u dha shpërblime dhe toka.

— Po Zogun e kthyen këtu Fuqitë e Mëdha! — ndërhyri Habibi.

— Kjo është e vërtetë, — tha Mentari Dika. — Por kjo s'do të ndodhte, po të kishim qenë më të fortë këtu brenda, po të kishim ditur t'i jepnim popullit ato që i premtuam, po të kishim qenë më të bashkuar!

— Mua më ka mbetë një peng në zemër! — tha Habibi.

— Ç'peng?

— Sot që e shikoj ç'po heqim, çuditem me veten time, ku isha unë para katër vjetësh, që nuk rroka pushkën si shumë të tjerë! Ne vërtet s'kishim as tre muaj që kishim ardhë këtu, po bukur boll e kuptuem që Zogu po vinte prapë!

Mentari Dika shikonte Habibin nga Kosova dhe ishte i bindur se, po të kishte fytyrë pendimi, nuk mund të ishte ndryshe, veçse një fytyrë muskuloze e me nofulla të shtrënguara, identike me fytyrën e Habibit.

— Ti nuk e njeh babën tim!

— Kam dëgjuar!

— Edhe atij i ka mbetë peng. Po mirë që neve s'na shkoi mendja vetë të rroknim pushkën, po si, bre burrë, s'na erdhi një mace bishtdjegun në prag të dyqanit e të na thoshte, po ti, axhë Faredin e ti, vëlla Habib, pse nuk vini me ne të mbroni Shqipërinë?! A, zoti Mentari?!

Mentari Dikës iu ngatërruan paksa përfytyrimet. Tashiti fytyra e Habibit sikur ishte ndarë më dysh. Njëra gjysmë vazhdohte t'i shprehte pendimin, gjysma tjetër qortimin. Mentari Dika nxori me angështim frymën, që gati i fishkëlleu dhe tha:

— Ke të drejtë, Habib! Ke thënë një gjë të vërtetë, që unë e kam menduar shpesh. E di si thotë populli? — pyeti



Mentar Dika. — Të bëhem edhe një herë nuse, pa di unë si të nusëroj. Ne, që e pësuam mbi kurrizin tonë, e dimë më tepër se kushdo rëndësinë e mësimëve që nxorëm. Dhe dua të të them, se satrapi i Tiranës prapë do të rrezohet një ditë. Ai nuk është aq i fortë sa duket!

— Po i erdhi prapë koha kësaj, — gishti tregues i habibit tërhoqi këmbëzën, — atëherë vocërrakët do t'ia lëshoj bacës në prehën dhe më ke pas vedit!

— Po baca s'të qëndron për vete!

— Ani, grues!

Edhe Mentari ia shtrëngoi krahun me mirënjohje dhe ashtu qëndruan një copë herë me vështrimin te sheshi para depos, ku turma e xhandarët zhvendoseshin herë në njërin cep, herë në tjetrin, si në një skenë masive, përgatitur më parë dhe përsëritur kaq herë.

— Tashti, zoti Mentar, eja të të nxjerr nga kopshti! — dhe, pasi i tha se prania e tij në afërsi të sheshit ishte e rrezikshme, e tërhoqi për krahu dhe e nxori në kopshtin prapa dyqanit të mishit, i cili të kujtonte një xhungël të vogël, ku çdo pemë, çdo gjethe e çdo send, po ashtu edhe kokat e shpatullat e Mentarit e të Habibit dukej sikur thithnin e shpërndanin hije dhe diell.

## VIII

Mentar Dika hyri në dyqan me pamjen e njeriut që ruhet të mos bjerë në ndonjë gropë.

— Ulu këtu, ja këtu pranë meje!

Bido Peshti sikur u zgërdhi. Në të vërtetë ai kishte

një fytyrë pa buzëqeshje dhe vetëm nga zëri mund të kuptoje në buzëqeshje apo zgërdhihej. Po pavarësisht nga të gjitha këto, zërin e kishte të butë Bido Peshti. E gjithë pamja e tij ishte e butë, prej njeriu që s'di të jetë i keq e që s'di të gënjejë edhe po të dojë.

Kjo pamje e kjo pritje sikur e ngrohën pak Mentar Dikën.

— Unë erdha...

Po Bido Peshti nuk deshi ta dëgjonte. Ktheu kokën nga çirakët. Shënoi me gisht më të riun.

— Na-a-a ti, pspsp, një kafe për zotin Mentar! — dhe u kthye nga ai. — Më thuaj, zoti Mentar, a gjete punë?

— Jo!

— Ani çka, mos u shqetëso, do të gjendet një punë edhe për ty!

Dukej hapur se Mentar Dika nuk dëshironte ta zgjaste bisedën me Bido Peshtin. Shikonte poshtë pllakat e pastra të dyqanit dhe bile as ato nuk i shikonte... I kujtohej Mentar Dikës se atë mëngjes qershori të Njëzetekatrës, kur forcat e Revolucionit qenë futur në qytet, pikërisht atë mëngjes Bido Peshti qe hequr i sëmurë e nuk e kishte hapur dyqanin. Po kur në Shqipëri ishte rikthyer Ahmet Zogu, kishte qenë Bido Peshti ai që e kishte ngritur i pari flamurin te dera e dyqanit. Ç'është e vërteta, tjetër gjë nuk dihej për Peshtët, kaq dihej, dhe ndoshta kjo mund të kishte qenë politika e tyre më e madhe, — një mbyllje dyqani e pastaj një flamur. Dihej gjithashtu se dera e tyre e kishte trashëguar tregtinë që nga kohët e stërgjyshëve, denbabaden, siç i thonë. Dhe si për shumë tregtarë të tjerë, edhe për Peshtët kishte fjalë e thashetheme, që herë i nxinin, herë i zbardhnin, po më shumë i nxinin. Po Mentar Dikës, të cilit i kishin mbetur në mendje mbyllja e dyqanit dhe pastaj flamuri mbi derë, s'para ia kishte qejfi ta zgjatte bisedën me të dhe, bile, i vinte keq që Lato Morina, duke mos ditur asgjë nga këto, e kishte përzier padashur me Peshtët.



— Eh, kohë, kohë! — i erdhi në veshë, si nga fundi i botës, zëri i butë i Bido Peshtit. — Ke pasur një baba, që i kishte shokët të rrallë. Thonë se, kur kapërcente kufirin e kur fliste për Shqipërinë, gjithë Evropa e mirë e dëgjonte gojëhapur, dhe gjithë Evropa e keqe i varte buzët na-a-a, një pëllëmbë. Kështu thonë se, ta marrësh vesh ti, unë kam kujtime të bukura nga babai yt. Më kujtohet si sot, ja këtu, te kjo qoshe rrinte ulur, rrufiste kafën, shikonte turqit përtej xhamave, shikonte dhe mendojë. Një herë i tha babait tim, duke zgjatur gishtin nga unë:

— Taho, pse nuk ma çon Bidon mbrëmjeve te sokaku, t'i mësoj shqipen bashkë me të tjerët?

— Bidoja është burrë dyzet e kusur vjeç, ç'i duhet atij shkrimi e këndimi, — iu përgjigj babai im.

— S'ka gjë, ka edhe të tjerë dyzetekusurvjecarë, që mësojnë shqipen, ia priti yt atë.

Babai im u mendua, pastaj tha:

— Merre, Musa, ta kam dhënë Bidon!

Ashtu, të ulur përballë njëri-tjetrit, Mentari dhe Bidoja qëndruan një hop pa folur. Po Bido Peshti, që dukej i prekur nga këto kujtime, vazhdoi:

— Bereqavers, nuk jam fare qorr. Kur më tepron kohë, blej ndonjë gazetë sa për të thënë se lexoj shqip. Po Shqipërinë e kam dashur dhe e dua, e kam amanet nga babai, gjettë rahmet, që ta dua Shqipërinë si sytë e ballit. S'të kanë dhënë punë the? Mos u dëshpëro, zoti Mentar, të gjitha do të rregullohen në Shqipërinë tonë, çdo gjë do të zërë vendin e vet, vetëm se duhen dëgjuar pak edhe më të mëdhenjtë... Se... ta marrësh vesh ti, ta kanë inatin, ti ke luftuar kundër tyre, ja pse ta kanë inatin... E kuptoj unë, e kupto-o-oj!

Mentar Dikës iu sos durimi. Kaq munda ta dëgjonte.

— Mora vesh se ke qenë fshatrave, Bido aga, — tha ai

befas, si për të shpejtuar bisedën.

— Isha, po, — tundi kokën Bido Peshti. — Qëndrova një javë. Një javë, po s'do ta harroj kurrë. Se e kemi të bukur Shqipërinë. E kemi si zonjë të stolisur. Të të them të drejtën, zoti Mentar, m'u çelën sytë nga gjethi e nga

jeshillëku i fushave. Se jemi mykur këtyre qyteteve, dhe, siç e shikon, shit beze e shit muline...

— Atje në fshat ishit takuar edhe me Lato Morinën! — ia priti Mentar Dika.

Në derë u duk Sali kafexhiu me filxhanin e kafes në tabaka.

— Po, e takova Laton, e takova edhe Laton, si jo. Latoja është burrë i mirë, pa llafe, por... m'u duk sikur e kishte lënë ca, sikur i kishin rrjedhur trutë, ishte bërë hutaq e më harraq se unë!

Mentar Dika, që po dyshonte në dinakërinë e tjetrit, i dha zërit ca nota më të ashpra:

— Ai të kishte dhënë një napolon për mua!

Bido Peshti u trondit, ose të paktën bëri sikur u trondit.

— Jo, — tha, — do të ma jepte, por, me sa duket, harroi!

— Bido aga, — tha çiraku duke u afruar.

— Fol, — i tha Bidoja.

— Demiri kërkon t'i lëshosh në kopsht ujin e çezmës!

— Karafil, t'i thuash Demirit, të mos më vijë rrotull si çakalli, boshti që s'lyhet, thyhet!

— Ai tha se ty të shkon kot uji, Bido aga.

— Atë e di unë, ku më shkon uji. Hajt!

Sali kafexhiu zgjati tabakanë.

— Kafën, — tha ai.

— Ah! — u hutua Bido Peshti.

Tabakaja e kafexhiut qëndronte midis të dyve.

— Zotit Mentar. E porosita për zotin Mentar! — tha Bido Peshti.

Mentar Dika e ngriti filxhanin e kafes ngadalë, si në mëdyshje; ta merrte, apo...

— Të dridhen duart, zoti Mentar, — tha Bido Peshti me zërin gjithmonë të butë dhe buzëqeshi me fytyrën pa buzëqeshje.

Duke shikuar filxhanin si diçka të befasishme që ndodhej në dorën e tij, Mentar Dika tha:

— E kisha fjalën për napolonin!

— Të betohem, nuk më dha asnjë grosh e jo një napolon!



Bido Peshti përqendroi vështrimin te kurrizi i Sali kafexhiut dhe priti në heshtje, derisa ai të largohej nga dyqani.

— Mos të të mbetet merak. Latoja më tha, po në të vërtetë iku pa ma dhënë napolonin! — Kështu tha Bido Peshti, por padashur fytyra i mori një shprehje të paturpshme prej gjynahqari të vjetër.

— Unë kam besim te Latë Morina! — tha ftohtë Mentari Dika. — Kuj-to-hu mi-rë se mos... të ka da-lë nga men-dja!

Pas këtyre fjalëve, të rrokëzuara e të theksuara, vetullat e Bido Peshtit, të trasha, si të shkruara me laps, kishin mbetur pezull në hapësirën e ngushtë të ballit, gjysma e të cilit mbulohej nga fesi i zi me shkëlqime cohe të shtrenjtë. I gjithë qëndrimi, e gjithë fizionomia dhe heshtja e shtangur e tregonin Bidon burrë të fyer e të zemëruar, por gjithmonë të përmbajtur.

Me vështrim të ngulur pikërisht në hapësirën e ngushtë midis fesisë të zi dhe vetullave të mbetura pezull, mu sikur në atë ngushticë të qe dendësuar e gjithë dinakëria dhe kopracia e Bido Peshtit, Mentari Dika pyeti me këmbëngulje:

— Atëherë?

— Kur ti sapo kishe dalë nga burgu, unë të dorëzova katër napolona të Latos e jo të të mbaj një napolon! Por unë dua të di, kush t'i tha këto fjalë?

— Teli Bashari!

— Ai me fytyrën me rrudha e me llokma si hoje e prishur?

— Teli Bashari, pra!

— Asgjë nuk më dha Latoja, — tha Bido Peshti. — Për flamur, që nuk më dha asgjë!

Mentari Dika e shikoi në mënyrë të atillë, sikur nga sytë e tij të kaltër të çelët të kishte dalë një britmë e thekshme.

— Më tha se do të më jepte një napolon për ty, po nuk ma dha!

— Xha Teli nuk gënjen, — tha Mentari Dika.

— Teli është matufepsur. Teli me atë fytyrë si hoje

e prishur, — shtrembëroi dhe rrudhi fytyrën e vet Bido Peshti.

— Por është burrë i ndershëm!

Një karrocë, karroca që mbartte plehra për pemëtoret e për arat e Bido Peshtit, qëndroi buzë trotuarit.

— Ja-a-a, ç-i-i-il! — thirri karrocieri i ri, me frenat të tërhequr si tel violine. Kali kafshonte mëgojzën, lëvizte vithet, tundte lelet, shikonte me të bardhën e syrit dhe rrihte patkonjtë tashmë në trotuar.

— Otello, ku e çon? — i briti njëri nga çirakët e Bido Peshtit. — Në dyqan do ta futësh?!

Shumë kohë më parë, këtë djalë të ri, që i shkëlqente fytyra nga të zitë, që kishte një trup atleti e që i pëlqente të ecte shpejt me karrocë, dikush e kishte pagëzuar me shaka Otello — një student thoshin — dhe që nga ajo ditë të gjithë e thërrisnin Otello, pa e ditur nga vinte kjo fjalë e ç'domethënie kishte.

Otelloja, pasi e shikoi çirakun me të bardhën e syve, d.m.th. me inat, tha:

— Më lër rehat, a nuk e sheh se e ka zënë zekthi?

— Oj, një plakuc, me rrudha e me llokma si hoje e prishur, ngatërron botën! — tha Bido Peshti.

— Po mendjen e ka të kthjellët Teli Bashari! — ia ktheu me inat Mentar Dika, ndërsa ngrihej në këmbë.

— Ja-a-a, Çi-i-il!

— Otello, ç'dreqin ke që më vjen në dyqan? — i briti Bido Peshti.

— Aga, — tha Otelloja, — kapteri i kazermës s'më dha as sot pleh!

— S'të dha! — foli Bido Peshti dhe lëvizi nga vendi. U kthye nga Mentar Dika. — Mirupafshim, zoti Mentar. Hajde një herë tjetër të bisedojmë. — U kthye nga Otelloja. — Si nuk të dha?! Pleh nuk të dha?! Pleh për mua?! — Duke parë se Mentar Dika nuk po largohej, tha: — Mirupafshim, zoti Mentar. Një herë tjetër, një herë tjetër!

Mentar Dika, edhe pas këtyre fjalëve, nuk u largua menjëherë. Bido Peshtit, me sa duket, diçka nuk i pëlqeu



në fytyrën e Mentarit, gjë që e detyroi të zbriste nga min-  
deri e t'i betohej me të dyja duart mbi gjoks:

— Për flamur, zoti Mentar, Latoja më tha, por asgjë  
s'më dha!

— Kjo që bën ti, Bido Peshti, — e ngriti zërin Mentar  
Dika, — është politikë e poshtër. Kur unë dola nga burgu,  
ti m'i dorëzove vërtet katër napolonat që të kishte dhënë  
Latoja për mua, sepse atëherë ti pandehje që unë do të  
bëhesha përsëri toger dhe ndoshta më shumë se toger.  
Kurse tashti që ata më kanë vënë përpara, tashti që edhe  
Laton atje në fshat e kanë futur dy herë në burg për hiç-  
gjë, tashti ty, Bido, të erdhi koha të zbulosh fytyrën e  
vërtetë. Kështu, një napolon e fiton, por edhe me qeveri-  
në bëhesh i mirë. Përderisa qeveria s'më jep punë, pse u  
dashka që Bido Peshti të më japë napolonin? Kështu men-  
don ti?!

Bido Peshti kishte mbetur si mumje, me duart në  
gjoks. As lëvizi as foli, veç rrotulloi sytë andej nga lar-  
gohej Mentar Dika dhe bërberiti:

— Mua të më flasësh kështu ti, që jam një shqiptar i  
flaktë?!

## IX

Te dera e furrës u duk një lypsare e vogël me fy-  
tyrën plot preka të kaltra, si bojë e freskët shkrimi. Vësh-  
trimi i saj bridhte nga bukët e misrit, te simitet avu-  
lloshe, nga furrxhiu, te Mentar Dika.

— Ik, moj! — i briti furrxhiu.

Lypsarja u trondit nga britma, por nuk lëvizi.

— Ik, moj!

Ajo nuk lëvizi as qepallat.

— Po kësaj, ke ç'i thua?! — pyeti dhe u çudit furrxhiu.

— Duhet të jetë e uritur, — tha Mentari dhe ia bëri me dorë të afrohej.

Ajo sikur u çapit, po në çastin e fundit mbeti atje ku ishte, te pragu.

— Nuk beson, — tha Mentari. — Ka nga ata që i rrahin lypsarët e vegjël. — Shikoi nga vajza. — Prej nga je?

— Nga fshati majë malit, — zgjati ajo krahun në mënyrë të papërcaktuar.

— Ke prindër?

— Jo, i zuri dhimbja e barkut dhe vdiqën. Ne ishim dy fëmijë, unë dhe vëllai.

Mentar Dika dhe furrxhiu u shikuan në sy.

— Një natë vëllai fjeti dhe nuk u zgjua më, — tha ajo. — Kur u ktheva te rrapi, ku flinim, më thanë se nuk do ta shikoja më vëllanë.

— Si të quajnë? — e pyeti Mentari.

— Kati!

— Sa vjeç je?

Ajo nxori përpara pesë gishta, pastaj shtoi edhe pesë të tjerë.

— Afrohu, Kati!

Ajo shikoi me dyshim.

— Afrohu!

Më në fund, ajo eci deri pranë Mentar Dikës, po vështrimin nuk e hiqte nga hunda sfungjeroze me breshka e nga duart e mëdha leshtore të furrxhiut, i cili tashti dukej si ari i zbutur. Vajza, që e ndjeu ndryshimin e tij, sikur u çlirua. Duke e tërhequr Mentar Dikën nga cepi i xhakëtës, tha:

— Xhaxhi, dua bukë!

— Që kur s'ke ngrënë?

Ajo zgjati përpara dy gishta. E prapë tha:

— Dy ditë!

Mentar Dika shtrëngoi lekun e vetëm që kishte në



xhep. Kujtoi Gimin, Letën, Daklean, që i kishte lënë pa bukë në shtëpi. Herë-herë ndiente dorën e lypsares së vogël tek e tërhiqte nga cepi i xhaketës, si për t'i kujtuar se nuk kishte ikur.

— Xha Idriz, jepi një simite, — tha Mentari Dika dhe e hodhi lekun mbi tezgë.

Idriz furrxhiu, pa i prekur paratë, shikoi të zotën e parave.

— Jepi një simite, — përsëriti ai. — Një tjetër ma jep për dy fëmijët e mi!

Furrxhiu e shikoi prapë me mëdyshje, thujse i vinte keq që simitja e pjekur në furrën e tij të binte në duart e lypsares së vogël.

— Na, — tha pas pak me zë të zbratur e me shprehje më të zbratur, por as me inat, as me mëshirë.

Vajza buzëqeshi, pastaj shikoi Mentari Dikën, pastaj e kafshoi simiten me dhëmbët e parë, që i kishte të rrallë.

— Kot e bëre këtë, zoti Mentari. Ti je keq për vetë. Nuk do ta ndreqësh vetëm ti Shqipërinë!

Mentari Dika nuk foli. Mori simiten e dytë, u përshëndet dhe doli.

— Shko tashti, Kati, — tha ai.

Ajo e shikoi në heshtje. E shikoi, pa i rrahur qepallat.

— Shko te shoqet, — tha ai dhe u çapit në trotuar.

Ajo prapë nuk foli. Vetëm buzëqeshi, duke zbuluar dhëmbët e rrallë, po dorën s'e hoqi nga xhaketa e tij. Dhe përtypej. Dhe ecte, thujse pa e prekur tokën me tabanin e këmbëve.

— Mirë, — tha Mentari dhe ngadalësoi hapin, që t'i jepte mundësi Katit të shijonte simiten. — Atëherë e bëjmë bashkë një copë rrugë!

Tashti dielli ishte prapa tyre. Ai shikonte të lëviznin mbi kalldrëm hijen e vet dhe hijen e rreckosur të Katit. Kur doli në mëngjes nga vila, ishte hija që e ndiqte tinëzisht, tashti ishte ai, ishin ai dhe Kati që ndiqnin hijet e tyre.

Ra ora e qytetit.

Befas, përballë tyre qëndroi xhandar Kika (i pasuar gjithmonë nga xhandar Jonuzi). Duke u lëkundur mbi këmbët e gjata, shikoi Mentar Dikën, shikoi lypsaren, shikoi prapë Mentar Dikën dhe tha:

— Në emër të ligjit, je i arrestuar për fyerje të qytetarit të ndershëm, Bido Peshtit!

Mentar Dika edhe dëgjonte çfarë thoshte xhandar Kika, edhe shikonte hijet, edhe numëronte tingujt e orës. Pesë. Dhe heshtje. Heshtje e kaltër. Heshtje gushti.

— Po kjo? — pyeti Kika.

Xhandar Jonuzi qëndronte tepër serioz. Me këtë seriozitet ai sikur donte të plotësonte shkurtësinë e trupit.

— Ik, moj! — i briti xhandar Kika.

Vajza, që i kishte frikë xhandarët (më shumë se Idriz furrxhiun), këceu një hap prapa dhe shtrëngoi simiten pas gjoksit.

Rrotull tyre u afruan disa kureshtarë. Të gjithë e dinin e të gjithë e merrnin me mend pse mund të arrestohej Mentar Dika. Xhandar Kika u bë nervoz. E mbërtheu Mentarin për bërryli dhe briti:

— Më shpejt!

Simitja ra nga duart e Mentarit dhe, pasi preu tërthor trotuarin, u rrokullis në kalldrëm. Kati vrapoi, e ngriti dhe e shtrëngoi pas gjoksit. Simitja e parë ishte përgjysmuar.

— Jo andej, — tha xhandari.

— Nga? — pyeti Mentar Dika, që më në fund e kishte mbledhur veten. Në çastin e parë kjo ngjarje i qe dukur e pabesueshme, ireale, pak më vonë iu kthye në një gjë të mundshme, më vonë në një gjë të ngjashme me të vërtetën, dhe më vonë akoma, e padiskutueshme.

— Te posta numër katër, — tha xhandar Kika. Ktheu kokën nga kureshtarët. — Shporruni!

Tashti kishin mbetur hija e Kikës, më e gjata, e Mentar Dikës, e dyta, e Katit dhe e xhandar Jonuzit të barabarta. Një hije e pestë kaloi aty pranë dhe njeriu me të zeza e me papion, që kishte dalldisur nga vapa e që mban-te në dorë një rrasë me brimë të shpuar në mes, rrëshqiti përpara, ktheu te një qoshe dhe u zhduk.



## X

Posta numër katër kishte pamjen e një pagode, por mbante erë qiri, si kishë katolike, sepse telat e elektrikut nuk ishin zgjatur akoma në të gjithë qytetin, aq më tepër në periferi, ku ndodhej ajo.

Përpara rreshter Ago Agos, që ishte komandant i postës numër katër (postkomandant), prisnin dhjetë veta. I njëmbëdhjeti ishte ai vetë. Pastaj vinin xhandar Kika, ulur pranë tavolinës, në krah të rreshterit si dhe xhandar Jonuzi, i cili qëndronte te dera tepër serioz. Kishte edhe xhandarë të tjerë që vërtiteshin me ose pa punë nëpër oborr.

Kështu pra, atë mbrëmje të ngrohtë gushti, rreshter Ago Agoja vuri përpara një fije letër, mprehu lapsin ngadalë, si të mos i shkaktonte dhimbje, pastaj, meqë syri i kishte parë një qime në mëngën e xhaketës, e zuri qimen dhe e shkundi në prehrin e thatë të xhandar Kikës. Ky i fundit e zuri qimen dhe e fshiu pas pantallonave të Mentar Dikës (Mentar Dika, sigurisht s'bëri dot asgjë, se i kishte duart të lidhura). Pastaj rreshteri ngriti kokën dhe hodhi mbi Mentar Dikën një vështrim zyrtar, po mund të quhet edhe burokratik.

— Kush e ka radhën? — pyeti Ago Agoja. Kur hesh-tja zgjati më tepër sa duhej, më tepër sa lejonin rregullat e rreshterit, atëherë gishti i tij i zverdhur nga nikotina, pasi shëtiti nëpër të gjithë ata që qëndronin në këmbë, u fiksua para syve të Bido Peshtit. — Radhën e ke zotrote!

Tjetri, me fytyrën pa buzëqeshje, paksa u zgërdhi.

— Me të ma kërkuar, drang, ia lëshova napolonin në dorë! — tha ai.

— Kujt? — pyeti rreshteri.

— Mentar Dikës, — tha ai.

— Napolonin e kujt? — pyeti rreshteri.

— Të Lato Morinës, — tha ai.

— Mjaft, — tha rreshteri dhe diç shkroi. Shkroi ngadalë, me kujdesin e një tregtari çifut. Pastaj sytë e rreshterit, të ftohtë dhe indiferentë, si prej qelqi, bënë një parakalim të shpejtë gjatë trupës së dëshmitarëve. Aty nga fundi i këtij parakalimi, syri i lig ose dinaku, d.m.th. ai më i vogli, u rrëgjua fare, gati u mbyll. (Tjetri, që tregonte padurim të përjetshëm, rrinte hapur.)

Xhandar Jonuzi hipi mbi prag dhe, nga shumë i shkurtër, u bë mesatarisht i shkurtër. Tha:

— Zoti rreshter! Një fshatari i kanë gjetur fishekë pa pushkë!

— Hajde, hajde, deri ku arritën punët. Këta janë më të rrezikshëm se ata që kanë pushkë. Rraseni brenda!

— Si urdhëron! — tha xhandar Jonuzi kur ishte zhdukur prapa derës.

Tha rreshteri:

— Radhën e ke-e-e ti.

Çiraku i mesëm i Bido Peshtit u drodh, si ta kishte zënë ajo punë.

— Si të quajnë? — pyeti rreshteri dhe futi majën e lapsit në gojë.

— Limi.

— Çfarë Limi?

— Limi Tali!

— Bukur. Ti, Limi Tali, e pe me sytë e tu, kur Bido aga Peshti i dha Mentar Dikës napolonin e Lato Morinës?

— E pashë, — u përgjigj Limi Tali dhe e tundi kokën vetëm një herë, nga lart poshtë dhe pastaj nga poshtë lart, por në një mënyrë të tillë, që ngjasonte më shumë me një pohim të rremë.

— Ruhë, çun, se ta preva kokën!

Çiraku i vogël i Bido Peshtit theu gjunjët. Pak mbi flokët e tij fluturoi shigjeta e pështymës së rreshterit. Ajo kapërceu dritaren e hapur dhe ra mbi gjethet e lajthatës. Pastaj rreshteri fshiu buzët me kurrizin e dorës dhe tha:

— Tashti radhën e ke-e-e ti. — Gishti i nikotizuar i qe



drejtuar pikërisht çirakut të vogël, që sapo i kishte dredhuar pështymës.

— Si të quajnë? — pyeti rreshteri.

— Cen, — u përgjigj më i riu nga çirakët.

— Çfarë Ceni?

— Cen Mani.

Sakaq rreshteri kishte hequr çizmet dhe nëpër dhomë kutrumosi era e këmbëve të tij që, duke u përzier me erën e qenit të plakur (nga trupi i rreshterit), të grahmës së dhëmbëve të prishur e të rakisë, si fuçi e shpuar (të gjitha të rreshterit), e humbi individualitetin e saj, u bë një erë e të gjitha erërave.

Xhandar Jonuzi hipi mbi prag dhe nga shumë i shkurtër, u bë mesatarisht i shkurtër. Tha:

— Zoti rreshter!

— Fol, ore ti!

— Kanë sjellë Besnik Sazanin.

— A-a-a, Besnik Sazanin!

Në dhomë u fut një burrë i ri, nga i cili s'të binte asgjë në sy, veç flokëve, që i kishte të shkurtër, të egër si gjemba iriçi. Xhandarët që e shoqëronin, e shtynë nga prapa dhe Besniku u gjend para tavolinës së rreshterit.

— Përrjashta! — u bërtiti rreshteri xhandarëve. — Si guxoni të shtyni një qytetar të lirë?!

Kur xhandarët ishin larguar, rreshteri foli me të butë:

— Si thua, Besnik, a do të merremi vesh bashkë?

— As që di pse më ngritën nga shtëpia e më sollën këtu!

— Për të ditur, e di fare mirë ti, po ta do puna të thuash ashtu. A s'je ti që ke thënë se nuk do të votosh për kandidatin e shpallur?

— Po, kam thënë.

— Dhe ke thënë se gjoja kandidati i shpallur do të zgjedhë pastaj zotin prefekt për deputet?

— Po, kam thënë.

— Të kapa, — tha rreshteri, gjithmonë me zë të ulët e të butë.

— Po ju na keni thënë se njerëzit janë të lirë të votojnë për cilin të duan!

— Po, po, po, — foli shpejt rreshteri, si të kishte shtirë me revole. — Të lirë. Fare të lirë, — dhe hapi krahët për të treguar sa të lirë ishin zgjedhësit, — por ama ti... S'të kuptoj, çfarë njeriu qenke ti! Edhe pa punë ka mbetur, edhe hedh shkelma! Po fundja, të bisedojmë si vëllai me vëllanë. Nuk dashke zotrote që prefekti ynë të zgjidhet prapë deputet? A s'është ai që do të sjellë ujin e pijshëm në lagjen tuaj?

— Po ka tre vjet që ka premtuar e nuk e ka sjellë.

— Ustallarët po punojnë. Sa të gjenden tubat, çezma, opa-la-a. A nuk është ai që ngriti urën mbi përroin në mes të lagjes «Totolle», që zotëria jote të kalojë matanë pa iu lagur këmbët?

— Hodhi një tra nga një breg në tjetrin dhe trarin e mori uji që javën e parë.

— Po ç'dashkeni ju të lagjes «Totolle», urë me hekur e me qemer? Lutju zotit se kemi ligje që mbrojnë të drejtat e qytetarëve, se po të ishte për mua, të kisha varur për këmbësh që sonte. Hajde, marsh dhe qepe gojën, se e përndry-y-she... Sa për votën tënde, je i lirë, fare i lirë (krahët e rreshterit u hapën si pak më parë) t'ia japësh kujt të duash. Por para se të largohesh, dua të të them edhe dy fjalë. Si kujton, zotrote, nuk e dimë ne që edhe ti hodhe një pushkë të ndryshkur në krah dhe zbraze një ballë fishekë kundër nesh në qershorin e zi të vitit njëzet e katër?... Po ç'ishe e ç'je ti? Një copë ushtar. Një copë punëtor. Nuk e kemi me ty inatin. Të kemi falur. Por je ti, ama, që na detyron të hapim defterët e vjetër. More vesh ç'të thashë? Hajde ik dhe vëri gishtin kokës, se unë për vete s'kam parë qeveri të merakoset kaq shumë për punëtorët, për argatërinë, për çirakërinë, për të gjithë të varfrit, për të gjithë fshatarët e për të gjithë hallexhinjtë, ku janë e ku s'janë. Natën e mirë!

Një minutë më vonë, pasi Besnik Sazani qe larguar, rreshter Ago Agoja, duke u përpjekur të fshihte prapa kurrrizit duart që i dridheshin nga nervozizmi, tha:

— Si thoni, vazhdojmë punën tonë? — Këto fjalë i qenë drejtuar trupës së heshtur të dëshmitarëve.

— Posi, — foli i pari Idriz furrxhiu, që mezi priste ra-



dhën për t'u pyetur. — Të mbarojmë shpejt, zoti rreshter, se më mbeti furra mbyllur. Zotrote e di, bukët bajate nuk i blejnë myshterinjtë.

— E di, — tha rreshter Ago Agoja, duke kruar një-rën këmbë me gishtat e tjetrës. — Fajin s'e kam unë. Fajin e ka ky! — dhe shënoi me gisht Mentar Dikën, pamja e të cilit tregonte se mendimet e tij ndoshta ishin më afër piramidës së Keopsit, sesa hetimeve që zhvilloheshin aty.

— Edhe unë ashtu them, zoti rreshter, pak më shpejt, — tha Sali kafexhiu, duke shikuar vetëm këmbët e veta. — Të pyetemi e të ikim, se nuk kemi siguruar as bukën e darkës.

— Shpejt duhet, shpejt, — tha edhe Otelloja. — Po s'bëra njëzet rrugë, Bido agai s'më paguan asgjë.

(Si të kishte dëgjuar zërin e të zot, kali i Otellos lëshoi një hingëllimë të mprehtë në oborrin e postës dhe karrrocës i kërcitën kërbishtet.)

Folta Papi, që ishte në fund, gati më e gjatë se të gjithë dhe gjithmonë e drejtë, e bardhë, e zezë, kishte kryqëzuar duart mbi gjoks, shikonte rreshter Agon, si të shikonte fundin e botës. Dhe heshtte.

— Fajet i ka ky! — përsëriti rreshteri, duke shënuar prapë me gisht Mentar Dikën, po vështrimin e kishte ngulur në nofullat e shtrënguara të Habibit nga Kosova.

Tringëlliu zilja. Rreshteri e shikoi telefonin me inat e me përbuzje, si të qe duke shikuar një armik të gjallë.

— Phu-u! — shau ai, ngriti receptorin dhe lëvizi manivelin.

Dëgjoi një copë herë, briti dhe shikoi të tjerët, si t'u kërkonte ndihmë; largoi receptorin dhe kroi veshin; thithi dhëmbët e krimbur dhe shikoi prapë të tjerët me sytë tërë mjegull; briti dy herë; «A!... A!...» dhe befasi lëshoi shigjetën e dytë të pëshlymës pa paralajmërim. Po çiraku i vogël i Bido Peshtit u ndodh sërish i shkathët, arriti të thyente me kohë gjunjët, të kërruste kokën dhe pëshlyma, me bishtin si kometë e shuar, goditi gjethet e lajthatës.

Më në fund zëri përtej telit u ndërpre dhe rreshteri e vari receptorin në vendin e vet. Tha:

— Teli i kaurit! Puna boshe! Asnjëherë s'marr vesh çfarë më thonë në telefon! — Shikoi nga të tjerët. — E dini ju, se në gjithë qytetin vetëm shtatë veta kanë telefon? Pasha, prefekti, kryetari i bashkisë, kryetari i gjyqit, komandanti i xhandarmërisë, majori i ushtrisë dhe unë, ah, edhe Hasan Manga, që është i pushës. U jam lutur të ma heqin, por jo-o-o, më janë përgjigjur, posta numër katër është në valën e punës, armiqtë e qeverisë vetëm nga kjo anë mund të lëvizin, se kjo anë ka pyje e përrenj, e çfarë s'ka kjo anë... Kishim rënë në qetësi për një vit e ca, kur bam, ia pati rrëzë Maleve të Shqipës!... — E ndërpreu fjalën se diçka iu kujtua. Shikoi nga xhandar Kika.

— Të shkosh e të gjesh ata të ndjekjes këtu rrotull!

— Si urdhëron!

— T'u thuash që, po panë njeri të ecë kokulur, t'i futin një plumb bythëve. — Heshti pak. — Kështu më thanë, — dhe shikoi telefonin.

— Si urdhëron! — Xhandar Kika shkoi deri te dera. Atje u kujtua për diçka, qëndroi dhe tha: — Po të gjithë e mbajnë kokën të kërrusur!

— Plumbin! — briti për inerci rreshteri por, ç'është e vërteta, pas ndërhyrjes së Kikës, sytë e tij qenë bërë të menduar dhe prapë indiferentë e të ftohtë si qelqi. — Ama jo! — tha befas. — Ulu. Ai Genc Boga dhe i gjithë soj e sorolli i tij, që vërtiten si çakej, do ta gjejnë belanë një ditë nga kapiten Shaban Sinani! — U kollit, futi majën e lapsit në gojë, drejtoi cepat e letrës, të cilët i kishte zhubrosur me bërryl gjatë kohës që bisedonte në telefon dhe tha:

— Ku mbetëm?... Po, po, fajet i ka ky, — tregoi me dorë Mentar Dikën. — Ky i ka fajet. Të gjithëve na dhimbset koha. Po ja, ç'të bëjmë, një vit e ca ndenjëm rehat. kur bam, plasi rrëzë Maleve të Shqipës. Vazhdojmë.

Një gjysmë ore më vonë rreshter Agoja kishte mbaruar hetimet me çirakët e Bido Peshtit, pastaj i erdhi raddha kafexhiut. Pas formaliteteve e pas pyetjeve të para, kafexhiu u përgjigj:



— Jo!

Sytë e rreshterit u ngritën ngadalë dhe e vazhduan inkursionin derisa u qepën pas fytyrës së Bido Peshtit.

— A nuk e pe tí, Selim, kur i dhashë napolonin e Latos Mentar Dikës?! — pyeti i çuditur Bido Peshti.

— Unë t'u luta të mos më merrje dëshmitar! Ti e dije që të dëgjova kur i the se Latoja s'të kishte dhënë asgjë për Mentar Dikën. Të gënjej, thua zotrote, Bido aga?

— Mjaft! — briti rreshteri.

— Atë dua dhe unë, — tha Selim kafexhiu. — Të iki.

— Jo, pa thënë po, s'mund të ikësh!

— A-a-a, mirë, ja ku po rri!

— Tre dëshmitarët e parë pohuan të vërtetën, — tha rreshteri.

— Punë për ta!

— Pa shikoji ç'burra të ndershëm janë! — tha rreshteri, duke ngulur sytë rastësisht në fytyrën e Limit.

(Limi tundi kokën nga lart poshtë e nga poshtë lart: e bukura gënjeshtër.)

Rreshteri futi lapsin në gojë dhe shikoi nga Idriz furrxhiu. Sikur e stepi pak hunda sfungjeroze e tjetrit, mbushur me tërë ata toptha breshkash të vogla njëra mbi tjetrën. Meqë kjo fytyrë gungaçe, plot të hyra e të dala, nuk iu duk e qetë, rreshteri e largoi vështrimin nga ajo po zëri i furrxhiut e arriti:

— Bido agai më porositi të them se zoti Mentar Dika theu një napolon për dy simitet që bleu sot tek unë! Po... në të vërtetë ai nuk theu asgjë!

— Po çfa-a-arë theu?

— Hodhi mbi tezgë një lek, mori dy simite dhe iku!

Rreshter Agoja u kërrus mbi tavolinë me pamjen e një bufi të rrjepur.

— Unë i thashë Bido agait të mos më merre si dëshmitar, por ai tha, hajt-hajt, Idriz, një fjalë goje ke për të thënë. Pastaj erdhi xhandar Kika e më mori. Më mori me pahir. Ju e dini, buka bajate nuk shitet.

— E di, more qen, e di që nuk shitet buka bajate! — u bë nervoz rreshter Ago Agoja. — Kam edhe një mesele tjetër me ty, që ta ruaj këtu, në xhepin e vogël!

— Çfarë, zoti rreshter? — briti Idriz furrxhiu, i fyer deri në kockë.

— Ti, qen, ke biseduar një copë herë me këtë (tregoi me dorë Mentar Dikën, si të tregonte një kërmë), aty para tezgës sate dhe e ke nxitur të bashkohet me Genc Bogën!

— Unë?! — briti prapë Idriz furrxhiu. Breshkat majë hundës sikur filluan të lëviznin e të hipnin njëra mbi tjetrën. — Unë, që gjithë botës i flas të mos merren me politikë!?

Rreshter Ago Agoja, që po bindej për dështimin e procesit, përplasi grushtin mbi tavolinë, u ngrit në këmbë dhe thirri:

— Ore Shkëlqim, ku je, ore Shkëlqim!

Në dhomë u fut xhandar Shkëlqimi me trupin e ngjeshur e me qafën e ngjallur të demit.

— Merre! — tha rreshteri.

I rrethuar nga dy xhandarë dhe i shtyrë nga krahët e fuqishëm të Shkëlqimit, në minutën tjetër Idriz furrxhiu u ndodh në bodrumin e errët, që ndriçohej nga tre qirinj. Pak më vonë, atje poshtë u dëgjua zhurma e një kamxhiku dhe klithma e parë e furrxhiut. Pastaj vazhduan të tjerë kamxhikë e të tjera klithma, të cilat rastisën me muzgun e ëmbël të mbrëmjes së gushtit, që kishte sjellë me vete një erë të freskët, një erë të mirë, të butë, të lehtë e të dashur, e cila e kishte zbratur disi zyrën nga kutrumosjet e rënda të rakisë, të trupit, të dhëmbëve të prishur, të këmbëve e të shumë kutrumosjeve të tjera të rreshterit.

— Unë kam edhe një dëshmitar tjetër, — tha Bido Peshti. — Otellon!

Karrociери i Bido Peshtit ose Otelloja, qëndronte gjysmë i kthyer nga dera, gati për t'u zhdukur, sapo kjo të ishte e mundur.

— Po-o-o, si të të them, unë i shkreti! — belbëzoi ai. — E di se Bido agai... të të them të drejtën, as di gjë unë, as kam dëgjuar gjë. Unë isha në rrugë me Çilin, që ma kishte zënë zekthi.

— O jevg, — tha Bido Peshti, — paske gjetur punë tjetër?



— Jo, aga!

— Atëherë pse gënjen?

— Jo, unë s'gënjej. Po kur zoti rreshter më shikoi drejt në sy, m'u duk sikur më tha: «e kuptoj që paske marrë një lek nga Bido agai, prandaj lëre bisedën që ke pasur me të dhe fol të vërtetën, se të fika». Ja kështu e kuptova unë. Se, që ta merrni vesh ju, për mua është hera e parë që futem në një postë xhandarmërie. Fajet i ka zoti rreshter, që më shikoi në sy.

Fytyra e skuqur dhe e fryrë si pufkë e rreshterit që lëshuar e varur, si të kishte ngrënë diçka të thartë.

— Mua të më bësh fajtor ti, njeriun e qeverisë?! — briti ai për herë të dytë (britmën e parë e kishte ngrënë Idriz furrxhiu).

— Çilin e kishte zënë zekthi dhe unë...

— Hajde marsh! — e ndërpreu rreshteri.

Karrocieri, si ta kishte pritur me kohë këtë urdhër, kërcëu së prapthi dhe u zhduk prapa derës.

Në rrugë u dëgjua:

— Ja-a-a, Çii-i-il!

Kur zhurma e qemerëve të karrocës u shua, rreshter Ago Agoja u ngrit në këmbë, parakaloi në çorape gjatë trupës së dëshmitarëve dhe qëndroi përpara Foltë Papat.

— Po ty, zonja Foltë, kush të solli këtu? — pyeti ai dhe shikoi nga Bido Peshti. Ky i fundit ngriti supet.

— Ti? — pyeti ai Kikën pas pak.

— Po!

— E mora me mend! — tha rreshteri i dëshpëruar.

— Një ditë korriku me sabahile, — shpjegoi Kika, — ai hëngri mëngjes me dy fëmijët te Foltë Papi!

Foltë hiç. Ajo, si zakonisht, me duart të kryqëzuara mbi gjoks shikonte rreshterin, si të shikonte fundin e botës.

Rreshter Ago Agoja eci disa hapa nëpër dhomë, u rrotullua rreth vetes, ngriti duart si të falej në xhami, pastaj tha me zë ankues:

— Obobobo-o-o, ç'më gjeti me këta budallenj! — u kthye nga Kika: — Po tashti jemi në gusht, ore Kikë!

Nuk e ditke ti që napolonin ky e mori sot nga Bido Peshti!? — U kthye nga Folta: — Ik, ti, Foltë! Nuk e kemi me ty, e kemi me këtë dhe me tët nip. Po e kapëm atë Gencon, kokën në hu do t'ia ngulim. Po ti ik, ik, Foltë, ik!

— Po iki! — tha ajo dhe me hapat e saj si prej burri doli, duke lënë prapa cingërimën e paftave të çliruara.

Rreshteri bëri një rrotullim gati të plotë. Në fund të këtij rrotullimi, ai u gjend hundë më hundë me Habib kasapin, të cilit nga mërzitja, nga pritja e nga padurimi i kishte kërcyer damari i ballit.

Rreshter Ago Agoja drejtoi trupin dhe, pasi i hodhi kasapit një vështrim profesional e pasi kuptoi se edhe nga Habibi nuk mund të nxirrte asgjë të dobishme, u zbraps dhe nuk e pyeti. Nuk e pyeti as më vonë. As kur Habibi nguli këmbë të pyetej.

Xhandar Jonuzi hipi sérish mbi prag:

— E kuptova! — tha rreshteri, pa e dëgjuar fare. — Rraseni brenda!

Megjithatë, për inerci, xhandar Jonuzi tha:

— Një jevg mbështolli plëndësin me zorrë dhe ia vërviti në kokë Pervin agait dhe Pervin agai, që i kishte premtuar t'i blinte votën...

— Rraseni brenda! Oj, edhe jevgut na i qenka tekur të bëjë revolucion! Rraseni brenda!

Pas kësaj britme, rreshter Ago Agoja mbathi çizmet, u ul në karrige, fytyrëlëshuar, vështrimhumbur e pamjemefshtë. Po zërin e pati të egër:

— Po ti, more, ç'bën kështu, që na nxjerr gjithë këto telashe? Dy vjet me radhë, pas revolucionit tuaj, gati lamë kockat duke luftuar nëpër rrethime me mbeturinat e Fan Noles. Kohët e fundit sikur na kishin rënë veshët rehat, por jo... bam, ia pati befas rrëzë Maleve të Shqipërisë. Pse, ore, krye çdo viti e krye çdo dy vjetve s'paskemi punë tjetër ne, veçse dyfek me ju, derisa të na sajoni prapë një revolucion tjetër si ai i pari?!... Oj!... Oj!..., Kaq shumë u prish kjo botë, sa duhet vetëm unë t'ju mbledh e vetëm unë t'ju jap mend, o zo-ti Mentar? Tashti zotrote po bëhesh edhe hajdut, po fut hundët edhe në punët e të tjerëve. Kërkon të hedhësh Laton kundër Bido aga



Peshtit. Lato Morina të vrasë Bido Peshtin, hë! Bido agai të paloset në dhe, por edhe Latos t'i vdesin fëmijët për bukë. E pse, sepse të hipi ty në kokë të vjedhësh një napolon. Turp e faqe e zezë! — E ngriti zërin më shumë: — Ke edhe qëllime të tjera ti, e di unë, e di. Tamam në këto ditë feste, kur Shqipëria do të bëhet me mbret, kërkon të turbullosh ujërat, po-o-or, mblidhe mendjen se nuk të ecën tek unë. Latos do t'ia qëndis unë të vërtetën. Edhe hyqymetit po unë do t'ia qëndis qëllimet e tua të prapa!

Por, Mentar Dika, aq sa mund t'i fliste një njeriu që kishte baritur mbi tokë një shekull më parë, aq i foli edhe rreshterit. Dhe vazhdonte të qëndronte aty, sikur e gjithë kjo çështje dhe të gjitha këto fjalë s'kishin të bënin fare me të. Në të vërtetë ai qëndronte aty me pamjen e një njeriu që e ka vendosur prej kohësh fatin e vet. Ai e shikonte fare qartë se ç'i mbetej për të bërë dhe kjo qartësi sikur e qetësonte, sikur ia mblidhte mendimet. Duke përfytyruar vendin e fshehtë, ku ndodheshin Genc Boga, mitralozi, pushkët, arkat me bomba e me fishekë, befas buzëqeshi me atë mënyrën e tij të rëndë e inatçore, që nuk ia ndryshonte shprehjen e fytyrës dhe për herë të parë i lejoi vetes ta zhvendoste peshën e trupit nga këmba e majtë në të djathtë. Në fytyrën e tij nuk ishte vështirë të lexohej, si në një libër të hapur, ndjenja e gëzueshme e hakmarrjes, dhe jo për dështimin e një rreshteri, po për zbulimin e një Folte, të një Habibi, apo të një kafexhiu e furrxhiu, pa zënë në gojë Besnik Sazanin e shumë e shumë të tjerë.

— Ç'na bëre kështu, more Mentar Dika! Ka luftuar për drejtësi ky popull e kjo qeveri dhe nuk të lejon as kaq të futësh njerëzit në ngatërresa e në grindje!

Zëri i rreshter Ago Agos po ngrihej gjithnjë, siç vjen duke u ngritur tingulli i një violine në kurdisje e sipër. Por edhe zemërimi po lëvrinte në sytë e tij. Tashti ai kishte marrë përsëri pamje profesionale, kishte mbathur çizmet e nuk shikonte asgjë, përveç Mentar Dikës dhe, për herë të parë, fytyra e tij e squllur jetonte çaste madhështie për detyrën që i kishin dhënë.

— Njeriu, more ti, — vazhdoi Ago Agoja, — duhet të



jetë më i qetë se uji i kënetës, më i shtruar se bari i livadhit. Të arrestojnë. Bukur. Ti hesht, Të lirojnë. Bukur. Ti hesht. Të kërkojnë një deklaratë. Ti jepe. Qëllimi i vetëm dhe i fundit i njeriut është të jetojë, të jetë i gjallë, ja, të marrë frymë! — dhe rreshteri u mbush vetë me frymë thellë dhe gjatë. — Të thonë, e more napolonin? E mora, thua. S'të kuptoj ç'njeri je. Sikur s'të rrjedh gjak në zemër, por akull! Mblidhe, ore mendjen, mos të të duket vetja sikur je përsëri në kohën e revolucionit e po shkel mbi kufomat tona!

Meqë ai rreshter ia kishte gjetur në njëfarë mënyre mendimet e fshehta, atëherë, sipas zakonisht, Mentar Dika ngriti duart e prangosura dhe me pulpat e gishtave lëmoi mustaqet e shkurtra.

Tha rreshteri:

— Po të pyes për të fundit herë, a do të pranosh që e more napolonin?

— Jo!

Rreshter Ago Agoja u shpërfytyrua, trokiti gishtat mbi tavolinë dhe briti:

— Mos kujto se jam i kënaqur me kaq, megjithëse të vërtetën e nxora në shesh edhe pa ty! — Kështu tha, dhe befas ndërroi pamje me të njëjtën lehtësi, siç ndërrojmë një rrugë për t'i rënë më shkurt!...

... Ishte vonë kur rreshteri, pasi kishte shikuar një copë herë terrin e natës që vuloste dritaret e postës, përpiloi procesverbalin, i cili u firmos nga Bido Peshti dhe tre girakët e tij.

Ishte akoma më vonë, kur Idriz furrxhiun, gati pa frymë e gati pa jetë, e çuan në shtëpi mbi një karrocë dhe po aq vonë, kur Mentar Dikës i hoqën prangat.

— Thyeje qafën! — i bëri rreshteri. — Por mos të të mbushet mendja të gënjesh herë tjetër! — Dhe shtoi: — Të kisha unë një vilë si ajo, do të shkruaja jo një, por njëqind deklarata!

...Së fundi rreshter Agoja mori telefonin dhe, sipas porosisë, i raportoi komandantit të xhandarmërisë, kapiten Shaban Sinanit gjithë sa i ndodhën me Mentar Dikën



dhe me dëshmitarët. Sado që këtë raport ai e veshi me shitesa e zbulurime, për të ngritur autoritetin e vet, mori këtë përgjigje nga kapiteni:

— Ore Ago, ore tutkun, ç'më telefonon kot? Sa më shumë që ai dhe dera e tij gëzon simpati në të gjithë qytetin, aq më shumë e kemi për detyrë ta poshtërojmë para të tjerëve, ta bëjmë qesharak, derisa të humbasë logjikën e të bëjë skandale, pastaj, pa-a-astaj... E more vesh? Një herë në jetë mund të të jepet rasti ta thërresësh në postë për një napolon. Një napolon është shumë. Për një lek ta thërresësh. As për një lek. Ta bësh palaço përpara të tjerëve për hiçmosgjë! T'i marrësh fytyrën. Ai, ose duhet të gjunjëzohet e të bëjë si duam ne, ose për të s'ka vend midis të gjallëve.

Përtej telit zëri i kapitenit heshti. Megjithatë rreshter Ago Agos, si gjithmonë, i trullosur dhe i nervozuar pas çdo bisede telefonike, i kishte mbetur akoma në dorë receptorin!

— Për hiçmosgjë! — gjëmoi prapë zëri i kapitenit. Pas dy minutash zilja e telefonit ra prapë dhe ai, pa e ngritur mirë receptorin, dëgjoi:

— Për hiçmosgjë!

Atë mbrëmje, duke kaluar nëpër mend gjithë sa kishin ndodhur në postën numër katër, rreshter Ago Ago-ja thoshte me zë në vetminë e zyrës:

— Duhet të jetë ca budalla, me nder jush, ky kapiteni ynë, që më bën histori të gjata. E ku mbahen mend ato? Pse nuk më thotë: «ore Agush, a je i zoti t'ia heqësh brekët në mes të pazarit Mentar Dikës dhe atëherë të kam dhënë tapinë e vilës së tij!»

Mbante erë mjegull.

Nga ferra e nga mjegulla doli një qenie, që i preu rrugën Mentar Dikës. Ajo ishte një qenie e vogël, me flokë të shpupurisur, me këmishë deri në fund të këmbëve, me një simite që e shtrëngonte pas gjoksit e me një gjysmë tjetër nën sqetull. Me dorën e lirë, ajo e zuri Mentar Dikën nga cepi i xhaketës dhe ai, pas një ngurrimi të shkurtër, eci, si të ishin marrë vesh prej kohësh. Si më parë, ajo gati shkelte në majë të gishtave, pa e prekur tokën me tabanin e këmbëve. Hëna e prerë ia tregonte fytyrën më të dobësuar, si pare kallp dhe prekat si lodër pikëzash që mund të shkoqeshin nga ajo pare, sapo t'i shkundje pak.

— Më paske pritur? — e pyeti kot Mentari.

Lypsarja tundi kokën. Flokët e saj të gjatë e të shpupurisur ishin përzier me mjegull.

— Kati, është vonë, shko të flesh, — tha ai.

Ajo e shikoi dhe nuk i foli, por dorën e shtrëngoi më fort pas cepit të xhaketës.

— Mirë, eja me mua, — tha ai pas pak.

Në dritën e zbehtë të hënës sytë e saj buzëqeshën.

Asgjë nuk dëgjohej nëpër shtrojën e njomur nga vesa, përveç kandrrave dhe kuaqtes grindavece të bretkosave, që vinte nga largësi të panjohura. Në kodrat përtej xixëllonin zjarre (të barinjëve) që ndizeshin e shuheshin si pika të kuqe në errësirën e argjendtë, ndërsa sipër në qiell yjet pikëzonin si koleksion monedhash të lashta. Pemët flinin në këmbë, po ashtu edhe silueta e një gomari buzë një livadhi. Po nga ai livadh Mentari dhe Kati panë t'u vinin përballë një grup njerëzish, që ecnin çuditërisht ngadalë e çuditërisht në heshtje, si të mos donin të prishnin atë gjendje të përgjithshme dremitjeje dhe përgjumësie. Meqë monopati ishte i ngushtë, ata qenë të detyruar t'u lëshonin rrugë dhe të prisnin derisa para tyre të kalo-



nin tetë xhandarët e parë, që ecnin për dy, me pushkët në sup e me rripat e kapelave nën mjekër. Pas xhandarëve ecnin pesë të burgosur të lidhur me pranga, zhurma e lehtë e të cilave ishte e vetmja që prishte qetësinë e asaj nate. Me koka të qethura, vetëm në këmbë, duke u mbajtur te njëri-tjetri e duke shikuar këmbët e veta të zbathura, të burgosurit dukeshin si njerëz të një planeti tjetër, të humbur në mendime kushedi se ku, pa asnjë lidhje me botën që i rrethonte dhe asnjëri prej tyre nuk ngriti kokën për t'u hedhur të paktën një sy dy udhëtarëve të rastit. Po megjithatë, tek ata njerëz të heshtur Mentor Dika mundi të njihnte pesë të pandehurit e gjyqit të fundit, të akuzuar për tentativë vrasjeje ndaj presidentit, të cilët, me gjithë mungesën e provave, i kishin dënuar me pushkatim. Kolona u mbyll nga tetë xhandarë të tjerë, që ecnin gjithashtu për dy, me pushkët mbi supe e me rripat nën mjekër. Befas, përpara Mentariit u gjend një oficer, fytyra dhe mosha e të cilit ishin mbuluar nga veli i hënës. Oficeri më parë shikoi Mentarin, pastaj Katin, pastaj bëri një shenjë, që donte të thoshte «zhdukuni» dhe priti aty derisa Mentari dhe Kati u nisën në rrugën e tyre. Livadhi, pemët, gomari, yjet, nata, që të gjitha këto ranë përsëri në gjendje dremitjeje e përgjumesie të thellë.

Pasi kishin bërë disa hapa, Kati, duke u ngritur në majë të gishtave e duke u zgjatur në drejtim të veshit të Mentarit, pëshpëriti:

— Xhaxhi, në këtë rrugë unë kam parë edhe burra të tjerë të lidhur, që nuk janë kthyer më kurrë në pazar!

Mentar Dika për pak tha «po», vetëm në çastin e fundit u përmbajt, i shtrëngoi dorën Katit dhe pëshpëriti:

— Eja të shpejtojmë, se jemi vonë!

Përtej fushës së lyer me ngjyrën monotone të hënës, ai shqoi konturet e qytetit me dritat e rralla të rrugëve, që nga larg dukeshin si sy të skuqur të një egërsire. Shkëlqimi që lëshonin ato drita i vishte sendet me një ngjyrë të keqe, që e bënte natën më të dendur, sikur qyteti të ishte rrethuar nga humnera të shumta e të padukshme. Si për të mos rënë në njërin nga këto

humnera, Mentar Dika ngadalësoi hapin. Diçka i kishin zënë veshët. Një si komandë.

— Tashti! — tha ai me vete, por me zë.

Pas komandës u dëgjua gërvishtja e llozeve të pushkëve.

Tha prapë:

— Tashti! — Kësaj radhe gati pa zë.

Kaluan disa çaste, ndoshta një minutë e tërë. Pastaj një tjetër komandë, fare e shkurtër. Dhe krisma. Dhe heshtje. Dhe si më parë, zjarret e barinjve ndriçonin gati si pika të kuqe në errësirën e largët e të argjendtë. Kurse aty pranë këpucëve të Mentar Dikës çërriti një kandërr e vetme. Më tej çërritën një mijë, një milion kandërra të tjera. Ndërsa kuarja e bretkosave jo vetëm që s'kishte heshtur asnjë çast, por pas krismave sikur që bërë më grindavece dhe më e afërt. Kati u shtrëngua pas krahut të Mentarit dhe e shikoi me ngulm.

— Mërdhuh? — e pyeti ai Katin që po dridhej.

— Jo, nuk mërdhuh!

— Mos të vriten këmbët nga barërat?

— Jo, nuk më vriten!

— Mos u trembe nga pushkët?

— I vranë, xhaxhi?

— Po.

— Pse?

— Kur të rritesh do t'i kuptosh këto maskarallëqe. Po ti më thuaj, pse nuk e paskë ngrënë gjysmën e simites sate?

— E ruajta për dy fëmijët e tjerë që ke ti në shtëpi.

— Ku e di ti?

— Dëgjova te furra!

Mentar Dika e shikoi me vëmendje, si të bindej edhe një herë për zgjuarsinë e saj.

Kur ranë në rrugët e qytetit, padashur, ai shtrëngoi dorën e vogël të Katit. Nëpër qytet kishte njëfarë gjallërie, sidomos atje ku kafenetë ishin më të shpeshta. Te sheshi pranë rrapit të madh u dëgjua një trumbetë, që u kthye shpejt në muzikë. Pak më tej një orator fliste para



disa burrave me fytyra të përgjumura dhe Mentar Dika dëgjoji se ai u fliste për zgjedhësit e dytë, për të cilët do të votohej pas tri ditësh, më 17 gusht, pastaj për deputetët e për një asamble që do të ndryshonte formën e regjimit e do t'u gjente një mbret Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Tashti që monarkia e ardhshme po futej në rrugën e ligjshmërisë, edhe ritmet e trumbetave, që ktheheshin shpejt në muzikë, edhe vetë muzika e bandës ushtarake, kishin pësuar ndryshime, ishin bërë më të rënda, më festive, më madhështore.

Te një shtyllë, nën shpalljen për 2000 frangat që jepeshin për kokën e Genc Bogës, ishte ngjitur një shpallje e dytë.

**Kush strehon rebelin Genc Boga, pushkatohet në vend, familja internohet, shtëpia digjet, trualli konfiskohet!**

Mentar Dika mbeti në këmbë, me fytyrën që i kishte marrë pamjen e disa përfytyrimeve jo të këndshme. Vila. Qemeri. Bodrumi. Genc Boga. Dakleë. Gimi. Leta. Rreziqet. Tha:

— Kati!

— Xhaxhi, më thirre?

— Po sikur të kthehesh te shoqet?

Nën dritën e verdhë të fenerit që ndriçonte shpalljet, Mentarin dhe Katin, fytyra e irnosur e kësaj të fundit sikur u zbardh dhe prekat blu u bënë më të theksuara. Ajo nuk foli. Edhe sikur të kishte dashur, nuk do të mund të shqiptonte asnjë fjalë. Kaq e kuptoi Mentari. Ai vetëm ndjeu një shtrëngim të fortë në krah. Me këtë shtrëngim dora e vogël dhe e hajthme e Katit i komunikonte një mijë fjalë menjëherë, për deshifrimin e të cilave Mentari s'kishte kohë: ishin vonë, duhej të ktheheshin në vilë sa më parë. (Gjendja e jashtëzakonshme!)

— Mirë pra, Kati!

Kati bëri një përpjekje për të buzëqeshur, por i vlejti vetëm sa për të zbuluar dy dhëmbët e parë.

Kur u larguan nga pazari dhe u futën rrugicave të lagjeve, këmbët e Mentarit u rënduan, u bënë më të nga-



thëta, derisa qëndruan, derisa bënë një kthesë të fortë dhe shpejtuan si më parë drejt disa zigzageve të errëta.

— Xhaxhi, pse u kthyem prapë?

— Do të shkoj te një shok, po ti, Kati, mos u tremb, ti do të vish me mua sonte!

Ecën shpejt, shpejt dhe fshehtas nëpër rrugica, derisa Mentari qëndroi befas, sepse veshët i kishin zënë një rënkim të mbytur. Ai kërkoi me sy nëpër errësirën e shqetësuar nga drita e dobët e hënës dhe, kur në anë të rrugës gjeti një trup të shtrirë, u kërrus, ra në gjunjë dhe pas pak pyeti:

— Besnik, ti qenke?!

Besniku vetëm rënkonte.

Mentari përgjoi heshtjen e rrugicës dhe në minutën tjetër ai ecte me Besnikun në krah drejt portës së shtëpisë që ishte aty pranë. Kur ai dhe Didi (gruaja e Besnikut dhe shoqe e Dakleas) i fshinë fytyrën e gjakosur dhe i freskuan Ballin, Besniku hapi sytë, shikoi Didin e Mentarin, pastaj, si t'i vinte turp për gjithë sa i kishte ndodhur, uli vështrimin te duart e veta tërë plagë.

— Ishin pesë ata që m'u hodhën përsipër, — tha me një fije zëri. — Ishin civilë, po xhandarët bënë rojë te kthesa e te pragu i pontës sime!

— Ç'të thanë?

— Ç'të thonë, duan vota bejlerët dhe zotërinjtë. Kur s'të blejnë dot me para, atëherë të rrahin!

Pas pak, kur Didi e kishte ndërruar dhe pastruar disi, Besniku tha prapë (me një fije zëri):

— U takuam, Mentari!

— Po jo rastësisht. Kam dashur të vij tek ti. Edhe sonte u ktheva qëllimisht këtu.

— Kështu s'jetohet më, — foli gati i përhumbur Besniku.

— Po, diçka do të bëjmë!

— Ku ma gjen. Gati jam!

— Do të vijë koha që t'i bëjmë përsëri tym bejlerët, mehmurët dhe të gjithë armiqtë tanë. Po ti ki kujdes, ruhu dhe prit lajm nga unë!

Para se të humbiste në mjegullimën që kishte në kokë, Besniku deshi t'i shtrëngonte dorën Mentarit, po gish-tat e tij mbetën të palëvizur.



## XII

Didi sapo kishte mbyllur portën prapa krahëve dhe Mentari ishte akoma i përhumbur, kur te qoshja e rrugicës e befasoi prapë ajo qenia e vogël me këmishë të gjatë dhe flokë të shpupurisur, përzier me hënë e me mjegull.

— Ah! Këtu më paske pritur, Kati?!

— Po, xhaxhi!

— Tashti, si thua, shkojmë në shtëpinë time?

— Po, xhaxhi!

Dhe ecën prapë rrugicave pa dritë, ai me hapa të gjatë e të shpejtë, ajo me majat e gishtave, pa e prekur tokën me tabanin e këmbëve. Kur arritën në lagjen periferike pranë vilës, ku si zakonisht Mentari e ndiente veten më të sigurt, padashur mendimet i morën hov dhe iu futën nëpër ato shtëpi të vogla përreth, ku kishte njerëz që flinin, që kridheshin në ëndrra e që përkohësisht ishin çliruar nga hallet e shqetësimet, nga dëshirat, nga qëllimet e pasionet. Por vetëm përkohësisht. Dhe ai, i rrethuar nga heshtja e natës, nga konstelacionet e nga ekstaza e yjeve mbi kokë, ecte duke menduar e duke ndier praninë e dorës drithërake të lypsares së vogël në cepin e xhakëtës. Ishin dashur të kalonin gati katër vjet pas përmbysjes së revolucionit, ishin dashur të kalonin gjashtë muaj pas amnistisë, që ai të kuptonte e të bindej plotësisht se njerëzit e thjeshtë nuk e kishin harruar revolucionin, se revolucioni kishte lëshuar rrënjë në zemrat e në mendjet e tyre, se ata nuk e donin regjimin e Zogut dhe se të gjithë prisnin një kohë më të volitshme...

Këto mendonte Mentari Dika e për këto do t'u fliste Gencit dhe Dakleas sapo të kthehej në vilë... dhe kushedi ç'mund të kishte ndodhur me pamjen e tij, kushedi si mund të kishte ndryshuar qëndrimi dhe hapi i tij, që e detyruan Katin e vogël ta hiqte dorën nga cepi i xhakëtës, ta kapte nga mënga e t'i thoshte:

— Xhaxhi!

— Ah, Kati, çfarë?

Ajo sikur tundi kokën në shenjë qortimi dhe ai nuk e kuptoi, nëse i kishte shkelur këmbët e zbathura, apo thjesht kishte zgjatur hapin dhe e kishte lënë prapa.

— Xhaxhi! — përsëriti ajo po me atë ton.

Sidoqoftë, pas pak marrëdhëniet midis tij dhe Katit ishin kthyer në gjendje normale dhe ata vazhduan sërish rrugën të qetë, nëse do të jetë me vend përdorimi i kësaj fjale për ato kohë.

Edhe te huri, ngulur në varoshin para vilës, nën shpalljen e parë kishin ngjitur një të dytë. Megjithëse Mentari tashmë e dinte përmbajtjen e shpalljes së dytë, prapëseprapë nuk e la kureshtja. Ndezi një shkrepëse...  
**Pushkatohet në vend...**

Mentar Dika u largua nga shpalljet, si gjithmonë, me inatin në sy, në fytyrë e në buzë. Kati, që kishte hequr dorën nga xhaketa e tij e që mbeti prapa, thirri e trembur:

— Xhaxhi!

— Ah! — shtangu ai.

— Xhaxhi!

— Eja, Kati, mos u tremb!

Ajo vrapoi dhe e zuri nga cepi i xhaketës.

## XIII

### NJERËZIT ME TË ZEZA

... Pasi dëgjoi qëndrimin që kishin mbajtur në postën numër katër për padinë e Bido Peshtit kundër Mentari Dikës, pasi dëgjoi rrethanat e takimit të Mentarit me



Besnik Sazanin dhe pasi urdhëroi që për mbrojtësit e këtij të fundit të hapeshin dosje të veçanta e të mbaheshin në vërejtje, njeriu me të zeza, që fliste nga katedra e nga gjysmerrësira, tha:

— **Non dimenticare...**<sup>1)</sup> këndej ka kaluar një revolucion që ka lënë gjurmët e tij kudo. Ekziston një ligj: ndërsa ne përpiqemi t'i shkulin nga rrënjët ato gjurmë, revolucionin i përmbysur përpiqet t'i ngulë sa më thellë. Kështu duhet kuptuar edhe mbrojtja që i kanë bërë ata Mentar Dikës!

Njeriu tjetër me të zeza, që dëgjonte një metër para katedrës dhe një metër poshtë katedrës, lëvizi në anë të karriges dhe u duk sikur u shndërrua në një grumbull leckash të mjera, që prisnin një erë të fortë për t'i fshirë nga faqja e dheut. Kurse tjetri, katërkëndëshkëndrejt, foli nga lart:

— **Ora senti, bastardo!**<sup>2)</sup> Kur ta shohim të arsyeshme, ne do të bëjmë sikur gjoja do të heqim gjendjen e jashtëzakonshme. **S'intende...**<sup>3)</sup> që në vigjilje të proklamimit të monarkisë do të krijohet një gjendje e lirë dhe festive në gjithë qytetin. **Ansi...**<sup>4)</sup> do të hapim edhe fjalë për një amnistie, **come se...**<sup>5)</sup> gjërat u zbutën dhe kudo mbretëron paqja dhe qetësia. **Allora...**<sup>6)</sup> le të shpesojmë se ata, pasi ta kenë besuar gjendjen e re, do të fillojnë të lëvizin, kurse ju do të dyfishoni rrjetin e ndjekjes e të përgjimit. **Così speriamo...**<sup>7)</sup> se edhe këto dhelpra që kanë mbetur do të bien në duart e gëzoftarit! — Këto tha ai dhe fërkoj ngadalë mjekrën e gjatë e të zezë me majuckë.

- 
- 1) (it.) — Mqs harroni.
  - 2) (it.) — Tashti, dëgjo, bastard!
  - 3) (it.) — Kuptohet.
  - 4) (it.) — bile
  - 5) (it.) — sikur
  - 6) (it.) — atëherë
  - 7) (it.) — Kështu shpresojmë.

Libri i tretë

---

DËNIMI





### PROLOG 3

... Por nuk cenohet dinjiteti, as mund të ulet autoriteti i një republike, e cila lufton e punon për të ngritur në këmbë një monarki të re (dy emërtime — një diktaturë), vetëm sepse një orë pasi ishte ngrysur, nëpër kalldrëmet e qytetit N u dëgjuan gërvima këpucësh me gozhdë (të xhandarëve), trokitje portash, fishkëllima bilbilash, britma, klithma, të qara fëmijësh e shumë zhurma të tjera të ngjashme ose jo të ngjashme me to... Fundja, pse disa qytetarë (më të ndershmit) u treguan të urtë e të mençur dhe vrapuan për të votuar në dritën e diellit, e pse disa të tjerë (fundërrinat), të ngjuar nëpër shtëpitë e tyre, pritën sa të lindte hëna e pastaj të shqetësonin Tiranën, Ministrinë e Punëve të Brendshme, prefekurat... për të lënë kështu xhandarët e gjorë pa gjumë e pa çlodhje?!



A s'ishte e drejtë që ajo natë të shpallej e dyshimtë dhe të futej në listat e zeza të monarkisë së ardhme?

Pavarësisht se të nesërmen bëmat e asaj nate do të përjetësoheshin në kolonat e kronikës së ndritshme të shtypit zyrtar si zeniti i patriotizmit shqiptar, ajo do të mbetej e do të quhej nata e katër z-ve, e Zezë, e Zgjedhjeve, e Zogut (zyrtare), e Zogollit (opozitare).

Historia, ajo që shikon përpara e jo prapa, ka një zakon të mirë, që kur bën përgjithësimet, mbështetet kryesisht në faktet, e, duke u mbështetur në faktet, ajo nuk harron asgjë e nuk të fal asgjë...

# I

## GENCI DHE FËMIJËT

Gati çdo mbrëmje fëmijët prisnin xhaxhi Dinin të vinte nga pazari dhe t'u tregonte ndonjë histori, apo ndonjë përrallë. Pastaj ata binin të flinin, të bindur se xhaxhi Dini do të udhëtonte natën për të shkuar në fshatin e tij. Ai u kishte thënë se fshati ishte afër, ja, tek ato bregoret, ku dukej një kasolle. Ai prapë do të kthehej të nesërmen, për të shitur diçka në pazar dhe prapë do të vinte tek ata. Xhaxhi Dini u kishte premtuar t'i merrte edhe në fshat, ku ata do të hanin manaferra, por edhe fiq kishte xhaxhi Dini, e çfarë nuk kishte ai, qen, mace, një lopë, një viç,



kishte edhe gomar, që xhaxhi Dini nuk e sillte në shtëpinë e tyre, se e mbante të lidhur në një han.

Ndodhte që xhaxhi Dini të vinte aty që në mëngjes, nganjëherë ndodhte të qëndronte aty gjithë ditën, deri në mbrëmje dhe nuk largohej pa i vënë ata në gjumë. Më vonë ai tha se nuk do të shkonte më në fshat, veçse kur të fillonin shirat, tha se kishte disa punë në qytet dhe pastaj... Këto ishin ditët më të bukura për fëmijët, sepse xhaxhi Dini një pjesë të mirë të kohës e kalonte me ta. Ato ditë Leta ose nuk qante fare, ose qante pak e rrallë, po ndodhte edhe të qeshte. Sa për Gimin, ai vazhdonte të ishte më serioz për të gjashtë vjetët e ca që kishte. Ai të shikonte gjithmonë pa i përplasur qepallat, por, vetëkuptohet, që serioziteti i tij ishte tepër fëmijëror. Edhe kur në shtëpinë e tyre erdhi Kati (ajo u quajt motra e madhe), asgjë nuk ndryshoi: ishin dy, u bënë tre, që dëgjonin përrallat e xhaxhi Dinit, ose që luanin ndonjë lojë tjetër, ta zëmë luftash me turqit etj. etj. Veçse me Katin puna qëndronte pak ndryshë. Ajo, sikur kishte harruar të qeshte, sikur nuk dinte të qeshte. Por as të qante. S'kishte lot, s'kishte as gaz. Gëzimet e hidhërimet dukej sikur ia kishte thithur fytyra e dobësuar me ato preka si pika boje, se edhe prekat, nuk i kishte të zakonshme, ngjyrë kafe, si të gjitha e si shumica e prekave, po të kaltra, fare të kaltra, si bojë e freskët shkrimi. Ajo qe e para që zbuloi se xhaxhi Dini vërtet ishte i mirë, por ishte edhe pak hutaq. (Kati e bënte këtë vërejtje vetëm kur Genc Boga përgjigjej me vonesë sa herë e thërritnin me emrin e ri.) Por, sidoqoftë, tek e shikonin të ri e të shkathët, më të gjatin në vilë, ata ishin të bindur se xhaxhi Dini ishte i fortë, po të donte ai, rreshter Ago Agon, xhandar Kikën, që ishte si një stërhell, apo xhandar Jonuzin si xhuxh, por edhe xhandar Shkëlqimin, si top dhjami — po të donte xhaxhi Dini i hidhte të katër mbi tjegullat e çatisë. Po xhaxhi Dini nuk mund të rrinte tërë ditën me ta. Jo vetëm që s'ishte njeri pa punë, po shpesh binte edhe në mendime. Sigurisht, mendonte për kasollen e vet, për manaferrat, për fiqtë, për kumbullat, mendonte edhe për arat e për misrin, po edhe për gomarin (që



herë e lidhte në han, herë e linte në fshat), e kushedi për çfarë tjetër mund të mendonte xhaxhi Dini. Pastaj, ai bisedonte me mamin e me babin, edhe me xhaxhi Telin bisedonte. Afëherë, po të ishte ditë, fëmijët tërhiqeshin në lodrat e tyre, ose merrnin dhinë e kecin dhe i çonin për t'i kullotur ferrave rrotull varosheve e buzë përroit atje poshtë, dhe, po të ishte natë, ata binin për të fjetur, sigurisht, më parë hanin, po t'u jepnin për të ngrënë. Po para se të binin, ata i thoshin xhaxhi Dinit të vinte përsëri të nesërmen. Dhe xhaxhi Dini u thoshte: «Po». Pastaj u thoshte: «Natën e mirë!» — «Natën e mirë!» i thoshin edhe ata. Dhe këto skena përsëriteshin pothuaj çdo mbrëmje, me përjashtim të atyre rasteve, kur Genc Boga ishte «nisur për në fshatin e vet» (në vendin e fshehtë), pa u takuar me ta.

Por një ditë edhe për fëmijët diçka ndryshoi. Kjo ndodhi kur mami me babin se çfarë biseduan me xhaxhi Dinin dhe pas kësaj bisede ai nuk gjeti më kohë për t'u treguar përralla e të tjera histori. Babi dhe xhaxhi Dini, pasi mbaruan së meremetuari muret që rrethonin vilën dhe shtëpinë e vjetër, hapën disa brima të shëmtuara (si gojë të çara dhe i hapën kudo, këtu, atje, më tej e më përtej), që i quanin frëngji e që, pasi i hapnin, i mbulonin prapë me gurë. Kur mbaruan këtë punë, filloi meremetimi i çardakut në shtëpinë e vjetër me qemer, derisa ai u rrethua i tëri me mure të trasha. Kurse mami, ajo vazhdonte punën e vet, d.m.th. vazhdonte të zverdhej, të bëhej më e ve-e-erdhë se e verdha dhe se ç'kishte një hall të madh mami, që e detyronte herë të ndihmonte burrat, herë të mbyllej në dhomën e gjumit e pastaj të dilte nga dhoma me sy të skuqur. Babi dukej krejt i ngrysur dhe shumë i zemëruar. Sidomos xhaxhi Dini, edhe ai se ç'kishte një hall dhe sa herë që e shikonin ashtu të menduar, fëmijët përsëri tërhiqeshin në lodrat e tyre, po keci, keci jo. Ai, si për inat, as që donte t'ia dinte se ç'ndodhte me xhaxhi Dinin... I mësuar manar pas tij, gati e ndiqte prapa kudo që shkonte dhe xhaxhi Dini nuk harronte kurrë t'i këpuste gjethe e bisqe, që keci e pas kecit dhia, i hanin duke tundur bishtin e vogël.



## GENCI DHE HYRIA

Edhe atë mëngjes keci e shikonte Genc Bogën me sytë e tij të gjelbër e të pastër në gurrkali, si të kishte një dëshirë të fshehtë për t'i thënë e për t'i kërkuar diçka. I ulur nën hijen e arrës së madhe, Genci fërkonte me pëllëmbë kurrizin e brishtë të kecit dhe, ndërsa dëgjonte ë-ë-të e tij, kujtonte një nga ngjarjet më të fundit, që i kishte ndodhur në jetën e shkurtër prej komiti...

*...Hyria i dha Gencit bukë e gjizë. Nga drita e pishës, hija e saj e gërmuqur dridhej e zmadhohej si gjëmë nëpër muret e kasolles. Genci e ndjeu menjëherë se plaka ishte nën pushtetin e një brengje: pasi kaloj duart e dridhshme nëpër xhupin prej basme, me pulpat e gishtave preku shaminë e zezë, në anët e së cilës i vareshin cullufet e thinjura.*

— Ç'kërkon, moj nënë? — pyeti Genci.

— Një gjilpërë! — tha ajo. Tha prapë si me vete: — Të ndjekin, por s'të zënë dot. Kanë edhe xhandarët punën e tyre! — dhe vazhdoi të kërkonte gjilpërën.

Genci hante me oreks. Kishte dy ditë pa ngrënë. Dhe plaka i kishte vënë përpara gjithë bukën e gjithë gjizën që iu ndodh në kasolle. (Ishin ditët e para të ndjekjes, se pastaj ai do të mësohej me atë jetë!)

— Je çun i ndershëm, apo... — Hyria nuk e mbaroi fjalën.

— Po, moj nënë! — Genci e shikoi i çuditur dhe i befasuar.

— Je tamam ai që ndihmove Veteranin e Luftës për të mos rënë në duart e xhandarëve?

— Po, moj nënë — tha Genci gjithmonë i çuditur dhe i befashuar.

— Hallall të qoftë! — tha ajo, futi duart në gji dhe i hodhi në prehër një qeskë. Qeska lëshoi një tringëllimë të mbytur.

— Ç'është kjo? — pyeti Genci.

— Paratë! — tha Hyria.

— Pse m'i hodhe në prehër?

— Kam njëzet vjet që i kursej!

— Mua s'më duhet asgjë, vetëm ja, kjo kafshatë bukë.

Drita e pishës, që herë i ndriçonte ballin, herë hundën e mjekrën, sikur tallej, sikur luante me fytyrën e saj të ngurrosur. — Dua të m'i numërosh, — tha Hyria.

— E pse?

— Dua të di sa para kam kursyer.

Genci shikoi qeskën.

— Jo tashti, — tha ajo.

— Po kur?

— Pasi të kesh ngrënë.

Disa minuta më vonë, Genci i derdhi paratë në vatër. Ato tringëllinë, se ishin shumë, por ishin të gjitha të vogla, ishin qindarka të verdha dhe vetëm rrallë e tek, si dhia ndër dhen, zbardhte ndonjë çerek leku.

Në kasolle kishte rënë heshtje. Flaka e pishës dridhej, kërciste, mbante erë tym. Hyria merrte frymë me zor. Trink-trink-trink tingëllonin qindarkat.

Tha Hyria:

— Sa herë i numëroj, më ngatërrohen nëpër duar.

— Ç'do të blesh me këto para? — pyeti Genci.

— Një dhi, — tha ajo. — Njëzet vjet që nuk dëgjoj një vërrimë dhie. Kur isha më e re, më kujtohet si sot, të vetmen dhi që kisha ma hëngri Xhango hajduti. E zuri dhinë në sytë e mi, unë iu luta Xhangos të mos ma prishte dhinë, se isha grua e ve e s'kisha fëmijë, se vetëm atë dhi kisha, por ai e theri, e rropi, e poqi këtu në buzë të pyllit, hëngri sa deshi, mishin tjetër e futi në tarkaç, mua më hodhi kockat që kishte lëpirë vetë dhe iku. Pastaj Xhangon nuk e pashë më. Thanë se e kishte pic-



kuar gjarpri — Hyria e ndërpreu rrëfimin. Çuni kishte numëruar edhe qindarkën e fundit.

Tha Genci ngadalë:

— Pesë lekë e pesë qindarka!

— Me aq para nuk blen as postiqe! — psherëtiu pas pak Hyria.

Një copë herë heshtën. Vetëm bulkthi këndonte kashtave të kasolles. Kishte edhe zhurma të tjera, që ishin zhurma pylli të një nate të ngrohtë korriku.

Kur ai u ngrit për të ikur, se nuk ishte e udhës të flinte në kasolle (ai do të flinte në pyll), Hyria tha:

— Prit, çun, se e gjeta gjilpërën!

E kishte gjetur mbi rrogos dhe nuk e kishte lënë Gencin të largohej, pa i qepur me pe të zi mëngoren e bardhë, grisur në gjoks.

Aty pranë:

M-m-m, dhia.

Ë-ë-ë, keci.

Këto kujtoi Genci atë mëngjes dhe ndjeu prapë dhimbje për plakën e kasolles, që jetonte gati e vetmuar e gati e veçuar nga fshati buzë një pylli të dendur e të madh.

### III

#### GENCI DHE KRIST PAPI

...Shpesh ai kishte çaste lëkundjeje. Nganjëherë i bëhej se do të qe më mirë të tërhiqej nga vendimi që kishte marrë për të gjykuar e pastaj për të vrarë Krist Papin.

Dy net më parë ai ishte nisur për atje, por qe kthyer, pa arritur në shtëpinë e tezes. Kudo monopateve e shtigjeve të periferisë kishte pasur xhandarë, që ndalonin kalimtarët dhe u kërkonin letërnjoftimin. Ai kishte pritur gjatë, fshehur pas kaçubeve, por më kot: rruga nuk qe hapur. Kështu Genci ishte kthyer prapë dhe radhën tjetër kishte vendosur të shkonte atje i shoqëruar, ta zëmë nga Teli Bashari, që ishte plak e nuk ngjallte dyshime. Të dy ata mund ta zgjidhnin më mirë rrugën, mund t'u shmangeshin më mirë rreziqeve. Ashtu do të bënte. Por, duke ndenjur në hijen e arrës së madhe, që ndodhej në atë pjesë të oborrit, të cilën Dikët e kishin bërë zakon ta quanin kopsht, padashur ai përfytyroi çastin kur do të gjendej përballë Krist Papit. Përfytyroi edhe çastin tjetër, kur ai do të nxirrte revolen, do t'ia kthente grykën drejt zemrës... dhe...

— Gjysma e skuadrës do t'i marrë nishan ballin, gjysma tjetër, ti, ti, ti dhe ti. — ky i fundit kishte qenë Genc Boga, — do t'i merrni nishan gjoksin, ja këtu, nga e majta, ku ndodhet zemra. Sapo unë të jap komandën zjarr, ju do të kenë kujdes të shtini të gjithë menjëherë! — Kështu u kishte folur oficeri disa minuta para ekzekutimit të një shoku të tyre ushtar, dënuar si dezertor. Po Genci nuk mori pjesë në atë ekzekutim. Pas pak atij i qe përzier në stomak dhe oficeri e kishte shtyrë me inat:

— Ik, ti, zemërpulë!

Tashti as Genci vetë nuk e kishte të qartë pse dy net më parë ishte kthyer pa shkuar deri te Kristi: nga rreziku se mund të ndeshej me xhandarët apo pikërisht nga përfytyrimi i skenës, kur ai do të nxirrte revolen e do të shënonte në zemër të Kristit. Në të vërtetë ai nuk e dinte cili kishte qenë shkaku kryesor, po të paktën i kujtohej se në vilë qe kthyer shumë i lodhur. Prej disa netësh flinte pak, ose aspak. Gjithmonë e njëjta gjë: përfytyrimi i skenës... Genci e kishte parë ushtarin e vranë, por jo atë çast, disa orë më vonë. E kishte parë kur nga fshati fqinj kishte ardhur e shoqja e të vranit, një nuse e re as njëzet vjeçe,



me djalën dyvjeçar në krah, koka e të cilit varej e pafuqishme në supin e së ëmës.

— Erdhi, — tregoi e shoqja, dhe ushqeu djalën me tul buke e me pak sheqer që i kishte kursyer nga racioni i tij. — Unë i thashë, ti po vdes për vete, s'të ka mbetur pikë gjaku në fytyrë, ai më tha të shpëtojë Fani më parë... Koriçkat e bukës me pak sheqer m'i dha mua, pastaj iku në mesnatë dhe unë dëgjova që e kishin dënuar dhe e kishin vrrarë! — Kështu tregonte ajo dhe qëndronte në gjunjë para kufomës së të shoqit, ndërsa Fani dyvjeçar, me fytyrën prej plaku, tërë zhubra e rrudha, me kokë të lëshuar në supin e së ëmës, nuk dukej as i gjallë, as i vdekur, por të paktën kuptohej që merrte frymë, nga lëvizja gati e padukshme e shpatullave.

Ë-ë-ë, vërriti keci që, tek i fërkohej pas gjurit, e shikonte Genc Bogën me sytë e tij të ngushtë, të gjelbër e të pastër në gurrkali, si të kishte dëshirë t'i thoshte diçka.

— Ah, dashke ujë! — tha Genci. U ngrit nga stoli, lëshoi kovën në pus dhe me pamje që i luhatej midis kujtimeve dhe realitetit, dëgjoi krikëllimën e çikrikut, e cila tashmë i qe bërë tepër familjare. Mbushi legenin me ujë dhe e vuri pranë këmbëve. I pari, si zakonisht, u afrua keci. Pastaj dhia. Ndërsa pinin, të dy ëmë e bir lëviznin bishtin e vogël. Të gjitha këto pamje e gëzonin Gencin. Edhe kur ai me një shok të kompanisë, ushtar Destanin, filluan të ushqenin nga racioni i tyre Fanin e vogël, po këtë gëzim ndien, sidomos, kur vunë re se ditën e pestë femija mundi të ngrinte kokën, të zgjaste duart e t'u buzëqeshte. Edhe e ëma po ashtu u kishte buzëqeshur dy ushtarëve. Ajo shkonte çdo ditë mbi varrin e të shoqit dhe e qante, duke i thënë se e kishte lënë të vetme në botë, me Fanin, që akoma s'kuptonte sa e rëndë ishte bërë jeta... Keci e dhia pinin ujë dhe tundnin bishtin. Pastaj ai u këputi disa bisqe dhe u ul përsëri te stoli pranë pusit, nën hijen e arrës së madhe. Ç'bëhej tashti me Fanin e vogël e me nënën e tij?...

Përtej mureve të vilës, përfund varosheve dukeshin majat e holla të plepave, rrapet e mëdha shekullore dhe degët e varura të shelgjeve lotuese. Pastaj vështrimi i



Gencit ngjitej atje ku kishte zabele, ku kishte fusha të verdha e pas fushave pyje të dendura dhe diku në cepin e tyre, një çati me tjegulla, që ishte mulli fshati me ujë. Mbi mulli shtrihej një tjetër pyll, pikërisht pylli, ku Genci kishte fjetur natën e fundit, para se të zbriste në vilën e Dikëve.

Atë ditë të bukur gushti që Genci ishte ulur te stoli pranë pusit, atje larg e fare lart mbi pyjet përballë shkëlqente në diell Guri i Bardhë. Atje do të takohej ai me Lato Morinën, po vetëm pasi të kishte gjykuar e dënuar Krist Papin... Dhe ai do ta bënte këtë, pavarësisht se kishte zemër të dhimbsur; do ta dënonte tradhtinë e Kristit, sepse jo vetëm që ishte i biri i një revolucionari, por edhe vetë Genci, megjithëse s'kishte marrë pjesë në revolucion, dëshmitar e bashkëkohës i tij kishte qenë. Ai e kishte jetuar atë kohë dhe atë frymë, kishte njohur edhe nga afër mjaft pjesëmarrës të revolucionit. Ai kishte lexuar e dëgjuar të flitej për Avni Rustemin, për shoqërinë *Bashkimi*, për qëllimet dhe idealet e saj, kishte dëgjuar të flitej për parti të ndryshme, për beteja e revolucione të tjera në botë, për një revolucion që ishte bërë në Rusi, për Leninin, për Federatën Komuniste Ballkanike, nga të cilët trembeshin aq shumë Ahmet Zogu dhe miqtë e tij. Edhe për shumë gjëra të tjera kishte dëgjuar ai para dhe pas ndeshjes me djalin e pashës D në sallën e ankandit e në klubin *Bristol*, që kishte qenë beteja e tij e parë në jetë. Dhe së fundi, i takoi atij t'i dilte krah Veteranit të Luftës dhe kjo kishte qenë beteja e tij e dytë. Tashti atë e priste beteja e tretë: do të hakmerrej për tradhtinë ndaj Veteranit të Luftës e ndaj Revolucionit, do të vriste Krist Papin dhe pastaj do të hidhej me armë në dorë në Malet e Shqipës, ku do të fillonte betejën e katërt...

Plepat e hollë, shelgjet lotuese e rrapet me degë shumë në fund të varosheve, zabelet, fushat e verdha, pyjet, mulliri, përsëri pyjet dhe atje larg e fare lart Guri i Bardhë, — gjithçka e të gjitha që ngriheshin para syve të tij, sikur e ftonin, sikur e thërritnin, sikur ia bënin me dorë që ai të kthehej e të ngjitej përsëri tek ata... tek ata... në luftë me të gjithë djajtë, me të gjithë ata që vritnin



njerëz kot, që vdisnin fëmijë nga uria e që mbillnin kudo fatkeqësi. Genci i përbuzte të gjithë këta djaj, pa përjash-tim të gjithë dhe e dëfrente mendimi se midis tyre nuk mund të gjendej asnjë i vetëm që ai të mos e urrente... Dhe do të vinin të tjera ditë... Jo më kot ai me Mentarin ki-shin vendosur të transportonin armatimet e vilës në Malet e Shqipes menjëherë, sapo të hiqej gjendja e jashtëza-konshme. Por edhe Destani, që ishte ushtar atje larg e që përkujdesej për jetimin e vogël e për gruan e ve, Destani, që ishte vazhdimisht i dhimbsur dhe i pakënaqur, mund të bëhej edhe ai një komit i mirë, si Latoja e si Mentari. Ja, u bëmë katër. Ziqi, pesë. Gjashhtë, ushtari tje-tër i kompanisë, në shtëpinë e të cilit qenë arrestuar bash-kërisht me Mentarin. Se ku kishite lexuar Genci, lëvizjet e mëdha kështu e kishin pasur fillimin. Një këtu, një atje, një më tej... bëhej një çetë, dilte një njeri, që mbledhte të tjerët, që mësonte të tjerët, ngrihej një komitet dhe kështu me radhë... një parti... një ushtri... një vit... pesë... dhjetë... Po, po, ai nuk kishte zbritur në qytet dhe nuk ishte futur në vilën e Dikëve vetëm për t'u hakmarrë, vetëm për të vrrarë Krist Papin! Jo, aspak!

Guri i Bardhë në majë të malit, një gur i egër, i madh, me shpella, me hije, me dritë e me shkrepë të mprehtë, ngrihej përballë dhe gjithçka rreth tij e rreth Gencit shtrihej çuditërisht aq e qetë, sa nuk të shkonte mendja kurrë se njerëzit ishin në luftë me njëri-tjetrin, se qeveria kërkonte me këmbëngulje kokën e Gencit, dhe e kërkonte për dy mijë franga ar. Në ato çaste në fytyrën e Gencit kishte diçka të butë e të kthjellët, por s'është e drejtë t'i gjykosh njerëzit vetëm nga pamja e jashtme, as natyrën nga heshtja e saj.

Natën e parë të përmbysjes së Revolucionit, babanë e Gencit e kishin kthyer në shtëpi të sëmure. Ai që e kishte shoqëruar, një nga krerët e Revolucionit, midis të tjerave kishte thënë se çdo revolucion, që pengohet ose që përmbysset me ndihmën e bajonetave nga jashtë, me dhunë e me mashtrim nga brenda, herët a vonë përsëri do të ngrihet, përsëri do të shpërthejë, përsëri do të fi-tojë. Rrugë tjetër s'ka. Populli nuk e duron gjatë shtyp-



jen, as gënjeshtrën, ai nuk e harron fitoren që ka arritur dikur me gjakun e vet. Fundja, bejlerët dhe bajraktarët përmbysën Revolucionin që bëri populli, por jo idetë e tij. Këto e të tjera si këto kishte thënë miku atë natë dhe Gencit, që e kishte përcjellë deri në të dalë të qytetit, i kishte mbetur i gjallë zëri i tij, i kishte mbetur e gjallë figura e tij e fuqishme, e sidomos fjalët e fundit para se të zhdukej nëpër terrin e natës:

— E di ti, Genc, që je trashëgimtari ynë e që të përket ty dhe brezit tënd të bëni revolucione më të mëdha?!

Aty pranë tij, Gimi, Leta e Kati tërhoqën dhinë për litari dhe kaptuan portën e vilës për ta kullotur gëmu-shave e ferrave të përroit. Keci vraponte mbi këmbët e dobëta dhe hidhte shkelma. Mëngjesi i gushtit ishte i ndritshëm dhe i këndshëm.

— E di! — përsëriti Genci pas pak.

## IV

Përmbaruesi plak dhe i vjetër, zoti Nazmi, që e kishte fytyrën si pergamen, herë të grisur, herë të pluhurosur, herë të zhubrosur, por asnjëherë të shtrirë, ngriti çekicin prej druri:

— Një dollar të gjitha toptan!

— Ç'janë këto, një dollar të gjitha toptan? — pyeti një zotëri me kapelë nga fundi i sallës.

— Qerim, tregoja zotërisë se ç'janë!

— Si urdhëron! — tha Qerimi, shërbëtori i zyrës së



përbarimit, dhe gjysmë i kërrusur vrapoi me hapa të shpejtë e të shkurtër drejt banakut. — Mirë, ore lalë, si të jetë thënë, si të dëshirojë zotëria jote! — dhe arriti te banaku. Atje tha:

— Një qilim, një...

— Qilim i vjetër, i shpuar, i ngrënë, — tha zotëria me kapelë nga fundi i sallës.

Disa miza xanxare uturinë si për inat mbi kokën e Qerimit, që e kishte të rruar me brisk e që në përgjithësi e kishte të rrumbullakët e të vogël, si susak i pazhvilluar.

— ... një pasqyrë tualeti, — tha ai.

— E thyer në dy cepa! — e ndërpreu prapë zotëria me kapelë.

— ... një ibrik bakri...

— Për të ardhur keq! — e ndërpreu zotëria.

Përbaruesi plak ngriti çekiçin:

— Një dollar të gjitha toptan!

Salla heshte.

Zotëria me kapelë, nga fundi i sallës, eci përmes stolave dhe sehixhinjve që kishin zënë kafimin.

Rreshter Ago Agoja shkundi trupin e madh, si të shkundte plogështinë dhe briti:

— Lëvizni, ore, hapni rrugë zotërisë!

Xhandar Shkëlqimi shikonte Daklean tepër i habitur, por edhe thjesht i ndezur nga disa pasione të liga. Daklea, që kishte veshur po atë fund e po atë xhaketë, si në ditën e sekuestrimit, e krehur me kujdes, me flokët e rëndë mbi supe, e hajthme, e bukur, vështronte gjithçka dhe cilindo, vetëm xhandarin e ri nuk e vështronte, dhe kur sytë e saj ndesheshin me sytë e tij të paturpshëm, atëherë kërruste kokën dhe zhytej në mendime të verdha (siç kishte edhe fytyrën). Ndërsa qafa e xhandarit të ri skuqej... e skuqej... thujse gjaku do t'i pëlçiste përmbi lëkurën e ndritur. Mentat Dika nuk shikonte njeri. As Daklean, që pas çdo vështrimi amoral dhe imoral të xhandarit afrohej vetvetiu nga i shoqi.

Zotëria me kapelë u gjend ballë për ballë me hundën si sfungjer i ngopur me ujë e me fytyrën tërë plagë e tërë të nxira të Idriz furrxhiut (torturat në postën numër



katër të xhandarmërisë), i cili, pasi i hapi rrugë zotërisë me kapelë, i pëshpëriti shokut që kishte pranë:

— Ç'të ka ndodhur, Sali, që i paske sytë të skuqur e të enjtur?

— Unë nuk votova për kandidatin e tyre as gjatë ditës as gjatë natës. Bereqavers, nuk më rrahën si të tjerët, po më mbyllën në një bōdrum dhe më lanë pa gjumë tërë natën. Unë bëj të mbyll sytë, ata të Ferit beut shpo e qesh e hidh ujë...

— Qafirët! — pëshpëriti Idriz furrxhiu.

— Kostumi... shumë i vjetër, — tha zotëria me kapelë, që më në fund kishte arritur te banaku. Tha prapë: — shu-u-u-më i vjetër! — dhe e preku me kujdesin e tepruar të një artizani.

— Pa shiko dollapin!

— I çarë, — tha zotëria me kapelë.

— I çarë, por prej arre, — tha përmbaruesi plak.

— Prej arre, por i çarë...

— I çarë, por marangozi mund t'i bëjë meremetime!

— Meremetimet duan para të tjera! — tha zotëria.

Paf, kërciti pëllëmba në tepën e rruar të Qerimit. Shkundi dorën. Kishte vrarë dy miza njëherësh.

— Gjym prej bakri demode, — tha zotëria me kapelë. Pas pak u zmbraps dhe shikoi në sy përmbaruesin plak: «Jo», donte të thoshte ai shikim. Atë «jo» e kishte kuptuar gjithë salla.

Përmbaruesi plak ngriti çekiçin:

— Një dollar!

Salla heshtte. Oferta kishte mbetur pezull. Atëherë përmbaruesi (me fytyrën si pergamen i zhubrosur) tregoi me gisht një velenxë të vjetër, teshat e gjumit, dyshekë e jorganë dhe ngriti çekiçin:

— Një dollar toptan!

— Qafirët! — se ç'tha nëpër dhëmbë Sali kafexhiu.

Hunda sfungjeroze e furrxhiut u shtrembërua. Breshkat e vogla mbi kurrizin e saj u dukën sikur do të binin poshtë e do të ecnin nëpër këmbët e njerëzve.



— Fustani, kostumi, dy dyshekët, dy jorganët, velenxa, një dollar!

Oferta mbeti përsëri pezull.

— Lëvizni, hapni rrugë! — thirri befas rreshter Ago Agoja që, më në fund, kishte parë të futej në sallën e përmbaramit një fytyrë të re. Ç'është e vërteta, Ago Agoja donte që ky ankand të mbaronte sa më parë. Nga mungesa e rakisë fytyra i qe bërë baltë, qeskat nën sy i qenë varur, po edhe duart i dridheshin.

Të gjitha kokat u rrotulluan në drejtim të derës.

— Shkëlqim! — u kthye rreshteri i vjetër nga xhandari i ri.

Shkëlqimi u drodh pak po vështrimin nuk e hoqi menjëherë nga Daklea.

— Shkëlqim, ç'm'u shashtise kaq shumë?! Hapi rrugë Faredin Kosovarit!

Faredini nga Kosova kaloi dorën nëpër mjekrën e gjatë qimedredhur, si të Mojsiut të Mikelanxhelos. Flitej se atë mjekër ai nuk e kishte rruar që nga kohët e komitllëkut kundër turqve. Dhe eci. I veshur me tirq të bardhë, me brez të gjerë, me qeleshe e me peshqir rreth qeleshes, me qostek e me një peshqir tjetër mbi sup, i gjatë (ai dukej sikur e kishte bezdi gjatësinë e vet), qëndroi një çast para turmës, si Mojsiu para detit. Por ai nuk i ra detit me stap për ta çarë më dysh e për t'u hapur rrugë njerëzve, ai s'ishte legjendë, as libër i shenjtë, kuran a bibël, ai ishte thjesht një emigrant kosovar ose Faredin Kosovari, siç e kishin bërë zakon ta thërritnin në qytetin N, i cili gati një çerek shekulli më parë kishte luftuar në Kaçanik e gjetkë, kudo që kishte shkelur këmba e gjeneralëve turq. Këtij Faredini turma i hapi rrugë menjëherë, pa qenë nevoja për ndërhyrjen e xhandar Shkëlqimit. Ai eci si anije e bardhë, duke lënë pas vetes një kilvatër<sup>1)</sup> njerëzor. Kosovari emigrant u ul në radhën e parë të stolave (dhe kilvatri u prish nga tallazet e njerëzve, që zunë vendet e tyre). Pastaj hoqi qeleshen, përziu

---

1) Rruga ujore që lënë prapa anijet.



flokët e shkurtër me pëllëmbë; pastaj e vuri qeleshen mbi stol, pranë vetes; pastaj hoqi edhe peshqirin e supit dhe e lëshoi mbi qeleshe; e prapë mbi qeleshe vuri edhe llullën, që e nxori nga pala e brezit; e prapë pranë qeleshes vendosi kutinë e duhanit, kutinë prej fakfuni të ndritshëm. Rrezja e diellit, që u thye në kapakun e saj, goditi në sy përmbaruesin plak. Ky i fundit, i verbuar nga shkëlqimi, shikoi me të bardhën e syrit dhe lëvizi nga vendi. Kosovari emigrant tundi kokën në vend të përshëndetjes dhe, i bindur se njerëzit e kishin vlerësuar me kohë luftën që kishte bërë ai për pavarësinë e Shqipërisë, i bindur se nuk ia kishin harruar e nuk do t'ia harronin kurrë sakrificat (në betejën e Kaçanikut i ishin vrarë dy nga tre djemtë), shikoi ata që kishte pranë me sytë si dy topazë të zinj, që ashtu si e gjithë fizionomia e tij, tregonin se ishte njeri me vullnet të fortë, se kënaqësitë e jetës, pavarësisht nga mosha e thyer, nuk ishin zhdukur akoma nga shpirti i tij. Ktheu kokën nga ai që kishte përbri, po zërin e ngriti sa për gjithë sallën:

— Makinën e qepjes, — tha. — Kam do pare vetëm për një atë makinë!

Zuri të mbushte llullën.

— Nusja e tem biri qep! — tha.

E mbushi llullën.

— Të kujt janë, bre zotni? — pyeti prapë atë që kishte pranë.

Ai u zgjat dhe i pëshpëriti:

— Të Mentar Dikës!

Kosovari fërkoj eshkën pas gurit.

— Të kujt?

Rrahu masatin dhe e ndezi. Era e këndshme e eshkës u përhap nëpër sallë bashkë me heshtjen e rastit që kishte rënë.

— Të Mentar Dikës!

Një copë herë fytyra e thatë, por e shëndetshme e kosovarit, si të kishte jetuar tërë jetën në pyje, humbi prapa shtëllungave.

— Nuk e njof, — tha.



— Është i biri i njerit nga mësuesit e parë, që kanë hapur shkollën shqipe në qytetin tonë, i Musa Dikës!

— I Musait?!... Jo, bre! — tha Faredini nga Kosova.

U mbloodh këmbëkryq mbi stol, nxori nga hundët dy pirgje të gjata tymi dhe për herë të parë ngriti sytë të shikonte përmbaruesin, njerëzit që mbushnin sallën, xhandarët, plaçkat nën e mbi banak.

— Po ata libra? — pyeti.

— Në ankand!

— Ç'libra janë?

— Të Naim Frashërit!

Faredini nga Kosova u mendua pak. Sytë e tij të pëcërruar tregonin se e kishte vënë në zor kujtesën.

— Naim Frashëri! — përsëriti si me vete dhe fytyra e thatë i mori një shkëlqim të brendshëm. — Të toskës, që ka shkruar për Skënderbegun?

— Po.

Tundi kokën në mënyrë të papërcaktuar.

— Kush asht, bre, ky Mentar Dika?

— Ai.

E shikoi.

— Po më dhimbet, — tha.

— Ia ka sekuestruar me pahir kreditori, — u zgjat akoma bashkëfolësi drejt veshit të tij, ngaqë zërin e kishte graduar fare ulët.

Faredini nga Kosova e shikoi në sy, e shikoi i shtangur. Në ato çaste fytyra e tij u duk si kobure e vjetër me çark të ngrehur. Pastaj ngriti peshqirin dhe e hodhi në sup. Ngriti kutinë e duhanit dhe e futi në palat e brezit. Ngriti qeleshen e bardhë, rrethuar me peshqirin e bardhë dhe e vuri në kokë. Siç ishte, këmbëkryq, më parë çliroi njërën këmbë dhe e lëshoi mbi çimento. Po me atë gjest e ritëm lëshoi këmbën e dytë. Për një çast kërkoi llullën në brez, por nuk e gjeti. E kërkoi në stol, por as aty nuk e pa. Atëherë u kujtua: llullën e kishte në gojë. E thithi fort dhe fytyra — kobure me çark të ngrehur humbi midis shtëllungave. U ngrit e, duke u tundur mbi këmbët e gja-



ta, la prapa fjollat e tymit, që mbetën një copë herë pezull në rrugën e ngushtë midis stolave.

Përtej dritares u duk një grup fshatarësh, që vinin drejt shkallëve të prefekturës. Fshatarët bënë zhurmë dhe zhurma jehonte para sallës së përmbarrimit, që ndodhej në katin e parë të prefekturës. Pas pak u dukën përsëri fëmijë, gra, pleq, plaka, djem, e përsëri fshatarë me thasë e torba bosh në krah e gra me kanistra e shporta bosh në kokë.

Paf, kërciti koka e rruar e Qerimit. E hodhi mizën para këmbëve, e shkeli dhe mbërtheu sytë te grumbulli i njerëzve, që lëviznin si valë para prefekturës.

— Qerim! — thirri përmbarruesi plak, zoti Nazmi. — Këtu shiko e jo atje!

— Si urdhëron, zoti Nazmi! — tha ai, po sytë nuk i hoqi nga sheshi.

Jehona e turmës, që kërkonte bukë, futej deri në sallë, ku nuk dëgjoheshin më as pëshpëritjet e njerëzve dhe as zukatja e mizave. Pamja e përmbarruesit të vjetër ishte bërë e paarsyeshme:

— Qerim, këtu shiko e jo atje!

— Djalë i madh e kam pesë muaj pa punë! — tha Qerimi.

— Ti je nëpunës, je shërbëtor i qeverisë dhe s'merresh me politikë! — Zëri i përmbarruesit ishte bërë i ashpër, i paarsyeshëm, si vetë pamja e tij.

— Si urdhëron!

— Ne s'merremi me fshatarët e me punëtorët.

— Si urdhëron, — tha Qerimi me sytë nga sheshi.

— Me fshatarët e me punëtorët merret zoti komandant i xhandarmërisë, — tha përmbarruesi. Dhe shtoi: — Kapiten Shaban Sinani!

— Si urdhëron!

Turma u rrokullis e ngjeshur dhe u fut në rrugën e ngushtë me zhurmë e me rrëmbim, si një lumë i gjerë midis dy shkëmbinjve. Iku. Iku drejt Sheshit të Pazarit. Drejt depove. Atje ushtoi nëpër qiell jehona e saj, si jehona e urisë.



— Qerim, makinën mbi banak, — tha përmbaruesi.

Kur «Singeri» qe ngritur mbi banak, përmbaruesi plak shikoi çmimin në listë, ngriti çekiçin dhe thirri:

— Një dollar!... — Por në çastin kur shqiptonte rrokjen e fundit, ai kishte parë t'i afrohej përsëri banakut Faredini nga Kosova. Me përvojën e një nëpunësi të vjetër të përmbarimit, diçka kishte lexuar në pamjen e tij, diçka jo të zakonshme, sigurisht.

Faredini nga Kosova e arriti banakun pa shikuar njeri dhe tha:

— Librat! Ja, qeto! — dhe vuri pëllëmbën e madhe mbi librat.

— Librat? — pyeti përmbaruesi i befasuar.

— Librat e toskës, që ka shkruar për Skënderbegun! Sa pare duhen? — pyeti prapë me ton të rëndë, si për ta sjellë në vete përmbaruesin e vjetër.

— Janë vepra të Naim Frashërit!

— Sa pare duhen, bre zotni?

Përmbaruesi kërrusi kokën në listë. Si çmim filles-tar ishte shkruar pesë lekë, por ajo diçka jo e zakonshme që kishte parë e që kishte nuhatur te Faredini nga Kosova, e nxiti të bënte një kapërcim të habitshëm:

— Njëzet e pesë lekë! Një dollar!

Nëpër sallë fluturoi një uturimë habie.

— Një dollar! — tha kosovari emigrant.

Përmbaruesi plak ngriti çekiçin dhe thirri:

— Një dollar. Një herë!

Kosovari emigrant thithte llullën dhe shikonte çekiçin e përmbaruesit.

— Një dollar! Dy herë! — Tashti zëri i përmbaruesit kishte marrë një timbër të ri, një nuancë të re, timbër e nuancë profesionale.

Salla heshte.

Kosovari emigrant thithte llullën.

Rreshter Ago Agoja shikonte me inat xhandarin e ri.

Xhandari i ri nuk e hiqte vështrimin e paturpshëm nga Daklea.

Daklea ishte ngjeshur pas Mentarit. Mentari shikonte Daklean. Dhe turma shikonte gjithçka.



— Një dollar! Tri herë!

Çekiçi ra mbi banak.

Paf, kërciti tulla e Qerimit. Kësaj radhe ai nuk mjaftoi që e kishte vrarë mizën, por pasi e hodhi në tokë, e shkeli edhe me këmbë.

— I gëzofsh! — tha përmbaruesi plak.

— Gëzim paç, — tha kosovari emigrant.

— Ulu, — iu lut përmbaruesi plak. — Sa të bëjmë formalitetet!

Pas pak kosovari emigrant hodhi mbi banak pesë franga, mori një dëftesë, ngriti librat dhe u kthye nga Mentar Dika.

— Merri! — tha.

Mentar Dikës iu çel fytyra, por vetëm për një çast.

— Axhë Faredin, prapë do të m'i marrin, — tha ai, — është e dyta herë që m'i sjellin këtu.

— Librat jo! — tha kosovari emigrant. — Mos lejo të t'i marrin!

— Kreditori dhe xhandarët! — tha Mentari.

— Bjeru me pushkë tika-a-au-u-u!

Tashti ai qëndronte përballë Mentar Dikës me shprehje të qetë dhe kjo qetësi thuafe bënte punën e një muri mbrojtës ndaj botës së ligë dhe armiqësore që i rrethonte, vlente të kuptohej gjithashtu se ai kosovar ishte mësuar që të kegen ta pranonte si një gjë të pashmangshme, pa të cilën, fundja, as jeta vetë s'do të kishte kuptim. Por, me ta pranuar e me t'u shfaqur e keqja, e gjithë qenia i kreshpërohej, i ngrihej në këmbë për ta përballuar atë të keqe, për ta shtypur e për ta zhdukur krejt. Pastaj, dalngadalë, shprehja e fytyrës së tij u bë çuditërisht e dashur dhe e shkujdesur. Dhe tashti ai qëndronte me nurrin e një njeriu të madh, ku çdo pjesë e gjymtyrë e trupit, çdo qelizë e çdo kockë dukej si e ndërtuar me gurë qiklopikë. Së fundi, ai nguli shikimin e zgjuar në sytë e Mentarit. Dhe në atë shikim të thellë e të gjatë, plaku nga Kosova, komiti i hershëm, heroi i Kaçanikut, sikur hetoi një vendim të heshtur në sytë e trazuar të Mentar Dikës, një vendim që të kujtonte betejat e që ishte akoma



i fshehtë, po megjithatë ishte vendim, dhe bile tronditës, që priste rastin e kohën të dilte sheshit.

— Na, merri! — Tashti vështrimi i Faredinit nga Kosova ishte ngulur te librat, thithte llullën dhe shikonte vetëm librat.

Mentar Dika lëmoi lehtë mustaqet e shkurtra me pulpat e gishtave (sepse tjetri ia kishte kapur mendimet e fshehta), i mori librat nga duart e Faredinit dhe po atë çast, vendimi i fshehtë dhe i pashprehur akoma, sikur i doli në sipërfaqe, sikur iu ngul në çdo tipar të fytyrës së ngurtësuar.

Tha Faredini nga Kosova:

— Kështu, bre, të lumtë! — dhe pamja e tij thatime shëmbëlleu sërish me një kobure çarkngrehur. Pastaj koburja kaloi tytën gjatë banakut, mbi rreshterin e vjetër, mbi xhandarin e ri e mbi rreshtin e xhandarëve në fund të sallës dhe mori rrugën midis stolave. Te porta qëndroi, u kthye ngadalë, hodhi vështrimin nëpër popull, i shikoi të gjithë dhe aty nga radhët e fundit i ra në sy i biri.

— Këtu qenke, Habib?

— Këtu, babë!

— Nuk e bleva makinën për gruen tande!

— E di, babë! — tha i biri me ton miratues.

Faredini nga Kosova hipi mbi prag me të dyja këmbët, u kthye i tëri nga salla e, megjithëse i kërrusur, u duk i gjatë sa një hata. Balli i gjerë, bashkë me vështrimin e përqendruar, e tregonin jo vetëm të zgjuar, jo vetëm të zemëruar, të hidhëruar e të papërkulur njëkohësisht, por edhe nga ata që kanë parë e kanë hequr shumë, edhe nga ata që dinë të jetojnë e që dinë t'i përshtaten çdo rrethane, pa hequr e ndryshuar një qime nga parimet e nga medimet e veta. Tha:

— Atij që ju gërget, bjerini me pushkë, tika-a-au-u-u, dekë në vend!

Heshtje. Dhe kosovari emigrant u zhduk prapa hesh-tjes. Fill pas tij lëvizti Habibi. Edhe ai, si një kopje besnikë e të atit, u ngul mbi prag i kthyer nga salla, me ndriçimin e mesditës mbi shpatulla. Rrudhat e nxira rreth syve iu bënë më të thella, iu fry damari në ballë, i shkrepiti



e bardha e syve, po megjithatë, vështrimi i mbeti i qartë, i qetë dhe i vëmendshëm. Tha:

— T'u mirë mbeçi! — dhe u zhduk pas të atit, prapa derës së përmbarimit.

... Disa orë më vonë nuk ishte shitur asgjë tjetër dhe salla gati ishte boshatisur. Pastaj erdhi përsëri aty zotëria me kapelë, që i bleu toptan, të gjitha toptan, ç'kishte mbi banak e nën banak për tetë dollarë, përfshirë edhe makinën qepëse «Singer». (Kështu kishte ndodhur gjithmonë: më në fund i blinte Veniamin Çeku përmes përfaqësuesit të vet.)

Bashkëshortët Dikë, me librat në dorë e me një dëftesë, që vërtetonte shitjen e mallit dhe shlyerjen vetëm të një pjese të kështit të dytë, u nisën për në shtëpi, por, para se të kaptonin pragun, përmbaruesi plak i paralajmëroi:

— Që nga kjo ditë, zoti Veniamin Çeku gëzon të drejtën për ta shitur vilën tuaj në ankand!

Pasi u tha këto fjale, ai ngrii sytë në qiell (në tavan) me pamje të zbutur, të dhimbsur e plot keqardhje. Idriz furrxhiu dhe Sali kafexhiu (njëri me plagë në fytyrë e me breshkat e shqetësuara mbi hundë, tjetri me sy të skuqur e qepallafryrë), që kishin qëndruar aty deri në fund, u shikuan sy në sy, dolën jashtë, pastaj furrxhiu tha:

— Ti, Sali, e di që unë s'para jam përzier në politikë. Ty sikur të qeshi pak nuri gjatë kohës së Fan Nolit. Kurse unë gjithmonë kam parë vetëm punën time, shtëpi e furrë, furrë e shtëpi. Edhe nipi më thoshte, ç'njeri je ti, dajë, ty sikur s'të ecën gjak, por ujë. Unë i thosha, rri o çun, se bejlerët mbi kokë do t'i kemi gjithmonë. Kjo është politikë e vjetër, më thoshte nipi. E vjetër e re, i thosha unë, kaq di daja. Po vërtet, Sali, sikur më paska pasë rrjedhur ujë nëpër damarë e jo gjak. Hej, rini!

Kaq, pastaj secili iku në punë të vet.

Dielli ishte ulur. Njerëzit ktheheshin të hanin darkë e të mbylleshin brenda (gjendja e jashtëzakonshme). Nëpër mure ishin shumëfishuar shpalljet me shkronja të



zeza: Për kokën e rebelit Genc Boga 2000 fr. ar. Fotografia e Gencit me ballin e drejtë e flokët e çelët i shikonte në çdo dhjetë metra. E në çdo dhjetë metra lexohej shpallja tjetër: **Kush strehon rebelin Genc Boga, pushkatohet në vend...**

Bashkëshortët Dika shpejtuan hapin. Vila ishte afër, por edhe përëndimi. Te varoshet përballë portës, Daklea ndjeu dobësi dhe u mbajt te krahu i të shoqit. Ishte e lodhur, nuk ecte, gati lundronte, aq e lodhur ishte.

## V

Të nesërmen në mëngjes letërshpërndarësi i zyrës së përmbarrimit ngriti gjyzlykët e vjetër, por ata i ranë prapë në majë të hundës. Dhe ai, si ta dinte më parë se kjo gjë do të ndodhte dhe se ishte krejt e domosdoshme, mbeti i kënaqur.

— Ja, këtu, — tregoi me gisht.

Daklea vuri firmën me dorë të dridhur.

Plaku i dorëzoi lajmërimin, ngriti gjyzlykët nga maja e hundës, bëri një gjest që ia ndryshoi shprehjen e fytyrës nga kënaqësia në keqardhje dhe tha:

— Çdo ditë... çdo ditë, nuse... e njëjta gjë... mandate... mandate!... — U mbush thellë me frymë dhe çalë-çalë mori rrugën e kthimit përmes varoshit. Qëndroi: — Nuse, e kishe njohur çunin e Tahir Balliut?

— Po, xha Istref!

— Helmoi veten qyqari sot në mëngjes, disa minuta pasi i kishin dhënë mandatin për shtëpinë. Edhe ai si ju,



me Veniamin Çekun e kishte punën. Helmoi Vetën! — tha plaku i pikëlluar dhe hoqi këmbët zvarrë.

Me të lexuar rreshtin e parë të lajmërimit, që bënte fjalë për shitjen e vilës në ankand javën e parë të shtatorit, Dakleas gati iu morën mendtë dhe u mbështet pas kanatit të rëndë të portës. Qëndroi ashtu symbyllur më se një minutë, e bindur se kishte humbur aftësinë për të gjykuar e për të shikuar. Edhe dritat e buta të mëngjesit, që i kujtonin vitet e rinisë, të cilat janë gjithmonë të bukura, pikërisht sepse janë vite rinie, atë mëngjes nuk e nanurisinin, përkundrazi, e bënin të ndihej më e kapitur nga pesha e rëndë e apatisë; edhe aroma e trëndafilave, që ngopte ajrin e oborrit dhe që ishte aq e njohur e aq familjare për Daklean, atë ditë i dukej se kishte diçka të huaj, diçka nga aroma e varrezave, ku ajo shkonte herë pas here për të mirëmbajtur varrin e së ëmës e të të atit; e ngaqë ishte vetë e lodhur, i lodhur iu duk edhe zëri i kumrisë që këndoi mbi një degë të arrës së madhe dhe që tashti fluturoi e trembur, duke lënë pas vetes një shigjetë gri. E lodhur iu duk edhe gërvima e çikrikut të pusit, ku njëri nga fëmijët po mbushte ujë.

Pastaj Daklea u largua nga porta. Ajo u përpoq të normalizonte hapin, të largonte kaosin që kishte në kokë dhe të vendoste rregull në mendimet e veta, të vendoste radhë e ritëm. Kur ngriti sytë, befas u gjend pranë Genc Bogës, ulur në një stol të paradhomës. Ai, si të kishte kuptuar diçka, e la mënjanë revolen që pastronte dhe gati me pahir mori nga duart e Dakleas atë copë letër të bardhë, që ajo e kishte palosur me kujdes. Si e këputur nga gjunjët, Daklea u ul në stolin përballë tij.

— Ç'do të bëhet më vonë? — pyeti ajo me zërin e një njeriu gati të mundur.

Nga drejtimi i atij zëri, Genc Boga e kuptoi se vështrimi i Dakleas ishte ngulur në fytyrën e tij. Përderisa do t'i duhej të mblidhte e të gjente fjalët e nevojshme, hëpërhë ai mendoi t'i bënte një thirrje: «Daklea!» por as atë nuk e bëri. Ajo thirrje i mbeti vetëm në ndërgjegje. Në të vërtetë Gencit i vinte edhe keq edhe mirë, kur shikonte Daklean të merrte frymë me trishtim të plotë,



ndërsa në cepat e buzëve t'i skicohej një rrudhë e egër revolte.

— Dëgjo, — tha ai, — ditët e para, kur pashë hijen e vdekjes të më ndiqte këmba-këmbës, m'u errësua bota, m'u errësua gjithçka dhe, ë beson, dy herë me radhë e ktheva tytën e pushkës drejt zemrës. Kur e mendoj tash-ti, them ç'gjë e tmerrshme është ta quash veten të mundur, të biesh poshtë e të dorëzohesh! — Lëkura zeshkane gati ngjyrë ulliri e fytyrës së Gencit, flokët e shkurtër e të çelët dhe sytë gri në ballin e drejtë, — të gjitha këto tipare, tashmë i kishin dhënë fytyrës së tij një pamje të vendosur e të prerë, aq sa e detyroi Daklean të thoshte me vete se «mysafiri i rebeluar», siç e quante ajo, dipte të mbahej me dinjitet. Në të vërtetë asaj i pëlqente optimizmi i tij, i pëlqente thjeshtësia, i pëlqente edhe kur ai e shikonte me afërsi të atillë, si të ishin lindur e rritur bashkë. E gjithë pamja e tij, i gjithë trupi i tij, që nuk ishte i zakonshëm dhe që i ngjante një shkëmbi të latuar, e detyronin Daklean të ndihej plotësisht nën pushtetin e «mysafirit të rebeluar».

— Kam dashur të bëj një bisedë me ty! — tha ai dhe u ngrit nga stoli, po kur u ngrit, u duk sikur copa e shkëmbit mezi u shkëput nga toka, mezi u rrokullis, mezi eci. Eci lart e poshtë nëpër dhomën e zbrazur, ku s'kishte veçse një stol, stoli ku qe ulur ai, një stol tjetër, ku ishte ulur Daklea, një tavolinë pa mbulesë e ndonjë orendi, që u kishin sjellë e vazhdonin t'u sillnin fqinjët. — Një bisedë të shkurtër!

— E marr me mend, biseda jote do të jetë për... — Ajo deshi t'i thoshte për frëngjitë, për çardakun, që e kishin bërë si fortifikatë e për të tjera gjëra të përafërta me frëngjitë, me çardakët e me pushkët. Ai e shikonte drejt në sy: ajo kishte filluar prapë të shqetësohej. Genci vuri në gojë një cigare, e ndezi dhe e thithi thellë.

— Pse i shmangesh kësaj bisede?

Ajo heshti.

— Dy fjalë, — tha ai.

— Për çfarë? Për pushkët, për frëngjitë, për çardakun? — Më në fund Daklea nuk e përmbajti veten.



Ai e shikoi pak i çuditur.

— Po, — tha, u ul dhe befas i vuri dorën në gju. Dorra e tij ishte e madhe, e rëndë, e ngrohtë, po Daklea nuk lëvizti, nuk u tronditi: si grua, ajo e kishte kuptuar se Genc Boga nuk dinte dhe as ishte i ndërgjegjshëm ku e kishte mbështetur dorën.

— Ti e di që unë erdha këtu për t'u lidhur me ju, për t'i dhënë rrugë çështjes sonë. Tashti ne e kemi pothuaj të qartë se ç'na mbetet për të bërë. Po ti e di, gjithashtu, se unë kam ardhur këtu edhe për një çështje tjetër, dua të zbuloj të vërtetën për vrasjen e Veteranit të Luftës dhe të fshatarit që e strehonte. Për të zgjidhur këtë të vërtetë, do të më duhet të takohem me Kristin, djalin e Folta Papit dhe, po të jetë se ai del fajtor, po të jetë se ai ka tradhtuar, atëherë unë do ta dënoj dhe dënimin do të jem i detyruar ta zbatoj menjëherë në vend.

— Ta vrasësh? — pyeti Daklea.

— Si mendon ti, në qoftë se ai ka tradhtuar, a mund të falet? — Kësaj radhe u duk sikur zëri i ri pozitiv ishte ushqyer nga trupi i tij i ngjeshur dhe i fortë, nga shkëmbi i latuar.

Daklea u mendua gjatë.

— A mund të falet tradhtia? — nguli këmbë ai.

— Jo, — tha më në fund Daklea, — por s'mund ta vrasësh në prani të së ëmës!

— Unë do ta ekzekutoj tradhtinë, fundja, në kushtet që kam e jo në kushtet e dëshiruara. Por duhet të dish edhe një gjë. Tezja ime, po ta marrë vesh tradhtinë e të birit, nuk është nga ato që ta fal një faj të tillë. E megjithatë ajo është nënë, dhe unë do të përpiqem që flaka e revoles sime të mos përcëllojë sytë e saj. Po Kristin nuk mund ta fal vetëm sepse në shtëpi ndodhet e ëma. Kjo është kryesore. As nuk mund ta shtyj dënimin. Se pastaj mund të jetë vonë. Janë rrethanat që më nxitin të veproj me shpejtësi. Ti e di, kur u ndamë me Kristin buzë greminës, unë i dhashë emrat e katër fshatarëve pjesëmarrës në revolucion. Ai fjeti në tre prej tyre dhe ata rrezikohen të gjitha tashti. Para disa ditësh Kristin e nxorën nga spitali, ku i shëruan plagët e torturave. Po xhandarmëria



nuk do ta lërë për shumë kohë të qetë. Do të fillojnë gërr-mërr, derisa t'ia nxjerrin të gjitha. Por... një herë që provova të arrija deri në shtëpinë e tij, që e pamundur. Megjithatë, erdhi çasti. Së shpejti ata do të festojnë shpalljen e monarkisë dhe, duan apo s'duan, do të detyrohen t'i japin fund gjendjes së jashtëzakonshme. Atëherë... – Genci bëri një shenjë, që donte të thoshte se tradhtari jetonte ditët e fundit. Pasi një heshtje e gjatë. Sytë e tij gri ishin bërë të padepërtueshëm, si sytë me jetë e pa jetë të statujave.

Kur Daklea pandehi se Genc Boga s'kishte më asgjë për t'i thënë, befas dëgjoji sërish zërin e tij:

– Më është mbushur mendja se duhet të jemi më të fortë e më të vendosur, përndryshe do të bëjmë një gabim të pafalshëm ndaj çështjes që na lanë trashëgim baballarët tanë. Armiqtë vërtet e përmbysën Revolucionin e Njëzetekatrës, por idetë e tij mbetën të gjalla. Revolucioni, ashtu si vila juaj, hëpërhë ndodhet në periferi, po fryma e tij përsëri do të ngrihet dhe populli, që sot është me ne vetëm në heshtje, nesër s'ka pse të mos ecë përkrah nesh, përderisa shtypja është bërë më e madhe, çifligarët më të egër, uria e varfëria më të thella. Kur ai të ngrihet përsëri, siç u ngrit katër vjet më parë, atëherë Zogu e kushdo tjetër qoftë, s'do ta kenë të gjatë. Po frymën e kësaj kryengritjeje e kemi ne për detyrë ta mbajmë të gjallë dhe mua më bëhet sikur i shoh me sy brezat që do të vijnë pas nesh e që, sipas meje, do të bëjnë më shumë se ne. Çfarë e si do ta bëjnë, do ta bëjnë vetë apo bashkë me ne, këtë unë nuk e di dhe kjo është tjetër çështje. Por di që diçka po zien nëpër botë dhe bota do të ndryshojë, siç ka ndryshuar vazhdimisht.

Ata rrinin përballë njëri-tjetrit dhe që të dy nuk folën një copë herë. Daklea, nga ana e saj, mendonte se afërsisht këto fjalë i kishte dëgjuar edhe më parë nga Mentari, po në gojën e Gencit ato kishin një tingëllim tjetër, tingëllimin e vetë brezit më të ri, që po përgatitej të merrte përsipër e ta çonte më tej çështjen e revolucionit. Kurse Genci nga ana e vet mendonte më thjesht: ishte hera e parë që ai transmetonte fjalët e njërit prej

udhëheqësve të Revolucionit, dëgjuar atë natë të Njëzetekatrës, kur i sollën në shtëpi të atin të sëmurë rëndë.

— Janë tendosur telat! — e theu prapë heshtjen Genc Boga. — Nuk di se ku e kam lexuar, po në një libër shkruhej se dikur tendosja e telave të violinës ka qenë më e vogël. E di pse? Ata u tërhoqën paralel me tendosjen e nervave të njerëzimit. Hë, a s'është e çuditshme?!... — Genc Boga e bëri shuk lajmërimin për ankandin e shtëpisë së Dikëve, që i kishte mbetur në dorë dhe e hodhi përtej dritares, ku një fragment i kopshtit dhe i qiellit dukej si dekor me ngjyra të ndezura.

E ndërkohë, fytyra e Dakleas, që ishte një fytyrë e zbehtë, por e ngrohtë, fytyrë e një gruaje që kishte mbetur gjithmonë pak fëmijë, sikur kishte humbur bukuri-në, ëmbëlsinë dhe tërheqjen e zakonshme, sikur ishte bërë më e ashpër e më e guximshme.

## VI

Kështu i kaloi ajo ditë Dakleas, derisa u ngrysoi. Në mbrëmje pati sërish lëvizje të jashtëzakonshme të fqinjëve. Si në kohën e sekuestrimit, fqinjët hynin e dilnin, asnjëherë bashkë (se ashtu duhej, se ashtu e kërkonin rregullat e fshehtësisë spontane, se e tillë ishte koha), bisedonin për gjëra të ndryshme e për çfarë nuk bisedonin, por vetëm për ankandin e vilës, që ishte edhe shkaku i këtyre vizitave, nuk thoshin asgjë. Më të guximshmit shanin ligjet, nëpunësit e lartë, çifligarët dhe fajdexhinjtë, kujtonin me mall Revolucionin, që s'kishte jetuar gjatë dhe uronin të bëhej siç ua kërkonte zemra,



uronin të vinin ditë më të mira. Pastaj largoheshin, duke thënë se plaka ose gruaja kishte bërë një lakror, ëmbël-sirë etj. dhe ata u kishin sjellë pak sa për ta provuar. Dhe ecnin përmes varosheve, drejt grumbullit të shtëpive të fundit të qytetit, duke u shkëmbyer me një tjetër siluetë, që shkonte drejt vilës së Dikëve, sikur e gjithë kjo lëvizje të drejtohej nga një dorë e vetme, nga një dispeçer i stërvitur, që s'lejonte të takoheshin dy veta bashkë. Kjo fillonte me hyrjet e daljet e më të rinjve, vazhdonte me burrat e gratë e në fund fare, në orët e vona të natës lëviznin pleqtë e plakat, që s'para kishin gjumë, që rrinin më gjatë, që uleshin këmbëkryq në verandë e brenda në vilë, por edhe në oborr uleshin dhe aty, në dritën e hënës ose të llambës me vajguri, të rrethuar nga hijet e nga zhurmat e natës, shtroheshin në biseda të gjata, duke filluar nga turqit, te Princ Vidi, Esad Pasha e deri tek Ahmet Zogu. Boshti dhe kuptimi i këtyre bisedave ishte se asnjë gjakatar, cilido qoftë ai, dhe asnjë të huaji, cilido qoftë ai, nuk do t'i zinte këmba dhë e nuk do të bënte kurrë hair. Kishte nga ata që bisedonin, bie fjala, edhe për Haxhi Qamilin, tregonin histori që i kishin parë me sytë e tyre, tregonin për vrapin e bejlerëve sapo ndienin erën e ushtrisë vullnetare të këtij fshatari të varfër nga rrethi i Tiranës. Kurse për Revolucionin e vitit 1924, ata bisedonin si për një ngjarje që kishte ndodhur të djeshmen, tundnin kokën të dëshpëruar dhe heshtnin me një heshtje që fliste më shumë se çdo fjalë.

E fundit fare edhe atë natë erdhi përsëri plaka Deje, e cila, pasi tha «Subhane allah, mjaltë e qumësht!», bëri zakonin e saj që e kishte bërë tërë jetën (e s'i fyhej askush), d.m.th. nxori xhezven, bishtin e së cilës e fuste si revole në ushkurin e çitjaneve, vuri përpara qeskën e sheqerit dhe qeskën tjetër të kafes dhe tha:

— Nuse, na ban një kafe!

Dhe, kur i zbrazti të gjitha shprehjet e mallkimit ndaj të gjithë atyre, të cilëve u «kishin zënë sytë dhjamë», pasi shau mbarë e prapë, me rrënjë e me degë bejlerë e turq (këta të fundit i kishin vrrarë djalin e madh pe-



sëdhjetë vjet më parë), u ngrit e iku me duart prapa kryqeve, duke thënë më se një herë:

— Subhane allah, mjaltë e qumësht!

Kështu mbaroi edhe kjo natë e jashtëzakonshme, për t'ua lëshuar pastaj radhën vizitave dhe hyrje-daljeve të zakonshme fqinjësore, të cilat as shënohen, as shkruhen dhe as vihen re.

Por, si të ishte një vijim i pashkëputur i këtyre vizitave, një mëngjes në oborrin e vilës u çapitën nja dhjetë ish-nxënës dhe nxënëse të Dakleas.

E ulur në mes tyre, nën hijen e arrës së madhe, dalngadalë Daklea sikur zuri të shkëputej nga bota e nga hallet e përditshme, vështrimet e saj sikur dilnin nga brendësia e qenies dhe derdheshin jashtë në gjysmërrëthin e të vegjëlve. Kur dëgjoi e kur kuptoi se kishin qenë mësuesit ata, që u kishin thënë nxënësve se ish-mësuesja e tyre kishte ditëlindjen (28 vjeç), që u kishin dhënë lulet dhe i kishin nxitur të vinin aty, Dakleas iu zbërthye goja, fjalët i rrodhën me lehtësi dhe kjo ngjarje e vogël sikur ndodhi për t'i kujtuar se, përveç jetës së rëndë e të mbyllur, që ajo bënte prej dy vjetësh, ekzistonte edhe një tjetër jetë, të cilën Daklea gjithashtu e njihte mirë. Por, kur ajo e kishte kaluar fazën e vështirë të takimit me ish-nxënësit, që duke i hapur plagë të vjetra po i shëronin të rejat dhe kur ajo ndjeu ngrohtësinë e cicërimave të tyre të gëzuara, befas, nga thellësi e qenies iu ngrit një si brengë e re, e vogël vërtet, bile fare e vogël, por e rëndë për shpirtin e saj të lënduar prej vitesh: me çfarë do t'i gostiste të vegjlit, që kishin ardhur për t'i uruar ditëlindjen? Ajo vazhdoi të bisedonte me ta, të bashkonte, të diferenconte e të krahasonte karakteristikat e tyre, që ua mbante mend akoma, pa harruar se kishte ardhur koha t'i gostiste, kur befas dëgjoi hapat e njohura e të ngadalta të Teli Basharit. Me t'u gjendur pranë, ai sikur bëri një përpjekje për t'i mbledhur në një pikë të vetme të gjithë ata kubikë e rombe të shpërndara nëpër fytyrën e plakur, hodhi vështrimin rrotull, i përshëndeti nxënësit, u tha ndonjë shaka e



i përkëdheli dhe pastaj futi dorën në xhep, prej nga nxori një letër me karamеле...

Disa minuta më vonë fëmijët zunë të luanin nëpër kopsht e nëpër varoshe bashkë me Gimin, me Letën e Katin dhe pastaj u larguan. Daklea lëshoi një psherëtimë gati tingëlluese, ku ndihej edhe kënaqësia që ajo kishte provuar me rastin e vizitës së ish-nxënësve, edhe hidhërimi që provonte tashti, kur kishte mbetur pa ta.

Dhe kështu, gjëma që kishte sjellë atë mëngjes mandati për ankandin e vilës, me orët e me ditët që kishin kaluar, gati ishte ftohur. Një mbrëmje Daklea i tha Mentarit:

— Mua më duket sikur s'ka ndodhur asgjë me ne, E di pse? Sepse askush nuk përfilli të na fliste për ankandin!

## VII

Daklea, që eçte trotuareve, ndiente t'i fshikej fytyra nga një erë e lehtë freskuese dhe kjo freski vlente për t'i kthjelluar disi mendimet. Sytë e saj ruanin një vezullim të zbehtë, tek digjeshin si sytë e një të sëmuri, kur sapo ka kaluar një krizë.

Nëpër rrugë kishte lëvizje, ngrihej pluhur dhe rrezet e hënës humbisnin në një mjegull tymi të hirtë, ku llambat elektrike mezi ndriçonin një rreth të vogël. Tashti që gjendja e jashtëzakonshme ishte hequr, të dukej sikur i tërë qyteti kishte dalë jashtë për të gëzuar lirinë e rifituar. Dëgjoheshin thirrjet e atyre që shitnin meze me pite,

fruta e çikërrima të përdorimit të përditshëm, por edhe stoli të vogla, aq në modë për gratë e asaj kohe. Qyteti N mund të ishte qyteti më i përgjumur i botës. Dhe ishte. Por papritmas, nga një diçka, që në fillim do të të dukej fare e zakonshme e fare pa rëndësi, mund të bëhej qyteti më zhurmëmadh e një ndër më të gjallët e botës... Dhe ja: atë mbrëmje, përveç karrocës së Memës, që vazhdonte punën për pastrimin e qytetit deri në orët e vona të natës, edhe Bido Peshti i kishte dhënë bashkisë (me qira, sigurisht) karrocën e Otellos, se pléhrat ishin të shumta, kurse pas dy ditësh shpallej monarkia dhe mbreti i Shqipërisë ose i shqiptarëve, si do të quhej ai... Otelloja, dihet, e kishte kalin të shpejtë, por edhe karrocën më të re se të Memës, prandaj për çdo ecejak të Memës, ai bënte tri. Po Mema që e hiqte veten për njeri të drejtë, e kishte paralajmëruar Otellon se do të thyente kokën me atë të ecur të shpejtë dhe nuk vonoi që fjalët e profetit Memë të vërtetoheshin.

Pikërisht në ato çaste, kur karroca e Memës (nënkupto Hana e Memës) kishte qëndruar për pushimin e saj të famshëm, kur kamxhiku i Memës vërtitej qesim nga prapa për të trembur qentë që derdheshin rrugicave si Niagarë e vogël, duke fërkuar thonjtë pas kalldrëmit, u dëgjua një rrapëllimë, si të rrokulliseshin njëqind fuçi bashkë. E kur njerëzia kërcyen trotuareve, për të mos rënë nën qemerët e Otellos, rrapëllima u ndërpre menjëherë, njerëzit panë Otellon të fluturonte përprjetë e një çast më vonë të mbahej si macja me thonj pas një shtylle telefoni, panë gjithashtu karrocën të gremisej e të përsheshej si një grumbull hedhurinash, panë kalin me pallëm të këputur, të qëndronte në këmbë mbi trotuar, të ngrinte veshët e vegjël dhe të rrihte vithet me bisht, panë edhe një-rën nga rrotat të vazhdonte rrugën e saj, pastaj, befas, të shmangej, të ngjitej mbi një prag e, si pa të keq, të futej brenda në dyqanin e një tregtari të madh. Kjo ngjarje shkaktoi, siç pritej, rrapëllima e bubullima të tjera, që erdhën nga ajo e qeshur e përgjithshme, nga ato britma gëzimi të papritura, po të mos llogaritim shamatën që ngritën tregtari dhe çirakët e tij kundër rrotës e kundër



Otellos së pacipë, shastisur e mbërthyer pas shtyllës së telefonit.

Në kohën kur «mbarë» qyteti qeshte, po aty afër ndodhi edhe një ngjarje tjetër e jashtëzakonshme. Befas, Hana, që po bënte pushimin e saj (të famshëm), e ngriti vetë kokën, pa ndihmën e Memës (gjë e rrallë) dhe rrotulloi qafën e hollë e të gjatë si të një gjirafe. Përbri saj kishte kaluar një dori, qimja e të cilit shkëlqente nga shëndeti dhe rinia. Doriu, që ishte kalë shale e që kishte mbi vete një zotëri, kaloi pa e vënë re fare Hanën e Memës. Po Hana e Memës rrotulloi sytë, duke e ndjekur doriun qimendritur me vështrimin e saj të etshëm për diçka misterioze. Atëherë Mema e pa të nevojshme të bënte ndërhyrjen e tij, d.m.th. ta zinte Hanën nga mëgojza, t'ia kthente qafën drejt dhe t'i pëshpëriste:

— Ec, Hanë, s'është mall për ty ai!

Dhe Hana eci ngadalë, duke hedhur vështrime të trishtuara, e zhytur në ngathtësinë e vet, e zhytur në vetminë e vet të përjetshme, pa një gëzim e pa një ditë pushimi në vit.

Mjaftuan vetëm këto dy raste, si fillim, që «mbarë» qyteti të dilte nga gjendja e dremitur dhe të gjallërohej i tëri.

Ndodhi edhe diçka tjetër. Diçka e vogël. Fill pas gjurmëve të doriut dikush thirri se kishte parë Murron e tërbuar. Thirrja dhe vrapi i tij shkaktuan një stepje të përgjithshme, por ky s'qe veçse një keqkuptim, sepse në të vërtetë ai s'kishte parë Murron e tërbuar, por një tjetër, qenin e zotërisë mbi doriun. Megjithatë edhe ky rast shkaktoi të qeshura e zhurmë.

Daklea Dika ecte anëve të rrugëve, duke u ruajtur të mbahej sa më larg rrëmujave. Por, ç'është e vërteta, kjo ishte pak e vështirë, sepse atë mbrëmje i tërë qyteti kishte marrë vetëm pamjen e rrëmujës. Sidomos atje ku ecte banda muzikore, me korteun e pafund të fëmijëve e të lypsarëve, të të dehurve e të të papunëve profesionistë etj. etj., atje vrumbullitte një zallahi e madhe, shumë e madhe. Pikërisht në këtë zallahi, një fshatar, që kishte mbathur këpucë të rënda ushtrie, kaloi pranë Dakleas me



hapa të gjata prej gamileje dhe një çast më vonë lëshoi një britmë që e detyroi Daklean të qëndronte në vend.

— Tosllum aga!

Tosllum agai, që ishte një burrë trupmadh, i veshur për festë, me jelek të qëndisur me gjymysh e plot gajtanë të kuq, ktheu kokën nga ai që i thirri, u kthye edhe vetë i tëri përballë tij, futi dorën në brez, nxori një dhjetëshe turku, dhe në çastin tjetër dy flakë e dy krisma u ndezën e jehuan pesë metra përballë njëra-tjetrës. Festja e zezë e Tosllum agait u rrokullis deri te këmbët e Dakleas dhe aty ngeci vetiu, sikur këmbët e Dakleas të kishin qenë dëshira dhe caku i fundit i saj. Ndërkaq Tosllum agai kishte rënë përmbys, kurse fshatari me këpucët me gozhdë e me shallvaret e arnuara, me revolen në njërin dorë e me dorën tjetër në supin e gjakosur, vrapoi anës rrugës, pranë bandës ushtarake, përmes Sheshit të Pazarit, që atë natë ndriçonte më shumë se zakonisht dhe pastaj humbi në gjirin e mjegullave të hirta të pluhurit.

Dakleas i zuri veshi një fjalë të cunguar, e cila, sado që u përsërit, mbeti gjithmonë e cunguar:

— Vra... vra... vra...

— Iku! Iku!

Njerëzit u përhapën dhe Sheshi i Pazarit lëvizti, zhurmoi e u duk sikur u zhvendos, sikur u shkëlqy, sikur u rrotullua dhe u bë copë-copë. Kjo pamje dhe të gjitha pamjet e tjera, të kujtonin tashti mbretërinë e nënujshme.

Një patrullë prej dy xhandarësh vrapoi përmes sheshit, duke u rënë bilbilave e duke thirrur:

— Mbajeni, ore, mbajeni!

Pastaj xhandar Kika pyeti:

— Kush shtiu?

Heshtje.

— Ah, vrasje! — tha xhandar Kika.

— Paskan vrasë një aga! — tha xhandar Jonuzi.

— Jazëk u qoftë!

Jazëk!

Ga-ga-ga. Me sa dukej, zhurmat e lëvizjet në vigjilje të monarkisë, i kishin çoroditur patat, të cilat i kishte



zënë nata në shatërvanin e qendrës së qytetit, derisa pasha D e kishte parë të arsyeshme të niste një qehaja për të mbledhur cipëplasurat në saraje.

— Largasu! — bërtiste qehajaj.

Ga-ga-ga...

Daklea doli me shumë mundim nga kjo rrëmujë dhe vazhdoi rrugën për ku ishte nisur.

Për të shtuar gëzimin e festës, nëpër xhamitë e nëpër teqetë ishin ndezur të gjithë kandilat, nëpër kisha bëheshin mesha dhe, vetëkuptohet, ndizeshin qirinj nga mbrëmja në mëngjes. Faleshin për monarkinë demokratike hoxhallarë e besimtarë, priftërinj, shehlerë e dervishë të të gjitha feve e sekteve, rrufainj, bektashinj, krrutë, helvetë, ortodoksë e katolikë etj. Kambanat e kishave jehonin dra-a-ng, dra-ang, dra-ang dhe prapa tyre pluskonin me tinguj të hollë kambanat e vogla, isoja e të cilave kishte qenë dhe kishte mbetur e pakuptueshme për njerëzit e tokës. Kurse nga majat e minareve thërritnin hoxhallarët, me duart prapa veshëve e me fytyrat drejt qiellit, ku yjet vazhdonin të ndriçonin e të këputeshin, duke lënë pas vetes vegimin e tyre të shkurtër, por të bukur.

Te sheshi para prefekturës, pajtimtarët e bashkisë vishnin me dafina ballkonet, shtyllat e elektrikut e të telefonave, bënë harqe dhe flamurët kombëtare valëviteshin kudo me dhjetëra e me qindra, që nga kulmet e ndërtesave, deri te harqet me dafina. Si për të shoqëruar vigjiljen e festës, te ballkoni i degës së Bankës Kombëtare valëvitej edhe flamuri i madh tringjyrësh me sëpatën e fashizmit në krye. Me të parë atë flamur, një ndjenjë trishtimi dhe zemërimi fërgëlloi brenda qenies së Dakleas... kishin kaluar më se dy vjet, kur ajo, pasi kishte bërë apelin, kishte dëgjuar zhurmë në rrugë. Të rinj, studentë e popull kishin ngecur pranë dritares së klasës ku Daklea jepte mësim. Kapiten Shaban Sinani kërkonte që demonstrata të shpërndahej, ai premtoi se do ta çonte zërin atje ku duhej dhe flamuri i fashizmit italian do të hiqej nga ballkoni i degës së Bankës Kombëtare. Dakleas, që kishte dalë në dritare, i bëhej sikur turma po luhatej. Ishin çaste vendimtare kur ajo thirri të mos u besonin fjalëve të Kapite-



nit e kur ajo, pasi doli nga shkolla, u fut në radhët e demonstruesve që ecnin drejt Bankës Kombëtare. Dikush mbështeti një palë shkallë pas ballkonit, po kapiteni nxori revolen dhe kërcënoi se do të vriste cilindro që do të guxonte të hipte atje. Por hipi Daklea. Dhe ndërsa hipte, mendoi se megjithatë kapitenit, si kapadai që ishte, do t'i vinte turp të vriste një grua... Këto kujtoi ajo, ndërsa shikonte valëvitjen e flamurit të huaj mbi kokë. Kujtoi edhe ditën e nesërme, kur e pushuan nga puna, sepse kishte hedhur në tokë flamurin e fashizmit, e tashti, ndërsa ecte përmes sheshit të prefekturës, ndjeu përsëri në brendësi të qenies atë fërgëllimë trishtimi e zemërimi të dy vjetve më parë dhe pastaj shpejtoi hapin.

Përballë klubit *Bristol* Daklea dëgjoi tingujt e një trumbete, që u kthyen në muzikë. Pa aty një turmë të rinjsh, që kishin zënë rrugën përballë klubit dhe pada-shur qëndroi bashkë me kalimtarët e tjerë. Nga klubi doli një krijesë kuqashe, që ngjante me një toptth dhjami, lyer në të kuq, të cilit, në vështrim të parë, nuk i kuptohej as mosha, as seksi. Kur toptthi me dhjamë u ndodh në mes të trotuarit, dy të rinj i vunë përpara një karrige dhe e ndihmuan të hipte. Kuqashi, pa moshë e pa seks, pasi i hodhi turmës së të rinjve një vështrim asgjësues, nxori nga xhepi disa fletë letre me format të vogël, ia bëri me dorë bandës muzikore që të heshte, pastaj shikoi llambën elektrike mbi kokë, si t'i thoshte «Mos më tradhto!». Pasi që vendosur qetësia, ai nisi leximin me një zë, që më në fund mundi të vërtetonte se kuqashi ose toptthi me dhjamë anonte në përqindjen më të madhe nga seksi mashkullor, ose gati mashkullor.

## MANIFESTI I RINISË SË KLUBIT B R I S T O L

*Sot, më 30 gusht 1928, në vigjilje të ditës së madhe të 1 shtatorit, që do të kthehet në ditë historike, ne, rinia e klubit Bristol vend-*



sëm të bëjmë këtë miting, me qëllim që të shfaqim mendimet dhe dëshirat tona lidhur me disa ngjarje të kohëve të fundit.

Nuk është e vërtetë ajo që thonë disa opozitarë se djelmënia jonë qëndron krejt indiferente kundrejt së nesërme. Prej kohësh në radhët tona ka filluar të fryjë një erë e re, që po e shkund rininë nga plogështia e djeshme, që po e bën të ngrejë zërin e saj nën kushtrimin e marshit të punës e të mundit. (Duartrokitje.) Edhe ata pak të rinj, që janë akoma të verbuar pas boshit të unit e nga myku i individualizëmës dhe që u mungon tejpamja, që janë të hutuar nga jeta bastarde, nga luksi e nga dëfrimet e korruptuara, së shpejti do ta ndiejnë përgjegjësinë që jetojnë në një kohë kur s'duhet të ekzistojë as nata e ku e vetmja kryefjalë duhet të jetë përparimi. (Ovacione.)

Ne jemi të mendimit se koha na ka vënë përpara detyra të mëdha, që kërkojnë punë të mëdha. Duhet shkukur nga rrënjët çdo gjë e vjetër dhe duhet ne vetë ta marrim në dorë, ne, njerëzit që kuptojmë ç'është diktatura e ndritur, ç'është Mbinjeriu i Niçes, ç'është monarkia dhe ç'janë idealet e vërteta. Ne nuk e fshehim faktin që jemi pakica e rinisë, ne nuk e fshehim faktin që në këtë miting s'jemi veçse pesëdhjetë veta, por e themi me gojën plot se në të ardhmen do të jemi ne që do të bëhemi barinjtë e këtij vendi të shumëvujtur. Ne jemi të mendimit se populli s'ka nevojë për arsim. Arsimi, kultura, idetë dhe politika janë për ne, përfaqësuesit e rinj të klasave sunduese, për ne, që kemi tokat, dyqanet, shtëpitë, fushat e malet, për ne, që kemi floririn e diamantet, me një fjalë, për ne që kemi gjithë pasuritë e tundshme e të patundshme të vendit tonë. Ne jemi të mendimit se do të ishte e dëmshme që populli të merrej me politikë. Ka turma dhe ka elitë që



ka lindur për të drejtuar këto turma. Dhe dy ditë më vonë, më 1 shtator 1928 do të ketë edhe një mbret, i cili, duke qëndruar mbi elitën, do të drejtojë kombin mbarë në rrugën e lulëzimit e të begatisë. (Duartrokitje. Ovacione.)

Por ka edhe rebelë të infektuar nga idetë e Njëzetekatrës, që lëvrijnë si krimba të fshehtë dhe përpiqen të brejnë trungun tonë të shëndoshë e pastaj të marrin tokat tona, gratë e xhevahiret tona. A e dinë ata vallë se kjo s'ka për të ndodhur kurrë? A e kuptojnë ata se lufta e tyre drejtohet kundër zhvillimit historik të kapitalizmit, të cilin Shqipëria e pret siç pret bujku i mirë shiun e shtrenjtë?... Ja, cilët janë njëfarë Genc Boga e simpatizantët e tij, ose plakut matuf, që gjeti vdekjen disa kohë më parë e që për fat të keq mbante emrin Veterani i Luftës.

Duke shpejtuar përgatitjet për festimet e mëdha të monarkisë demokratike, po e mbyllim këtë miting, të bindur se fara e krimbit nuk është zhdukur, se shpata duhet mbajtur e zhveshur dhe pushka e vajisur. Ne betohemi solemnisht se do të bëjmë të gjitha përpjekjet që dashuria për monarkinë dhe mbretin e ardhshëm august të zërë vendin e merituar në zemrat e në radhët e rinisë sonë.

Poshtë rebelizmi i tipit të Genc Bogës!  
(Rrahje këmbësh në kalldrëm.)

Rroftë mbreti! (Ovacione të gjata.)

Pas këtyre thirrjeve e pas duartrokitjeve, porta e klubit Bristol u hap tejtejt dhe të rinjtë e elitës së qytetit N u zhdukën me zhurmë në brendësi të lokalit, prej nga vërshoi drejt qendrës era e rakisë, e konjakut dhe e shumë alkooleve të tjera. I fundit, i shoqëruar nga një grup të rinjsh, u fut ai, topti me dhjamë, niçeisti i shquar, i rralli Mbinjeri, teoricieni i madh i monarkisë, hapat



e të cilit ishin të shkurtër e të shpejtë, si t'ia kishin shtrënguar këmbët me vida të ndryshkura.

Qielli skuqte nga fishekzjarrët. Muzikat binin. Rruga u hap dhe Daklea, e pështirosur nga kjo ngjarje e nga këto skepa, u largua prej aty, tashmë me hap të shpejtë, për të ecur pastaj në disa rrugë më të qeta, më të ngushta, më pak të ndriçuara, gati të errëta. Papritmas, herë përpara, herë përbrinjë, herë prapa saj u duk ai, njeriu me të zeza, arkitekti, historiani, arkeologu, ekzistenca e të cilit të kujtonte gjithmonë rrugët periferike, vjetërsirat, ku mund të fshiheshin antikitetet, që ishin gjahu i tij i preferuar. Ai ecte, si gjithmonë, me xhaketë të zbërthyer, me gishtat e duarve në xhepat e shumtë të jelekut, gjithashtu të zi, i turbulluar, i hutuar, i mbyllur në vetvete, pa shikuar e pa përhëndetur njeri. Cigarja, që i varej përjetë në cep të buzëve, s'kishte xixa, s'kishte as tym, ishte shuar. Përjetë e shuar.

Kur Daklea arriti te pragu i shtëpisë së shoqes, ajo kuptoi se heshtja dhe gjysmerrësira e rrugicave, por edhe njeriu me të zeza e kishin frikësuar disi. Shikoi rrotull dhe meqë nuk i zuri syri asgjë, bile as njeriun me të zeza, shtyu kanatin e portës, trokiti dhe zëri i njohur pyeti nga brenda:

— Kush është?

— Didi, hape, jam Daklea!

Minutën e dytë, ato u përqaftuan jo në prag të portës, po brenda në shtëpi dhe u ulën mbi një hasër. Minutën e tretë, befas filluan të qeshnin. Kjo ndodhi sepse Daklea kishte ngulur vështrimin te flokët e kreshpëruar të Besnik Sazanit në fotografinë përballë. Kishin një histori më vete ajo fotografi dhe ata flokë. Disa herë me radhë Besniku i kishte lagur dhe krehur flokët për t'i shtruar, por me të kthyer kurrizin foto-lugati (kështu quhej aso kohe fotografi i parë i çastit në qytetin N), pa shikuar mirë tek aparati, flokët e Besnikut kreshpërohehin si më parë. Fundja, ashtu kishte dalë, me flokët për-pjetë si gjembat e iriqit. Ja pse, dy shoqet qeshnin sa herë që u binte në sy kjo fotografi. Por të qeshurat e kësaj

mbrëmjeje, si në një marrëveshje të heshtur, ishin të mbytura.

Tha Didi:

— Mentarit tënd nuk i dhanë fare punë, kurse Besnikun tim e hoqën nga fabrika e alkoolit, pa ia zënë fare në gojë Revolucionin, po gjoja për shkurtime, kurse të nesërmen, pa aguar mirë, e zëvendësuan me një tjetër. Të gjithë ata që morën pjesë ose përkrahën Revolucionin, këtë fat po pësojnë, të gjithë po i heqin nga puna një nga një. Se ç'do të bëhet, një zot e di!

Tashti gazi kishte fluturuar nga buzët, nga sytë e nga fytyrat e dy shoqeve.

— Po si jetoni? — pyeti Daklea.

Në vend të përgjigjes, Didi shikoi rrotull. Me syrin e stërvitur të gruas e me syrin e stërvitur të kohës, Daklea kishte vënë re që në fillim, pa shkelur mirë në prag të dhomës, se edhe në atë shtëpi duhej të kishte kaluar patjetër nëpunësi plak i përmbarimit.

Didi tregoi tezgjahun në qoshe të dhomës. Tha:

— As pëlhurat nuk shiten. Edhe kur shiten, fare lirë.

Tashti vijnë pëlhura të bukura nga Italia.

Tha prapë Didi me pëshpërimë:

— Edhe ato pak para që kishim kursyer, e di ç'i bëri Besniku?

— Ç'i bëri? — pyeti Daklea.

— Pushkë! Bleu një pushkë të re!

— Po atëherë, si?...

— Ashtu, rram-bam, herë shesim, herë na ndihmon ndonjë shoq apo i njohur.

— Ashtu dhe ne, — tha Daklea.

— E di çfarë — thotë Besniku?

— Çfarë thotë?

— Jam gati të dal komit, thotë, po s'di ku të takohem me Genc Bogën!

Atëherë Daklea tha:

— Për këtë punë kam ardhur!

— Fol pra! — iu lut Didi edhe e kënaqur, por edhe e zverdhur.



— Pas dy ditësh, më një sh'ator në mëngjes, te Guri i Bardhë!

— Po me cilin?

— Me Genc Bogën!

— Ah! — psherëtiu Didi e kënaqur dhe e frikësuar njëkohësisht. Pastaj mbështeti kokën në supin e Dakleas dhe u përlot, U përlot edhe Daklea.

Disa minuta më vonë dy shoqet, pasi kishin biseduar më me hollësi për këtë çështje, kujtuan shumë gjëra të tjera nga fëmijëria e rinia e tyre. Prapë mosha bëri të vetën (nuk ishin akoma as tridhjetëvjeçare), prapë qeshën me flokët e Besnikut dhe Daklea, e kënaqur për vizitën që i kishte bërë shoqes, u largua sigurisht, pas një përgjimi të kujdesshëm.

Në një rrugë pranë Sheshit të Pazarit ajo befasi u gjend përballë Idriz Furrxhiut, tek i cili tashti binin në sy më shumë plagët e fytyrës (torturat në postën numër katër), sesa hunda e madhe, si çomage, ngarkuar e shtrembëruar nga tërë ato breshka, që thepiseshin njëra mbi tjetrën.

— Nuse, në këtë gazetë të kam mbështjellë dy bukë!

Dakleas i erdhi turp t'i merrte bukët. Tha:

— Mua më ndodhet një dorë miell!

— Merre dhe nisu. Po të jetë për bukë, sa të jem gjallë unë, — ai i ra gjoksit me grusht, — as mos u bëni merak!

Disa minuta më vonë, kur u fut në oborrin e vilës, Daklea ndjeu një lodhje të menjëhershme. U capit deri te shkallët e verandës, u ul në shkallaren e parë dhe fshiu djersët e ftohta me mëngën e fustanit. Me t'u futur në ambientin familjar, me të dëgjuar dhinë tek ripërtypej krap-krap-krap, ajo kujtoi se fërgëllima që e kishte ngacdhoej, po ngiitej lart dhe po dilte mbi qenien e saj. Si për shoqërim idesh, lulet e oborrit, të ndriçuara nga hëna vetëm nga njëra anë, iu bënë sikur të gjitha kishin kthyer fytyrën nga ajo, si dikur ish-nxënësit e saj të parë, kur drejtori, pasi e paraqiti, e la vetëm për vetëm me ta.

E po ky shoqërim i kujtoi Dakleas edhe lëvizjet e kota që ajo kishte bërë nëpër klasë për të përballuar emocionet e orës së parë të mësimit... Po ato emocione kishte ndier edhe atë ditë, kur iu lut nxënësve të rrinin urtë, ndërsa vetë shkoi pas demonstratës dhe ngjiti shkallët për të rrëzuar në tokë flamurin e huaj... Me po ato emocione ajo që kthyer edhe tashti në vilë duke menduar se atë mbrëmje sillte dy gjëra: së pari, bisedat me Didin, sidomos për Gencin, Mentarin dhe Besnik Sazanin, së dyti, bukët dhe fjalët e Idriz furrxhiut, por edhe shumë përshypje të tjera.

Ah, po, në rrugicat pranë shtëpisë së Didit si dhe në rrugicat pranë vilës, ajo kishte parë edhe njeriun me të zeza. Po ai, përse dukej sikur e ndiqte nga prapa?

## VIII

Genc Boga u nis për te Krist Papi.

Mjegulla që shtrihej arave e varosheve, thithte dritën e zbehtë të hënës së prerë, që sapo kishte dalë. Errësira dhe heshtja e mbrëmjes sikur i jepnin mundësi Genc Bogës të ruante aftësinë për të gjykuar qetësisht. Qëndroi në anë të një livadhi, përgjoi zhurmat e qytetit që vinin të mbytura dhe shikoi dritat e rralla, që mezi xixëllonin e mezi çanin errësirën e trashë deri te sytë e tij.

Duke pritur shenjën që duhej t'i jepte Teli Bashari, Genc Bogës iu kujtuan rrëfimi i Mentari Dikës për pushkatimin e pesë të dënuarve për «çështje politike» disa net më parë. Që të provonte edhe një herë ato emocione, si dhe emocionet e dikurshme të fëmijërisë, ai shkoi vetë deri te shkarëzima në fund të livadhit...



— Arnaut— briti oficeri i Perandorisë Turke dhe goja e tij e madhe me buzë të lëshuara sikur u shtrembërua nga një përqeshje si e djajve nëpër përralla.

Dielli, që sapo kishte perënduar, kishte lënë akoma nëpër qiell ca reflekse të buta, që i tregonin njerëzit dhe botën të skuqur, si të kullonin gjak.

— Ç'pati turku që përqeshi? — e kishte pyetur njëri nga të vegjlit Gencin tetëvjeçar.

Një nga tre shqiptarët përpiquej t'i thoshte diçka oficerit turk, por oficeri ngutej, ai s'kishte kohë të priste e të dëgjonte «arnautin». U dha shenjë zaptijeve t'u lidhnin sytë, shqiptarët nuk pranuan, zaptijet u zmbrapsën, ngritën pushkët, shtinë dhe shqiptarët u rrëzuan me thirrjen «Rroftë Shqipëria!». I hoqën zvarrë, i hodhën në një gropë të përbashkët, hapur më parë dhe i mbuluan. Çdo gjë u krye me ngut dhe po me ngut turqit u larguan në drejtim të qytetit, prej nga, tashmë, dëgjoheshin thirrjet e hoxhallarëve majë minareve për faljen e jacisë.

Të vegjlit, që u ndodhën aty rastësisht, me të mbetur vetëm, dolën nga ferrat, vrapuan drejt varrit të përbashkët të tre shqiptarëve dhe, pasi i erdhën një herë rrotull, befas, të kapulluar nga tmerri, ia mbathën vrapit drejt qytetit. Atyre nuk u rastisi të ktheheshin më aty, veçse pas tetë vjetësh, në vitin 1918, tashmë në moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare, kur njëri nga shokët i lajmëroi se karroca e zezë kishte dalë nga burgu dhe kishte marrë rrugën drejt livadhit të bukur. Ata shkuan prapë atje, jo më rastësisht, por qëllimisht për të parë se çfarë bënin agresorët dhe çfarë transportonin me karrocën e zezë gjatë asaj jave, gjithmonë më të perënduar të diellit. Ishin krijuar disa dyshime, diçka ishte folur për një spiun shqiptar, që tradhtonte shokët e vet. Dhe ata shkuan. Kësaj radhe shqiptarët ishin dy dhe çuditërisht, ashtu si oficeri i Perandorisë Turke tetë vjet më parë, edhe oficeri i Perandorisë Austro-Hungareze, megjithëse nuk i kishte buzët të mëdha e të varura si të turkut, nuk deshi e nuk pati kohë t'i dëgjonte. U krye po ai veprim, shqiptarët nuk pranuan t'ua lidhnin sytë, xhandarët apo ush-



tarët e huaj u zmbropsën, ngritën tytat, shënuan, zjarr, dhe shqiptarët u rrëzuan buzë gropës me thirrjen «Rrof-të Shqipëria!». Në këtë pikë të veprimit pati vetëm një ndryshim të vogël. Tetë vjet më parë përfaqësuesit e Perandorisë Turke, megjithëse nguteshin, qëndruan të gjithë për t'i mbuluar në varrin e përbashkët, ndërsa nga përfaqësuesit e perandorisë tjetër të vitit 1918 qëndroi vetëm gjysma, kurse gjysma tjetër, me oficerin në krye e me tradhtarin nga prapa u kthye menjëherë në qytet, sepse, me sa dukej, ngutja kësaj radhe ishte më e madhe. Gjashtëmbëdhjetëvjeçarët, që ishin pesë, midis tyre edhe Genc Boga, kësaj here nuk ia mbathën vrapit të kapulluar nga tmerri, por i ndoqën nga larg agresorët dhe në njëfarë vendi panë oficerin të trokiste në një portë, e cila qe hapur nga një vajzë e re, e bëshme dhe e bukur. Dihej: ato vajza i kishin sjellë me vete të huajt, që pastaj, si shumicën e ushtrisë, do t'i braktisnin rrugëve të Shqipërisë për të lypur një copë bukë shesheve dhe pra-gjeve të portave.

Të prekur nga këto ngjarje, gjashtëmbëdhjetëvjeçarët genë betuar se nuk do të qëndronin duarkryq, por do t'u jepnin dënimin e merituar tradhtarit dhe agresorëve. Kështu genë betuar...

Këtë mbrëmje, ndërsa Genc Boga ecte pas Teli Basharit, për të arritur në shtëpinë e Krist Papit, ky betim i vjetër i vërtitej nëpër kokë, megjithëse, për të thënë të vërtetën, tradhëtari ishte vrarë nga të tjerët, kurse Genci vetë, dhjetë vjet pas atij betimi s'kishte bërë akoma asnjë vrasje. Por ja, më në fund, kishte ardhur një çast edhe për Genc Bogën.

Nga cepi tjetër i livadhit, Teli Bashari «ndolli dhinë e humbur». Rruga ishte e lirë. Genc Boga bëri një përpjekje të shkëputej nga këto kujtime dhe pyeti veten mos vallë ishte vonuar. Se edhe ai ngutej atë mbrëmje, por qëllimi i ngutjes së tij ndryshonte nga qëllimi i ngutjes së oficerëve të huaj dhjetë e tetëmbëdhjetë vjet më parë. Pasi të kishte mbaruar punë me Krist Papin, d.m.th. pasi t'i kishte bërë gjyqin që meritonte, ai do të kthehej



menjëherë në vilën e Dikëve, sepse të nesërmen do t'i duhej të largohej pa rënë drita, për t'u takuar pastaj te Guri i Bardhë me Lato Morinën dhe me Besnik Sazanin e fabrikës së alkoolit.

Pas pak, kur u futën në rrugicën e parë (në rrugicën e dytë ndodhej shtëpia e Folta Papit), ai ndjeu përsëri atë rrezik real, të cilit i qe trembur shpesh kohët e fundit. Por kjo ndjenjë i kaloi shpejt: tashmë Genci kishte fituar sigurinë e zakonshme, kishte hedhur tej ndjenjën e diçkaje, që herë-herë sikur e mbërthente si me darë dhe eci me hap të vendosur deri në qoshen tjetër, deri në rrugicën e dytë, ku gjendej shtëpia fatale, shtëpia e tezes, aq e dhimbsur dhe aq e dashur për të.

Teli Bashari qëndroi, nxori shaminë dhe fryu hundët. Një xhandar ishte kthyer në rrugicën e dytë. Por jo, sigurisht që jo për ata. Ç'mund të bënte një xhandar i vetëm me Genc Bogën? Xhandari do të shkonte, kurse Genci do të futej në shtëpinë fatale, ku do të përzihej malli me detyrën, ku vendin e ndjenjave do ta zinte logjika dhe pastaj...

Ashtu ndodhi. Teli Bashari pyeti xhandarin se mos i kishte zënë syri një dhi e një keç. Xhandari i tha jo dhe iku në punë të vet. Teli ndolli dhinë dhe kecin e humbur: rruga ishte e lirë.

Genc Boga trokiti te porta një herë, dy, tri herë, po meqë askush nuk u përgjigj, ai u hodh nga muri, ra në oborr, u fut në dhomën e madhe, ku ndriçonte një llambë me vajguri e ku digjeshin në vatër ca shkarpa, mbi të cilat ishte hedhur një tullë. Genci ngriti fitilin e llambës dhe priti. Po nuk priti shumë. Shtëpia e vjetër dykatëshe filloi të dridhej nga disa hapa të rëndë që shkelnin sipër. Ai i njohu ata hapa.

— Teze! — thirri Genci.

Pas pak:

— Kush është?

— Teze, jam unë!

— Kush je ti?

— S'më njeh nga zëri?



Hapat ecën prapë dhe dërrasat e vjetra të shkallëve filluan të rënkonin. Genc Boga përgjonte dhe merrte me mend trupin e gjatë e të drejtë të Foltës, duart e lëshuara poshtë dhe këpucët me pafta të çliruara, por që aty, në ambientin e shtëpisë, cingërima e tyre nuk ishte aq e theksuar si në gurët e kalldrëmit. Me trupin e madh ajo zuri gati gjithë katërkëndëshin e derës. Pastaj, si të mos i mjaftonte drita e llambës mbi oxhak, ngriti kandilin që mbante në dorë, për ta parë më mirë atë që ishte ulur në divan. Kur u bind se e kishte njohur, e vuri kandilin mbi dollapin e bukës pranë derës dhe tha me basin e saj:

— Ti-i-i?

— Po, teze!

Folta hodhi hapin përpara, po sakaq Genci u gjend pranë saj. Ajo e shikoi në heshtje, tundi kokën me mallëngjim e me qortim, pastaj hapi ngadalë krahët dhe e shtrëngoi të nipin me fuqinë e një burri. I mbështetur pas trupit të saj, si gjithmonë, Genc Boga e ndjeu veten sikur kishte rënë në krahët e së ëmës. Folta e puthi në të dyja faqet, dhe jo pa mall, por... pa buzëqeshje, dhe Genci e kishte marrë me mend që më parë se ajo nuk do t'i buzëqeshte.

— Më thuaj, si je? — pyeti basi i saj.

— Mirë, teze, — tha Genci.

Folta i vuri duart në supe, e shikoi me vëmendje, e rrotulloi, e largoi, e afroi, sikur ai të ishte një kukull e jo një djalë më i gjatë se ajo e më i fuqishëm se ajo.

— Mirë qenke, — tha. — Shpëtove... Edhe Kristi ua hodhi. I gënjeu dhe ua ho-dhi! — Folta e shikoi sërish me një nga ato shikimet e saj të rënda. — Mirë qenke dhe dukesh tamam si komit me këtë setër dhe shami të kuqe rreth kokës. Tashti të mendojmë se ç'duhet të bëni, ti dhe... Kris-ti.

Nga mënyra si fliste për të birin, Genci kuptoi se Folta ose nuk donte të fliste fare, ose fliste me pahir e pa qejf. Por ai s'kishte ardhur këtu për të biseduar me tezen për punët e Kristit. Ai donte të takohej me Kristin vetë, prandaj tha tjetër për tjetër:



— Po ju si keni qenë, teze?... Kolën si e ke?

— S'jam mirë, — tha ajo. — Nuk e di, por s'jam mirë!  
— Dhe nuk deshi të sqaronte asgjë më tepër. — Kola mirë është. Kristi doli nga spitali.

Eci ngadalë e rëndë, u ul mbi divan dhe ia bëri Gencit me dorë, që t'i ulej pranë.

— Të ishte gjallë motra ime, do të vinte pas teje kudo që të shkoje!

— Po, — tha Genci dhe sytë iu veshën me kujtime.

— E shkreta motër! — psherëtiu ajo dhe Genci vuri re se Foltës iu drodhën buzët e trasha. — Kujdes Gencin, më tha kur vdiq!

Për një hop biseda e tyre u ndërpre. Genc Boga shikoi zjarrin dhe tullën. Folta e vuri re përqendrimin e tij, por foli:

— Kristi m'i tregoi të gjitha!

Genci e shikoi dhe u bind se ajo donte të dinte akoma, donte të dinte gjithçka, jo për kureshtje të thjeshtë, po për diçka tjetër, shumë më të rëndësishme, për një të vërtetë, pa të cilën e kishte vështirë të jetonte. Edhe Folta e shikoi dhe u bind se ardhja e të nipit kishte një domethënie më të madhe sesa malli e dashuria për të, për Kristin e për Kolën. Ky hetim, që ata u bënëin fytyrës dhe mendimeve të njëri-tjetrit, e kishte vështirësuar bisedën midis tyre.

— Fshatrave ishte më i sigurt, — tha Folta.

— Po, teze, atje do të kthehem, — tha Genci.

— Rreziku është bërë i madh. Kristi doli nga spitali dhe na i tregoi të gjitha. Na tregoi si kishit shpëtuar Veteranin e Luftës dhe fshatarin që e strehonte, na tregoi si ishit ndarë dhe... pastaj Kris-ti ishte rrëzuar, gjoja duke ndjekur Veteranin e Luftës, e kishin zënë ethe të forta dhe ata e kishin shtruar në spitalin e Tiranës. Për ty, ne s'dinim asgjë, vetëm dinim që ishte gjallë dhe këtë e merrnim me mend nga shpalljet nëpër muret e qytetit. — Pasi tha këto fjalë, Folta u ngrit, shkoi te zjarri, tërhoqi tullën me mashë, e mbështolli me një copë thes, e mbështolli përsëri më mirë dhe e ngriti me kujdes, si të ngrinte një fëmijë kopan. Pastaj eci drejt derës me ri-

tëm të dyshimtë, thujajse mendohej para çdo hapi, ta hidhte apo të kthehej prapë. Te pragu qëndroi, ktheu nga Genci fytyrën e pezmatuar, hodhi një nga ato vështrimet që digjnin dhe tha:

— Për Kristin!

— Ku është? — pyeti Genci.

— Sipër!

— Ç'bën atje?

— Fle!

— Kaq herët?

— S'është mirë Kristi! Nuk e ka marrë veten që kur doli nga spitali. Po të mos ia kujtoj unë, as ha, as pi! — Ngriti kandilin nga dollapi i bukës, kaptoi prahun, por aty qëndroi prapë dhe foli me ton të atillë, si të qe duke thënë më kryesoren: — Këmbët, sidomos, i rrinë akull!

Eci dhe hapi i saj i rëndë goditi shkallaren e parë. Qëndroi dhe pyeti:

— Do të vish ta shikosh?

Genci mbeti. Ai e kuptoi se po afrohej çasti vendimtar. Diçka e mbërthente në vend, diçka tjetër e shtynte përpara!

— S'ka gjë, — shpejtoi Folta e penduar, — takohesh nesër në mëngjes. — Dhe hapi i dytë goditi shkallaren e dytë. Atje, si të qe kujtuar se nuk kishte vetëm Kristin në shtëpi, por edhe djalin e vogël, tha:

— Kolën do ta zgjoj!

— Jo, mos e zgjo, teze! — foli menjëherë Genci, gati i trembur.

— Pse të mos e zgjoj? — pyeti Folta. — Kola nuk është i sëmurë. Vetëm i lodhur. E lodhin muret që ngre.

Folta hidhi hapin e tretë.

— I sëmurë është Kristi, — tha. Basi i saj tingëlloi i trishtuar dhe i ngarkuar me dyshime.

— Megjithatë, Kolën mos e zgjo, teze! — Nguli këmbë Genci.

— Mirë, nuk po e zgjoj, — tha Folta dhe u zhduk pas kthesës së shkallëve.

Ndërsa rrinte në divan dhe shikonte dhomën e madhe të zjarrit, pothuajse të zhveshur, gjëja që i ra më shumë



në sy qe fytyra e përvuajtur e shën Marisë në konizmen e pikëzuar nga breza të panumërt mizash. Në një qoshe të divanit atij i zuri syri gjilpëra, rrotëza të bardha dhe cepin e një qëndisme. Para se të zëvendësonte të shoqin në restorantin e vogël, Folta Papi qe bërë e njohur për qëndismat e bukura dhe shumë nga vajzat e reja bënin porosi aso kohe për pajën e tyre. Në hapin e pesëmbëdhjetë të Foltës, që ishte hapi i fundit e shkallarja e fundit Genc Boga ndërpreu çdo mendim. Ai i kishte ngjitur mijëra herë ato shkallë. Pesëmbëdhjetë. Pastaj hapi i Foltës u bë më i kujdesshëm. Edhe doreza lëvizti ngadalë... Kështu ecte ajo tre vjet më parë, kur Kristi vuante e dergjej nga veshkat. I thanë Foltës se djali duhej shtruar në spital. Por ajo nuk e shtroi, sepse nuk i gjeti paratë që i kërkonin. I thanë Foltës se djali s'duhej të hante asgjë të fërguar, as vezë e as spinaq, asgjë të kripur, ai duhej të hante vetëm sheqer, qumësht, biskota. Folta buzëqeshi hidhur. Ku t'i gjente ajo sheqerin, qumështin e biskotat? Dhe për sa kohë? Për një vit me radhë! Ndoshta edhe më gjatë! Po megjithatë Folta s'la gjë pa bërë, s'la qëndisma, s'la rrobë pa larë, s'la ndihma e veresie pa marrë, e me gjithë kursimet që i mbeteshin nga restoranti, një ditë u gdhi duarbosh. Kristi, si më parë, dergjej në dyshek. Atëherë Folta mori dy trasta të mëdha, shkoi te një bakall, i mbushi me biskota e sheqer dhe i tha bakallit që t'i shkruante në «defterin e veresive». Bakalli u alarmua, ngriti çirakët në këmbë, po Folta rrëmbeu trastat dhe eci. Kur shikonte se çirakët i afroheshin aq sa mund t'i rrëmbenin trastat, ajo qëndronte në qetësi, tendoste trupin e drejtë e të gjatë, hidhte rrotull vështrimin e ftohtë e të zemëruar të syve të zez dhe priste... Kur çirakët zmbropeshin, ajo vazhdonte rrugën si më parë, me hapin e saj, që nuk ngutej kurrë. Kështu shkoi deri në shtëpi... Filluan prapë punët në restorant, qëndismat, përgjimi i sëmundjes, larja e rrobave, shlyerja e borxhit të bakalli, netët pa gjumë te koka e Kristit, të cilit mjeku ia kishte hequr shpresat, po të mos shtrohej në spital.

Një hap... Folta po zbriste dhe ai shikonte me sytë e mendjes trupin e saj të drejtë, kokën lart dhe lëvizjen e



duarve sa herë që ngrinte dhe lëshonte hapin mbi shkallarën më poshtë... Dy... tri... katër... Edhe kur mbaruan të pesëmbëdhjetë shkallarët, ajo nuk e shpejtoi hapin. Drita e zbehtë e kandilit ndriçoi pragun. Pastaj trupi i madh i Foltës, si më parë, zuri derën. Dhe si më parë, e vuri kandilin e ndezur mbi dollapin e bukës dhe pastaj u ul pranë të nipit.

— Këmbët i kishte akull Kristi, — tha ajo. — I vura tullën, sikur lëvizi pak, por nuk u përmend. Dhe unë nuk e zgjova. Sa një pare i është bërë fytyra. Që kur u kthye nga spitali i Tiranës, Kristit i ra fare shëndeti. Më vjen keq për të, më pikon, ja këtu, në zemër!

— Teze, ti sikur më fsheh diçka për Kristin? — pyeti befas Genci.

— Shpëtoi Kristi nga ndjekja e nga dyshimet e xhandarmërisë, por e zuri një fatkeqësi tjetër, po aq e madhe! — Folta heshti dhe shikoi e pikëlluar këmbët e veta.

— Ç'është kjo fatkeqësi?

— Iu kthye përsëri bixhozit, si atëherë kur ishte më i ri. Po tashti luan kumar të vërtetë! I them të kërkojë punë, të paktën të dalë në restorant me mua, se unë plakë jam dhe ai, po të dojë, mund të bëhet si i ati, akçi i zoti, po nuk e ka syrin andej. E tërheqin të ligat Kris-tin tim!

— Po paratë ku i gjen? — pyeti Genci.

— Nuk e di. Unë i dhashë vetëm një herë, ditët e para, kur u kthye prej andej. Kam fat, thotë. Më ecën dora, thotë. Zaret!

Fytyra e Gencit po ngurtësohej

— Kola më tha se Kris-ti ishte parë edhe te gratë e liga atje poshtë, — u drodh zëri i Foltës, gati në të qarë. — Pi edhe raki çdo natë. Dhjetë net që pi raki, që luan kumar dhe shkon te gratë e liga!

Heshtën.

— Ka një hall. Është i dëshpëruar. Kur kthehet çakërrej, ngjitet lart dhe qan. Edhe sonte, para se ta zinte gjumi, qau.

— Ti nuk e ke pyetur?

— E kam pyetur. Kërrus kokën dhe nuk flet. Por



njëherë më tha se i vjen keq për Veteranin e Luftës dhe për fshatarin që e strehonte.

Flaka e kandilit, harruar mbi dollap, herë ngrihej, herë ulej. Në faqen e murit hijet e tyre zgjatëshin e mblihdëshin dhe, kur flaka fiksohej, atëherë edhe hijet bëheshin të qëndrueshme. Kështu vazhdoi kjo lojë, derisa Folta ngriti akoma fitilin e llambës dhe shoi kandilin. Pastaj ajo befasi u ngriti, u ra me mashë cungjeve të zjarrit dhe vuri kusinë.

— Do të të bëj një dorë oriz, — tha Folta.

— Jo, teze, — tha ai.

— Pusho!

— Ruaje për Kolën e për... — Nuk pati dëshirë ta shqiptonte emrin e Kristit.

— Pusho, — tha ajo. — Ti ke dalë nga varri dhe erdhe tek unë, e unë të të kursej orizin!

U kthye me hapin e ngadalshëm, e gati të paurdhërueshëm, u ul pranë Gencit dhe foli si për një gjë pa rëndësi:

— Nuk do të vdesim. Thonë se fabrika e alkoolit do të zgjerohet e së shpejti do të ketë punë edhe për Kristin. Kështu thonë. Populli do që të pijë. Kur populli vuan, i shkon mendja të rakia, si Kristit tim!

— Teze, — tha pas pak Genci, — ty sikur të bren njëfarë dyshimi! — Kur e mbaroi këtë frazë, ai u kujtua se kishte bërë një pyetje, që as duhej dhe as kishte dashur ta bënte. Këtë ai e kuptoi edhe nga fytyra e Foltës, që u pre dhe u zverdh menjëherë.

— Dyshoj, the?

— Po!

— Nga një e keqe e madhe! — tha Folta.

— Nuk të kuptoj!

— Unë e di pse vuan Kristi!

— Çfarë di ti?

— Unë e di pse e ka humbur, pse pi e pse luan bixhnoz Kristi! — tha ajo.

— Pse?

— Ai ka tradhtuar! — këtë frazë ajo e kishte thënë shtruar, pa u penguar. Kështu ndodh, kur, pasi e kemi

përsëritur një mijë herë me vete, të njëmijënjëtë e themi me zë. — Po, — tha ajo, — nuk ka tjetër kuptim, që ai është i lirë e që ka pare e sillet si rrugaç, vërtet i dëshpëruar dhe qan, por si rrugaç!

— I ke rënë në sy?

— Po, — tha basi i saj. — I thashë, mos na ke bërë ndonjë të pabërë me njerëzit e qeverisë? Ai u zverdh dhe pastaj qau, i lënduar nga fjalët e mia. Por unë, duke parë se nuk po hiqte dorë nga rrugaçëritë, i thashë prapë një natë tjetër, ti ke tradhtuar, i thashë. Ai prapë qau, pastaj tha se, do të vriste veten, po t'ia përsëritja. Ta vrasësh veten, posi, i thashë unë në zemërim e sipër. Megjithatë, që nga ajo natë unë kam heshtur. Jam nënë, trembem nga ndonjë hata. Por kam dyshime për sjelljen e Kristit dhe më vlon zemërimi përbrenda, sado që më duket sikur është penduar për prapësitë që mund të ketë bërë.

Pas këtyre fjalëve, ra një heshtje që zgjati shumë dhe që u bë e papëlqyeshme.

— Jetojmë në një kohë të keqe, Genc, — tha Folta, si të fliste me vete e jo me të nipin. — Njeriu duhet të bëjë kujdes, se mund të shkelë kur të duash në dërrasë të kalbur!

— Ia ke gjetur paratë? — pyeti Genci.

— Jo! — tha ajo. — Nuk kam dashur ta kontrolloj! Më dridhet trupi. Ç'më mbetet t'i them e ç'më mbetet të bëj po t'ia gjej? — Pas këtyre fjalëve fytyra e saj u lëshua dhe u plak dhjetë vjet të tjerë. Genci vuri re se ajo mbahej me zor, se ajo ishte nën shtypjen e një vuajtjeje të madhe. Folta u zverdh. U zverdh akoma. Deshi të fliste, po buzët nuk iu bindën. Atëherë mbeti ashtu e nemitur dhe vetëm disa çaste më vonë ktheu fytyrën nga i nipi, por vështrimin jo. Vështrimin e kishte në tavan. Diçka kishte dëgjuar. Një si zhurmë, një si thirrje. Pastaj thirrja u bë e qartë.

— Foltë! Foltë!

Genci e njohu. Ai që thërriste ishte zëri i Kristit. Zëri i përgjumur i Kristit. Atë zë ai mund ta njihte, sido që të dilte e ngado që të vinte. Folta mbërtheu



duart pas divanit dhe u ngrit. Eci drejt derës, gjithmonë me hapin e ngadalshëm, të rëndë e gati të paurdhërueshëm, ngriti kandilin nga dollapi, e nderi dhe shkeli në prag. Atje qëndroi, ktheu kokën nga Genci dhe tha:

— Eja!

Këtë fjalë ajo e tha me siguri të atillë, siç mund të flitet për një gjë që s'mund të jetë ndryshe, që s'mund të ndodhë ndryshe, për një gjë që s'lejon dykuptim.

— Eja! — përsëriti dhe në timbrin e atij zëri e në pamjen e asaj fytyre, që ngjante me fytyrën e së ëmës si dy pika uji, ai ndjeu dashurinë amënore, ndjeu thirrjen e gjakut, të gjakut të vet, që e lidhte me tezen me mijëra pejza të padukshme. I hipnotizuar nga ai zë, Genc Boga shkoi pas tezes për të shkruar aktin e fundit të asaj drame të vogël, që luhej atë natë në një shtëpi të vjetër, në njërën nga rrugicat e shumta të qytetit N.

## IX

Në dritën e kandilit, që llapste në duart e së ëmës, ai mezi shqoi në gjysmerrësirë fytyrën e Gencit, që herë i ndriçohej nga njëra faqe, herë nga tjetra.

— Ti-i! — briti ai në mënyrë të atillë, si t'i kishte plasur nën këmbë një bombë e fuqishme.

— Po, unë! — tha Genci dhe falënderoi gjysmerrësirën për buzëqeshjen që i kishte degraduar në ngërdheshje.

— Ti-i! — briti prapë Kristi, dhe kësaj radhe nga fytyra i qe fshirë si me magji tronditja e papërcaktuar e ças-

teve të para. Vendin e saj, tashmë, e kishte zënë një mall e një gëzim i vërtetë.

Kristi largoi kuvertën e vjetër e të zbërdhulur, nën të cilën edhe Genci kishte fjetur kaq herë, u ngrit në këmbë, u lëkund, gati për t'u rrëzuar, po shpejt e gjeti ekuilibrin dhe po aq shpejt iu hodh Gencit në qafë. Genci rrinte drejt e ftohtë si një shtyllë, që nuk reagon e nuk ndien asgjë, sado të fryjnë erëra e sado të djegë dielli. Po Kristin e kishte marrë malli dhe s'para kishte kohë të kuptonte e të nuhaste ftohtësinë e Gencit, me të cilin ishin rritur si dy vëllezër.

Te pragu, me kandil në dorë qëndronte Folta, që ishte edhe nënë, edhe teze. Errësira, e cila shtrihej prapa kurrizit të saj, shkrihej me rrobat e zeza dhe ajo shëmbëllente me një përmendore në buzë të honeve. Fytyra e saj ishte tepër e ngërthyer e tepër në dilemë, si e një njeriu që nuk di e nuk vendos akoma me cilin të bëhet dhe anën e kujt të mbajë. Si nënë, ajo e kishte ndër menjëherë gëzimin e çiltër të të birit dhe, si teze, ajo ishte bindur për ftohtësinë dhe ashpërsinë e të nipit. Ndërsa shikonte lojën e dritës e të hijes në fytyrat e të dyve, gëlltiti pështymën, si të kishte gëlltitur dozën e parë të helmit. Dhe tek qëndronte ashtu, e ngulur si përmendore, të dukej e vendosur dhe e gatshme për të gëlltitur doza të tjera helmi.

Por puthjet, malli dhe këmbëngulja e Kristit sikur e detyruan Gencin të vinte buzën në gaz. Në mënyrë të pandërgjegjshme edhe Folta (nënë e teze) vuri buzën në gaz dhe kjo ishte hera e parë që buzëqeshte gjatë asaj mbrëmjeje.

Kristi ndjeu turbullirë, qëndroi një çast me dorën në ballë, pastaj u kërrus drejt krevatit dhe u shtri. E ëma vendosi kandilin mbi një stol të lartë dhe e mbuloi të birin me kuvertën e vjetër e të zbërdhulur. E mbuloi me kujdes, i zuri këmbët me dorë, i afroi tullën që i kishte shkuar poshtë dhe, si të mos mjaftonte tulla, ia pushtoi gishtat dhe ia mbajti një copë herë midis pëllëmbëve të veta.

Tashti që kandili ishte vendosur në stol dhe flaka



nuk llapste më, tashti që fytyra e ngushtë dhe e hollë e Kristit me faqet e thara nga dobësia e me mollëzat e kërcyera ndriçohej e gjitha, lëkura poshtë syve ngjyrë gri të hapët (nga sytë ngjante me Gencin) ishte nxirë dhe fishkur mjaft për të njëzet e pesë vjetët që kishte.

Ka të ngjarë që fytyra e Gencit të ketë shprehur keqardhje, sepse s'kishte kuptim dhe shpjegim tjetër që Folta të buzëqeshte sërish dhe kjo ishte hera e dytë që buzëqeshte gjatë gjithë mbrëmjes. Para të birit dhe të nipit ajo ishte bërë si fëmijë. Kur mendoi se mund të largohej, tha:

— Po shkoj të ziej orizin!

— Më mirë qëndro këtu, teze, — tha Genci, pa e ditur pse e kishte shprehur atë dëshirë.

— Jo, do të shkoj, — tha ajo.

— Unë s'dua, nuk më hahet!

— Pilafi i Folta Papit duhet të të hahet. Ti e di që unë me atë pilaf e mbaj gjallë restorantin.

— Po unë do të largohem menjëherë! — tha Genci.

— Do të hash, pastaj do të largohesh, — tha Folta.

— Këtu s'mund të rri... Këtu...

Folta u step pak.

— Xhandarëve as që u shkon në mendje që ti mund të vish këtu! — tha ajo dhe u nis e vendosur me hapin e saj të pandryshueshëm.

— Lëreni derën hapur, sa të zbres shkallët, — tha sërish te pragu, duke treguar me dorë kandilin.

Genci numëroi një... dy... tri... e, ndërsa numëronte, ai përpiqej të merrte me mend edhe pamjen e rënduar, edhe lëvizjen e graduar të duarve, edhe trupin e drejtë të Foltës... Shtatë... tetë...

— Më është prishur gjumi, — tha Kristi (sa për të thyer heshtjen).

... Dhjetë... njëmbëdhjetë numëronte Genci dhe mendoi se duhej të fillonte menjëherë nga hetimet, se gjithçka duhej bërë shpejt, se pastaj do të ishte vonë, do të ishte vështirë. Kristi do të kërkonte nga ai shpjegime, p.sh. si kishte mundur t'i shpëtonte ndjekjes, si e kishte kaluar këtë kohë, do ta fuste në biseda intime e në

hollësira të tjera, mund t'i kërkonte të qanin hallet së bashku, apo të mendonin për të ardhmen dhe të gjitha këto hollësira mund ta pengonin Gencin t'ia arrinte qëllimit për të cilin kishte ardhur këtu... Katërmbëdhjetë... pesëmbëdhjetë...

— Besoj, t'i ka treguar të gjitha Folta, — tha Kristi.  
— Puna jote mori rrugë tjetër, kurse unë i gënjeva dhe ata e hëngrën gënjeshtren time, sikur gjoja u rrëzova dhe humba lidhjet me repartin.

Genc Boga, megjithëse e dinte që më parë e që në fëmijëri, se Krist Papi u përkiste atyre njerëzve, të cilët gënjehen lehtë nga të tjerët dhe për vete janë të pazotët të gënjejnë, prapëseprapë, kur dëgjoi fjalët e fundit të Kristit, që dëshmuuan sërish se nuk ishte i aftë as për të gënjyer, ndjeu një peshë në gjoks, çliroi grushtet dhe mori frymë thellë, gati i penduar pse kishte ardhur aty. Pak më vonë ai kishte marrë pamjen e një njeriu që ndodhej para një muri të lartë, të pakapërcyeshëm, por që, megjithatë, ai duhej ta kapërcente, sepse një gjë e tillë ishte e domosdoshme, ishte krejt e detyrueshme.

— Ç'ke? — pyeti Kristi, që duhej të kishte kuptuar diçka të dyshimtë në qëndrimin e Gencit.

— Çfarë?

— Pse u prishe në fytyrë?

Genci shikoi Kristin dhe në fytyrën e hollë, të ngushtë e të plakur para kohe, i dukej sikur shikonte atë jetë, që për brezin e tyre kishte qenë një trazirë e përhershme, kishte qenë luftë dhe prishje ekuilibri, sundim i vazhdueshëm i së keqes, i pasigurisë, i mizerjes... Dhe ja, Gencit iu bë sikur në shpirtin e tij po anonte keqardhja për Kristin... Por, aty për aty, një tjetër fuqi, gati e pavarur nga ai, e nxiti t'i thoshte:

— Unë i di të gjitha!

— Çfarë di ti?

— Pa më thuaj, ku ishe atë mëngjes kur u ndezën dy zjarret e kur xhandarmëria rrethoi Veteranin e Luftës dhe fshatarin që e strehonte?

— Kjo pyetje vërteton se ti nuk di asgjë! — tha Kristi dhe fytyra iu mpreh si e dhelprës prapa kafazit.



Sado që Genci u përpoq të mos e tradhtonte veten, ishin sytë që e tradhtonin: në thellësi të bebëzave gri kishte diçka të fortë e të ftohtë, të ngjashme me mermerrin. Tashmë ai po ngjitej me vendosmëri nëpër murin që pak më parë i qe dukur i pakapërcyeshëm.

— Fol, pra! — gati bërtiti Genci. — Lame Gjuzi më tha se ti, pasi fjete tri net te Rrahmani e te Llazi, ditën e katërt kishe shkuar te Lamja. Ti i the se do të flije vetëm një natë, i the se të nesërmen do të të duhej të dilje nga shtëpia që pa gdhirë për të parë, ose fundja, për të ndezur vetë dy zjarre pranë e pranë. Ai të vuri për të fjetur me kasollen e vogël, larg kasolles së madhe, ku flinte vetë me fëmijët, se në kasollen e vogël rrugët e shpëtimt ishin më të lehta dhe pylli ishte më afër.

— S'di, s'më kujtohen të gjitha menjëherë!

— Në mesnatë Lame Gjuzi e kishte zgjuar një krishtë. Ai, që e dinte hallin, ishte ngritur dhe kishte dalë me kujdes. Ca zhurma e ca feksje drite e kishin çuar drejt kasolles së vogël. Nuk ishte gabuar. Ata të kishin kapur. Nga fjalët e tyre, Lame Gjuzi kuptoi se të kishin rrethuar në gjumë. Ishin dhjetë xhandarë.

Pasoi një heshtje.

— Të thashë, s'më kujtohen të gjitha!

— Ishte edhe kapiten Shaban Sinani. Të rrahën me hu e me shkelma dhe vazhdimisht të premtinin diçka, po fjalët e tyre nuk vinin deri në veshët e Lames. Së fundi, xhandarët të lidhën plagët, të hipën mbi një kalë dhe... Ndoshta nga ky çast fillon historia e Spitalit Ushtarak të Tiranës, prej nga ti u ktheve i shëruar, por me she-njat e plagëve në fytyrë e në duar.

Në çastet e para, i befasuar nga fjalët e nga pyetjet e Gencit, Kristi që trembur dhe trupi i kishte marrë formën e një trajektoreje. Por më vonë, kur tregimi i Gencit po i afrohej fundit, dora-dorës Kristi zuri të merrte pamje të përrulur e të pashpresë, si të një qeni të rrahur.

— Tashiti, lëri dredhitë, — tha prerë Genci. — Unë s'kam kohë të qëndroj këtu. Nesër më duhet të nisem maleve! Pas këtyre fjalëve në dhomë ra heshtje, që u thye nga disa krisma të largëta pushkësh, kurse aty afër, në



kopshtin që Genc Boga e njihte aq mirë, e ku ai kishte luajtur dikur me Kristin shilarthi, dëgjohej kënga e një qokthi, i cili këndonte shtruar, me rrallësi e me ndërprerje të ngathëta që të bënin nervoz, pi-i-i... pi-i-i... pi-i-i...

— Pse e bëre këtë? — pyeti Genci,

— E bëra, — tha befaz Kristi dhe mbeti disa çaste si i përhumbur.

Tha prapë:

— A nuk e kupton ti, Genc, se jemi krejt të pafuqishëm për të luftuar kundër tyre?

— Po ti, a nuk e kupton se je krejt i pazoti për të kapur rrymat e lëvizjet e jetës rrotull vetes e rrotull të tjerëve?

— Jemi të dënuar me vdekje!

— Dikush edhe do të vdesë!

— Atëherë kujt i duhet sakrifica jonë? Jeta është prerë keq dhe ne s'mund ta ndryshojmë!

— Lëri llafet e tepërta, — tha Genci, — dhe pranoje hapur se ke tradhtuar!

— Fundja, ti i ditke të gjitha! — tha ai pas një heshtjeje.

— Të thyen torturat dhe të joshën paratë, me të cilat ti luan kumar, shkon pas grave të liga dhe pi raki! Prej kohësh ke treguar shenja prapësie, punonin Folta dhe Kola, kurse ti bridhje rrugëve pa punë!

— Kam dashur të jetoj më bukur! — tha Kristi.

Gencit, që ishte vazhdimisht i shqetësuar, iu ngjiti në fytyrë një shprehje ironie, që e tregonte të shpërqendruar, por në të vërtetë kjo gjendje dëshmonte se ai po e humbiste durimin. Tha:

— Mos duke shitur të tjerët është më bukur?

— Ata më rrahën shumë e më dhanë shumë para! — briti ai, humbi kontrollin ndaj vetvetes, tërhoqi xhaketen që e kishte te koka e krevatit, i shqepi astarin, nxori prej aty disa pako me napolona kartë, u këputi spangon me dhëmbë, i hodhi me vërtik dhe napolonat u shpër-



ndanë nëpër dhomë. — Njëqind napolona më dhanë, aq sa japin për kokën tënde!

Herë-herë, aty poshtë tyre dëgjoheshin hapat e tezes, tek ecte nga dollapi i bukës në vatër dhe anasjelltas. (Ajo bënte pilafin për të nipin.)

— Po tashti ç'ke ndër mend të bësh? — pyeti Genci, që mezi po e përmbante veten. — Mos do të tradhtosh edhe familjet e fshatarëve që të strehuan?

Pasoi një heshtje tjetër, e gjatë.

— Të kanë thirrur? — pyeti Genci me këmbëngulje.

— Cilët?

— Ata që të dhanë paratë!

— Në spital nuk më ngacmuan. As ditët e para pas kthimit. Vetëm para dy ditësh më thirrën.

— Ç'të kërkuan?

— Atë që the ti. Gjithçka që mund të di!

— Ti ç'ke ndër mend të bësh?

— Nuk e kam shkruar akoma raportin.

— Kur ta kërkojnë?

— Shpejt!

— Do ta shkruash?

— Nuk e di!

— Do ta shkruash, me siguri. Tashti që u bërë vegël e tyre, tërë jetën do të të poshtërojnë!

— Kurse ty të është mbushur mendja të bësh luftë, — tha Kristi.

— Luftë! — tha Genci. — Jemi të mundur, por jo të gjunjzuar!

— Paske gjetur shokë?

— Po!

— Do të vriteni, ti e të gjithë ata që do të të pasojnë.

— S'ka gjë, — tha Genci, — po të paktën do të lëmë prapa qoftë edhe një xixë, që më vonë do të shërbejë për të nderur zjarrin e madh!

— Beson se do të ketë zjarr?

— Përderisa ka xixa!

— S'do t'ia arrini qëllimit!

— Po s'ia arritëm ne, do t'ia arrijnë të tjerët! — tha Genci.

— Njerëzit bënë luftë, bënë revolucion, e mbajtën fuqinë gjashtë muaj, e fundja çfarë fituan?

Genc Boga i hodhi Krist Papit një vështrim shpartallues dhe bëri një gjest, që ishte njëkohësisht i ethshëm, energjik dhe i paduruar. Nën këtë vështrim e nën këtë gjest, në fytyrën e Krist Papit kërcyen njëherësh të gjitha ngjyrat dhe po atë çast ai mori pamjen e një të dënuari që ecën drejt vendit të ekzekutimit, i bindur se nuk do të ketë mëshirë për të dhe as në hapat e fundit nuk do të arrijë ndonjë dekret për t'i falur jetën. Për më tepër, nëse në fillim, në lëvizjet e tij, në shikimin e në zërin e tij kishte pasur gjakftohtësi, pastaj turbullim, por edhe një fije shpresë, pas atij vështrimit dhe pas atyre gjesteve të Gencit, ai tashmë e kishte futur veten në radhën e të vdekurve prej kohësh. Megjithatë u duk sikur bëri një përpjekje të fundit, kur tha:

— A s'mund të më falësh?

— Të të fal?! As unë as shokët e mi nuk të falim!

Poshtë në dhomën e zjarrit u dëgjuan sërish hapat e rëndë të tezes tek bënte pilafin. Po pastaj ata hapa filluan të ngjiteshin nëpër shkallë. Parandjenja e nënës, mendoi Genci. Ai mendoi gjithashtu se prania e saj do ta bënte të pamundur dënimin e tradhtisë. Padashur Genci zuri të numëronte hapat e Foltës... një... dy...

— Pse të mos më falni, përderisa jam penduar?!

— Po tradhtinë ku ta çojmë?

— Do ta shpagueaj!

— Tradhtia nuk shpaguehet. Veterani dhe ai që e strehonte nuk ngjallen më. Emrat e fshatarëve ku ti fjete, nuk mund të të hiqen më nga koka. Emri yt që është shkruar në listën e spiunëve të xhandarmërisë, nuk mund të fshihet, pavarësisht nga dëshira jote. Sa më shumë të jetosh, aq më shumë dëme do të bësh, aq më i poshtër do të bëhesh, sa edhe vetja do të të mërzhitet.

... tre... katër...



Diçka kishte parë përsëri Kristi në fytyrën e Gencit, që e shtyu të thoshte:

— Pra, ky qenka fundi im?

— Tjetër rrugë nuk ka për ty! — tha Genci.

— Kaq herë kam dashur të vras veten, por...

— Por?

— Më dridhet dora!

... Pesë... gjashtë...

Tashti Genci ndihej më i qetë. Çastet e para, që mund ta detyronin të mos e kryente misionin, për të cilin kishin ardhur, kishin kaluar. Muri i lartë ishte kapërcyer. Fytyra e tij nuk shprehte më lëkundje. Ajo ishte thjeshtë fytyra e Genc Bogës, me ballin e dystë e me ngjyrën ulliri të errët. Tashti vetëm duhej shpejtuar, sepse hapat e Foltës (që ishte nënë e që ishte teze) po afroheshin.

... shtatë... tetë...

Qokthi këndonte si më parë, me ritëm të ngadalshëm, që Gencit i ngacmonte nervat. Larg u dëgjuan krisma. Nga Sheshi i Pazarit jehuan ritmet e një trumbete, që u kthyen shpejt në muzikë. Kështu fillonte gjithmonë. Një trumbetë, pastaj e gjithë banda ushtarake. Muzikat vinin të mbytura deri në shtëpinë e Papëve, sepse ajo ndodhej larg qendrës.

... nëntë... dhjetë... Folta po ngjitej më shpejt. Parandjenja e nënës, mendoj prapë Genc Boga.

— Nuk e kuptoj se si midis nesh ishte mbledhur dhe rritur një llum kaq i madh, ku mund të lëvrijnë vetëm krimbat! — tha Genci. — Një ditë zemërimi i popullit do të shpërthejë sërish, por në qoftë se në gjirin tonë do të kemi njerëz si ti, çfarë mund të bëjmë ne?...

... njëmbëdhjetë... dymbëdhjetë...

Tashmë Krist Papi shikonte tavanin dhe priste ekzekutimin, pa lëvizur, pa marrë frymë.

... trembëdhjetë...

Befas dora e Kristit lëvizi nën kuvertë. Nga kjo lëvizje këmbët i mbetën jashtë, të thata e të verdha, si këmbët e një kufome.

... katërbëdhjetë...

Genci u ngrit nga karrigia. Po kur u ngrit, dëgjoi në prag frymëmarrjen e rëndë të Foltës. Dhe iu bë sikur ajo i shikoi të dy me dyshim. Në fillim dyshimi i saj ra vetëm mbi Gencin, por, meqë fytyra e të nipit iu duk e drejtë, e pastër, si të kishte qenë duke biseduar me të birin për gjëra të vogla e pa rëndësi, që nuk shkaktojnë turbullime, e hodhi vështrimin nga i biri dhe menjëherë e tërë qënja e saj u tendos. Në fytyrën e tij Folta kishte parë hijen e vdekjes, bile pa edhe dorën e Kristit nën kuvertë të ngrihej ngadalë dhe dyshoi...

Pam, u dëgjua një krismë e vetme, Dora e Kristit u var dhe në dysHEME ra me zhurmë një revole. Vështrimi i syve gjysmë të hapur të Kristit qe mbërthyer në tavan dhe si më parë, këmbët kishin mbetur jashtë, të thata e të verdha.

Folta u çapit, qëndroi para Gencit dhe pyeti me sy. Genci heshte.

— Ç'ndodhi me... — dhe pa guxuar ta plotësonte pyetjen, shikoi napolonat kartë, të shpërndarë nëpër dhomë.

— Foltë, çfarë ndodhi? — pyeti i përgjumur Kola nga dhoma tjetër.

Folta lëshoi një klithmë të mprehtë, ra në gjunjë dhe u zvarrit pas napolonave. Mblodhi sa mundi, i zhubrosi sa mundi, grisi sa mundi, hapi dritaren, i hodhi në errësirë dhe thirri:

— Merrini! Me-e-rri-i-ni-i!

Pastaj u kthye nga i biri, i mbuloi fytyrën me të dyja pëllëmbët dhe i tërë trupi i fërgëlloi nga dënësia të forta. E mjeruar dhe e çoroditur për krijesën e vet, si nënë e dhembës, por e tradhtuar, e dhunuar, e plagosur në trup e në shpirt, u shemb mbi krevat si cule e zezë.

— Foltë, çfarë ndodhi? — pyeti sërish i përgjumur Kola nga dhoma tjetër.

... Edhe në shpirtin e Genc Bogës diçka ishte shembur... diçka ishte ngritur... Me këtë përshtypje e me këto ndjenja e mendime të kundërta, ai u largua nga ajo shtëpi me fytyrë të ngrysur, sikur kthehej nga një varrim e me hap të matur, sikur futej në një betejë...



«Në qoftë se ti je grua trime, kur do ta tregosh veten veçse tashti?!» Kjo frazë i tingëllonte Gencit pas çdo hapi dhe ai nuk ishte i sigurt, ia kishte thënë tezes atë, apo e kishte mbajtur për vete.

Kur u hodh nga muri e kur Teli Bashari «ndolli dhinë e humbur», Genc Boga i përzuri mendimet, ose të paktën bëri sikur i përzuri dhe, që nga çasti kur shqoi Telin, fytyra e tij kishte marrë sërish shprehjen e zakonshme... Megjithatë, përtej atyre mureve, diku në një rrugicë e në një shtëpi, ishte ajo, Folta Papi, e gjatë, e drejtë, e bardhë, e zezë, e shembur mbi krevat si cule, ishte edhe ai, Krist Papi, i dremitur, me sytë e ftohtë e pa jetë në tavan, ishte edhe zëri i përgjumur i Kolës:

— Foltë, çfarë ndodhi?

3/16/83  
Jensuor nga Dix

X

## NJERËZIT ME TË ZEZA

— ... Ajo ecte me qetësi të shtirë, po në të vërtetë... As u takua me njeri, as i shkoi njeri në takim. Mund të them, — vazhdoi ai, — se vetëm një herë i buzëqeshi fshehurazi një të njohuri. Kaq. Pastaj erdhi pjesa më e rëndësishme e udhëtimit të saj. U largua nga rrugët kryesore dhe u fut rrugicave. Ecte ngadalë, po dukej që përgjonte, derisa u fut në shtëpinë e punëtorit të fabrikës së alkoolit, Besnik Sazanit, nr. 96, në dosjen e të cilit shkruhet se

ka qenë pjesëmarrës me armë në Revolucionin e Njëzetekatrës.

Njeriu me të zeza, ulur një metër poshtë e një metër larg katedrës, heshti. Dritat e zbehta, që zbrisnin nga një pikë e padukshme e tavanit, i binin mbi kokë dhe figura e tij deformohej nga hijet që shtypeshin poshtë. Si gjithmonë, ai të linte përshtypjen e një grumbulli leckash të mjera, të hedhura e të përplatura pa kujdes mbi karrige. Përballë tij, mbi katedrën e lartë ngrihej katërkëndëshi (kënddrejtë) me majucën e gjatë të mjekrës së zezë të shpërbërë nga ndriçimi i dobët që i vinte jo nga lart, por vetëm pjerrtas. Pas mjekrës së ndriçuar fort, pas hundës së ndriçuar vetëm në majë, diku aty në një pikë të arsyeshme mezi i shquheshin dy të çara, që duhej të të kujtonin sytë. Pastaj greminat e veshëve, shkretëtira e ballit dhe errësira, që mbështillej si lëmsh prapa shpatullave të tij të palëvizshme.

Zhurma e makinës së shkrimit, që vinte nga humbëtitrat e dhomës, heshti edhe ajo. Pritej që aty poshtë grumbulli i leckave të zeza të largohej, po kësaj radhe ai befasi qëndroi. Tha:

— Agjenti im i ri, Kristaq Papi, i quajtur Krist, morëm vesh se disa orë më parë vrau veten... ose u vra nga të tjerët!

Njeriu tjetër i zi, që dëgjonte nga lartësia e katedrës, u përkul pak dhe të çarat e errëta mbi hundë (sytë) iu zgjeruan, iu zbardhën për një çast, vetëm për një çast, se pastaj ato u kthyen përsëri në të çara të errëta, ndërsa trupi i madh, që kishte mbetur i përkulur përpara, vazhdonte të përkulej, derisa hija në murin prapa mori formën e një sëpate. Atëherë, nga gjysmerrësira u ngrit lart një krah i zi dhe mbi kokën po aq të zezë (çdo gjë e zezë) lëvizti ngadalë, si meteor (i zi), grushti i tij i stërmadh. Ky grusht qëndroi pak pezull, pastaj goditi fort. Dhe katedra rënkoj.

— **Finalmente!**<sup>1</sup> — thirri ai. — Ndodhi ajo që prisnim prej kohësh!

1) (it) më në fund.



Thirri prapë:

— **Le cartelle!**)

Prapa kurrizit të tij u duk për herë të parë gjatë seancave të natës një hije e tretë, që vendosi mbi katedër një vandak me dosje. Hija shkoi dhe u kthye disa herë dhe vandakū i dosjeve u bë si mur i ngjeshur rrotull katedrës, derisa njeriu me të zeza ose katërkëndshkënd-drejti thirri:

— **Basta!**<sup>2)</sup> Ç'janë gjithë këto dosje?

— Pjesëmarrësit në revolucion! — tha hija e tretë.

— Shumë!

— Po t'ju sjellim edhe të fshatit, do të duhej një sallë e madhe!

Katërkëndëshkënddrejti zgjati krahët, rrëzoi dosjet në dysheme, si të rrëzonte muret që e rrethonin, shkopsiti njëren sumbull të këmishës së zezë, bëri fresk me dorë, pastaj tha:

— Unë dua vetëm dosjet e atyre që kanë rënë nëpër burgje e që kohët e fundit i kemi pushuar nga puna!

Pas pak tri hijet u mblodhën kokë më kokë, pëshpëritën, ngurruan e ranë në mendime, thirrën e kundërshantuan, derisa më në fund u përpilua një listë me njëzet shtëpi, që duheshin rrethuar menjëherë.

Tha prapë ai nga katedra:

— **Stanotte... Domani sara tardi!**<sup>3)</sup> Përderisa Kristaq Papi u vra ose vrau veten, kjo do të thotë se Genc Boga ndodhet patjetër në qytet dhe **probabilmente**<sup>4)</sup> në njëren nga këto shtëpi!... **Siamo intesi?**<sup>5)</sup> — Dhe për herë të parë në seancat e natës njeriu i katedrës kaloi pëllëmbën e dorës nëpër tërë gjatësinë e mjekrës me majucë të hollë.

...Njëra hije u zhduk po në humbëtitrat misterioze të dhomës nga kishte dalë pak më parë. Hija tjetër, lëmshi

1) (it.) dosjet

2) (it.) Mjaft!

3) (it.) Sonte..., Nesër do të jetë vonë!

4) (it.) Ka të ngjarë!

5) (it.) U kuptuam?

me të zeza doli prapa ndërtesës, ku disa silueta të tjera vinin rrotull tinëzisht dhe prisnin sinjalin për t'u futur brenda. Por atë natë hyrja e fshehtë nuk u hap më. Bile nuk u hap as për Adelaidën. Diku në thellësi dëgjoheshin një mijë zhurma të mbytura. Zhurma këpucësh me gozhdë, zhurma helmetash, zhurma pushkësh e bajonetash, zhurma xhandarësh e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë zhurma të tjera, që po t'i përmbledhim në një të vetme, do të themi se ato zhurma u përkitnin kompanive ndëshkuese në çastet para nisjes.





## PROLOG 4

Jeta ishte vendosur mbi gërmadhat e një bote, themelet e së cilës po lëkundeshin, po shpërbëheshin, po rrafshoheshin. Të shtypurit e kishin gjakun të djegur nga këto gërmadha, të ndezur nga padrejtësia e të hakërryer nga ndjenja e hakmarrjes. Si të tillë ata përgatiteshin të mos e ndalnin hapin kundër botës së vjetër, që vërtet jepte shpirt, por që i ngjante një përbindëshi, rrezikshmëria e të cilit bëhet më e madhe në çastet e fundit. Ata donin të flitnin për heroizmin e të parëve dhe donin të ngrinin krye, bota e vjetër u thoshte, jini të bindur, jini të nënshtruar, kthejeni fytyrën nga kisha e xhamia. Ata donin të flitnin për të ardhmen e tyre dhe donin të ngrinin krye, bota e vjetër u thoshte kthehuni prapa, përuļjuni monarkisë, shkelmoni revolucionin. Por ata nuk donin të zmbropseshin, donin të dënonin



çdo bindje e nënshtrim të verbër, donin ta zhduknin skllavërinë, dhe në qoftë se dikush do t'i akuzonte si fajtorë, atëherë ata do të përgjigjeshin se nuk ishte faji i tyre, por i nënave që i kishin lindur të tillë dhe faji i botës së vjetër që, duke qenë vetë mizore e barbare, akuzonte trokun e botës së re, i cili shpejtonte të afrohej e të thoshte fjalën e vet...

— Daklea, shuaje dritën! — përsëriti Mentar Dika.

Genc Boga u ngrit në këmbë. Por u ngrit me vull dhe stoli rënkoj në heshtjen e mëngjesit të hershëm. Ai qëndroi një çast para tyre me sigurinë e njeriut që ndihet mirë, që ndihet i fortë, i çlodhur dhe i freskët. Fytyra dhe pushka që mbante në dorë, i kishin marrë shkëlqim të hirtë, të rëndë, shkëlqim nate e mëngjesi.

— Dritën! — përsëriti Genc Boga fjalët e Mentarit.

Fitili i llambës kërciti, llapsi, kërciti prapë dhe u shua. Aroma e natës dhe e mëngjesit të ngrohtë, ngarkuar me vesë e me aromën e gjelbërimit të pjekur e të vonë, u përzie me erën e vajgurit. Dhoma u errësua, me përjash-tim të dritares, ku derdhej ajo që s'mund të quhej akoma dritë. Daklea zgjati dorën dhe mbuloi fëmijët. Qetësi. Fry-mëmarrja e fëmijëve. Qetësi. Jashtë dëgjohehin kand-rrat. Jashtë ndihej gjithashtu heshtja dhe mugëtira. Genc Boga eci drejt derës. Mentari me Daklean i shkuan pra-pa. Ata nuk folën më. Nuk folën as në verandë, as në oborr, as në kopsht. Megjithatë, kur Genci vuri këmbën në shkallën e vogël, mbështetur pas murit, Mentari Dika pëshpëriti:

— Presim sa më parë, ndoshta që nesër të na dërgosh fjalë për të ngarkuar armët. Mos harro, vila do të shitet brenda javës!

Kur koka e Gencit doli baras me murin, ai qëndroi, u kthye nga Dikët, u kërrus dhe tha afërsisht:

— Mirupafshim! — Pastaj u hodh matanë.

Me të mbetur vetëm, Dikët u shikuan në sy. Ata e kuptuan menjëherë dëshpërimin e njëri-tjetrit. Ata sikur qenë mësuar me «mysafirin e rebeluar». Largimi i tij sikur u kishte lënë një zbrazëti. Ndërsa Mentari hiqte shka-llët, Daklea vuri syrin në njërin nga frëngjitë.

Atje përtej Genc Boga, që tashmë s'ishte veçse një si-



luetë, qëndroi në vend dhe sikur u kërrus, sikur u tkurr, sikur kërcëu anash dhe prapë u fut midis ca shkarëzimave të varoshit, të cilat mezi skicoheshin nga mugëtira. Po kësaj radhe ai sepse ishte kthyer me fytyrë nga vila, sepse ishte kthyer prapë dhe bile me hap të shpejtë. Nga larg koka i tundej në mënyrë të çuditshme. Pastaj gati vrapoi. Diku i ngeci xhaketa, u ndal për një çast dhe prapë vrapoi.

Prapa tij sikur dëgjohej një trokëllimë e mbytur hapash. Kur iu afrua murit të vilës, atëherë Dikët dëgjuan frymëmarrjen e shpeshtë të Genc Bogës, që kësaj here ishte edhe e rëndë.

— Genc, shkallët t'i kam vënë pas murit! — pëshpëriti Mentari Dika.

Kur u hodh në kopsht midis Dakleas dhe Mentarit, Genci tha:

— Kanë rrethuar vilën!

— A të njohën?

— Nuk e di!

— A të ndoqën?

— Nuk e di!

— Po tashti? — pyeti Daklea.

Frymëmarrja e Gencit ishte gjithnjë e shpeshtë. Dhe e rëndë. Pamja e tij kishte një shprehje thjesht zemërimi.

— Si ndodhi? — pyeti Mentari.

— Si ndodhi, unë nuk e di! — u përgjigj Genci, duke u përpjekur të imitonte gjakftohtësinë e Mentari Dikës, sado që nuk ia arriti plotësisht, sepse mushkëritë e lodhura nga vrapimi akoma nuk i ishin qetësuar. — Po di që jemi të rrethuar! — Vështrimi i tij kaloi nga Mentari te Daklea.

— Të rrethuar!

— Do ta përballojmë bashkë! — tha Mentari Dika. Pas atij toni të veçantë, me të cilin kishte shqiptuar fjalët e fundit, dukej sikur s'kishte mbetur më asgjë për të biseduar.

Megjithatë, Daklea pyeti:

— Do të ketë luftë?!

Nën çatinë e shtëpisë së vjetër me çardak e me qemer u dëgjua vërritja e përgjumur e kecit dhe pastaj zëri

i dridhur i dhisë. Në atë drithërimë dallohej dashuria e nënës për të voglin.

Daklea deshi ta prishte heshtjen e zgjatur, ajo deshi të fuste, të thërriste, por u kujtua se ishte qetësi dhe se xhandarët s'duhej të ishin larg. Megjithatë thirri, por, kur thirri, kishte arritur t'i mbyllte buzët me kurrizin e dorës:

— Pra, do të ketë luftë!? — Dhe qenia e saj u duk si tel i tërhequr fort.

Mentari dhe Genci shikuan njëri-tjetrin, pastaj Daklean. Dhia nxori përsëri një vërrimë të përgjumur. Keci jo. Dhe të gjithë e morën me mend se keci flinte tërë besim, me kokën të mbështetur te gjiri i saj. Po kur vërrima e dhisë u përsërit me nuancë me të theksuar, që të kujtonte vigjilencën e nënës, atëherë Genc Boga tha:

— Më duhet të bëj një përpjekje për të çarë rrethimin! — Nuk mund të thoshe se ishte duke shikuar Daklean, por s'mund të thoshe as të kundërtën. E qartë ishte vetëm një gjë: tashmë ai kishte marrë një vendim dhe ishte i inatosur me veten. Pasi mbështeti shkallët pas murit, vuri këmbën në shkallaren e parë.

— Do të vritesh! — tha Daklea, duke parë mëngjesin dhe Gencin me njërin këmbë në shkallaren e parë.

— Ndoshta do ta çaj rrethimin! — tha Genci dhe me shtrëngimin e buzëve ai sikur mundohej të transmetonte tensionin e frikshëm, por të papërfillur të forcave të veta shpirtërore.

— Do të vritesh! — përsëriti ajo.

— Nuk mundesh! — tha Mentari me zë të qetë. — Është vdekje e sigurt. Neve do të na duhet të luftojmë së bashku. S'jemi të parët që do të luftojmë të rrethuar, që do të çajmë e që ndonjëri nga ne ndoshta do të vritet! — Shqiptimi i fjalës së fundit për një çast shoi çdo gjë. Ideja e vdekjes hodhi një si vel të zi në mes të atyre njerëzve që pëshpëritnin rrëzë murit.

Pasoi një heshtje e gjatë, e cila u thye nga disa hapa të ngadalshëm e të njohur. Pas pak Teli Bashari doli nga mugëtirat e çartallosura të shtëpisë së vjetër pranë arrës së madhe dhe u ndal para tyre me fytyrën të lodhur, të



prerë nga rombe e kubikë të panumërt, të veçuar e të bashkuar, që lëshonin hije e shumëzoheshin nga reflekset e dobëta mëngjesore. Ai qëndroi i heshtur, duke shtrënguar në një rën dorë maliherin, në tjetrën gjerdanin. Tha:

— E mora me mend që kur u ktheve. Kështu ndodh. Natën bëjnë rrethimin, në mëngjes fillojnë luftën. — Ai kishte folur thjesht, si për një gjë të shënuar me kohë në rëndin kronologjik të ngjarjeve dhe mund të themi se qëndrimi i tij kishte larguar nga mesi i tyre hijet, dyshimet dhe lëkundjet më të fundit.

— Shkojmë të marrim armët dhe të vendosemi në pozicione! — tha Mentar Dika.

Qëndruan akoma përballë njëri-tjetrit, por askush nuk tha asgjë më tepër. Dhe secili nga ata të katër e besoi plotësisht se te kjo heshtje dhe te kjo qetësi e kishte buri-min fuqia e vërtetë.

## II

Lindja e diellit erdhi me cicërimat e veçuara të ndonjë zogu, me kantilena të qeta, me trille të gëzueshme, që dalngadalë u kthyen në një melodi të përsosur polifonike të harabelave, kumrive, cicërmive e të shumë zogjve të tjerë dhe kur në këtë kompozim spontan dëgjohej herë pas here e shkrehura e ndonjë laraske, si shkrehja e një pushke në mes të një kori, atëherë, të gjitha ato cicërima, kantilena e polifonira heshtnin menjëherë, por heshtnin vetëm për një çast, se në çastin tjetër ato derdheshin sërish në një melodi të re, me ritme të reja, me akorde të reja.

Dhe prapë:

Krr-krr-krr e kollitura e laraskës.

Paf.

Kjo kishte qenë një krismë. Një krismë e vetme. Pas kësaj gjithçka kishte ngrirë: një krismë revoleje me grykën lart...

Pastaj ra një heshtje që zgjati derisa dielli u ngrit një pëllëmbë mbi vargmalet e largëta.

Pranë sheshit të bashkisë u dëgjua zhurma e autobusit ose e atij që mund të quhej autobus, i cili çonte udhëtarët e parë në Tiranë. Në mesditë ata do të zbritnin në lulishten prapa bashkisë së kryeqytetit. Nga bashkia në bashki... Autobusi u nis dhe, si të ishte prituri kjo nisje, si të kishte qenë një sinjal apo një shans, nga fundi i varoshit përballë portës së vilës u dëgjua një zë i fortë:

— Mentar Dika, ne të këshillojmë ta dorëzosh sa më parë Genc Bogën që ke brenda. Rebeli do të gjykohej sipas ligjeve në fuqi!

Pas krismës e pas këtij zëri, zogjtë, kumritë e laraskat kishin heshtur dhe, për më tepër, nuk u dëgjua asnjë zhurmë tjetër anësore, asnjë akord, asnjë skapamento. Më saktë, të gjitha ose disa nga ato zhurma mund që edhe të vazhdonin, po veshët e të rrethuarve dëgjuan sërish vetëm zërin që përsëriti:

— Mentar Dika...

Tika-a-u-u.

— Tashti dëgjo ti të flasim ne! — thirri Mentar Dika.

— Fol!

— Ne dëshirojmë të nxjerrim jashtë fëmijët!

Heshtje e gjatë. Në fund të kësaj heshtjeje, u dëgjua:

— Asnjë fëmijë s'do të dalë jashtë pa dorëzuar më parë rebelin. Keni vetëm një orë afat për t'u menduar. Ky është ultimatum. Pas një ore shtëpia do të sulmohet e do të bëhet shkrumb e hi! Por para se të ndodhë kjo, duam t'ju kujtojmë se sot Shqipëria do të shpallet monarki demokratike. Dorëzimi i rebelit pa luftë do të bëhet shkak për zbutje dhe lehtësira gjyqësore!



Në mbarim të afatit të ultimatimit, secili, sipas planit të Mentar Dikës, kishte zënë vendin e vet. Genc Boggën ai e vendosi në ballë të vilës. Andej pritej sulmi kryesor, prandaj e furnizoi edhe me bomba dore. Teli Bashari do të luftonte në ballin e shtëpisë së vjetër, ku banonte vetë. Mentar Dika nga çardaku, ku ishte vendosur mitralozi, do të mbronte anën e prapme të vilës, që shikonte nga shtëpitë e lagjes periferike, si dhe anën jugore, që shikonte nga fshatrat. Që të dyja këto anë kufizoheshin me një përrua, në brigjet e të cilit kishte shelgje, plepa e rrape, ferra e gëmusha, kishte kallama e ligatina. Pikërisht në anën e prapme të vilës ishte edhe shpresa e shpëtimimit, në qoftë se do të mund ta mbanin luftën derisa të ngrysej. Po nga lartësia e çardakut, rrethuar me mure të trasha, ai mund të kontrollonte njësoj edhe ballin e vilës e çdo lëvizje tjetër aty rrotull.

Vetëm Daklea ishte lënë e lirë. Ajo do të mbronte fëmijët, që flinin akoma dhe do t'u bënte ndonjë shërbim luftëtarëve, kur ata të kishin nevojë.

Sapo mbaroi afati i ultimatimit, u dëgjua një krismë e vetme dhe vërshtëllima e një plumbi që kaloi mbi murin e oborrit, mbi tjegullat e portës dhe ra e copëtoi suvanë e ballit të vilës mbi verandë. Prapa heshtjes që zotëroi pas krismës, mëngjesi i shtatorit u duk bosh, pa jetë e pa lëvizje.

— Mentar Dika, — u dëgjua po ai zë, — vetë Tirana është interesuar për fatin tuaj. Dorëzimin pa luftë, shkëlqesia e tij Ahmet Zogu do ta vlerësojë si një gjest mbarsësie në këtë ditë të shënuar dhe do t'ju bëhen lehtësirat e rastit. Sot nuk është ditë për të luftuar. Sot është ditë mitingjesh e fishekjarrësh. Shqipëria do të bëhet me mbret. Tirana vetë ju jep tri orë afat për t'u menduar. Në orën dymbëdhjetë të mesditës fillon sulmi që do t'ju

fshijë të gjithë nga faqja e dheut. Mos t'ju gënjejë mendja se mund të dilni të gjallë nga vila. Rrethimi është i plotë. Pa shpresë shpëtimi. Presim të ngrini flamurin e bardhë!

Asnjëri nga të rrethuarit nuk lëvizi nga pozicionet e caktuara dhe në përgjithësi gjithçka mbeti e ngrirë, përjashtuar zogjtë që fluturonin e cicëronin si çdo ditë. Përjashtuar edhe vërrimat e dhisë e të kecit, si dhe lëvizjen e xhandarëve rrotull varosheve që kufizonin vilën, edhe lëvizjen e kamionëve ushtarakë që sillnin xhandarë e që merrnin disa të tjerë.

— Duan të na trembin, duan që të humbasim kurajën, — tha Mentar Dika nga çardaku. — Vringëllimë armësh, ja ç'është kjo varavingë. Po e vërteta mbetet e vërtetë, jemi të rrethuar dhe asgjë më tepër. Po megjithatë neve na intereson që ata të sulmojnë sa më vonë. Po ta mbajmë betejën derisa të errësohet, atëherë kemi shpresa për të çarë rrethimin!

Kështu kaloi një orë.

— A jeni gjallë? — thirri po ai zë nga varoshi.

— Po, gjallë jemi! — u përgjigj Mentar Dika.

— A po mendoni për dorëzimin?

Ky dialog u shkëmbye edhe në fund të orës së dytë. Por, kur ora e qytetit tingëlloi dymbëdhjetë herë, në vend të dialogut, në drejtim të vilës u nis një krismë. Një e dytë. Një rrëmujë krismash nga të dyja anët. Beteja kishte filluar.

Derisa krismat numëroheshin akoma, në fytyrën e të rrethuarve u shquan gjurmë tronditjesh dhe hutimi. Po këto gjurmë u shuan shpejt.



## GENC BOGA

Pushkët e rralla të fillimit, si dhe rrëmuja e krismave pak më vonë, dalngadalë u zëvendësuan me krisma që tashti qëllonin drejt pozicioneve. Një xhandar doli nga cepi i murit në fund të varoshit, më se pesëdhjetë metra larg dhe zgjati kokën. Pastaj nxori shpatullat, trupin dhe befasi u kthye prapë. Kur doli përsëri, dukej qartë se dikush e nxiste dhe e shtynte nga prapa. Genc Boga shënoi. Xhandari vuri dorën në ballë dhe ra në tokë. Një minutë më vonë nga të katër anët e vilës plasën batare pushkësh, thuajse asnjë grimcë ajri nuk mbeti pa u përshkuar nga plumbat dhe pa u mbushur me erë baruti. Oborri si dhe ajo pjesë e oborrit, që e kishin bërë zakon ta quanin kopsht, u mbuluan me bisqe e gjethe pemësh, ndërsa suvaja e ballit të vilës, që binte poshtë me copa të mëdha, thërrmohej dhe mbushte ajrin me tym të bardhë e të athët gëlqereje.

Tashti jo një, po disa xhandarë njëherësh zgjatnin kokën nga cepi i murit dhe i jepnin kurajë njëri-tjetrit. Ishte e qartë: mitralozi dhe pozicionet e frëngjive i kishin zënë në befasi. Po dikush i nxiste dhe ata sulmonin me zigzage, shtriheshin e hidheshin përpara me hope. Plumbat vërshëllenin me ankim, çanin ajrin dhe zukatnin si arrëza.

— Zjarr të dendur! — Ky ishte zëri i Mentar Dikës.

— Fishekë! — kërkoi Teli Bashari.

— Xha Teli, nuk t'i kanë fajet fishekët, por pushka, që e ke të vjetër. Merr tjetrën në verandë! — Ky ishte prapë zëri i Mentar Dikës.

Plumbat rrihnin muret e vilës, shponin trungjet e pemëve dhe ciflonin gurët, që nxirrnin xixa. Disa xha-



ma qenë thyer, disa korniza të dritareve qenë hallakatur, të tjera vareshin, të tjera kishin rënë poshtë. Tjegullat kërcitnin, fluturonin copëra dhe binin në oborr e gjetiu. Tymi i suvasë vazhdonte të ngrihej si mjegull e hollë...

Genc Boga vraponte nga një frëngji te tjetra. Shtinte dhe kontrollonte me pëllëmbë tytën e nxehur të pushkës.

— Zjarr të dendur! — Ky ishte zëri i Mentar Dikës.

Xhandarët herë tërhiqeshin si një sustë kur mblidhet, herë sulmonin prapë, si një sustë kur çlirohet. Dikush thërriste prapa tyre:

— Genc Boga, eja në shesh të burrave, eja!

— Zjarr! — Ky ishte zëri i Mentar Dikës.

— Genc Boga, eja...

Kjo thirrje i kujtonte Genc Bogës atë që i kishte ndodhur gjashtë muaj më parë, lidhur me historinë e ankandit të veprave të Naim Frashërit, kur te dera e përmbarimit zotërinjtë e rinj (i biri i pashës D dhe shoku i tij) i thanë: «Eja pasdite në klubin tonë Bristol, eja!...»

... Me gjithë përgjigjen negative që Folta Papi i dha djalit të pashës D Genci, duke i qëndruar besnik betimit të vet të heshtur, shkoi po atë pasdite. Me të hedhur brenda hapin e parë, hunda e tij u shpua nga era e alkooleve të ndryshme, përzier me erën e livandove po aq të ndryshme. Pa zënë akoma vend, Genci vuri re se në klub qe vendosur një heshtje e menjëhershme dhe kjo gjë bëri që ai ta ndiente veten si mbi gjemba. Të gjithë sa ishin aty kishin ndërprerë bisedat dhe e shikonin, sikur ai të ishte një kafshë e rrallë e një kontinenti të largët. Genci, që mezi kishte pritur sa të vinte, dëgjonte rrahjet e zemrës dhe nuk e dinte ç'pamje e ç'ngjyrë i kishte marrë fytyra. U ul dhe shikoi nga kamerieri. Po kamerieri (me kostum të zi, që ishte kthyer nga Amerika e që paria e kishte detyruar të hiqte papionin) i kalonte pranë «pa e vënë re». Atëherë Genci hodhi sytë nga banaku. Edhe atje u ndesh me fytyrën e ftohtë si prej mermeri të banakierit. Nëpër klub u shtuan pëshpëritjet, u shtuan edhe të qeshurat, edhe breshëria e porosive:

— Një konjak



- Jes, ser<sup>1)</sup>
- Rum!
- Si urdhëron, bej! O'kej!<sup>2)</sup>
- Fërnnet!
- Erdhi, mister!<sup>3)</sup>

U duk sikur lokali i ri e harroi Genc Bogën: pas heshtjes ai kishte nisur jetën e zakonshme.

— Jam go-go-gomari më i madh në botë, — fliste dikush me zë të lartë.

— Ti nuk i ke veshët të gjatë! — e ngushëllonte tjetri, më i dehur se i pari.

— Fant spathi! — Ai që foli e që mblodhi të gjitha letrat mbi tavolinë, qeshi me zë të hollë, si kone e goditur në bark: ki-ki-ki-i-i! — dhe befas zuri të shikonte Genc Bogën. Pastaj tha: — Jepini raki, se raki do ai, që të mbyllë zgurdën prej punëtori!

Genci ndjeu t'i ngjitej një zjarr në fytyrë. Ndjeu forcë në duar e kudo. Megjithatë u përmbajti dhe priti. Po nuk priti shumë. Te dera e klubit, me një vonesë të vogël prej autoriteti, u duk i biri i pashës D, i shoqëruar nga shoku i pandarë, që njihej edhe nga mustaqet e holla mbi buzët e holla. I biri i pashës D u afrua duke tundur një zinxhirkë, në majë të të cilit varej një si medalion i ndritshëm. Eci përmes tavolinës dhe, si pa të keq, qëndroi para Genc Bogës.

— Jam go-go-gomari më i madh në botë! — Ai që fliste dukej që vuante, dukej që ishte edhe i dehur.

— Të thashë, veshët nuk i ke të gjatë!

— Ma mori va-va-vajzën nëpër duar... Kamerier, një ma-ma-malaga!

— Jes, o' keji!

Zinxhirka dhe medalioni tundeshin para syve të Genc Bogës, i cili e ngriti kokën ngadalë dhe e gjithë pam-

1) ang.) — Po, zotëri!

2) (ang.) — dakord

3) (ang.) — zotëri

ja e tij, dhe e gjithë qenia e tij tregonin se mezi e kishte pritur këtë çast e këtë takim.

Djali i pashës D, që ishte zverdhur e që dukej i egër, e rrotulloi zinxhirkën në gishtin tregues dhe e preku Gencin paksa në faqe. Një e qeshur e lehtë dhe tallëse u valëvit nëpër klub dhe pastaj e qeshura fluturoi si zog nëpër dritaret e hapura. U dëgjua:

— Jepini një libër pa kapakë të Naim Frashërit, që të largohet i kënaqur!

Banakieri dhe kamerierët ndërprejnë çdo lëvizje. Disa myshterinj, që nuk qeshnin, kishin shtangur si pinguinë.

— Fant!

— Prapë fant!?

— Ç'kujtove ti?— dhe i mbloodhi të gjitha letrat, duke qeshur ki-ki-ki-i-i... — Jepini një libër të grisur!

Djali i pashës D (brakicefali), i shoqëruar nga shoku i tij mustaqehollë, buzëhollë e kokëhollë (dolikocefali), e vërtiti prapë zinxhirkën dhe prapë e çiku Gencin në faqe me atë si medalion të ndritshëm.

— Shpojeni me gjilpërë, që të zgjohet nga gjumi!

Të qeshura fluturoese nëpër klub.

— Jepini një dollar të ngopet me bukë, pastaj të kthehet këtu!

— Kujdes, hapni sytë! — tha dikush me seriozitet. — Duket si qenie e veshur me forcë primitive, që ka lindur tek ai para se të lindnin djajtë!

— A s'e vini re, — tha një tjetër me tallje, — librat që ka lexuar e kanë mësuar të mbahet me dinjitet!

— Na qenka serioz si një murg!

— Kujdes, ju them! — tha prapë ai që fliste me seriozitet.

Në fund të këtyre shakave, apo në fund të këtyre të vërtetave (lexuesi le t'i marrë si të dojë), të qeshurat ishin ndërprerë krejtësisht dhe klubi Bristol kishte rënë në një heshtje, ku mund të dëgjohej edhe zukatja e një mize të vetme.

Tashti, përveç djalit të pashës D dhe shokut të tij, Genc Boga pa aty pranë edhe banakierin, fytyra e të cilit kishte marrë pamjen e të zotit të shtëpisë, kur midis miq-



ve të rëndësishëm i vjen papritur një kushëri i varfër. Ai e shikonte Gencin në heshtje dhe lutej me të gjitha tiparet, me të gjitha gjymtyrët, me rrobat e me gjithçka tjetër, vetëm e vetëm që mysafiri i paftuar të largohej sa më parë nga lokali i tij.

Genc Boga futi paketën e cigareve në xhëp dhe befaz buzëqeshi. Ne nuk e dimë si e qysh e mori e si e qysh e shpjegoi djali i pashës D atë buzëqeshje, po dimë që befaz sytë e tij u dukën si dy gryka pushke.

Tha djali i pashës:

— Ke ardhur këtu për të çuar përpara revolucionin e mjekërcjapit Fan Nol, ë?

— Kam ardhur t'i përgjigjem ftesës që më bëre në mëngjes në sallën e ankandit! — foli me ironi Genc Boga. Tek shikonte ata sy — gryka pushke — Genc Bogës i vinte t'i pështynte dhe ai e vërviti pështymën nëpër gojë, por në çastin e fundit u përmbajt. U përmbajt edhe kur djali i pashës D tha:

— E ka hutuar zhurma e klubit!

— Sikur t'i jepnit një dackë për ta sjellë në vete! — e këshilloi plot mirësjellje shoku aty pranë.

— Mund t'i jap një dackë, po kam frikë se mos shkërmoqet si rërë, — tha djali i pashës D. Megjithatë ai e goditi lehtë në faqe me shpinë të dorës, me gjestin e kavalierëve, kur godasin armikun me dorëzë për ta ftuar në duel. Shoku i tij ndiqte me sy lëvizjet e djalit të pashës D, si qeni kur ndjek lëvizjet e të zotit.

Tashti ishin ndërprerë edhe frymëmarrjet. Por dëgjohej zukatja e mizave.

Genc Boga u ngrit në këmbë ngadalë dhe u duk se e bëri këtë pa dëshirë dhe po ashtu ngadalë kërciti dhembët me inat. Pastaj e mbërtheu për jake djalin e pashës D, i hodhi dorën tjetër në bel dhe e ngriti peshë. Pa u lëkundur e pa ndër vështirësi, me të mbi kokë, eci përmes rreshtave të tavolinave (tavolinat dhe njerëzit kishin shtangur nga kjo e papritur, ndërsa djali i pashës D përpëlitej dhe shikonte me sy të zgurdulluar, si të ishte i pranishëm në përmbysjen e botës) dhe e vërviti drejt xhamit të madh



e të trashë të klubit. Xhami nxori një si krismë revoleje dhe u thërrmua i tëri në kokrriza gati të padukshme, disa nga të cilat e pickuan Genc Bogën në fytyrë...

... Xhamat e verandës u thyen gati të gjithë. U thyen me zhurmë dhe ranë në oborr. Disa cifla erdhën deri te Genc Boga. Bashkë me to erdhi edhe zëri i Mentar Dikës:  
— Bombat!

Breshëritë u vërshëllenin mbi kokë. Plumbat ciflonin gurët e frëngjive, ciflonin tjegullat e mureve e të çatave dhe rrëzonin bisqe e gjethe pemësh.

— Xha Teli, shko në ndihmë të Gencit!

Edhe Mentar Dika andej e kishte kthyer mitralozin, nga sheshi përballë portës dhe që nga çardaku i shtëpisë së vjetër mitralozi i tij dukej sikur ishte vënë në garë me pushkët e mitralozat që shtinin drejt vilës nga këndet e rrugicave. Shi plumbash.

U thyen edhe xhamat e fundit të verandës.

... Një cep i xhamit të madh kishte mbetur pa u thyer. Genc Boga edhe atë e theu me shkelm. Djali i pashtës D përpëlitej në trotuar, pa qenë në gjendje të fliste. Shoku i tij mezi e ngriti e mezi hodhi një hap, duke thirrur për ndihmë një karrocë.

Kur Genc Boga doli në trotuar, prapa krahëve ndjeu vetëm heshtjen e thellë të klubit. Pastaj, deri te veshët e tij erdhi një uturimë e mbytur. Pastaj ajo u bë më e fortë, më e afërt dhe më e paduruar. Instinktivisht Genci u kthye me fytyrë nga uturima, dhe pa atë që e kishte parë më parë me sytë e mendjes: të gjithë ishin ngritur në këmbë, ishin grumbulluar, ishin ngjeshur sup më sup dhe me fytyra të egërsuara ecnin drejt tij. Genci qëndroi dhe hapi pak këmbët, si për të qenë i gatshëm për çdo rast. Një, kundër dhjetëra vetave. Që kur hyri këtu, ai e dinte se kishte hyrë në gropën e gjarpërinjve të helmuar, që mbanin erë alkoolesh e livandosë e që s'mund të jetonin ndryshe, pa qenë të egërsuar e pa pickuar botën me helmën e tyre. Ai e merrte me mend edhe fundin (jo më kot të afërmit e farefisi e kishin quajtur kokëshkretë), e me-



gjithatë, befas, ngriti dorën. Alkool e livandomëdhenjtë qëndruan si të hipnotizuar. Ai i shikoi me neveri ato fytyra të bardha, të ngjallura e të lyrshme.

— Nuk paska mbetur asnjë i ndershëm midis jush?!  
— Kjo qe fraza e dytë që Genc Boga shqiptoi në klubin Bristol. Tjetër frazë ai s'pañi kohë të shqiptonte, sepse turma e fytyrave të lyrshme tashmë kishte dalë në trotuar e kishte rrethuar dhe qe lëshuar kundër tij. Edhe Genci u lëshua kundër tyre. Të parët ai i përmbajti, i përballloi, i mënjanoi, i rrëzoi përtokë, por ata ishin shumë..

— Genc! — thirri Mentar Dika nga çardaku. — Genc!  
— përsëriti ai.

Genc Boga mezi e dëgjoji zërin e Mentarit nga breshëritë dhe ulërimat e xhandarëve.

— Bombat! — Tha Mentar Dika.

Genc Boga u ngrit në këmbë dhe hapi portën e vilës për të vërvitur bombat mbi xhandarët, por nuk pa asnjë prej tyre, sepse ata ishin tërhequr nga breshëritë e mitra-lozit të Mentar Dikës. Atë çast dëgjoji prapa krahëve zërin e njohur:

— Mbylle portën!

Pas këtij vërsrimi të parë, Genc Boga ishte qetësuar. Në fytyrë i kishte rënë një hije e ndritshme optimizmi, që ishte vetëm e tij... Tashmë ai kalonte i qetë nga një frëngji në tjetrën dhe më i qetë fliste me vete:

— Diçka po ndodh!

Thellë nga qendra e qytetit dëgjoheshin muzikat, tingujt e të cilave herë afroheshin, herë largoheshin. Dëgjoheshin edhe krisma... Krisma të largëta e të mbytura...  
Tha prapë me zë:

— Diçka po ndodh! — Genc Boga, që kishte pasur rast ta njihte mirë periferinë e qytetit, sidomos gjatë jetës së shkurtër prej komiti, përcaktoi menjëherë vendin e krismave: posta numër tre. Ai që luftonte atje ishte, ose duhej të ishte, Lato Morina që, sipas fjalës, do të qe afruar për ta pritur Gencin te Guri i Bardhë.

Dueli i pushkëve aty dhe atje,

Tymi i suvasë ngrihej si mjegull e hollë. Dhe ai tym mundonte më shumë Teli Basharin, që ishte plak e që kollitej shpesh.

## V

### TELI BASHARI

E tërë e kaluara e Teli Basharit, tërë jeta e tij s'kishte të bënte fare me këtë betejë e me gjithçka tjetër që pëndodhte atë ditë. Ai asnjëherë s'kishte bërë luftë, bile as në afërsi të saj nuk ishte ndodhur. Kishte qenë dëshmitar e bashkëkohës, por jo pjesëmarrës i Revolucionit të vitit 1924. Kishte qenë dëshmitar e bashkëkohës, por jo pjesëmarrës i Luftës së vitit 1920, kundër pushtuesve italianë në Vlorë. Kishte dëgjuar për vitin 1912 dhe për shumë beteja të tjera më të vjetra kundër turqve, por Teli Bashari, që i kishte kapërcyer të shtatëdhjetat, kishte vazhduar gjithmonë punën e vet, pa i hequr kurrë nga duart çekiçin e gozhdët. Ai jo vetëm s'kishte luftuar asnjëherë, por as kishte shtirë. Mund të kishte shtirë rastësisht në një gjueti, edhe atje jo në nishan; vetëm përpjetë, i mobilizuar me pahir nga qehallarët e një beu, sa për të trembur e për të futur gjahun në shteg. Por edhe kjo kishte ndodhur tridhjetë vjet më parë (në kohën e sulltan Hamidit). Megjithatë, më shumë për forcë zakoni, edhe ai e kishte blerë një pushkë të vje-



tër, të cilën (përsëri për forcë zakoni) e mbante gjithnjë të pastër e të vajosur. Po tashti, tek rrinte pas frëngjisë dhe përpiqej të shikonte përmes perdes së syve të plakur xhandarët që bërtitnin e shtinin përballë, Teli Basharit i vinte keq që s'kishte marrë pjesë në asnjë nga betejat që ishin bërë në truallin e Shqipërisë.

Disa xhandarë që dolën nga cepi i murit bashkë me të tjerë, kishin marrë drejtimin e frëngjisë, ku luftonte Genc Boga dhe vinin përballë me kërcime të çuditshme. Teli Bashari mezi ua shquante rrobat në shtrojën e gjelbër të varoshit. I bëhej sikur dëgjonte një zë të egër:

— Hidhu!

Por edhe veshët, si sytë, nuk i kishte të kthjellët.

— Hidhu!

E megjithatë, mund të thoshte se ai ishte zëri i kapiten Shaban Sinanit.

Nxori tytën e pushkës në frëngji. Çap. Pushka nuk i ndezi. Xhandarët afroheshin me hope, shtriheshin e ngriheshin. Me hope e me zigzage. Çap. Përsëri nuk i ndezi.

Phu, pështyu Teli Bashari dhe, pasi e shikoi pushkën me dyshim, i futi në gojë fishekun e tretë. Sakaq, ai vuri re se xhandarët, që ishin hedhur drejt frëngjisë së Genc Bogës, po zmbropseshin. Vuri re gjithashtu, se mitralozi i Mentar Dikës qëlloi në varoshin përballë dhe cifla të tjerë u ngritën pranë frëngjisë së tij. Çap. Nuk i ndezi. Kur pa se xhandarët qenë fshehur prapa cepit të murit, Teli e përplasi pushkën në tokë. Dhe po atë çast iu bë sikur dëgjoi përmes krismave:

— Xha Teli, merr pushkën tjetër në verandë!

Krisma.

— Tjetrën në verandë! — Po. Ky ishte zëri i Mentar Dikës.

Teli Bashari u ngrit ngadalë, me lëvizje prej plaku, dhe eci drejt verandës. Aty u vonua pak, se kishte dëgjuar të qarar e fëmijëve, sidomos të Letës dhe zërin e Dakleas, që u jepte kurajë. Së fundi mori të kthehej te frëngjia e tij me pushkën tjetër në dorë, po diku qëndroi menjëherë, si t'i kishte dalë një pengesë e pakapërcyeshme.

Thirri:



— Genc, o Genc!

Po Genci vazhdoi të shtinte. Dhe Teli Bashari harroi pse e kishte thirrur. Harroi jo vetëm nga pleqëria, por edhe nga tronditja për atë që po i shikonin sytë...

Dëgjoji, ose iu duk sikur dëgjoji:

— Bombat! (Ky ishte përsëri zëri i Mentar Dikës.)

Pas pak po ai zë:

— Xha Teli, shko në ndihmë të Gencit!

Po vërtet, përpjekja bëhej para frëngjisë së Genc Bogës. Teli Bashari u drejtua nga ai dhe befas thirri:

— Genc!

Ah, tashti u kujtua Teli pse e kishte thirrur pak më parë. Njëri nga xhandarët po i ngjitej murit mbi kokën e Gencit.

— Ge-e-enc! — i thirri ai sërish, ngriti pushkën dhe shtiu. Xhandari klithi, u rrëzua nga muri dhe u largua si lejlek me një këmbë. Po Teli Basharit nuk i bindeshin duart. Nuk i bindeshin shpejt. Sa e vendosi pushkën në frëngjinë pranë Gencit, sa i xori gëzhojën dhe i futi fishekun tjetër, sa mori nishan me sytë që i kishin zënë perde, sa lëvizi gishtin dhe e shkrepiti, xhandari, duke kërcyer, gjithmonë si lejlek, u fsheh pas cepit të murit, pesëdhjetë metra në fund të varoshit.

— Vonë! — tha Teli Bashari me vete, por me zë. — Vonë! — tha prapë.

Përsëri heshtje. Përsëri krisma. Dhe në këto heshtje të copëtuara e krisma të rralluara, deri te veshët e Teli Basharit vinin zërat e qytetit e të rrugicave pranë. Një bori makine. Edhe një tjetër. Makinat ecnin shpejt. Dhe ishin makina të mëdha. Makina ushtrie. Sjellin xhandarë, tha Teli me vete. Në shtëpinë pranë dëgjohej vaji i një fëmije. Një hingëllimë, trokëllima e potkonjve të një kali. Të kalit të kapitenit të xhandarmërisë, tha Teli me vete. Ai kishte mbetur i çuditur: veshët po i kapnin tinguj e zhurma që s'i kishin kapur prej vjetësh. Dhe prapë pushkët. Dhe prapë beteja. Dhe prapë dueli. Kur ja, andej thellë, në sheshet e rrugët e qytetit u dëgjuan muzikat, që herë afroheshin, herë largoheshin. U dëgjuan edhe krisma



pushkësh, po Teli e pati vështirë të përcaktonte vendin ku binin. Më pranë dëgjoi zërin e Gencit, që pëshpëriti:

— Diçka po ndodh!

Këtu luftë. Atje muzika. Luftë edhe në një cep të periferisë.

— Po, po, diçka po ndodh! — imitoi Teli Bashari fjalët e Gencit dhe nxori tytën e pushkës në frëngji.

## VI

### MENTAR DIKA

— Toger Dika, ç'të duhet gjithë ky municion? — pyeti togeri i prapavijës, që ishte përgjegjës i depove të municionit rrëzë malit të Dajtit. — Po ta gjetën zogistët, të pushkatuan në vend!

Kjo bisedë bëhej në një kohë kur ushtria e Revolucionit, pas ndeshjes së fundit në Qafën e Priskës, nuk ekzistonte, ose pothuajse nuk ekzistonte më. Mentari Dika kishte mbajtur pas vetes jo më shumë se një skuadër.

Vështrimet e dy togerëve u ndeshën, siç ndeshen dy bile biliardoje kur bëjnë karambol. Me sa dukej, që në bankat e akademisë në Itali, togeri i depos ishte mësuar t'i vlerësonte vështrimet e Mentari Dikës, me të cilin nuk i kishte ecur asnjëherë. Prandaj, pas një ngurrimi të vogël, e uli i pari vështrimin e tij dhe pyeti i zemëruar:

— Toger Dika, prapë nuk të kuptoj, ç'të duhet gjithë

ky municion? — Kështu tha ai dhe shikoi shtatë ushtarët që shoqëronin Mentar Dikën. Vështrimi i tij kishte qenë thjesht ekzaminim, si për të matur vendosmërinë e tyre në rast se konflikti ashpërsohej deri në përdorimin e armëve. Edhe prapa togerit të depos qëndronin dhjetë ushtarë që shërbenin në depo dhe s'mund të thoshe se atyre aq u bënte grindja e dy oficerëve.

Në hapësirën e ngushtë të asaj që mund të quhej edhe depo, edhe zyrë (një e ndarë me dërrasa në mes të depos), ku dy togerë të rinj, të armatosur, të parruar, të lodhur, të ashpër, qëndronin përballë njëri-tjetrit, duke u shikuar me pabesi, me egërsi e me kërcënim, ishte krijuar një atmosferë antagoniste, së cilës mund t'i duhej vetëm një gjest i pamatur, një lëvizje e dyshimtë ose e pandërgjegjshme, që të shpërthente e të pëlciste gjithë municionin që ndodhej aty, të hidhte në erë gjithë sa ndodheshin aty...

— Hidhu!

Mentari i vërshëlleu një plumb mbi kokë. Xhandarët ishin hedhur në sulm nga ana e përroit. Ndodhi ashtu siç e kishte parashikuar ai. Sulmi i dytë u bë nga ana e prapme, pikërisht në pjesën e varosheve, që ishte më e thyera, që ishte me shkarëzima e që gjatë shirave të dimrit krijonte një si liqen të gjatë, një si rrip uJOR, një si hendek natyror, që fillonte nga vila dhe zgjatej deri afër përroit, ku seroseshin rrapet, shelgjet e plepat. (Kishin sulmuar pikërisht andej nga shpresonte Mentari se do të çanin rrethimin kur të ishte errësuar.) Në fillim xhandarët vrapuan në këmbë nëpër terrenin e thyer, po kur u penguan nga breshëritë e mitralozit të Mentar Dikës, që i gjeti të papërgatitur e në befasi, u kërrusën. Pastaj u shtrinë dhe bënë përpjekje të përparonin drejt vilës me zigzage e me zvarritje. Po Mentar Dika lëshoi breshëri të gjata sepse, nga përvoja si ish-oficer, ai e dinte se çastet e para të betejave kishin rëndësi të madhe dhe vendimtare për gjithë zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

— Hidhu! — Ky nuk ishte zëri i kapitenit. Ky ishte vetëm përgjasimi i zërit të tij.

— Hidhu! (Përgjasimi.)



U dëgjua një klithmë e një rënkim. Disa xhandarë, pasi hodhën në krah ndonjë të vrarë a të plagosur, duke përfituar nga terreni i thyer, vrapuan dhe zunë pozicione më të përshtatshme.

Tashti dihej: ata që kishin zënë pozicione e që mbësh-teteshin nga një ose më shumë se një mitraloz, së shpejti do të hidheshin në sulm. E kështu, duke pasuar njëri-tjet-rin, xhandarët mund të arrinin rrëzë mureve që rrethonin vilën. Dhe po të arrinin deri aty... Ishte çasti më i përshtat-shëm për të përdorur bombat e dorës. Vetëm me shiun e copave të tyre mund të shpërnguleshin nga pozicionet që kishin zënë... Dhe u shpërngulën.

... Mentar Dika, duke pasur besim në drejtësinë e fja-lëve të veta, tha:

— U kuptuam, toger?

Togeri i depos shqyrtoi përsëri me një vështrim të shpejtë ushtarët prapa krahëve të Mentar Dikës. Pavarë-sisht se ajo që pa në fytyrat e tyre nuk i pëlqeu, ai tha:

— Ushtria u thye. Fan Noli bashkë me anëtarët e tjerë të qeverisë zunë Vlorën dhe presin vaporin që të largohen. Re-vo-lu-ci-o-ni u përmbys, toger!

Këto fjalë, megjithëse s'ishin të reja e megjithëse di-heshin, prapëseprapë tingëlluan të rënda si varë. Por ta-mam në këtë pikë kulminante të vlimit e të antagonizmit, toger Dika bëri atë pyetje, të cilën, me sa dukej, e prisnin prej kohësh ushtarët e të dyja palëve, sepse nuk kishte kuptim tjetër lëvizja e përgjithshme dhe e pandërgjegjshme e trupave të tyre, që pak më parë kishin qenë të ngrirë si hej akulli.

— Po kur punët qëndrojnë kështu, toger, atëherë më thuj, pse e ruan këtë municion dhe për cilin e ruan?

Heshtje.

Tha prapë Mentar Dika:

— Për Ahmet Zogun, që po vjen i armatosur deri në dhëmbë me armë, me municione, me bashibozukë të huaj? (Prapa krahëve të të dy togerëve fluturuan copa fja-lësh miratuese.)

Pas kësaj pyetjeje e pas këtij kundërveprimi të për-



gjithshëm, togeri i depos jetoi një gjendje dualizmi, shikoi për të fundit herë sytë e kaltër e të çelët të toger Dikës dhe iu bë sikur ata ishin ndezur nga një flakë e fshehtë. Toger Dika nga ana e vet kishte lëmuar me pulpat e gishtave mustaqet e shkurtra dhe i kishte lëmuar ngadalë, sepse lexuesi e di, ai i lëmonte ato sa herë që të tjerët ia kuptonin mendimin, ose sa herë atij vetë i lindte një mendim i tmerrshëm. Ta vras këtë toger, se armik do të bëhet, mendoj toger Dika.

Po togeri i depos, si ta kishte kapur me kohë këtë mendim, qe zmbarsur në çastin e fundit. Tha me zemërim:

— Mirë, toger Dika!

Pas kësaj fjale në depon e municionit, ushtarët u çliruan, morën frymë lirish, si të kishin qenë para një mine, së cilës sapo i kishin hequr mekanizmin sekret.

— Merri ato që të duhen, toger Dika, por jam i detyruar të mbaj shënime në regjistër!

Pas shënimeve antagonizmi u duk sikur kaloi nga fytyrat e njerëzve në faqet e regjistrit, sikur u ngushtua midis vizave të tij, u fut në kallëpë dhe u përjetësua aty.

Pastaj toger Dika ngarkoi kuajt dhe u largua, pa i humbur nga vështrimi (aq sa kjo ishte e mundur) sytë e turbulluar të togerit të depos... Si e shpërndau edhe skuadrën e fundit të kompanisë së vet, me të cilën gjashtë muaj më parë qe futur në Tiranë dhe gjashtë muaj vigjëloi për të mbrojtur revolucionin, Mentar Dika e vazhdoi rrugën e shoqëruar vetëm nga një ushtar. Tashti rruga ishte gjithnjë tatëpjetë, në drejtim të Tiranës, që mbulohej e zbulohet nga lëmshet e mjegullave të rënda e të dendura...

Mentar Dikës i theri një dhimbje në krahun e majtë. Ishte plagosur dhe pas pak ai pa gjakun mbi xhakëtë. Por duhej ta duronte dhimbjen, të lidhte plagën, të ndalonte gjakun, të zgjaste jetën, të luftonte, ta turpëronte sa më shumë armikun. Duhej të hakmerrej për shokët e vrarë, për shokët e burgosur, të internuar, të emigruar. Duhej të hakmerrej për Daklean, për fëmijët, për vete, për jetën e rëndë të të gjithëve, për Shqipërinë, për Revolu-



cionin që ishte përmbysur. Duhej t'u tregonte armiqve se beteja e sotme s'ishte tjetër veçse një shkëndijë e zjarrit që ishte ndezur në vitin 1924. Ai zjarr nuk ishte shuar. Dhe nuk do të shuhej kurrë. Ai priste çastin të ndizej e të pëlciste prapë... Gjaku zuri t'i pikonte nga mënga, po fundja, për Mentar Dikën vdekja kishte qenë gjithmonë një fuqi që nuk kapërcehej dot, nuk shmangej, ajo ishte një e vërtetë e trishtueshme, por edhe e madhërishme. Ajo mund të ishte edhe e turpshme. Hoqi xhaketën, grisi astarin, pa harruar t'u lëshonte breshëri xhandarëve, që lëviznin te përroi në fund të varoshit dhe me ndërprerje të shkurtra zuri të lidhte plagën.

Xhandarët sulmuan sërish. Kësaj radhe ata sulmuan njëkohësisht nga balli i vilës e nga varoshet prapa. Mentar Dika e kuptoi se kapiten Shaban Sinani po luante kartën e fundit: po bënte sulmin vendimtar. Në qoftë se zmbropset ky sulm, thoshte me vete Mentari, armiku do të pësojë një goditje morale, që do të shtojë shpresat tona për ta mbajtur luftën derisa të ngryset.

(Më dhemb krahu, më dhemb shumë krahu!)

Pas pak Mentar Dika hapi kasetën e tretë të municionit. Poshtë kishin mbetur edhe shtatë kaseta. Kishin mbetur edhe tri arka me bomba. Mund të luftonin akoma.

... Pasi e futën municionin në vendet e fshehta të shtëpisë së ushtarit të kompanisë, ata e ndien veten tepër të lodhur (një javë të tërë që luftonin kundër bandave të Ahmet Zogut, një javë të tërë që nuk flinin, ose flinin fare pak), qepallat u ranë si plumb dhe i zuri gjumi para se të kishin thënë që duhej të flinin.

Të nesërmen Mentar Dika u zgjua pa gdhirë mirë, me gojën të hidhur, me kokën të turbull e me vështrimin më të turbull. Ishte as në gjumë, as zgjuar, kur e gjithë bota rreth tij u zhduk dhe mbetën vetëm ai, vetëm shokët e shpërndarë, Revolucioni i përmbysur dhe një pikëpyetje e madhe për të ardhmen... Ai e dinte se një pjesë e shokëve kishin marrë arratinë për të kapërcyer kufijtë. Të tjerë qenë shpërndarë nga dy e nga tre. Kishin lënë edhe takime, parulla, kishin shfaqur dëshira e hamendje nga



më të ndryshmet dhe që të gjitha këto hamendje e parashikime qenë dukur reale dhe të mundshme. Një takim të tillë kishte lënë edhe ai po atë mbrëmje...

Largoj batanijet, u ngrit në këmbë (atë çast vuri re se kishte fjetur i veshur) dhe filloi ecejakun nëpër dhomë, i brengosur e me shpirt të dërrmuar, duke shikuar herë-herë përtej xhamave siluetat e pemëve, që mezi shquheshin në mungëtirën e parë mëngjesore. Pastaj dëgjoji një si zhurmë. Pastaj mendoi se atë zhurmë e bënte i zoti i shtëpisë. Pastaj deshi të bisedonte menjëherë me të: kur të agonte, largimi i tij do të paraqiste rreziqe të shumta. Rrotulloi çelësin, hapi derën, po kur u gjend përtej pragut, disa hije të zeza si lugetër iu hodhën përsipër. Një minutë më vonë vuri re edhe ushtarin, të zotin e shtëpisë të lidhur e të gjakosur. I morën të dy...

(Më dhemb krahu, më dhemb shumë krahu!)

Deri në çardakun e shtëpisë së vjetër erdhi jehona e ca krismave të reja. Ato kishin ardhur nga një tjetër pikë, që s'ishte më në postën numër tre, po mund të ishte në afërsi të postës numër dy, mund të ishte një vatër e re përpjekjeje, e cila si e para, lëvizte, shuhej e ndizej sërish diku gjatë, gjithmonë rrotull periferisë së qytetit.

... Miku, ish-ushtari i Revolucionit, futi kuajt në oborrin e vilës, që ndriçohej nga hëna, shikoi Mentarin me buzëqeshjen e tij të vrarë nga tre vjetët e burgut, e përqafoi dhe një copë herë nuk gjeti fjalën me të cilën duhej të fillonte bisedën. Mentarit i kujtohej se edhe gjatë Revolucionit ai kishte qenë ushtari më i heshtur, prandaj foli i pari:

— Qenke rrezikuar!

— Ani çka, duhen, zoti Mentar. Se mos mbaroi lufta jonë! — Shikoi barrën e kuaive. Mitralozi, fishekët e arkat me bomba ishin fshehur nëpër thasë. — Ti, për këto të shkreta, s'pate kohë të mendoje për vete. Të arrestuan. — Ai nuk përmendi se bashkë me Mentarin që arrestuar edhe vetë, se bashkë me Mentarin që dënuar edhe vetë.



Asgjë s'tha për këto, as aty, as më vonë, kur ishin rreth vatrës, kur hanin darkë e pinin duhan.

Tha prapë:

— Anë çka, zoti Mentar, pushka dhe fisheku duhen gjithmonë. Njerëz jemi. Me armiq!

Duke shikuar arkat me bomba, që ishin pesë, fishekët e pushkëve dhe dhjetë kasetat e mitralozit, që ishin të paprekura, të paçelura, Mentar Dika tha:

— Pse nuk paske mbajtur ca municion për vete?

— Kam, zoti Mentar. Kam edhe dy pushkë të tjera! Të kujtohet, zoti Mentar, me sa zor ia shkëputëm këto armë togerit të depos? Të kujtohet se si zogistët e përmbysën shtëpinë, por s'gjetën asgjë, asnjë fishek? Thashë me vete, këto armë e këta fishekë paskan këmbë të mbarë. Ja, këtu do të jemi, do ta shikosh, një ditë do të na e zbardhin faqen përsëri!...

— Bombat! — thirri Mentar Dika.

— Zjarr të dendur! — thirri prapë.

Pastaj beteja u bë ashtu si bëhen të gjitha betejat. Herë zbriti nga çardaku Mentar Dika dhe shkoi pranë Genc Bogës e Teli Basharit, ta zëmë për të hedhur bomba bashkë me ta, herë u largua nga frëngjia Genc Boga dhe hipi deri në çardak për të luftuar bashkë me Mentar Dikën. E kështu me radhë.

(Më dhemb krahu, më dhemb shumë krahu!)

Jehona e bandës ushtarake ishte gjithmonë në lëvizje. Atje dëgjoheshin jo vetëm tingujt e saj, por edhe të lehurat e qenve që, si kafshë me instinkte të zhvilluara, e kishin bërë zakon ta prisnin bandën me të lehura dhe ta shoqëronin e ta përcillnin po me të lehura.

## VII

### DAKLEA DIKA DHE FËMIJËT

Për Daklean çdo vërshëllimë plumbi lidhej me një mendim, që mund të ishte i tmerrshëm, po mund të ishte edhe thjesht një mendim i çfarëdoshëm, një mendim i papërcaktuar akoma. Të gjitha këto mund të lexoheshin lehtë në fizionominë e saj, si dhe në vështirimin e syve kafë të çelët. Pastaj befas ajo u shkund. E kishin shkundur krismat e mitralozit të Mentarit në çardakun e vjetër. E kishte shkundur edhe zëri i tij i shqetësuar:

— Zjarr të dendur!

Ajo u drodh tek i pa fëmijët kruspull e tek i përfytyroi të vrarë ose të plagosur. Krismat fluturonin në oborr e mbi çati. U thye edhe xhami i fundit i dhomës së gjumit dhe plumbi u ngul në mur. Një herë Daklea mendoi t'i zbriste fëmijët nën qemerin e shtëpisë së vjetër, në bodrumin e fshehtë, ku kishin mbajtur armët dhe Genc Bogën. Por jo. Mund të binte zjarr, mbeturinat e shtëpisë së vjetër mund të shembeshin dhe fëmijët mund të mbeteshin të bllokuar brenda.

Leta qau e para. Ajo fërkoi sytë, shpërndau lotët nëpër faqet e zverdhura dhe qau, me të qarën që ngjante aq shumë me të mamasë: me vaj, me dënësë, me ngashërim. Gimi shikonte si i madh, pa i përplasur qepallat.

— Mama, shkojmë te babi! — tha ai.

— Jo, Gimi, — tha Daklea.

— Po s'duhet ta lëmë vetëm babin. Ata mund të na e vrasin, të na e burgosin prapë, dhe pastaj kush do ta lirojë nga burgu, si atëherë kur ti më ke thënë se unë isha tre vjeç? — Por ai më kot përpiquej të mos e tregonte frikën, se ajo dukej në sytë e tij.



Sa për Katin, çështja ishte më thjesht e më ndryshe. Ajo pothuajse nuk ndihej fare. Për të sikur s'kishte ndodhur asgjë. As pse ishin zgjuar herët: ajo shpesh qe zgjuar pa aguar, nga shkëlma të panjohur e të papritur. As pse vërshëllenin plumba; ajo ishte rritur midis zhurmave e krismave. Veç ajo, duke qenë më e madhe se dy fëmijët e tjerë, sikur kishte kuptuar pak më shumë se ata dhe sikur pyeste: mos do të ndahem nga ju, nënë Daklea, mos do të mbetem prapë vetëm?!

Në mur u ngul një plumb i dytë.

Kur i vendosi fëmijët në këndin e aneksit, Daklea sikur u qetësua pak dhe po atë çast dëgjoji zërin e Mentarit sipër, te çardaku i shtëpisë së vjetër. Pas këtij çasti breshëria e mitralozave dhe e pushkëve u bë më e dendur. Daklea as e kishte marrë me mend se lufta mund të ishte kaq e egër. As në përralla. Bile në përralla lufta i qe dukur shpesh si lodër e thjeshtë dhe e këndshme.

Kur Mentari thirri: «Genc, hidh bombat!», ajo ra mbi fëmijët, si për t'i mbrojtur nga plumbat, që rrëzonin suvanë e mureve të dhomës së gjumit. Ajo dhe fëmijët filluan të kolliteshin, Leta të qante.

— Pusho, Leta! — thirri me inat e me dhimbsuri Daklea.

Leta pushoi vetëm një çast. Hunda e vogël si e Dakleas, të kujtonte fëmijët e këndshëm, por kokëfortë.

— Pusho, Leta! — tha prapë Daklea.

— Pshe të pushoj? — pyeti ajo.

— Sepse duhet të pushosh!

— Jo, më thuaj pshe të pushoj?

— Të dëgjojmë babin aty lart!

Në një nga këto çaste, kur beteja qe ndezur me bomba, Leta u drodh, mbylli sytë me duar (në vend të veshëve) dhe u hodh kutullaç në prehrin e së ëmës. Gimi, megjithëse edhe ai qe trembur, kishte mbetur pa lëvizur e pa përpëlitur qepallat... se edhe i ati nuk i përpëliste qepallat.

Pasi kaluan gjëmimet e bombave, Leta, që me sa dukej ishte mësuar disi me breshëritë e krismave, tha midis ngashërimeve:



— Mami, a të qaj pak për bukë?

— Pas pak do të hamë, — tha Daklea, që përgjonte vërshtëllimat e plumbave.

— Pshe xha Teli nuk shkon të na shjellë bukë shi përditë?

— Do t'ju ziej ca misër! — u kujtua ajo. Pa e zgjatur zbrazi trastën në tenxhere dhe e vuri në zjarr.

Leta shikonte zjarrin, tenxheren, misrat dhe thithte gishtin e madh.

Këto biseda e teka të fëmijëve, këto qëndrime të papritura, dëshira e kërkesa të tyre, që herë e preknin, herë e bënin të mendohej, e kishin ndihmuar Daklean të shkëputej sado pak nga pyetja që u vinte kryqin të gjitha pyetjeve të tjera: ç'do të bëhet me ne?... Ja ku e mbajtëm luftën derisa të ngryset, pastaj? ... Pastaj?... Ajo as e merrte me mend si do të mund ta çanin rrethimin në errësirë! Por vetë koha që kalonte, vetë beteja me të gjitha ngjyrat e luhatjet e saj, dalngadalë sikur po e humbiste atë diçka të veçantë e të jashtëzakonshme që kanë në fillim betejat. Të gjitha këto, si dhe bota e pafajshme e fëmijëve, sikur kishin ndihmuar për ta hedhur Daklean në bregun tjetër të këtij lumi të egër. Kështu, hijet e dëshpërimeve të vjetra e të reja, që lëvrinin në sytë e saj, kishin zënë të tulateshin e të shuheshin, kishin zënë të bëheshin pjesë e pandarë e asaj jete që s'mund të ishte ndryshe veçse e tillë, veçse e trazuar dhe e egër.

— Bombat, Daklea, Bombat! — u dëgjua zëri i Mentarit në çardakun e shtëpisë së vjetër.

Bombat! ja çfarë kishte kërkuar ai.

Daklea i porositi fëmijët të mos lëviznin, ndërsa vetë kërcëu në këmbë, vrapoi jashtë, u fut nën verandë, mbushi gjirin me bomba dhe u ngjit me vrull nëpër shkallët e drunjtë, të vjetra e rënkuese të çardakut.

Këtë aksion, që për Daklean ishte i pari që nga fillimi i betejës, ajo e bëri shpejt dhe me njëfarë qeifi. Por, duke lëshuar bombat pranë të shoqit, papritmas dora e saj e dridhur, e ngushtë, u zgjat në drejtim të krahut të lidhur të Mentarit dhe pyeti:

— Të dhemb?



(Më dhemb krahu, më dhemb shumë krahu!)

— Pak, — tha ai. — Tashti shko! — Mentari kishte vënë në përdorim notat më intime e më të dashura të zërit.

— Të veshësh xhaketën, — tha ajo.

— Nuk duhet, është vapë!

— Atëherë të ta lidh më mirë! — tha ajo.

Disa xhandarë po sulmonin përballë vilës, drejt frëngjisë së Genc Bogës. Mentari i vuri dorën në kokë Dakleas dhe e uli prapa murit të çardakut, ndërsa me dorën tjetër lëshoi breshëri të shkurtra.

— Shko, pra! — tha pas pak.

— Medoemos duhet të shkoj?

Kjo pyetje e dykuptimtë, në të njëjtën kohë mund të tregonte se Daklea ishte trembur, po mund të tregonte edhe këmbëngulje për të kërkuar se ç'duhej të bënte dhe ku mund të ishte vendi i saj. Por, meqë u bë në një çast kur askush (pra, as Mentari) nuk mund të përqendrohej për ta analizuar, mbeti pezull e pa përgjigje. Megjithëse Mentari në atmosferën e betejës bëri sikur nuk i dha rëndësi pyetjes së Dakleas, s'mund të thoshe se në qëndrimin e tij kishte falsitet, përkundrazi, ai qëndrim ishte krejt i natyrshëm dhe krejt i domosdoshëm.

Daklea fshiu ballin e djersitur me mëngën e fustanit dhe heshti. Mentari prapë lëshoi breshëri.

— Pse nuk shkon?! — e qortoi ai. — Fë-mi-jët!

Daklea fshiu prapë djersët, por fjala e rrokëzuar, *fë-mi-jët*, si të kishte qenë një mal me magnet, të cilit ajo nuk mund të mos i bindej, e vuri në vrap drejt tyre.

Pak më vonë, kur dueli i armëve kishte zënë të rrallohej e në një çast të caktuar të heshtte fare, veshët e Dakleas kapën krisma të tjera, që vinin nga anë të tjera të periferisë së qytetit. Tashmë ishin bërë tri vatra krisroheshin e që ktheheshin përsëri në vendin e mëparshëm. Por kësaj radhe veshët e saj dëgjuan edhe një zhurmë tjetër si nga mesi i qytetit, një zhurmë që ngjante me një murmuritje njerëzish në ditë pazari.

— Po kjo? — pyeti Daklea me zë dhe u vu të përgjonte

me kujdes zhurmat e largëta, muzikat, krismat rrotull qytetit. — Ç'po ndodh? — pyeti ajo.

Leta më parë qau, pastaj tha:

— A të qaj një çikë për bukë?

— Ah! — u kujtua Daklea, hoqi nga zjarri misrat e zier dhe fëmijët zgjatën duart.

## VIII

### KATI

— Bombat! — thirri prapë Mentari.

Daklea u hodh në këmbë.

— Daklea! — thirri ai. — Bombat!

Po më parë se Daklea qe ngritur Kati.

— Ti ku shkon? — pyeti Daklea.

— Atje! — tregoi Kati me gisht çardakun.

— E di ti cilat janë bombat?

— Sa herë që xhaxhi Mentari kërkon bomba, ti shkon tek arkat nën verandë dhe mbush gjirin!

— Do të shkoj unë, — tha Daklea. — Ti qëndro me Gimën dhe Letën.

Drejt Dakleas u zgjat krahu i Katit, i gjatë, i hollë, i djegur nga dielli. Me gishtat e thatë të duarve, ajo e shtrëngoi Daklean në bërryl. Tashti jo vetëm shikimi, por edhe mënyra si e shtrëngonte në bërryl, e përforconte lutjen e Katit.

— Bombat! — thirri prapë Mentari nga çardaku.



Ai nuk e kishte shqiptuar akoma të gjithë fjalën, kur Kati qe hedhur përpara me një kërcim të gjatë, kishte dalë në verandë dhe kishte zbritur shkallët, prapa të cilave ndodheshin arkat e bombave... Që nga ai çast Kati herë ngjitej me vrap nëpër shkallët e drunjtat të çardakut për të zbrazur gjirin e saj të vogël, që s'mernte më shumë se pesë bomba, herë ai gjë zbrazej te këmbët e Genc Bogës, herë futej në vilë (gjithmonë me vrap) dhe dilte prej andej për t'i çuar xhaxhi Telit ujë, por edhe fishekë i çonte. Tashti ajo e dinte ku ishin gjerdanët dhe trastat, kasetat e mitralozit, bombat gjatore e të vogla si vezë, i dinte të gjitha dhe nuk e ndërpriste vrapin, me përjashtim të rasteve kur shtrihej për t'u mbrojtur nga bombat e xhandarëve që pëlçitnin nëpër oborr. Këtë e bënte rregullisht, sepse ashtu i thoshte mendja, ashtu i kishin thënë edhe xhaxhi Mentari, xhaxhi Genci, xhaxhi Teli. Pastaj kthehej nga oborri njësoj si nga fusha e betejës, buzëqeshte dhe nga kjo buzëqeshje fytyra e re sikur i plakej disa vjet nga rrudhat anës syve dhe anës buzëve. Pas atyre buzëqeshjeve të rralla edhe prekat, që i kishte të kaltra, me kaltërsinë e bojës së freskët të shkrimit, i zbardheshin, i zverdheshin, ndërsa fytyra i shëmbëllente me një letërthithëse të vjetër, mbuluar me pika të zbehura nga koha.

— Bombat! — thirri prapë Mentari nga çardaku i shtëpisë së vjetër.

Në të vërtetë Kati kishte dalë jashtë që kur Mentari Dika s'kishte shqiptuar as gjysmën e kësaj fjale.

Bombat gjëmonin, jehonin breshëritë, vërshëllenin plumbat, thyheshin edhe copat e fundit të xhamave. Kishte kohë që Leta ishte hedhur përsëri symbyllur në prehrin e së ëmës; që Gimi kishte mbështetur kokën në supin e së ëmës; që Kati, e sapokthyer, rrinte pranë Dakleas, e zverdhur, e dobët, duke shikuar rrotull, si të mendonte diçka, si të kurdiste diçka, që s'e kishte menduar e kurditur deri atëherë. Ajo kishte frikë... por jo betejën, diçka tjetër. «Mos do të na ndajë kjo luftë?!...» Dhe ishte shumë e lodhur.

Në thirrjen tjetër nuk u ngrit Kati, por Daklea. Edhe ajo bëri një copë herë po atë vrap që kishte bërë Kati. Kështu derisa u lodh, derisa u zëvendësua përsëri nga Kati e Kati përsëri nga Daklea.

Beteja vazhdonte...

## I X

### KAPITENI – RRESHTERI – XHANDARI

Kapiten Shaban Sinani, pasi nxori jashtë rrezes së vështrimit këpucët e ndotura me dhera e barishte të egra të varoshit, më në fund e hodhi vështrimin prej inkuizitori drejt dy inferiorëve, të cilët qëndronin gatitu para tij. Pastaj u ngrit nga karrigia, bëri një ecejak nëpër pluhurin e rrugicës, mendoi se në përgjithësi shpirti i aventurave zotëronte jetën e njerëzve dhe befaz qëndroi përballë tyre.

— Ju të dy, pra, — tha ai, — keni ardhur tek unë të më thoni se, meqë ia dini të fshehtat vilës, merrni përsipër të futeni atje brenda, t'i arrestoni ose t'i vritni ata dhe t'i jepni fund luftës para orës katër e gjysmë, ë?!

— Po, — foli i pari rreshter Ago Agoja dhe kjo «po» u duk sikur doli jo nga goja e tij, por nga syri i madh i çapëlyer (që ishte i paduruari), ndërsa syri i majtë, i ligu, dinaku, që ishte më i vogli e që dukej edhe më i zgjuar; u rrëgjua aq, sa gati u mbyll. Dhe kapiteni pikërisht atë sy shikonte, se vetëm ai sy mund t'i ngjallte



shpresa të vagëlluara. Kurse lloshi tjetër, xhandari i ri, që e thërritnin me atë emër të shëmtuar (Shkëlqim), sa herë i dilte përpara, i kujtonte kapitenit ca ndjenja të pëgëra, siç i kujtonte edhe emri kuplara, bordell, apo shtëpi publike (kështu quhej së fundi nga partizanët e jetës moderne), ku ai vetë jo vetëm që s'ishte futur kurrë, por as pranë nuk pranonte t'i shkonte. Gati çdo ditë kapitenit i vinin informata për moskryerjen e detyrës nga xhandar Shkëlqimi dhe gati çdo ditë gjurmët e këtij xhandari ose përfundonin në kuplara, ose dilnin nga kuplaraja. Kapiteni do ta kishte pushuar me kohë nga puna, por e kishte penguar dy gjëra. E para, miku që kishte ai farë Shkëlqimi në sferën e lartë të prefekturës dhe, e dyta, natyra e tij e papërmbajtur jo vetëm në çështje të seksit, por edhe në ego, në zili, në smirë, në lakmi (në grykësi po se po) e në një mijë vese të tjera, që në rrethana të caktuara ishin jo vetëm të nevojshme, por edhe të domosdoshme për jetën dhe aktivitetin e një xhandari. Kështu, që, kapiteni vendosi t'i duronte të paktën edhe një herë ndjenjat e pëgëra që i ngjallte pamja e Shkëlqimit dhe ta shikonte drejtpërdrejt në ballin me qoshe.

— Bile ti ke premtuar, — tha kapiteni, duke u kthyer nga Shkëlqimi, — se, po të të jepet rasti, do të rrëmbesh vajzën katërvjeçare, që mund të hallavitet aty rreth dhe, duke e vendosur në gryën e hapur të pusit, do të kërçenosh prindërit të dorëzohen, se përndryshe... Kështu, ë?..

— Po, — vërtetoi xhandar Shkëlqimi.

Një plumb, që shkërmoqi tjegullat e murit, prapa të cilit mbroheshin kapiteni, karrigia e tij, plus adjutanti, lëshoi cifla dhe i detyroi të gjithë të shkundeshin.

— Dhe, në mos gaboj, — tha prapë kapiteni, — njëri nga ju kërkon si shpërblim vilën. — Kapiteni shikoi rreshter Ago Agon, (ky i fundit tundi kokën, «po»). — Tjetri kërkon të gradohet aspirant. — Kapiteni shikoi xhandar Shkëlqimin, (ky i fundit tundi kokën, «po»).

Kapiteni Shaban Sinani sikur ra në mendime, sikur kujtoi e sikur përsëriti diçka... Një orë më parë, këshilltari i atij që s'mund të quhej më president, por që s'ishte bërë



as mbret, e kishte marrë në telefon, e kishte kërcënuar, i kishte thënë se vetë shkëlqesia e tij Ahmet Zogu ishte mjaft i interesuar për fundin sa më të shpejtë të betejës në qytetin N, i kishte thënë gjithashtu se po të vazhdon-te beteja deri në orën katër e gjysmë të pasdites, kur ish-presidenti do të shkonte në parlament për të vënë kuro-rën, vetë shkëlqësia e tij presidenti, apo naltmadhnia e tij mbreti (këshilltari ishte ngatërruar disa herë me emër-timin e titullit), kishte urdhëruar pushimin e menjëhe-shëm nga puna të kapiten Shaban Sinanit, burgosjen e tij, gjyqin e... Po midis fjalëve që kishin shkaktuar rrëmujë në shpirtin e kapitenit, ai mbante mend se këshilltari, du-ke transmetuar gjendjen, mendimet, urdhrat dhe propo-zimet e presidentit apo të mbretit, kishte nënvizuar faktin se për t'i dhënë fund turpit që po ndodhte ditën e parë të shpalljes së monarkisë në një vilë periferike të një qy-teti të rëndësishëm. kapiteni duhej të tregohej jo vetëm këmbëngulës, por edhe dinak. Ai mund të premtonte shpër-blime të mëdha dhe grada të larta, bie fjala, një xhandar mund ta propozonte për rreshter, por edhe për kapiten. Edhe shumë gjëra të tjera mund të premtonte... Fundia edhe me top mund t'i binte vilës, vetëm e vetëm që ajo të heshte para orës katër e gjysmë. Por... kishte shtuar këshilltari pas një pushimi të shkurtër, topi do të përdorej vetëm në rast se nuk do të gjendej mënyrë tjetër për t'i dhënë fund rrethimit të vilës.

Kapiten Shaban Sinani u ul në karrige, nxori nga xhepi një blloknot të vogël dhe shkroi atë... që ne s'dimë çfarë ta quajmë, po për lehtësi e për komoditet, mund t'ia vëmë emrin dëshmi, ku vërtetohej se po të kryenin filan aksion filani dhe filani, atëherë xhandar Shkël-qim Fanit i jepej grada kapiten, kurse rreshter Ago Agos i dhurohej vila e Dikëve.

Kapiteni u zgjati dëshmitë dhe tha:

— Të shkoftë mbarë, rreshter Ago Agoja, zot i vilës së Dikëve!

Rreshteri mori dëshminë dhe sikur ia pati qejfi të thoshte një fjalë:

— Fol! — tha kapiteni.



— Po vila është rehen te Veniamin Çeku!  
— Rehenin e paguan shteti, dhe vila të mbetet ty!  
— Tellalli po thërret për ankandin e saj, — tha rresh-  
teri, duke hedhur në faqet e thara të kapitenit grepin e  
syrin të vogël, (të ligut, dinakut).

— Tellalli?! — briti e pyeti kapiten Shaban Sinani.  
Pastaj shikoi nga aspiranti që, si gjithë adjutantët,  
nuk largohej kurrë më shumë se pesë hapa nga kurrizi i  
tij. Urdhëroi:

— I thoni zotit Nazmi ta tërheqë menjëherë ankandin  
dhe tellalli ta mbyllë atë zgurdë të vjetër e të çjerrë!

Cifla tjegullash ranë prapë përpara kapitenit dhe për-  
para të tjerëve. Për më tepër një plumb, që çau ajrin aty  
pranë, lëshoi një vërshëllimë, të ngjashme me atë të një  
gjarpri të egër e të etur.

Pastaj kapiteni i zgjati dëshminë xhandar Shkëlqimit  
dhe tha:

— Të shkoftë mbarë, kapiten Shkëlqimi!

Xhandar Shkëlqimi u drodh, si ta kishte zënë epilep-  
sia, mori dëshminë nga duart e kapitenit dhe sikur ia  
pati qejfi edhe këtij të thoshte një fjalë.

— Fol, — tha kapiteni, pa e shikuar në sy kaplara-  
xhiun e famshëm të qytetit.

— Zonjën... Daklea..

— Çfa-a-a-arë?— pyeti kapiteni me ton tmerrësisht  
të çuditur.

— Zo-zo-njën Da-daklea për mantenutë! — tha xhan-  
dar Shkëlqimi me një zë të huaj, siç ishte e huaj dhe e re,  
e ardhur nga përtej detit edhe vetë fjala *mantenutë*.

Kapiten Shaban Sinani në mënyrë krejt të pandër-  
gjegjshme vuri dorën në këllëfin e revoles. Ta vras, tha  
me vete, dhe menjëherë i shkrepri në kokë, se asgjë nuk  
do të dilte nga një maskara i tillë. Po heshtja dhe tensioni  
që ishte nderë midis katër burrave që ndodheshin aty,  
sikur i kujtoi kapitenit të përmbahej, sikur... i kujtoi  
bisedën telefonike me këshilltarin e oborrit dhe në çastin  
e fundit që duhej të nxirrte revolen, shtrëngoi grushtet  
dhe tha me zë të përmbajtur:



— Xhandar... kapiten Shkëlqim Fani, një komandant xhandarmërie nuk merret me mantenutat!

Tha prapë:

— Nisuni! Ju shkoftë mbarë!

Kur kapiten Shaban Sinani mbeti vetëm (plus hija e aspirantit, që i vinte nga prapa dhe i shtrihej deri te majat e këpucëve), fytyra e tij me faqe të thara kishte marrë shprehjen e disa seriozitetëve... e disa mistereve... ndërsa qenia i qe mbledhur, i qe mpirë, i qe tkurrur, siç mund të mpihet e të tkurret vetëm ndjenja e hidhur dhe e rëndë e dështimit. Ndërsa rrinte ulur në karrige pas cepit të murit, me kurriz të kthyer nga beteja e nga vila, pinte duhan dhe shikonte vetëm këmbët e veta, më saktë, vetëm majat e këpucëve të ndotura nga dherat e barishtet e egra të varosheve. (Sa herë ato këpucë kishin ecur drejt vilës! Dhe sa herë qenë kthyer me thembra nga vila!)

— Për të ndihmuar planin e dy budallenjve, — tha pas pak kapiteni, — jep urdhër të shtohet zjarri e të sulmohet vila nga të gjitha anët!

— Si urdhëron! — Aspiranti kërciti thembrat dhe, ndërsa largohej, kapiteni e shikoi nga prapa me vështrim të verdhë e me vdekjen në zemër. Nuk i kishin mbetur as dy orë, pastaj... çfarë do të ndodhte më pastaj, kapitenin e tmerronte...

Por, duke shoqëruar me sy largimin e aspirantit, kapiten Shaban Sinani vuri re se për herë të parë gjatë asaj vere të nxehtë e të thatë, në një cep të qiellit ishin dukur ca re të holla e të bardha. Vapa e kishte munduar muaj me radhë kapitenin dhe ai i kishte pritur prej kohësh ato re bashkë me shiun freskues që do të sillnin pas vetes... Por... diç ndjeu kur i pa tashti, diçka që as vetë s'e kuptoi, siç gurisht diçka të zymtë. Fundja, s'ishin vetëm retë që e bezdisnin: ishte edhe uturima e largët, që vinte si nga qendra e qytetit. Ishin edhe pushkët e tjera (tri pushkë), që lëviznin si zhivë rrotull periferisë. Hoqi vështrimin nga shpatullat e aspirantit, si rrjedhim edhe nga retë dhe e nguli përsëri te këmbët e veta.



## X

— Rrugët janë mbushur me popull, që veshët dhe hapin i kanë drejt vilës! — foli gati me oratori aspiranti.

— Mirë, — tha kapiteni me gjakftohtësi të shtirë. — Populli në rrugë duhet të jetë sot. Festë është, festë e madhe! — Shikoi nga aspiranti. — Le të vihet banda në krye e le ta tërheqë popullin andej nga dëshiron ajo.

— Derisa banda hedh hapin në drejtim të vilës, populli i shkon prapa, po kur ajo merr drejtimin e kundërt, populli shkëputet.

— Ç'mendim ke, aspirant?

— Prefekti urdhëron të merren disa forca nga vila e rrethuar dhe të përdoren për të disiplinuar popullin.

— Të urdhëroj të marrësh vetëm pesë xhandarë nga forcat që kanë rrethuar vilën. Dhe nga një xhandar për çdo shtëpi tjetër të rrethuar.

Aspiranti nuk lëvizi.

— Çfarë akoma? — pyeti kapiteni dhe hoqi vështrimin nga majat e ndotura të këpuçëve të veta.

— Mos ndoshta erdhi koha t'i heqim fare forcat që kanë rrethuar shtëpitë e tjera?

— Jo!

Aspiranti nuk lëvizi.

— Fol, aspirant!

— Tashmë është e qartë, rebeli ndodhet këtu!

— Kjo nuk dihet akoma. Nuk dihet sa janë e ku janë. Xhandarët thanë se kishin parë një njeri që kishte dalë nga varoshet prapa vilës dhe që befas ishte kthyer prapë. Kush na siguron se ky njeri është pikërisht Genc Boga? Kush na siguron se këtu nuk lufton vetëm Mentar Dika me ndonjë tjetër, ta zëmë, me atë matufin që ndreq këpuçë? Asgjë s'dimë akoma me siguri. Pastaj mos harro, përveç vilës kemi edhe tri vatra zjarri të tjera. Ku është pra Genc Boga, këtu, atje, apo në njërin nga shtëpitë e tjera?



— Atëherë të kërkojmë ushtarë, — tha aspiranti.

— Jo, — tha prerë kapiteni. — Ushtarëve nuk u besoj. Edhe Genc Boga ushtar ishte kur na ngjau ajo me Veteranin e Luftës rrëzë Maleve të Shqipes.

— Postat kërkojnë përforcime, — tha aspiranti me zë të përmbajtur.

— Largohu, aspirant, dhe zbato urdhrat që të dhashë. Në radhë të parë të më sigurosh topin. Unë pres topin, kurse ti merresh me fjalë të kota!

Nuk dihet sa priti e sa ndenji kapiteni ulur në karrige, me vështrim te majat e ndotura të këpucëve, por dihet që në njëfarë kohe aspiranti u gjend sërish përballë tij, me dorën në strehën e kapelës. Fytyra e re e vartësit, si një libër i hapur, shpejtoi t'i kumtonte kapitenit ato që akoma nuk ia kishte thënë me gojë.

— Pas një ore topi do të jetë gati! — dhe i zgjati një pusullë.

Kapiteni lexoi pusullën, shikoi orën e xhepit. Tre. Topi do të arrinte në orën katër. Kështu të paktën, menjëherë pas orës katër vila do të rrrëzohej në tokë dhe do të bëhej e mundur të vendosej qetësia në qytet. Do të fillonin festimet e pezulluara. Do të punonte telegrafi dhe oborri do ta merrte lajmin pikërisht kur Ahmet Zogu do të ishte duke dalë nga pallati për të shkuar në parlament.

Kapiteni hodhi sytë përtej dhe pa një rreze dielli të zbriste nga retë e të shtrihej me përtaci midis shelgjeve, plepave dhe rrapeve. Shelgjet, plepat dhe rrapet lundronin, pastaj hepoheshin gati për t'u përmbysur në tokë. Retë ndeheshin të palëvizura (lëviznin plepat, dhe rrapet, dhe shelgjet). Dhe kapiteni nuk kuptonte çfarë ndodhte, nuk kuptonte se ku bëheshin ato lëvizje. Në fëmijëri ai kishte pasur qejf kur pemët e minaret vozitnin nëpër qiellin me re. Por jo tashti. Tashti ai ishte përqendruar vetëm te pusulla. Pasi e kishte lexuar, pasi e kishte kuptuar, së fundi e palosi dhe e futi në kuletë. Kështu pati futur në kuletë shumë vite të kaluara emërimin e tij si komandant xhandarmërie me vulën e Princ Vidit. Në kuletë. Topi në kuletë, mendoi dhe buzëqeshi papritur. Dhe po aq pa-



pritur fytyra iu ngrys sërish: sërish breshëritë e mitralozit dhe pëlcitjet e bombave. E kujt i kishte shkuar në mendje se në një vilë qyteti paskësh pasur mitraloza e bomba, tha kapiteni me vete.

Atje përtej çatia e vilës dhe akoma më përtej plepat, rrapet e shelgjet lotuese, lundronin në drejtim të lindjes dhe, nga ky lundrim në hapësirë, të dukej sikur të gjitha çatitë do të gremiseshin në fund të botës.

— Disa minuta para fillimit të qitjes, — tha kapiteni, — do të largoni xhandarët që kanë zënë pozicione nga ana e përroit prapa vilës!

— Si urdhëron!

— Qitjen do ta bëjmë nga balli, direkte, prandaj duhet pasur kujdes që asnjë qytetar të mos afrohet në drejtim të përroit, barinj të sidomos. Rrethimin do ta mbyllni menjëherë sapo të pëshojë topi e sapo të dëgjoni bilbilin tim!

— Si urdhëron!

— Të bëni luftë të zgjuar. Të tjera forca hëpërhë nuk kemi.

Pas pak:

— Atëherë shko! — tha kapiteni. — Jo, prit! — Pasi mbuloi fytyrën e aspirantit me tymin e cigares, tha: — E di ti, aspirant, se megjithatë topi do të vonohet?

— Jo, — tha aspiranti i çuditur. — Topi është nisur! S'ka pse të vonohet!

— Topi do të vonohet, sepse ushtria është në fushim...

— Por topi...

— ... sepse majori është tepër burokrat, ai ka detyruar prefektin vetë të presë më se një orë!

— Atëherë ç'të bëjmë? — pyeti aspiranti.

— Të shkosh prapë të telefonosh!

— Si urdhëron!

Kur mbeti vetëm, kapiteni kishte marrë një pamje që dukej më shumë e keqe se e rëndë. Buzëqeshi, por hidhur. E po hidhur dëgjoi pushkët në periferi dhe uturimën e turmës diku atje poshtë. Muzikat binin. Qentë lehin. Qentë gjithmonë lehin, kur dëgjojnë muzikë e pushkë, mendoi kapiteni. Mendoi prapë: po ata të dy, rreshteri batall dhe xhandari i pëgërë, ç'janë duke bërë tashti vallë?



## XI

Beteja vazhdonte prej tri orësh dhe ai ishte në një gjendje shprese e dështimi, qenieje dhe mosqenieje, kur i thanë:

— Kapiten, po vjen ajo!

Kapiten Shaban Sinani ngriti kokën aq sa duhej për të parë një njeri që vinte përballë. Pyeti:

— Cila, ajo?

Te kthesa bëri ballë një grua e gjatë, e drejtë, e bardhë, e zezë, që ecte as ngadalë, as shpejt, por me kokën lart e me vështrimin përpara, ecte me të ecurën e vet të përjetshme, të cilën ajo nuk e ndryshonte kurrë.

Tha kapiteni:

— Ç'punë kam unë me të?

Pas disa sulmeve dhe tërheqjeve kapiteni ishte ulur aty për të pirë një cigare e për t'u marrë më në qetësi me mendimet e veta. Siç ndodh zakonisht në fushat e betejës, kur kapitenët tërhiqen, kur oficerët vendosin të bëjnë një pushim sado të shkurtër, beteja bie pak, po mund të bjerë edhe shumë, mund të arrijë deri në njëfarë treve të përkohshme, me disa shkëmbime të rralla pushkësh sa për t'i prishur qetësinë kundërshtarit. E tillë ishte edhe beteja që po zhvillohej pas tërheqjes së kapitenit, që ishte tërheqja e dytë apo e tretë.

Tashti ai pinte duhan dhe mendohej. Ç'është e vërteta, kapiten Shaban Sinani nuk ishte nga ata që nisen në luftë e në rrethime si në dasmë. Me këto beteja e me këto rrethime ai ishte mësuar prej gati katër vjetësh, që të nesërmen e përmbysjes së Revolucionit «të shallvarremëdhënje». Ai e dinte që më parë se do të rrethuarit në vilë do të luftonin deri në fund, pastaj, do të vriteshin të gjithë, ose ndonjëri do të çante rrethimin e do të ikte (për belá). Po nuk e kishte marrë kurrë me mend që të rrethuarit në një shtëpi qyteti të qëndronin kaq gjatë, që kjo be-



tejë të vazhdonte përtej të gjitha parashikimeve të tij. Pastaj ndodhën edhe prapësi të tjera... Ashtu sikurse lindën edhe shpresa të vagëlluara, tepër të vagëlluara: rreshter Ago Agoja dhe xhandar Shkëlqimi. Pastaj lindi edhe shpresa tjetër: topi, që pritej të arrinte së shpejti. Po këto ishin vetëm shpresa dhe topi s'kishte arritur akoma.

Tha kapiteni:

— Kthejeni prapë!

— Ndoshta ajo vjen nga varrezat! — tha aspiranti.

— Ç'punë mund të kem unë me një grua që ndoshta vjen nga varrezat?

Aspiranti ngriti supet, por tha:

— Mund të ketë varrosur të birin!

— Ndjesë pastë! — tha kapiteni me inat.

— I biri quhej Kris-to-for, apo Kristaq, por që e thërritnin Krist, — tha aspiranti, duke e shikuar kapitenin me nëntekst.

Një plumb qëlloi njëhën nga tjegullat e murit që mbronte kapitenin. Koka dhe prehri i tij u mbushën me cifla. Lagjja periferike heshte, veç rrallë dëgjohej e qara e ndonjë fëmije.

— Kthejeni prapë!

— Veçse të përgjakemi me të e ta tërheqim zvarrë!

Kapiteni tregoi shenja nervozizmi jo nga përgjigjja e aspirantit, po nga fakti se pikërisht atë çast, qitja tjetër e pushkëve, ajo qitja e largët, që ishte dëgjuar në rrethinat e postës numër dy dhe numër tre, befas ishte zhvendosur edhe në postën numër katër, jo shumë larg prej aty. Ja dhe zhurma e mërzitshme e popullit si nga qendra e qytetit. Dhe muzikat. Dhe qentë.

Tha kapiteni:

— Shuajeni atë zhurmë!

Aspiranti, i cili qëndronte gatitu, s'bëri asnjë lëvizje, sepse ai e pati vështirë të kuptonte për cilën zhurmë e kishte fjalën kapiteni.

Një çast më vonë shikimi i kapitenit që i detyruar të bënte një gjysmë harku, drejt një zëri që sapo kishte folur:

— Pushoje luftën, kapiten!



Më parë se ta shikonte atë grua, ai e përsëndeti me një lëmsh tymi të dendur, që arriti deri në fytyrën e saj. Folta Papi u kollit rëndë. Tashti fytyra e kapitenit kishte marrë një shprehje të dukshme hutimi, siç merr fytyra e njeriut kur është i rrethuar nga një e keqe misterioze. Shkurt: në prani të Folta Papit, kapiteni kishte dhe ndiente diçka, por, se çfarë, këtë ai nuk e dinte akoma. Tha:

— Ah, paske arritur deri këtu?!

— Pushoje luftën, kapiten! — përsëriti Folta Papi.

Kapiten Shaban Sinani u ngrit në këmbë, por u ngrit ngadalë, si për t'i dhënë kohë vetes të mendohej, nëse duhej t'i hidhej në grykë Foltës së bezdisshme, apo ta duronte, ta dëgjonte e të mësonte arsyet e shkaqet që e kishin sjellë aty. Tashti që ishte ngritur, kapiteni ngjante me ata njerëz që është vështirë t'ua përcaktosh moshën, sepse fytyra e tyre është pa ngjyrë, ndërsa pamja, që e kanë tepër të përgjithshme, nuk u shpreh asgjë të veçantë.

Tha ai:

— E pse u dashka që ta pushoj luftën?

— Duhet të bisedojmë, — tha ajo, duke e shikuar gjoja e papërqendruar por, në të vërtetë, si grua me përvojë, kishte vënë re menjëherë se kapiteni nuk i kishte punët mirë.

— A s'mund të bisedojmë më vonë?

— Kur më vonë?

— Nesër, një ditë tjetër!

— Jo, — tha ajo, — Atje brenda ndodhen tre fëmijë!

Pas këtyre fjalëve, kapiten Shaban Sinani sikur ndryshoi qëndrim. Më parë se ta shikonte, i lëshoi përsëri në fytyrë një nga fjollat e dendura të cigares (Folta u kollit) dhe po aty i lindën një mijë mendime. një mijë shpresa të papërcaktuara, po sidoqoftë fjalët e fundit të Foltës kishin zgjuar interes tek ai. Tha:

— Ah, ti, moj e shkretë, gjithë jetën, përveç halleve të tua, ke vuajtur edhe për botën! — Por, duke u kujtuar se cila ishte Folta, duke u kujtuar se në ç'hall



kishte rënë vetë, i preu fjalët e ngushëllimit, ndryshoi shprehjen e fytyrës, ngriti me padurim duart dhe pyeti: — Për këtë punë paske ardhur tek unë?

— Kapiten, para së gjithash duhet të lejosh tre fëmijët të dalin jashtë atij xhehenemi!

— Pse-e-e?

— Ku është dëgjuar kjo që po ndodh? Burrat, po, dihet që për luftë janë krijuar. Unë të paktën kështu i mbaj mend. Edhe gratë, kur e ka dashur puna, kanë luftuar. Po të mbyllen fëmijët, jo, kjo jo, kapiten. Dëgjo ç'po bën populli?... Ai po zemërohet!... Ai është zemëruar!

Kapiteni e rrëshqiti vështrimin drejt veshëve të Foltës, pastaj drejt hiçit, drejt reve, që ishin shumëzuar e dendësuar në horizont dhe po i ngjiteshin kupës së qiellit. Dhe heshti. Por ajo ishte një heshtje e ndryshme nga të zakonshmet. Ajo dukej sikur vërtetonte se historia e këtij kapiteni ose kishte marrë fund, ose po i afrohej fundit të pashmangshëm. Por tha të kundërtën:

— Ata atje i kanë punët keq, zonjë!

— Po edhe unë prandaj kam ardhur!

— Atëherë ç'më flet vetëm për fëmijët?

— Kapiten, jep urdhër të pushojë lufta!

— Ta zëmë se e dhashë këtë urdhër...

— Jepe!

— Ç'do të ndodhë pastaj?

— Ç'do të ndodhë? — pyeti edhe Folta, pa e ndarë vështrimin nga fytyra e tij e thatë. — Atëherë unë do të shkoj tek ata që janë brenda dhe...

— Dhe?

— .... do t'i zbut! — tha ajo. — Po më parë jep urdhër të pushojë lufta! — Fjalët e fundit Folta i kishte shqiptuar si urdhër, por edhe si një këshillë, pa të cilën s'mund të bëhej ndryshe.

Kapiteni përcolli pështymën, si të përcillte zemërimin dhe në ato caste fytyra e tij kockëmadhe shëmbëlleu me një fushë beteje, nëpër të cilën frynin stuhi të brendshme, korrente e erëra të kundërta, përplaseshin dilema e mendime kontradiktore.



— Të pushojë lufta! — Këto tri fjalë ajo i kishte thënë përsëri me aq rëndësi, me aq qetësi, me aq zotërim të plotë të vetvetes, sa kapiten Sinani mbeti një hop pa lëvizur e pa marrë frymë.

Mbi vilë ra një hije si njollë e zezë. Pastaj njolla u zgjat, u përhap, pushtoi muret e saj dhe të gjithë varoshin. U përhap edhe më dhe përfshiu më parë Foltën, pak më vonë aspirantin, pastaj kapitenin, vetë dhe, së fundi, i gjithë dielli ishte fshehur prapa reve, i gjithë qielli ishte veshur, e gjithë bota kishte rënë nën hije.

Në një çast të këtillë, kapiten Shaban Sinani shikoi nga aspiranti.

— Të ndërpritet zjarri, të përforcohet rrethimi! — Shikoi nga Folta. — Po të më ndihmosh, do të të bëj të lumtur! — Heshti me sy të picërruar. — Mos ke edhe një djalë tjetër?

Dalngadalë pushkët heshtën në të gjithë rrethimin dhe veshët, të mësuar për orë të tëra me zhurmat e luftës, ranë në gjendje shurdhimi.

— Po, kam, — tha ajo.

— Do ta bëj mbret djalin tënd, do t'ia plotësoj të gjitha dëshirat, vetëm të më zbutësh ata, veçanërisht atë nip që ke atje!

— Edhe unë për nipin kam ardhur këtu, — tha Folta. — Atë dua të shpëtoj, nipin, në është vërtet atje brenda!

Tashmë kapiteni sikur e kishte mbledhur veten. Me pamje të ftohtë profesionale shikoi Foltën, si për t'u futur në mendimet e saj, njëkohësisht si për të nxjerrë anët e mira e të këqija të propozimit që kishte bërë ajo. Kurse Folta, tek e pa të tillë, të ftohtë e gjoja të shkujdesur, tha me vete: «Pse ma fsheh të vërtetën? Ti do të ishe gati të pranoje edhe ndihmën e një maceje e jo timen. I gjithë qyteti e di çfarë të kanë telefonuar nga pallati i Zogut e ç'do të thotë për ty ora katër e gjysmë!»

Ndërsa Folta fliste dhe shantë me vete kapitenin, sytë e këtij të fundit fiksonin vilën dhe mbeturinat e



kulmit të shtëpisë së vjetër, pastaj kalonin gjatë mureve të larta që i rrethonin dhe hetonin gjelbërimin e shumëllojshëm brenda e jashtë vilës. Vetëm një herë kapiteni i mbylli qepallat, siç mbyllej diafragma e të vetmit aparat fotografik të qytetit N, që shoqërohej me fjalën e fotografit: «Mbaroi!»

— Mbaroi! — tha ai si me vete, por me zë e, se ç'deshi të thoshte me këtë, nuk e sqaroi menjëherë. Më në fund shikimi i tij u ngul mbi Foltën. — Duhet të bësh ç'është e mundur për ta shkëputur nipin nga kthetrrat e Mentar Dikës. Gati dy muaj që ndjekim Genc Bogën, por kuçedra e madhe paskësh qenë ai, që ne e amnistuam dhe që na tundej rrugëve lirisht. Edhe dënimi më i madh mbi të do të bjerë! — Tha prapë: — E di ti, zonjë, se ne po përgatitemi t'u biem me top?... Jo, nuk e ditke?!... Edhe këtë t'ua thuash. Me top! Por do të jetë më mirë e më me nder për mbretërinë e për ne të gjithë, që kjo punë të zgjidhet pa top! — Tha prapë: — Të dyja palët fitojnë diçka, përndryshe do të jem i detyruar t'i djeg brenda të gjithë, me të mëdhenj e me të vegjël!

Nga qendra e qytetit përhapej valë-valë uturima e mbytur e njerëzve. Po atë rrugë ndiqte edhe jehona e bandës ushtarake. Por këto dy zhurma, ndonëse jo larg njëra-tjetrës, nuk shkriheshin, nuk bashkoheshin, edhe kur shkelnin në të njëjtat gjurmë, edhe kur ngjiteshin drejt qiellit. Secila nga ato jetonte e veçuar, secila kishte shkaqet e qëllimet e veta, që ishin krejt të ndryshme, siç ishin të ndryshme edhe jehonat që ato përhapnin. Padashur, kapiteni bëri një krahasim midis vetes dhe Foltës dhe gjeti po atë mospërputhje që kishte gjetur midis muzikave dhe jehonës së popullit. Po megjithatë foli:

— Të betohem, zonjë, se do ta mbaj fjalën. Nipit tënd do t'ia lehtësoj dënimin!

(Folta me vete: — Gënjen qeni!)

Heshtën një hop.

— Për flamur! — tha kapiteni.

Tha prapë:

— S'më beson, zonzjë?

— Të besoj, — tha ajo njësoj si t'i thoshte «jo».

— Shumë mirë, — tha ai, njësoj si t'i thoshte «re brenda».

— Të shpëtojmë nipin tim dhe nderin tënd!

— Të shpëtojmë edhe këtë ditë me shenjë të madhe për historinë e Shqipërisë e për mbretin tonë. Le të ndodhnin çdo ditë këto trazira, por vetëm sot jo. Sot jo!

— Po, — tha Folta.

— Atëherë?

— Fillojmë, — tha Folta. — Unë do t'i bind ata të dorëzohen!

— Aspirant, — tha kapiteni, — kontrollojeni për armë zonzjën Foltë!

Aspiranti kaloi pëllëmbët gjatë trupit të Foltës. Ish-te i turpshëm aspiranti dhe u skuq shumë.

«Jo», ia bëri me kokë ai.

Tha kapiteni:

— Na falni, zonzja Foltë, bëmë detyrën!

— Tashti jeni e lirë, zonzja Foltë, mund të shkoni menjëherë atje brenda.

— Rri me shëndet, kapiten!

— Shëndet paç, zonzja Foltë. Dhe do ta festojmë me pilafin tënd këtë ngjarje!

— Mirë se të vish, — tha ajo.

Kështu u ndanë. Ai mbeti në karrige, me vështri-min te shpatullat e saj të gjera, te trupi i gjatë dhe i drejtë, kurse ajo nisi të ecë varoshit, me hapin e saj të rëndë e gati të paurdhërueshëm.

— Por duhet shpejt, — tha kapiteni.

— E di, — tha ajo, pa e kthyer kokën e pa e ndalur hapin.

— Një qoftë se flamuri i bardhë nuk ngrihet brenda orës katër, do t'u biem me top. Nuk u ka mbetur veçse një orë.

— E di, — tha ajo, pa e kthyer kokën e pa e ndalur hapin.

— Një orën katër e gjysmë në qytet duhet të filloj-



në festimet e ndërprera. Do të flasë prefekti vetë. Po të dorëzohen më vonë, nuk do t'u bëjmë asnjë lehtësi!

— E di, — tha ajo, pa e kthyer...

— Do të digjen brenda si minjtë!

— E di!

Dielli notoi midis reve dhe kësaj radhe vila u mbulua e tëra me njolla të verdha. Rrobat e zeza të Foltës, që ecte përmes varoshit, herë binin në hije, herë damkoseshin në të verdhë. Një njollë e tillë ra edhe para këmbëve të kapitenit, që i zgjati aq, sa këpucët e tij të ndotura çikën periferinë e saj. Po tashti sytë e kapitenit nuk shikonin as Foltën, as njollën, ata shëtitnin nëpër pjesën tjetër të botës që, si më parë, kishte mbetur në hije, e, si më parë, pas heshtjes së pushkëve, kishte rënë edhe në dremitje.

Befas kapiteni briti:

— Foltë, e ke menduar mirë hapin që po hedh?

— Po, — tha Folta, duke qëndruar në vend.

— Në orën katër do t'i bie vilës me top! Mos harro!

— Jo!

— Mos të ka hipur në kokë të bësh ndonjë dredhi?!

— Jo.

— Thashë, kushedi, të gënjen mendja!

Ajo eci prapë përmes varoshit me çetësi dhe bindje. Eci me hapin e saj të zakonshëm, që s'dinte as ta shpejtonte, as ta ngadalësonte. Ky hap i Foltës, që kapiteni e njihte mirë, sikur i ndillte ca turbullira, por pastaj mendoj: «Fundja, shpresat i kam te topi. Dhe Foltën në dorë e kam, në xhehenem po e çoj!»

Shikoi nga aspiranti:

— Ç'ke dëgjuar për dy maskarenjtë, rreshter Agon dhe xhandar Shkëlqimin?

Aspiranti ngriti supet.

— Asgjë s'dihet! — tha.

— Po të paktën, askush s'i ka parë?

— Askush!

## XII

Ishte e çuditshme, pa u shuar mirë jehona e kris-mës së fundit, në vilën gjysmë të rrënuar, që mbante erë barut dhe erë suva të shkërmoqur, moritë e bletëve zunë të ngjiteshin nga bari e nga lulet drejt pemëve e nga pemët, sërish lule më lule. Mizat zukatnin herë këtu herë atje dhe ishte vetëm kjo zukatje që, për shoqërim idesh, të kujtonte në mijëra e në miliona herë të zvogëluar ushtimën e betejës që sapo ishte ndërprerë. Nga ajri i ngrohtë i ditës së parë të shtatorit dallëndyshet uleshin e ngriheshin në delir, ndërsa zogjtë, si ta dinin se beteja ishte ndërprerë vetëm përkohësisht, vërshuan me ngut në oborr e në kopsht për të kërkuar çerdhet e tyre të rëna në tokë së bashku me degët e thye-rra të arrës së madhe, pamja e përjetshme e së cilës tashmë ishte përçudnuar.

M-m-m.

Ë-ë-ë.

Askush s'ishte në gjendje të thoshte se ç'kishin bërë dhia me kecin gjatë betejës. Dihej vetëm që Teli i kishte lidhur më thellë nën qemerin e shtëpisë me çardak dhe u kishte vënë përpara degë për të ngrënë e ujë për të pirë.

Ishte kjo gjendje, kur befas, përmes varoshit u pa të ecte një grua e gjatë veshur me të zeza. Ndërsa ecte, dukej sikur mblidhte e mbartte mbi supë hijen e reve, njollat e verdha të diellit, heshtjen e pasbetejës, e cila u kishte dhënë veshëve një tingëllim të rëndë e të padurueshëm me shurdhërinë e saj.

Genc Boga u hodh në këmbë dhe i hoqi llozin portës, pastaj u kthye menjëherë në frëngjinë e vet.

Ajo shtyu kanatin e rëndë dhe hyri pak si duke ngurruar e si duke u penguar nga diçka e padukshme.



Ndërsa ishte me një rën këmbë në prag e me tjetrën brenda, thirri:

— Ku je, o i zoti i shtëpisë?

Nga kjo thirrje, që midis heshtjes tingëlloi e fortë, vilën e pllakosi një heshtje edhe më e thellë. Edhe jehona e muzikave në qytet, edhe uturima e mbytur e turmës, edhe krismat në periferi, sikur kishin heshtur, sikur ishin shurdhuar në një mënyrë të veçantë. Kur ja, në brendësi të vilës u dëgjuan ca hapa të lehtë. Pas pak në verandë u shqua më parë koka, pastaj supet, pastaj busti i Dakleas.

— Hajde, nuse, të të përqafoj!

Folta Papi e përqafoi Daklean, i vuri duart në supet, e ktheu djathtas, e ktheu majtas (jo pa përdorur fuqinë e krahëve) dhe e përqafoi prapë, dhe e puthi në ballë, dhe e puthi në sytë e ëmbël, që ruanin akoma diçka nga fëmijëria. Daklea u lëkund në krahët e Foltës, si valë e lehtë kur përkëdhelet në breg të detit.

Pyeti ajo:

— Si jeni, moj nuse?

— Siç na shikon, teze! — tha Daklea.

— Mirë fare qenkeni! — Dhe, pasi hodhi dy hapa nëpër oborr, pyeti: — Fëmijët?

— Mirë janë!

Në hapin e tretë sytë e Foltës kërkuan të tjerët, të cilët i gjeti një nga një nëpër frëngjitë e në cardak. Së fundi, vështrimi i saj bëri një gjysmë rrethi (gjuvsmë rrethi kishin bërë edhe thembrat, edhe supet e busti) dhe u ngul mbi të nipin. Ajo dukej e qetë, por e lodhur dhe kuptohej që nga larg se nuk e kishte vënë syrin në gjumë tërë natën. (Nga pikëllimi për Kristin, mendoi Genci). Veshja e saj me të zeza, midis gjelbërimit të fortë, në pamje të parë të dukej si një gjë e huaj, si një gjë pa vend, por do të të mjaftonte ta shikoje jo më shumë se një cast, që të bindeshe se ajo veshje vetëm e tillë mund të ishte, se ai trup i gjatë, i drejtë, vetëm me rroba të zeza mund të vishej, ndryshe as që mund të merrej me mend. Kurse fytyra e Foltës, mbi të cilën kishin kaluar furtuna e dhimbje të mëdha, tashti,



që e kishte humbur shkëlqimin e dikurshëm, që ishte më afër borës së squllur e të shkelur, dukej sikur përpiqej të harmonizonte përshtypjen e kundërt që të krijonte raporti midis rrobave të zeza dhe gjelbërimit të fortë. Edhe ajo fytyrë, pasi ta kishte shikuar më shumë se një gast, do të bindeshe se s'mund të ishte ndryshe, se s'mund të ishte e bardhë si dikur, se ishte krejt e natyrshme që ngjyra e saj t'i ngjante patjetër borës së squllur e të shkelur. Po kur foli sërish, me vështrimin të ngulur gjithmonë tek i nipi, midis heshtjes së vilës e të gjithë botës, atëherë nuk ishte aspak vështirë të kuptoje se, në të vërtetë, ai s'ishte veçse zëri i një gruaje ngarkuar me dhimbje e pikëllim:

— Kristi im e meritoi dënimin!

Genc Boga u ngrit t'i dilte përpara, ta përqafoje, por Folta i tha:

— Rri aty, nip, mos lëviz! — Shikoi nga të tjerët. — Askush të mos lëvizë nga vendi! — Mbylli kanatin e rëndë të portës, i vuri llozin e hekurt dhe, pa u kthyer mirë nga i nipi, tha:

— Aty të rrini, me gisht në këmbëz!

Në heshtjen e oborrit u dëgjua një vaj i mbytur, që lajmëroi ekzistencën e fëmijëve në një qoshe të vilës. Këto të qara sikur e ngrohën Foltën dhe ajo hodhi hapa të tjerë në drejtim të të nipit. Tha:

— Mirë qenkeni të gjithë?! Ata atje përhapën fjalë sikur gjoja kanë bërë kërdrinë me rebelët! I dëgjoni? — Ajo heshti aq sa duhej të heshte, aq sa duhej të dëgjohehin muzikat. — Festojnë mbretërinë dhe fitoren mbi ju!

Nga mënyra si u shqiptuan këto fjalë, tingëlluan edhe si pyetje, edhe si përgjigje. Prandaj asnjë nuk foli. Ndërkaq Folta u afrua pranë të nipit, i vuri dorën në sup, e ngriti në këmbë, e përqafoi, e puthi në ballë, i pëshpëriti në vesh, po zëri i saj u dëgjua nga të gjithë të pranishmit:

— Kristin e varrosa në mëngjes! — E shikoi Gencin me lotët që i vishnin sytë dhe në këtë gjendje nuk ishte vështirë të kuptoje se prej vitesh ajo kishte jetuar si murge-



shë, kishte bërë një jetë pa gëzime, që është bërë zakon të quhet jetë gri. — E varrosa vetëm. Se ashtu duhej. Unë dhe varrmihësi. Me karrocën e Memës! — Basi i saj ishte i shurdhër, por edhe i ashpër dhe vetëm ata që e dinin çfarë i kishte ndodhur disa orë më parë, mund të kuptonin se nëpër ato pejza kishte kaluar një e qarë e dëshpëruar dhe një tronditje e mbarsur me dhimbje e zemërim ndaj krijesës së vet. Po tashti nga ajo krijesë nuk kishte mbetur veçse një kujtim tragjik i përzier me vuajtjen dhe dashurinë e nënës dhe kjo përzierje pasqyrohej jo aq në fytyrën, sesa në zërin e saj, tek shpërndante dridhje të fshehta e të pandjeshme, por tmerrësisht të pranishme.

— Ju doni të dini se ç'ndodh jashtë vilës e ç'thonë për luftën tuaj? Ja ku po jua them: keni lënë nam. Doni tjetër? Për tri orë me radhë i keni futur dridhmat një qeverie të tërë dhe keni ngritur në këmbë një qytet të tërë. — Folta Papi fliste me një zemërim, që vinte gjithnjë duke u rritur. Së fundi, ajo shikoi Gencin, si për të matur vendosmërinë dhe trimërinë e tij. E bindur se ai qëndronte i patundur, nga thellësitë e gjoksit të Foltës doli një si tringëllimë gëzimi e lehtësimi. Pasi u tha qëllimin pse kishte ardhur aty, hallin e kapitenit dhe fjalën e tij për t'u bërë lehtësira, po të dorëzoheshin me të mirë, pasi u tha gjithë sa dinte për urdhrin e Zogut, për kurorën që do t'i vinin në orën katër e gjysmë, pasi u foli edhe për topin, për xhandarmërinë, që mbante të rrethuar njëkohësisht disa shtëpi të tjera të kundërshtarëve të qeverisë, të cilave po u shembnin tavane e dyshemera, e deri themelet po u hapnin, e deri kopshtet po u gërmonin, me shpresë se mos gjenin rebelë të fshehur, pasi u foli edhe për zemërimin e popullit në rrugë e për ndonjë hollësi tjetër, Folta Papi mbeti në këmbë, pa lëvizur, si shtyllë e nxirë, mbi të cilën kanë kaluar flakërima zjarresh të mëdha.

— E dini çfarë bëra sot në mëngjes? — Vështrimi i Foltës fluturoi larg si zog. — Para se të ngarkonim Kristin në karrocën e bashkisë, nxora pushkën e tim shoqi, ia dhashë Kolës dhe i thashë, ti, Kolë, i di të gjitha, shko laj gjynahet e vëllait tënd, që ta gënjyen e ta bënë tradhtar. I thashë Kolës, i dëgjon këto pushkë rrotull qytetit?



Do të jetë ai, Lato Morina, mik e shok i Mentar Dikës dhe i Gencit tonë. I thashë, Gencin pret ai, kaq e kuptoj unë. Kështu i thashë Kolës. I thashë Kolës, shko lufto si ai, bashkohu me të, turbullojini këta qen dhe pastaj i tregova Malet e Shqipës. — Vështrimi i saj fluturoi sërish si zog në drejtim të maleve. — I thashë Kolës, atje të shkosh. Kola mori pushkën, unë e putha në ballë dhe ai shkoi. — Folta Papi heshti aq sa duhej të heshte, aq sa duhej të dëgjoheshin pushkët e periferisë, pastaj tha: — Ja, kjo është pushka e Kolës, e njoh mirë unë pushkën e tim shoqi... — Befas Folta e humbi fillin e tregimit. Bashkë me tregimin, edhe vështrimi i saj kishte humbur sigurinë dhe qartësinë. Ata, që e dinin se çfarë i kishte ndodhur, nuk e patën të vështirë të kuptonin se në çastin e turbullirës sytë e saj kishin parë vetëm botën e nëndheshme.

Pyeti Folta me basin, që sa vinte bëhej më tragjik:

— A do të gjendet një pushkë edhe për mua?

Folta e mori pushkën që i dhanë, e vërtiti nëpër duar, i shikoi shënjestrën, i provoi llozin, vuri nishan në qiell dhe, kur uli tytën, u duk se nga buzët e saj u rrokullisën disa fjalë që, po të mblidheshin e të renditeshin, mund të tingëllonin afërsisht se edhe pushka e të shoqit, që sapo i kishte dhënë Kolës, e këtillë ishte.

Tha prapë:

— S'patëm kohë as të përshëndeteshim sipas zakonit. Me Gencin e me Daklean u përqafova. — Hodhi sytë nga Teli Bashari. — Si je, Teli, mirë?

Fytyra e Telit, ngarkuar me rombe e kubikë, u ndriçua nga një dritë e largët, por e ngrohtë.

Folta ngriti sytë në çardak:

— Si je, Mentar Dika, mirë?

Nga të çarat e reve dielli lëshonte hije e njolla nëpër oborr, nëpër çatitë e nëpër kokat e shpatullat e njerëzve dhe shtrihej e përhapej si fytyrë me pulla deri në largësitë e paarritshme e të mjegulluara të horizontit. Dhe të dukej sikur e tërë bota çlodhej e dremiste e kënaqur nga këto lodra e teka të reve. Të këtillë dukeshin edhe Mentar Dika, Daklea, Teli e Genc Boga që, si një fytyrë e vetme, ishin kthyer nga Folta Papi dhe e shikonin thujse



pa marrë frymë. Megjithëse të dënuar me vdekje dhe të ndërgjegjshëm se vdekja mund t'u vinte nga çasti në çast, bindja se njerëzit nuk do ta harronin luftën e sakrificën e tyre, nuk ua kishte zhdukur kënaqësinë e orëve të pakta, që mund t'u kishin mbetur për të jetuar.

Lart në hapësirën e djegur fluturonte një shpend i madh me krahët të palëvizshëm. Ai tundej, kthehej, ngjitej, rrotullohej gjithmonë i qetë, gjithmonë me krahët të palëvizshëm, gjithmonë mospërfillës për gjithë sa ndodhnin poshtë në tokë.

## XIII

Ne nuk dimë çfarë ishte duke menduar akoma kapiten Shaban Sinani, nuk dimë në shpresonte akoma se rreshter Agoja dhe xhandar Shkëlqimi do t'ia arrinin qëllimit, apo Folta Papi do të mund t'i zbuste ata që ishin atje brenda, asgjë nga këto nuk dimë, por... të paktën dimë që vështrimi i tij ishte mbërthyer me ngulm te porta e rëndë e vilës. Dimë gjithashtu se kapiteni kishte mbetur i gozhduar në karrige, me hijen e aspirantit prapa kurrizit dhe ishte thellësisht i heshtur e po aq i menduar. Ndoshta nga që ishte përqendruar vetëm te vila, vetëm te rebelët e rrethuar, te Folta Papi, te koha që kalonte (kishte mbetur edhe pak që ora të shkonte katër e gjysmë dhe topi s'kishte arritur akoma); ndoshta ngaqë e shikonte veten të arrestuar e duardhur përpara aspirantit, që tashti mezi i lëshonte hijen e drujtur pranë këmbëve; ndoshta ngaqë e kishin bërë të heshtur njëqind mendime e përfytyrime të tjera, nga të

gjitha këto e për të gjitha këto, në buzët e tij shpërtheu papritur një buzëqeshje e thartë, që ishte edhe keqbërëse. Tha:

— Jepuni edhe tri minuta afat për të ngritur flamurin e bardhë!

Varoshi përpara vilës, vila, gërmadhat e shtëpisë së vjetër, si dhe e gjithë bota tjetër anekënd ishin mbuluar me hije, me njolla të verdha e me heshtje. Pikërisht këtë të fundit, pikërisht heshtjen nuk mundi ta duronte më kapiteni. E dinte ai, gati e kishte pasë ditur që më parë, se edhe Folta s'do ta ngrinte flamurin e bardhë, edhe topi s'do të arrinte në kohën e premtuar.

U ngrit nga karrigia ngadalë dhe me lëvizje të matura e të buta, gjë që tregonte vendosmërinë dhe rrezikshmërinë që mund të paraqiste ai në këto çaste, eci me këmbët që rrihnin fort në tokë dhe pastaj thirri:

— Zjarr!

— Zjarr! — thirri prapë dhe vrapoi për të shkuar vetë në sulm.

## XIV

Daklea u lëshua me vrap përmes oborrit, duke menduar se ndoshta ishte instinkti i gruas, që e shtynte atje ku diçka duhej të kishte ndodhur e ku ndoshta rridhte gjak. Ra në gjunjë pranë Teli Basharit dhe mbeti një copë herë pa folur. Mezi mbushej me frymë. Kur iu qetësuan disi mushkëritë, thirri:

— Xha Teli!

Ai heshti me kokën të kërrusur mbi kondakun e push-



kës. Gjaku i rridhte nën gushë, ndërsa sytë i përpëliteshin si t'i dhimbnin nga drita. Daklea e mblodhi veten, vrapoi drejt vilës, grisi ca fasho nga një këmishë, mori ca duhan dhe, tashmë, pa asnjë ngurrim, u kthye te xha Teli për t'i lidhur plagën poshtë supit.

— Si je? — e pyeti.

Ai deshi të fliste, por nuk i mblodhi buzët. Atëherë ajo e shikoi në sy, si ta priste përgjigjen vetëm nga sytë e plakur e të thellë. Nga fytyra e Telit ishin zhdukur si me magji rombët e kubikët dhe vendin e tyre e kishin zënë rrudha të imta.

— Xha Teli!

— Keq! — tha ai me zë gryke.

Ajo ndjeu një hije prapa vetes.

— Domethënë... — pëshpëriti Mentari.

Qëndruan një copë herë pa folur.

(Beteja vazhdonte. Luftonin Genc Boga dhe Folta Papi.)

— Po tashti ç'duhet të bëjmë? — pëshpëriti Daklea.

— Do të luftojmë me një pushkë më pak. Mbrëmja po afrohet dhe më duket se diçka do të bëjmë... Shpresat tona varen vetëm te shpërthimi me bomba dore nëpër errësirë.

Befas Daklea mori me ekzaltim pushkën e Telit, mbështetur pas murit dhe tha:

— Edhe unë!

Ai e shikoi me një buzëqeshje të verdhë (Mentari i qenë zverdhur buzët nga lodhja, nga plaga e krahut e nga shumë shkaqe të tjera.) Pyeti:

— A do të qëndrojnë fëmijët pa ty?

Dalngadalë qenia e Dakleas sikur u çlirua nga ekzaltimi i çasteve të para. Tashti ajo kishte rënë nën pushtetin e një qetësie shprehëse, që vihej re në lëvizjet e natyrshme të syve, të kokës, të duarve e të trupit, në mënyrën si fliste, si ecte, si e hidhte hapin. Por edhe zëri i saj, që zakonisht ishte i tingëllueshëm, megjithëse pa volum, edhe ai zë dëshmonte për qetësi. Sidomos fytyra e Dakleas, e butë, e ëmbël dhe e pafajshme, si e një fëmije të rritur, bënte kontrast me pushkën që mbante në dorë, por pikë-

risht në këtë kontrast Mentari kishte parë forcën dhe vullnetin e saj për të luftuar. Ai e shikoi të shoqen në sy dhe pastaj ngjiti shkallët e çardakut, i bindur se gjithçka që do të ndodhte nga ky çast e paskëtaj, s'do të ishte tjetër, veçse një gjë e zakonshme dhe e pritur.

Para se të zinte frëngjinë, Daklea mendoi se kishte edhe një detyrë për të plotësuar. U kërrus, e ngriti peshë Teli Basharin dhe e vendosi nën qemerin e vjetër, që ishte një vend pak a shumë i sigurt. Po aty u detyrua të nxirrte nga xhepi i fustanit një shami të vogël dhe t'i mbulonte fytyrën: ai sapo kishte dhënë frymën e fundi.

Një minutë më vonë, thujse me përvojën e një luftëtari të vjetër, u kthye rrëzë murit, vështroi nga Folta, ndoshta për ta imituar dhe shtiu. Po nuk kishte shtirë veçse pesë herë, kur befaz dëgjoi zhurmë prapa krahëve. Leta me Gimën e me Katin e shikonin në heshtje, me sy të trembur.

— Pse keni dalë? — pyeti Daklea.

— Kemi frikë! — tha Gimi me seriozitet.

Leta shikonte të ëmën dhe, pa ndërprerë ngashërimet, thithte gishtin.

Një plumb, një i dytë dhe një i tretë rrëzuan copa tjegullash nga muri. Fëmijët u ngjeshën pas Dakleas. Daklea shënoi. Ata mbyllën veshët. Ajo shtiu. Ajo shtiu disa herë, pastaj tha:

— Mirë, qëndroni rrëzë murit! — dhe vazhdoi të shtinte, ndërsa ata vazhduan të mbyllnin veshët me duar. Vecanërisht Leta lëpinte lotët dhe shtrëngohej pas së ëmës sa herë që jehonin krismat e sa herë që atje përtej dëgjohehin britma të zemëruara.

— Daklea, fishekë! — thirri Mentari nga çardaku.

Ai vërtet thirri emrin e Dakleas, po Kati u hodh e para, me kërcimin e saj të gjatë e të lehtë.

— Ti, Gimi, e di ç'të bësh? — tha me lutje Daklea.

Gimi e shikoi me sytë e kaltër, përmbysi vetullat, siç bënte i ati kur fliste për gjëra të rëndësishme dhe pyeti:

— Ç'duhet të bëj, mami?

— Të marrësh Letën e të shkosh brenda në vilë!

— Mirë, mami, — tha ai pas pak si i madh.



Një minutë më vonë, Gimi i pari, Leta e dyta, ngjiten shkallët e verandës dhe u futën brenda.

Kur mbeti pa fëmijët, Daklea e ndjeu veten më të lirë e më të çliruar. Po ashtu si zërin, që e kishte të ulët e të qetë, edhe gjestet, kur lëvizte llozin, kur fuste fishekun në fole, kur merrte nishan nga frëngjia, — të gjitha këto lëvizje, të gjitha këto gjeste i kishte fare të zakonshme, si të kishte lindur me pushkë në dorë, kurse në të vërtetë ajo veçse një krehër pati zbrazur në të gjithë jetën e vet dhe kjo pati ndodhur shtatë vjet më parë, muajin e mjaltit në shtëpinë e Lato Morinës, rrëzë Maleve të Shqipës.

## XV

Diku aty pranë, prapa krahëve, kapiten Shaban Sinani kishte dëgjuar emrin e vet, të shqiptuar nga aspiranti. Ai nuk e ktheu menjëherë kokën, nuk e hoqi menjëherë vështrimin nga muret e vilës, ku priste (me shpresa të vagëlluara, sigurisht) të ngrihej flamuri i bardhë ose të kriste pushka e rreshter Agos dhe e xhandar Shkëlqimit. Por edhe pa e kthyer kokën prapa, nga vibracionet funebër të pejzave të aspirantit, ai e parandjeu se çfarë do t'i dëgjonin veshët e se çfarë do t'i shikonin sytë. Bile më parë se të kthente kokën e të shikonte skenën, ai kishte thënë:

— Kështu e pësuan, ë?

Para këmbëve të kapitenit kishin shtrirë kufomën buzëpërveshur të rreshter Ago Agos. Pa jetë, ai dukej

sikur ishte bërë më i madh, sikur gjymtyrët i ishin zberthyer e gjithëcka tjetër i qe zgërlaqur e lëshuar në gjatësi e në gjerësi. Kapiteni rrudhi hundët: mos mbante erë raki? Po. Si fuçi e shpuar. Njërën sy, të madhin, të paduruarin, të egrin, nuk e kishte të mbyllur siç duhet ta kenë kufomat, por të hapur e të zgurdulluar në drejtim të qiellit. Kurse tjetrin, të voglin, dinakun, të ligun, e kishte pak më në rregull, gjysmë të mbyllur, por edhe aq mjaftonte që kapiteni të pandehte se ai sy ishte duke e shikuar me ngulm e në të njëjtën kohë duke i thënë: «Pas nesh e ke radhën zotrote!» Dhe kapitenit iu bë sikur buzët e Agos ishin gati t'i hidhnin në fytyrë shigjetën e famshme të pështymës.

— Mbylljani sytë dhe kthejani kokën nga ana tjetër! — urdhëroi kapiteni.

Më tej kishin shtrirë kufomën e xhandar Shkëlqimit. Edhe i vdekur, ai dukej akoma i ngjallur, i shëndetshëm, veçse ngjyrën e fytyrës nuk e kishte rozë si zakonisht, por një rozë të kapërthyer me të verdhën dhe të dyja bashkë krijonin një hibrid të papërcaktuar, siç është e papërcaktuar edhe vetë fizionomia e vdekjes. Për rastësi, sytë e ish-xhandar Shkëlqimit kishin mbetur edhe ata të hapur, dhe përsëri, për rastësi, shikonin diku në një pikë nga qendra e qytetit. Kapiteni, si i hipnotizuar, hodhi vështrimin andej nga shikonin sytë e të vdekurit dhe iu bë sikur vështrimi i tyre arrinte deri në faqet e ndërtesës dykatëshe të shtëpisë publike.

— Mbylljani sytë! — tregoi kapiteni me dorë kufomën e ish-xhandar Shkëlqimit.

Më tej kishin shtrirë një kufomë tjetër. Po kufoma e tretë, bile edhe një e katërt, që po e sillnin, nuk kishte asnjë vlerë dhe asnjë kuptim për kapitenin. Xhandarë dhe aq!

— Ç'm'i grumbulloni këtu?! Hajde, hiqini të gjithë!



## XVI

Folta Papi nuk shikonte kurrë prapa dhe anash, ajo nuk e hiqte vështrimin nga frëngjia, ajo shikonte vetëm përpara, si të kishte zbuluar atje një botë të çuditshme, por edhe të urrejtshme që, po të mos e mbërthen-te me sy, ajo botë mund të tretej e të zhdukej pa rënë në shënjestrën e pushkës së saj, e cila krye çdo minute villte zjarr, përjashtuar rastet kur duhej t'i hiqej kre-hri e t'i futej i riu.

E ndërsa shtinte, Folta diçka mendonte... diçka kuj-tonte... Ndiante praninë e nipit aty afër (përmes kris-mës së pushkës së tij) dhe prapë diçka...

...Folta vrapoi drejt Bristolit, drejt turmës që zhurmonte, që shante e që shkelmonte Genc Bogën. Du-ke shtrënguar në duar hekurin që mbyllte qepenin e res-torantit, ajo thirri:

— Lëreni tim nip dhe kthehuni nga unë!

Një nga një fytyrat e bardha e të lyrshme, që mba-nin erë djersë, erë alkool dhe livando, e lanë viktimën të shtrirë në mes tyre dhe u kthyen nga Folta. Pak më vonë ata qëndronin të gjithë përballë saj, me atë vështrim e me atë qëndrim tallës e përcmues të burrit ndaj gruas, origji-na e të cilit është e largët, sa ç'është e largët periudha e patriarkalitetit të shoqërisë. Sakaq fytyra e Foltës kishte marrë një shprehje të rëndë, të zemëruar, nga e cila, e tërë qenia e saj e madhe ishte transformuar, dhe rrobat e zeza, që mbante të veshura prej vitesh, tashti i dukeshin të papërshtatshme e të huaja, ashtu sikurse na duken të huaja e të papërshtatshme zia dhe rrobat e zisë te vajzat e reja.

Në të vërtetë, sado e madhe dhe e egërsuar, sado që në dorë shtrëngonte një hekur më të gjatë se veten, fundja, një grua ishte ajo, një grua para gjithë atyre

burrave e djemve sqimatarë e xhigadurrë të fuqishëm. Po meqë ajo grua ishte Folta Papi, mund të thuash prapë se ajo s'ishte asgjë, dhe në të njëjtën kohë mund të thuash se ishte gjithçka. Me sa dukej, një gjë të tillë e kishin ndier edhe burrat, prandaj jo më kot njëri prej tyre tha:

— Hidhe hekurin, Foltë!

— Të hedh hekurin, që të talleni edhe me mua?

— Është armë e ftohtë dhe do të përfundosh në burg!

— Po burgjet përse janë bërë? — tha ajo dhe u lëshua me hekurin mbi kokë.

Disa, që e nihatën se Folta nuk do të përmbahej e nuk do të kursente askënd, u larguan menjëherë, të tjerëve ua pati qejfi të qëndronin, të tregoheshin se ishin burra... Fundja, ajo një goditje mund të arrinte të bënte, pastaj... Por, meqjithatë, edhe këta burra që kishin qëndruar akoma, kur e panë se ishin futur në rrezën e hekurit të Foltës, dhe si u bindën se ajo nuk kishte ndërmend të zmbërsej, u lëkundën e pastaj u shpërndanë si zogjtë kur mbi ta bie skifteri...

Pas pak Folta Papi hidhte hekurin mbi xhamat e thuer të Bristolit dhe merrte në krah të nipin e qjakosur e pa ndjenja. Po njëzet hapa më tej, befas, përpara Foltës u dukën si një mur i pakapërcyeshëm nja dhjetë burra, përsëri po nqa ata të Bristolit.

— Po tashti, Foltë, ç'do të bësh? — e pyetën ata. — Tashti që mbete pa hekur?!

Tashti?! — tha Folta. — Ja ç'do të bëj! — e vendosi Gencin me kujdes para këmbëve (tashmë ajo ishte qetësuar, se i nipi vërtet kishte humbur ndjenjat, por ishte gjallë), pa u nqatur futi dorën në mëngën e xhaketës (atë ditë, si shumë ditë të tjera, ajo kishte veshur xhaketën e të shoqit), nxori prej aty një goxha thikë mishi me dy presa dhe tha:

— Kujt ia ka qejfi, le të mos më hapë rrugë!

Tha prapë Folta:



— Shpejt, se nuk kam kohë të merrem me ju! — Dhe kur e pa rrugën të lirë, shtoi: — Tashti shkoni në shtëpi dhe vishni fustanet e zonjave!

Hodhi të nipin në krah, shkoi në ndërtesën e vogël të atij që mund të quhej spital dhe kur mjeku i vetëm i qytetit i hapi portën, ajo tha:

— A mund të ma sjellësh në vete këtë nip, që së shpejti do të shkojë ushtar?

Një herë, midis krismave të betejës, Folta i lëshoi zë të nipit:

— Dëgjo, Genc! Jemi në luftë e s'dihet çfarë na ndodh. Por unë që jam te zja jote e kam për detyrë të të them, se disa kohë më vonë, pasi ti kishe shkuar ushtar, djali i pashës si dhe vetë pasha hapën fjalë se do të të vritnin sapo të lirohesh nga ushtria!

— E di, teze, e kam dëgjuar!

— Janë të fortë ata! Ta kanë bërë benë!

Kaq biseduan. Dhe pastaj Folta Papi zuri të shtinte sërish, pa e kthyer kokën prapa, pa shikuar anëve, pa lëvizur, si një genie pa jetë, pa ndjenja, pa veshë, pa sy, pa asgjë!

## XVII

— Hidhu! — dëgjohej një zë tek nxitte xhandarët të sulmonin vilën.

— Hidhu!

Përmes frëngjisë. Genc Boga pa të mbushej varoshi

me xhandarë. Ata vraponin me zigzage, shtriheshin, shtinin dhe prapë vraponin gjithnjë më afër frëngjisë së tij. Atëherë ai e la mënjanë pushkën, rrëmbeu disa bomba dhe i hodhi njëren pas tjetrës. Xhandarët e prenë sulmin, mbetën një hop në këmbë si gurë të gjelbër, pastaj u shtrinë, ose thjesht u rrëzuan nga ato shkaqe dhe arsye që rrëzohen njerëzit në luftë.

— Hidhu!

S'ishte hera e parë që Genc Boga e dëgjonte atë fjalë dhe atë zë.

— O i zoti i shtëpisë!

Heshtje.

— O ti, Tajar Demiraj!

— Ç'kërkon, more zotëri?

— Dorëzo komitin!

Heshtje.

Po ai zë: — Dorëzo komitin!

Tajar Demiraj: — Kush je ti?

Po ai zë: — Komandanti i xhandarmërisë!

Tajar Demiraj: — Qofsh shëndoshë!

Po ai zë: — Mos e zgjat!

Tajar Demiraj: — Si e ke emrin zotëria jote?

Po ai zë: — Kapiten Shaban Sinani!

Tajar Demiraj: — Nuk të njoh!

Kapiten Shabani: — Do të digjesh brenda i gjallë bashkë me komitin!

Tajar Demiraj: — Eja ta marrësh komitin!

Kapiten Shabani: — Mendohu mirë!

Tajar Demiraj: — Kam pasur kohë të mendohem një jetë të tërë!

Atëherë kapiten Shaban Sinani u kthye nga xhandarët dhe thirri:

— Hidhu!

Kështu u kishte thirrur ai zë gati dy muaj më parë xhandarëve dhe ushtarëve që kishin rrethuar shtëpinë e Tajar Demirajt në fshatin rrëzë Maleve të Shqipës, ku strehohej Veterani i Luftës.



— Hidhu! — dëgjonte atëherë Genc Boga nga balli i shtëpisë, ashtu siç dëgjonte edhe tashti nga balli i vilës së Dikëve zërin e kapiten Shaban Sinanit. — Hidhu!

Genci shikoi nga Folta dhe tha:

— Kështu pra, teze, edhe unë ua kam bërë benë pashës dhe të birit të pashës.

## XVIII

Vetëm një herë, kur në duelin e betejës rrotull vilës u krijua një heshtje e rastit dhe fare e shkurtër, që lejoi të dëgjoheshin pushkët e periferisë, Folta Papi e prishi rregullin me të cilin kishte luftuar deri atë çast, hoqi vështrimin nga frëngjia, u kthye në drejtim të jehonës së pushkëve të periferisë dhe, si të ishte duke shikuar një njeri para syve, thirri:

— Të lumtë dora, o Kolë!

Dhe shtiu në drejtim të qiellit, tika-a-a-u-u-u!

Tika-a-a-a-u-u-u! shtiu sërish Folta, kësaj radhe jo përpjetë, por në shenjë. Dhe tek luftonte ashtu, pa e kthyer kokën prapa, pa shikuar anëve, pa lëvizur, si një qenie pa jetë, pa ndjenja, pa veshë, pa sy, i kujtoi Mentar Dikës ushtarin, që e thërritnin shkurtimisht Ziq, kur ata luftonin kundër një bande të armatosur të Ahmet Zogut, dy muaj pas fitores së Revolucionit të Njëzetekatrës.

## XIX

Pak më vonë, bashkë me mugëtirën e mbrëmjes që po sitej nga lart, edhe një pushkë tjetër heshti: Folta Papi mbeti me kokën mbështetur pas frëngjisë, si të kishte rënë në gjumë.

## XX

Paralel me tingujt e sahatit, beteja u ndërpre dhe heshtja pllakosi papritur. Heshtën pemët, të rrethuarit, xhandarët, muret e çatitë e vilës e të shtëpive të lagjes periferike. Edhe turma nga njëra anë e muzikat nga ana tjetër sikur kishin heshtur atje në largësinë e tyre. Vetëm harabelat, përkundrazi, nisën të lëviznin e të cicëronin: me të pushuar krismat, ata erdhën menjëherë pranë çerdheve. Dallëndyshet, që fluturonin pas mizave, uleshin mbi kokën e të rrethuarve, kapërcenin muret, valëviteshin mbi gjelbërimin e varosheve, që kishte marrë plagë të shumta nga pëlcitjet e bombave të dorës, ngriheshin pak atje ku ishin pozicionet e xhandarëve dhe prapë ktheheshin në vilën e rrethuar, si ndërlidhëse të paanshme për gjithë sa kishte ndodhur e po ndodhte aty.

Nga kulla e sahatit në mes të qytetit tingujt shpër-



ndareshin të butë, të mugët, të përsququr nga mbrëmja e ngrohtë e ditës së parë të shtatorit. Ata ranë shtatë herë.

Në të vërtetë, që në çastin e parë të heshtjes Mentar Dika kishte vënë re lëvizje të dyshimta: rrethimi nga ana e prapme e vilës sikur ishte përhapur, rreshtat e xhandarëve ishin larguar nga pozicionet e përroit dhe ai kup-toi menjëherë se topi duhej të kishte arritur dhe se po bëheshin përgatitjet e fundit për të filluar qitjen nga balli i vilës.

Nuk vonoi, nga cepi i rrugicës, po nga ai cep ku në orët e para të mëngjesit që dhënë ultimatumit për dorëzimin e Genc Bogës, po nga ai cep nga që dukur të vinte Folta Papi, u dëgjua një zë (zëri i mëngjesit) që lajmëroi:

— Dëgjoni ultimatumin e dytë! — Ky zë përhapi nëpër mugëtirë ca nota të gëzueshme. — Vila do të goditet me top! — Tashti zëri sepse tingëlloi i pikëlluar. — Keni vetëm tri minuta afat për t'u dorëzuar!

Pas këtij ultimatumit, si për shoqërim, e gjithë bota ra nën pushtetin e mugëtirës. Kjo ndodhi sepse majat e Maleve të Shqipës, që ngriheshin në horizontin e tymosur si kështjella me bedena shumë, kishin humbur edhe reflekset e fundit të diellit. Kurse aty mbi qytet e mbi vilë retë trazoheshin edhe më të ulëta, më të zeza e më të ngarkuara. Vetëm në një pikë të qiellit, aty ku retë qenë grisur, si një gëzim midis trishtimit, ylli i mbrëmjes u drodh me buzëqeshje të zbehta. Sikur kjo dridhje të kishte qenë sinjal i prituri prej kohësh, toka u tund, rryma ajri u lëshuan njëherësh, pemët valëvitën degët dhe një buçitje e fortë ushtoi nëpër qiell. Kjo që predha e parë.

Predha e dytë këputi majën e arrës dhe masivi i saj i gjelbër u rrokullis nëpër muzg, lëshoi hije mbi çardak, pastaj, si brumbull vigan ra larg, përtej mesit të varoshit, më për përroit se vilës. Mentar Dikës, tek pa arrën të copëtohet, diçka iu shkëput nga qenia e diçka i mungoi nga bota ku ishte lindur dhe ishte rritur.

Predha e tretë kaloi më ulët, theu përgjysmë një kumbull, që u ngrit lart si fosile prehistorike dhe ra mbi çatinë e shtëpisë së vjetër, fare pranë çardakut, prej nga Mentar Dika lëshonte breshëri kundër siluetave që lë-

viznin përballë vilës. Kishte ndodhur ashtu, siç ishte parashikuar: kur të fillonte qitja e topit, pozicionet e përroit do të heshtnin. Tashti, mendoi ai, po afrohet koha për të çarë rrethimin.

Pas predhës së tretë zotëroi një heshtje që zgjati më shumë se të tjerat. Pastaj u dëgjua po ai zë nga fundi i varoshit:

— Erdhi fundi të ngrini flamurin e bardhë, përndryshe do ta ulim grykën e topit dhe do të qëllojmë në shenjë! — Kësaj radhe zëri fliste jo vetëm me zemërim, jo vetëm me ngut, por edhe me dëshpërim: xhandarmëria s'kishte mundur ta plotësonte urdhrin e Tiranës në kohën e duhur. — Ju presim pesë minuta! — tha zëri përtej. — Asnjë marrëveshje tjetër s'mund të ketë midis nesh!

Në fund të minutës së pestë buçitja e predhës. pasi jehoi më ulët, u shpërnda kodrave dhe qiellit. Vila u drodh. Ajri u mbush me erë baruti. Predha tjetër, që vërshëlleu gjithashtu ulët, që shkuli tjegullat e mureve të oborrit, që shembi gjysmën e çatisë ku banonte Teli Bashari, la nga pas një tym të zi, që dalngadalë u shndërrua në flakë të dobëta. Predha e gjashtë shembi mure të tjera dhe, më në fund, gryka e topit, që ishte ulur rrafsh me tokën, hapi një brimë në murin e oborrit përballë dhe një tjetër në murin nga ana e përroit.

Fëmijët dolën nga vila, lëshuan britma dhe u strukën vetiu nën shkallët e verandës.

Ishte koha midis mugëtirës dhe errësirës, ishte afruar pra koha për të çarë rrethimin, kur Mentar Dika zbriti nga çardaku dhe, ndërsa po vraponte përmes oborrit, diçka ia ndezi gjoksin dhe e gozhdoi në vend. Një çast më vonë ai sikur harroi të mbushej me frymë dhe qe e cuditshme që nuk u shemb menjëherë, por mundi të qëndronte derisa e arritën Daklea dhe Genci. Vetëm atëherë nështa e trupit të tij ra mbi të shocën, e cila në fillim e uli në tokë, pastaj e shtriu ngadalë.

— Mentar! — thirri ajo.

Ai u tendos dhe në këtë tendosje u duk se kishte mbledhur fuqitë e fundit. Përtej mugëtirës fytvra i dukkej e zbardhur, si e çngjyrosur, por jo e trembur, as e



tronditur. Ishte vonë për t'u trembur, tashmë kishin kaluar të gjitha, tashmë ai shikonte Daklean dhe Gencin me qëndrimin e njeriut që e di se do të vdesë dhe që e ka pranuar vdekjen me qetësi. Duke lëshuar qepallat për të fundit herë dhe duke përtypur idhtirën që i kishte mbushur gojën, mendoi se po të donte mund t'i hapte prapë qepallat dhe po t'i hapte, ai e dinte se do të shikonte. së pari, trupin e hollë të Dakleas, fytyrën e saj të verdhë, por të përskuqur nga flakët e zjarrit që rritej vazhdimisht, pastaj do të shikonte Genc Bogën, të lodhur, por të ri e që duhej të jetonte akoma... Po nuk i hapi sytë. Nuk deshi vetë. Pak më vonë të gjithë kishin humbur dhe ishin shkrirë në një strukturë kaotike...

Megjithëse nuk shikonin qartë, megjithëse shikonin sipas hopeve të flakëve, Daklea dhe Genci në fillim e ndien, pastaj e kuptuan se përpara tyre ishte shtrirë vdekja dhe se rrotull tyre përgjonin e fërgëllonin të tjera vdekje, të cilat ndiheshin kudo, në ajër, në gjësimet e predhave, bile edhe në heshtjet midis gjëmimeve.

Ndërkaq, në ndriçimet dhe errësimet që vinin nga flakët e shtëpisë së vjetër, ata vunë re tiparet e Mentarit tek u zhveshën nga vuajtjet dhe gulshet e fundit, nga zemërimet, nga dashuritë, nga ëndërrimet, fytyra e tij u zbut ngadalë, u bë gati e përgjumur, gati mospërfillëse, si të mos ishte më fytyrë, por një copë e ftohtë mermeri.

Daklea qëndroi e ngurrosur, me duart të lëshuara poshtë, pastaj e shikoi të shoqin nga afër dhe, kur u bind se ai kishte vdekur, u shkreh në vaj si fëmijë, pa e fshehur fytyrën, pa e ulur zërin. Dhe s'dihet sa do të qëndronte e sa do të qante akoma, po të mos ishte buçitja tjetër e topit, që e detyroi t'i përmblihte e t'i përmbante ndjenjat e mendimet e përmortshme. Lamtumirë! Lamtumirë! tha me vete, duke shikuar për herë të fundit fytyrën e Mentarit, që për një pjesë të madhe të jetës së saj kishte qenë gjëja e parë që shikonte çdo mëngjes dhe e fundit para se të mbyllte sytë në mbrëmje. Duke kuptuar se ngjariet po rridhnin shpejt, po aq shpejt ajo që e detyruar të kthehej përfundimisht në realitetin e gjërave. Dhe

në këtë fazë kalimtare, iu bë sikur rrotull saj s'kishte ajër, sikur i merrej fryma dhe mushkëritë i kishin mbetur bosh. Lëvizti kokën, hapi buzët dhe, si ta kishte gjetur rrymën që kërkonte, u mbush thellë me frymë, Pastaj kaloi vështrimin nga Mentari te Genc Boga, prania dhe pamja e të cilit i ngjallte siguri, sa mund t'i besonte edhe jetën. Atëherë ajo foli me zë pak më të lartë se një psherëtimë:

— Genc, ngrije pak!

Topi shtiu më afër dhe më ulët.

Tha prapë po me atë zë psherëtimë:

— Duhet ta vendosim pas murit, që të mos e shikojnë fëmijët!

Sipër, në qiellin tashmë të errësuar, retë jo vetëm ishin fryrë më shumë, por edhe ishin ulur e nxirë më shumë. Prapa tyre dukej akoma vazhda e dobët që kishte lënë dielli i zhytur me kohë në thellësira të largëta, dukej rruga e fundit që kishte bërë ai, dukej fshirja e kësaj rruge, dukej ajo shuarje madhështore, që mbetet gjithmonë e tillë, megjithëse është ciklike, megjithëse përsëritet çdo njëzet e katër orë. Dhe diku në një cep të hapësirës së zezë, ylli i mbrëmjes vezulloi sërish me dritë minerare. E rrethuar nga retë kërcënuese, ajo ishte një dritë përpëlitëse, e qetë në dukje, por e pikëlluar në pa- fuqinë e saj për të arritur deri në tokë.

E gjithë kjo mbrëmje apo përtejmbremje, të gjitha këto pamje, këto lëvizje, buçitje dhe heshtje, sikur s'ishin tjetër veçse një pararendës i shtrëngatës, që po afrohej me trokun e largët e po ngushtonte gjithnjë më shumë rrethimin drejt qytetit.

Daklea hodhi vështrimin prapë nga i shoqi dhe prapë e qau si fëmijë, pa e fshehur fytyrën, pa e ulur zërin, ndër- sa pikat e para, të mëdha e të pjerrëta të shiut po afro- heshin me zhurmë e me trokëllimë, tuk-tuk-tuk...



## XXI

Tashmë kishte marrë flakë edhe çatia e vilës. Nxehtësia po bëhej e padurueshme sidomos për dhinë, lidhur prapa qemerit. Ajo vërriste, merrte vrull të këpuste litarin, ndërsa keci gjysmë i përzhitur vërtitej rrotull saj.

Pikat e shiut kokërrmadh qenë kthyer në rrebesh.

Genci ushtar kishte qenë dhe e dinte: përderisa do të shtinte topi, ata nuk mund të sulmonin dhe as rrethimin nuk mund ta mbyllnin prapa vilës në drejtim të predhave. Kur nata kishte zbritur në tokë si një frymëmarrje e rëndë dhe tiparet e tyre ishin mbështjellë nga errësira, nga shirat, nga flakët e nga tymi, ai tha:

— Atëherë...

— Është koha të ikësh, — tha ajo. — Po duke ecur në drejtim të predhave...

— Vetëm në drejtim të predhave s'ka xhandarë!

— ...rreziku është i madh!

— Ç'të bëj tjetër!?!... Rrethimi gjithmonë është i rrezikshëm!

Pikat e shiut, të ndriçuara nga flakët, binin si pika gjaku mbi tokë e mbi gjethe. Nxehtësia ishte e padurueshme. Midis këtij llahtari dhia lëpinte kecin e përzhitur nga flakët.

Genc Boga mbushi gjirin me bomba, po para se të largohej iu afrua dhisë, që ankohej. Ajo e shikoi Gencin me përqendrim. gati si për t'i bërë një kërkesë, gati si për t'i lypur diçka. Ai e zgjidhi dhinë, pastaj mbeti në këmbë aq sa iu desh të përmbliidhte mendimet e fundit. Keci fërkonte kokën pas gjunjëve të tij, e shikonte në sy dhe vërriste ngadalë, thua jse i pëshpëriste diçka të fshehtë.

— Me t'u larguar unë, — i tha Genci Dakleas, — dorëzohu menjëherë bashkë me fëmijët. Pastaj diçka do të mendojmë e do të organizojmë!

Pas këtyre fjalëve, Gencit s'i mbetej veçse të ikte. Sa më parë bile. Që të merrte fund beteja, që të mund të shpëtonin fëmijët me Daklean, ai ose duhej të vritej dhe të vritej menjëherë, ose duhej të ikte dhe të ikte menjëherë. Me një rrotullim të shpejtë u kthye nga Daklea, i pëshpëriti një «Mirupafshim» dhe vrapoi përmes shiut, që rrihte tokën, gjethet e që shuhej me zhurmë në flakët e zjarrit të madh. Qëndroi më pak se një çast te muri i shembur prapa vilës, aq sa të ushtonte predha e fundit e topit dhe, kur ajo vërsëlleu, edhe ai mori vrap bashkë me të. Po s'ishte larguar as dhjetë metra, kur ndjeu kecin t'i ngatërrohej nëpër këmbë. E pas kecit dhinë. Genci qëndroi, ktheu kokën nga Daklea si për t'i kërkuar ndihmë e si për t'i qarë hallin, por flakët e vilës, që e ndriçonin Daklean nga prapa, e kishin lënë në errësi fytyrën e saj. Ai u kthye nga keci dhe deshi ta largonte, por keci, që s'lëvizi nga vendi, e shikonte në sy dhe vërriste ngadalë, me një vërrimë çudie dhe intimiteti, siç bëjnë gjithë manarët. Fundja, Genc Boga nuk mund të priste më. Mori sërish vrap, duke ndier nga prapa kecin e pas kecit dhinë.

Kujdesi i parë që pati Genc Boga, ishte të futej në pjesën më të thyer të varosheve e cila, pasi mblihdte ujërat nga rrethinat e vilës, i çonte deri në afërsi të përroit, ku të thyerat bëheshin më të sheshta. Shiu që binte me rrëmbim, thërrmohej në pështjellime tymnash e mjegullnash, që bashkë me errësiën mezi lejonin të shquhej silueta e Gencit si dhe dy hijet e vogla, që zvarriteshin prapa tij e që mbeteshin të paidentifikuar.

— Ej, ti! — mbiu një zë nga errësira e nga rrebeshi.

Genc Boga fshiu fytyrën me mëngën e xhaketës. Ai e dëgjoi zërin (sigurisht mbytur), por kokën nuk e ktheu nga gëmushat buzë përroit, sepse bëri sikur nuk e kishte dëgjuar, ose sikur nuk i kishte dhënë rëndësi. Prapë vrapoi duke zgjedhur me kujdes shkarëzimat e të përthyerat më të thella të varoshit dhe një minutë më vonë ai s'ishte i



sigurt nëse i kishin bërë veshët, apo vërtet dikush e kishte thirrur: «Ej, ti!»

Një predhë, që nisi trajektoren me vërshëllimën e saj të zakonshme, gati të fshehtë, (buçitja si zakonisht do të dëgjohej pak më vonë), kaloi mbi kokën e Genc Bogës dhe ai u shtri, duke harruar çdo rrezik tjetër që mund t'i vinte nga xhandarët. Predha pëlciti njëzet metra larg. Dhe pastaj ai sikur dëgjoi prapë zëra. Kësaj radhe Genci e ktheu kokën anej më ngadalë, si për t'i dhënë vetes sa më shumë kohë të mendonte një rrugëdalje. Shikoi nga gëmushat, të cilat, përtej perdes së rrebeshit, dukeshin si njolla pa formë dhe atje shqoi vetëm mjegullirë, që përskuqej paksa nga flakët e largëta të vilës. Ndonëse të mbytur, zërat dëgjoheshin dhe Gencit i bëhej sikur ata binin të pjerrët, të fortë, të shpeshtë, binin me ritmin e kokrrave të mëdha të shiut, me zhurmën e tij tuk-tuk-tuk dhe e qëllonin kudo e pa mëshirë, tuk-tuk-tuk... Mos kishte ardhur çasti të përdorte bombat?... Mund t'i përdorte, sigurisht!... Por mund edhe të mos i përdorte!... Kjo e fundit ka të bëjë me gjakftohtësinë, mendoi ai. Dhe prapë iu bë sikur dëgjoi zëra, që më shumë mund t'u ngjanin britmave, në drejtim të të cilave Gencit iu shfaqën lëvizje bustesh prapa gëmushave. Tashmë dora e tij ishte futur në xhep dhe kishte zënë një bombë.

Befas keci fërkoj turirin te këmbët e Gencit. Dhia, ngjeshur pas kecit, merrte frymë me feçka dhe Genci përfytyroi si fryheshin e shfryheshin ijet e tyre. Sakaq, në çdo grimcë të ajrit u ndie nisja e fshehtë e predhës, aq e pritur nga Genc Boga. Ai thjesht u rrokullis dhe u platit pas tokës: predha kishte pëlcitur djathtas, pikërisht midis tij dhe gëmushave ku mund të ndodheshin xhandarët. Diku aty afër dhia ndillte me vërrimë shqetësuese kecin, që ishte çoroditur e që bënte kërcime e varavinga të kota.

M-m-m, dhia.

Ë-ë-ë, keci.

Tuk-tuk-tuk, pikat e mëdha e të shpeshta, të pjerrëta e të rrëmbyera të shiut.

Kur u shuan jehonat e predhës, që hidheshin e pri-

teshin kodër më kodër, ai ishte larguar njëzet metra të tjerë në drejtim të përroit, ku shtrihej ajo që quhej edhe shelgjishtë, edhe rrapishtë, edhe plepishtë, sepse kishte pak nga të gjitha dhe ishte një përzierje e të gjithave, por quhej edhe zabel, sepse askush nuk i ruante ato pemë nga sëpata, që kërciste aty dimër e verë. Vetëm rrallë, kur flakët e përtejme të vilës ngjiteshin lart, Genc Boga arrinte të shquante se si predhat e topave kishin punuar varoshet, kishin thyer, këputur e shkukur nga rrënjët plepa, shelgje e rrape të vjetra e të reja. Dhe më se një herë ai kishte menduar se ja, predha, që sapo mund të kishte dalë nga gryka e topit, do t'i binte përpara këmbëve, do t'i pëlçiste në kokë, do ta bënte fërtele, s'do t'i linte nam e nishan... Por jo, predhat vërtet e kishin ciflosur në ballë e në duar, po asnjëra nga ato nuk i kishte rënë akoma para këmbëve apo në çaçkë të kokës, siç e kishte menduar ai. E, ndërsa vraponte (pas tij keci e pas kecit dhia) e, ndërsa rrokullisej për t'u shpëtuar copave e ciflave, atëherë predha tjetër arrinte në varosh, ku pëlçiste me shkëlqimin e shkurtër të një rrufeje, herë këtu, herë atje e kudo, por asnjëherë te këmbët e mbi kokën e Genc Bogës...

## XXII

Daklea mbeti vetëm. Ajo nuk pa më veçse supet e Gencit; që humbisnin e shfaqeshin nëpër shkarëzimat e varosheve prapa vilës. Dëgjoi për pak kohë zërin e dridhur të dhisë e të kecit dhe u përpoq të merrte me mend gjendjen e ethshme të Gencit, që vraponte e shtrihej derisa pre-



dha të mbaronte vërshëllimën e të pëlçiste. Pastaj silueta e Gencit u shkri me errësirën, u zhyt në mjegullnajën e rrebeshit dhe ajo nuk e pa më.

Tashmë, fiakët e veçuara të të dy kulmeve, të vilës e të shtëpisë së vjetër me çardak e qemer, ishin bashkuar në një të vetme, që ndriçonin retë e ulëta, varoshet dhe rrebeshin, i cili binte nga lart si një vërvitje e pjerrët prej gjaku.

Ishte në një çast të këtillë, kur Daklea pësoi një tronditje tjetër të menjëhershme. Ajo u drodh. Fëmijët! Thirri disa herë me zë e pa zë: fëmijët! Tashti e gjithë qenia e saj ishte elektrizuar. Fëmijët! Ja cilët duhej të shpëtonte ajo, ja për cilët jetonte, ja për cilët ekzistenca e saj kishte akoma kuptim. Fëmijët!... Por ata heshtnin. E pse heshtnin? E pse nuk qanin më?... E pse nuk qante të paktën Leta?!...

Thirri:

— Gimi, Leta, Kati!

Asnjë përgjigje.

Vrapoi si fantazmë drejt shkallëve të verandës. Por atje mbeti e ngrirë: ajo kishte frikë të kërrusej, kishte frikë të shikonte nën verandë. Në ç'gjendje do të ishin ata vallë?... Më në fund briti:

— Gimi, Leta, Kati!

Asnjë përgjigje.

Atëherë zgjati duart dhe tërhoqi të parën Letën. Leta e shikonte syçapëlyer, pa mundur të nxirrte zë.

— Gjallë jeni?

Heshtje.

— Pse nuk përgjigjeni?

— Gjallë, mami! — tha Gimi. — Po kemi frikë nga topi e nga zjarri.

U ndie presioni i njohur i ajrit, që krijonte predha sa pa dalë mirë nga gryka e topit... Dakleas iu bë sikur kjo predhë ishte nisur pikërisht në drejtim të shkallëve të verandës, bile tashti ajo çuditej që nuk ishte kujtuar me kohë se të gjitha predhat e mëparshme vetëm në atë drejtim mund të ishin nisur, vetëm atë shenjë mund të kishin pasur: shkallët e verandës. Pra-

ndaj ra mbi fëmijët dhe i mblodhi rreth vetes, siç mbledh squka zogjtë kur mbi kokë i kërcënohet rreziku. Jo, edhe kjo predhë, ndonëse hyri përmes flakëve të vilës dhe lëshoi poshtë ç'gjeti përpara, nuk i qëlloi fëmijët. Po predha tjetër, që do të nisej së shpejti, do të qëllonte me siguri aty ku duhej, ose më mirë të tani. aty ku s'duhej. E vendosur më tepër se kurrë, Daklea u hodh në këmbë, për t'ia mbyllur grykën me çdo kusht përbindëshit.

— Mos lëvizni pa u kthyer unë! — Kështu u tha fëmijëve dhe shpejt e shpejt sajoi një rreckë, në vrap e sipër e lidhi rreckën në majë të një shkopi dhe e nguli menjëherë në një nga mbeturinat e mureve që kishin mbetur pa u shembur. Apo pati bindje se rreckën e bardhë e kishte ngritur në çastin e fundit, kur atje në cep të varoshit, dora e oficerit, që do të komandonte shkrepjen e topit, kishte mbetur e ngritur dhe e ndriçuar nga flakët, prapa të cilave dyndeshin errësitat. Daklea pyeti: a do ta shikonte oficeri rreckën, apo dhe duke e shikuar do t'ia kishte qejfi ta hidhte edhe një predhë, që për shpirtin e nënës mund të ishte fatale?...

— Prapësohu! — u dëgjua zëri i oficerit dhe predha fatale nuk doli nga gryka.

Kështu topi nuk shtiu më. Beteja e vilës kishte marrë fund, kurse në të kundërtën, trokëllima e shiut, që rrihte gjithë dhe tokën, që shubei me mërzhitje të vazhdueshme në flakët e ndritshme të zjarrit, u bë më e madhe, thuajse kishte pushtuar tërë botën.



## XXIII

Kudo ndihej era karakteristike e shkruabit, kur kthehen në hi e në thëngjij trarë e qepra, tavane, shtylla e gjithçka tjetër e re dhe e vjetër, që ka qëndruar mbi tokë më se një ditë, më se një vit, më se një shekull e ndoshta më shumë.

E lagur, e lodhur, tashti Daklea dukej krejt asnjënëse, krejt mospërfillëse për gjithçka që po ndodhte. Fëmijët, të zënë pas fustanit të saj, ecnin të heshtur e të ngurrosur, me një ngurrosje të plotë të shqisave, të trupit dhe të mendjes së tyre të vogël.

Vetëm Kati ngriti sytë (jo në çastin e parë, në një çast tjetër) dhe shikoi Daklean. Njëra faqe i thithte terrin e natës, tjetra ndriçimin e flakëve. Si të nxitur nga këto flakë, sytë e saj kishin dalë nga ngurrosja, ishin mbushur me mendim e me ndjenjë, ishin bërë të gjallë e të zgjuar.

Ajo pyeti:

— Mos duhet të ndahemi, nënë Daklea?

— Pse të ndahemi?! — pyeti edhe Daklea.

Sytë e trishtuar të Katit, të alarmuar e të zgjuar qeshën përbrenda.

— Nuk do të ndahemi pra?

— Jo! — tha prerë Daklea.

Pas pak ajo u duk mbi gërmadhat e mureve të vilës me tre fëmijët nga prapa. Leta ishte kapur fort pas fustanit të Dakleas. Gimi pas Letës. Kati pas Gimit.

Vetëtimat çanin qiellin me shkrepje zigzage dhe ndriçonin tokën anembanë, që me dublimin e hijeve të çdo objekti e me dritën e bardhë plot shkëlqim, të krijonin përshtypjen se, befas, kishe rënë në një botë ireale apo në një planet të panjohur. Afrimi i ca bubullimave akoma të largëta, por të fuqishme, që bënin

të dridhej ajri e të jehonin malet, dëshmonte se shiu kokërrmadh që rrihte me zhurmë pullazet, gjethet dhe tokën, do të kthehej në shtrëngatë të vërtetë.

Daklea mbeti një hop mbi gurët e mūrit të she-mbur, duke shikuar nga njëra anë rreshtat e gjatë të xhandarëve, që kullonin ujë të gjelbër nga strehët e gjelbra të kapelave, nga ana tjetër, turmën e ngjeshur që kishte zënë më se gjysmën e varoshit. Në turmë kishte burra me qeleshe e takije, me kasketa e kokëjashtë, siç kishte edhe gra kokëjashtë, me gërsheta, me shami e napa, që zbardhnin si pupa bore të pashkrirë mbi një lëndinë të errët. Kishte njerëz të punës me përparëse lëkure, argatë e punëtorë me kazma e lopata në krah, kishte edhe rrugaçë të zbathur e të shkalafitur, njerëz nga më të ndryshmit, të të gjitha profesioneve e të të gjitha kallëpëve. Kishte edhe nga ata vagabondë, endacakë e të papunë profesionistë, të rruar e të parruar, me flokë të gjatë ose fare të qethur, e deri kusarë që u ngjanin lypsarëve dhe lypsarë që u ngjanin kusarëve. Kishte njerëz të identifikuar ose jo, sepse zia e bukës bënte që të zhdukeshin e të shfaqeshin njerëz të njohur e të panjohur: qytetarë që shkonin fshatrave, me shpresë se miku do tu jepte një dorë miell, fshatarë që zbritnin në qytet me thasë e me torba bosh, me shpresë se mos qeveria i vinte gishtin kokës dhe u shpëtonte fëmijët nga uria e nga vdekja. E çfarë s'kishte në atë turmë, që për-bëhej nga njerëz të rastit e jo të rastit, sepse shumë prej tyre kishin ardhur aty me teneqe, kova, kusia, kazma e me mjete të tjera rrethanore për të shuar, sipas zakonit, zjarrin në vilën e Dikëve.

Por i gjithë ky popull, aq sa heterogjen, aq sa i veçantë dhe anonim, sikur gjeti një pikë bashkimi e marrëveshjeje në gjirin e tij dhe kjo ndodhi kur mbi murin e shembur u duk Daklea Dika me tre fëmijët nga pas. Atëherë, nëpër turmë u dëgjua një uturimë e mbytur pozitive dhe u shqua lëvizja e një vale të lehtë, pas së cilës do të vinin të tjera, ndoshta edhe më të forta.

Ky ishte shkaku që Daklea, me t'u shfaqur në grumbullin e gurëve me fëmijët të qepur pas fustanit, mbe-



ti një hop pa lëvizur, duke u hedhur të gjithëve një vështrim miqësor, pikëllues e mirënjohës. Pastaj ajo eci ngadalë përmes varoshit, si anije e ngarkuar rëndë, e zhytur thellë në ujë, me tri varka të vogla nga pas.

Kur arritën në mes të varoshit, ata u gjendën të rrethuar nga xhandarët dhe për më tepër Dakleas ia lidhën duart me pranga.

— Ti ik! — tha një xhandar dhe e shkëputi Katin me forcë. — Lypsare!

Kati mbeti midis xhandarëve dhe Dikëve të rrethuar, fytyrëzbardhur si kartë e prekëblu si letërthithëse. Një çast më vonë prekat e saj u dukën si rruaza gati për t'u shkërmoqur, e për të rënë në tokë.

— Jo! — thirri ajo dhe vrapoi të bashkohej me Dikët, po muri i xhandarëve e zbrapsi. Po ndodhte kështu rreziku që kishte përfytyruar kaq herë, po ndodhte që të kthehej prapë rrugëve e të lypte e të...

— Ik, moj! — i britën ata dhe dikush e qëlloi me shkelm.

Kati u zverdh, vuri duart në bel (me sa dukej xhandari e kishte goditur rëndë) dhe mbeti një copë herë si e paralizuar.

Turma heshtte, me atë heshtjen e saj, që fundja s'mund të quhej thjesht një heshtje e zakonshme.

Dalngadalë Kati e mori veten.

— Jo! — thirri prapë dhe pas kësaj thirrjeje u lëshua përpara si skifter, që duke ndjekur gjahun e imët, futet nëpër degët e bisqet më të ngatërruara të pemëve, derisa ia arrin qëllimit. Kështu u lëshua Kati, çau gardhin e xhandarëve, arriti Gimin dhe u qep pas tij me të gjithë forcën e vet.

Njëri nga xhandarët u përpoq ta shkëpuste sërish, po tre të vegjlit u bënë lëmsh dhe e kafshuan xhandarin ku mundën. Xhandari u tërhoq dhe shikoi oficerin që kishte marrë pamjen e një të vdekuri të pakallur, i cili, duke qenë me njërin faqe e gjysmën e buzës në errësirë, me tjetrën e gjysmën e buzës në dritë, tha:

— Lërimi! Ç'rëndësi ka për ne, një grua e burgosur apo e internuar me dy a tre fëmijë!

Kur rreziku i ndarjes mbeti prapa, Gimi shikoi nga xhandarët me seriozitet dhe në sytë e kaltër e në të gjithë fytyrën e tij kaloi një buzëqeshje inatçore (dublikatë besnike e buzëqeshjeve të të atit), që nuk ia ndryshoi fare shprehjen e fytyrës.

Kurse Leta, duke parë se xhandarët bënin ca gjëra të çuditshme, si bie fjala, mund të ndanin Katin nga ajo, e kishte zënë fustanin e së ëmës me të dyja duart dhe ishte e para herë në jetë që në një ngjarje të frikshme jo vetëm nuk qante, por as nuk i shkonte në mendje një gjë e tillë.

Ndërsa turma heshte, me një heshtje të rëndë e të shurdhër, të ngjashme me ato që ndodhin në natyrë para shtrëngatave.

## XXIV

Kapiten Shaban Sinani, i shoqëruar nga hija e vet (aspiranti), u gjend përballë Dakleas dhe pyeti:

— Ku janë të tjerët?

Sado i ndriçuar, sado i përsququr nga rrezet e flakëve të vilës si gjithë të tjerët, prapëseprapë, kapiteni nuk u ngjante të tjerëve. Tek ai kishte diçka të veçantë, që shprehej sidomos në zërin e tij, i cili të kujtonte jo thjesht një zë, por një dridhmë, një shuarje, një hiç.

— S'ka të tjerë, — tha Daklea.

Kapiteni, si të ishte i mbrujtur nga copa dylli, u duk sikur u shkri dhe sikur ra i gjithi te këmbët e veta. Megjithatë, u duk qartë se ai ishte akoma në gjendje të lëvizte buzët e duart. Pas këtyre lëvizjeve, xhandarët



që u ndodhën pranë u zhdukën prapa mureve të shembura të vilës.

Varoshi heshtte.

Të parën sollën kufomën e Mentar Dikës. Pastaj të Folta Papit. Pastaj të Teli Basharit. Dhe asgjë më tepër. Atëherë kapiten Shaban Sinani vrapoi drejt shtyllës së ngulur në cep të varoshit, shkëputi shpalljen me fotografinë e Genc Bogës, u kthye te Daklea, ia shpalosi para syve dhe tha:

— Po ky, ku është ky?

Daklea tundi kokën «jo».

Kapiten Shaban Sinani diçka kuisi si qen i rrahur dhe, i pasuar nga hija e vet (aspiranti), u zhduk gati me vrap drejt rrugicave të errëta.

Thonë se që nga prapa errësirave u dëgjua zëri i tij tek thërriste:

— Aspirant, ç'dreqin më je ngjitur si rrodhe?!

Thonë se aspiranti iu përgjigj me të egër (prapa errësirave):

— Zbatoj urdhrin e naltmadhnisë, kapiten!

## XXV

Kufomat, Daklea, fëmijët, turma dhe xhandarët zbritnin drejt qendrës së qytetit. Zbritnin në të njëjtën rrugë, apo në rrugë të ndryshme, kjo s'ka rëndësi, ashtu sikurse s'ka rëndësi as fakti se për ku ishin nisur një palë e për ku tjetra: drejt shtëpive, drejt varrezave, drejt burgut, drejt hiçit (lypsarët pa strehë). Për atë mbrëmje rëndësi mund të kishte një fakt i thjeshtë:

të gjithë këta njerëz ecnin nën një qiell kërcënues, të pushtuar fund e krye nga re të zeza, të fryra e të ulëta, që lëshonin shi me erë, që lëshonin vetëtima e bubullima. Njerëzit shpejtuan hapin. Por edhe shiu shpeshoi, u bë më i vrullshëm, siç u bë më e vrullshme shtrëngata, që vrapoi me galop mbi kurrizin e tokës e të turmës. Disa erëra të largëta e kushedi çfarë fenomenesh të tjera, e detyronin rrebeshin të zhvendosej, të largohej për diku, ndoshta në anën tjetër të qytetit po dhe më larg, në faqet e maleve, bile dhe më larg, pastaj, befas e afro-nin sërish me frushullimën e galopin e tij, si një barkë pa timon, që shtyhet e vërtitet nga tallazet e egra të detit.

Por, ndërsa rrebeshet shkonin e vinin, turma mbe-tej po ajo, ajo ishte aty në rrugë, ajo lëvizte e lëvizte me çapin e saj të matur, e zhytur në ujë, e zhytur në mendime...

Dikush thirri:

— Populli të rreshtohet i gjithi para prefekturës!

Duke dyshuar se turma nuk e kishte dëgjuar, thirri prapë:

— Fillojnë festimet e mëdha!

Dhe kur pa se turma po shkriërohej, po degëzohej rrugëve e rrugicave, thirri prapë:

— Do të flasë vetë zotëria e tij prefekti!

Megjithatë turma i kishte kthyer plotësisht kurrizin.

— Shqipëria u bë mbretëri! — thirri fort ai.

Tashmë turma ishte zhdukur nëpër ata qindra damarë të qytetit, që rriheshin nga rrebeshi, që ndrigohe-shin nga vetëtimat, që dridheshin nga bubullimat.

Ishte kohë me shtrëngatë dhe s'ishte kohë për të qëndruar jashtë. As për të dëgjuar shesheve të qytetit fjalime, apo çfarë tjetër akoma...



## XXVI

### MITINGU

Në një nga zhvendosjet, kur rrebeshi kishte pushuar ose ishte larguar dhe nga shiu s'kishte mbetur veçse një psherëtimë midis gjetheve të lagura, kur llambat e rrugëve ndriçonin jo më shumë se një hasër vend, te sheshi para prefekturës u mblodhën një grusht ithtarësh të Ahmet Zogut për të festuar ditën historike të kurorës mbretërore të Shqipërisë.

Nga ballkoni i prefekturës paksa dukej koka e vogël e prefektit, e cila tundej në ritmin e këtyre fjalëve:

— Në orën nandë e katërmbëdhjetë minuta të ditës së sotme, një shtatuer, një mijë e nandëqind e njizet e tetë, u shue nga jeta shqiptare Republika dhe përfaqësia e kombit vendosi atë që ishte vullneti i patundshëm i popullit, monarkinë de-mo-kra-ti-ke. Naltmadhnia e tij mbreti priti po sot në orën dhetë në pallatin e vet ofertën e kunorës që i bante populli shqiptar. Mbreti e pranoi kunorën dhe në orën katër mbasdite, midis vargjesh të gjata dhe të plotngjyrta të popullit dhe të ushtrisë, kaloi mbi automobilin e vet, u fut në parlament dhe u betua përpara zotit dhe popullit...

Turma prej njëqind ithtarësh, që bashkë me bandën muzikore ishte përhapur nëpër shesh, thirri:

— Rroftë e qoftë Zogu i Parë, mbreti i shqiptarëve!

— Ala-la-a-a-a! — u dëgjua një zë nga fundi.

Kjo britmë e vetme nuk mbeti pa tërhequr vëmendjen e nëntëdhjetë e nëntë të tjerëve. (Nuk ishte e para herë që dëgjohej ajo.) Të gjithë sa qenë aty kthven kokën prapa dhe pasthirrën: a-a-a! Fejza, i biri i Push agait, që sapo është kthyer nga Italia. Ndoth,

posi, sidomos ditët e para, ngatërrimi dhe pleksja e gjuhëve, ndodh, si jo, po... si...

Dikush thirri:

— Murroja!

Nga Fejza i Push agait vështrimet kaluan te... Murroja, që s'dihej nga e si kishte ardhur, por dihej që ishte aty në një cep të sheshit, ulur më bisht, me kokën lart e me jargët poshtë. Ç'është e vërteta cepin e sheshit e mbulonte errësira dhe ithtarët e mbretit mezi shquan siluetën e një qeni të madh e jo më të shquanin jargët e tij, por s'ka gjë, kaq përfytyrim u kishte mbetur atyre sa për të marrë me mend se aty ku kishte një Murro, kishte edhe jargë, ose anasjelltas, aty ku kishte jargë, duhej të kishte edhe një Murro.

Kështu menduan burrat dhe pastaj, duke tundur krahët si flamingo e si lejlekë para fluturimit, duke kërcyer mbi njëri-tjetrin, të njëqind ithtarët (99 + 1), plus dhe pjesëtarët e bandës muzikore, me kallo të shkelura e me kocka të dërrmuara, sulmuan portën e prefekturës dhe, sa hap e mbyll sytë, u zhdukën të gjithë brenda saj.

Vetëm pas disa minutash dikush mori guximin dhe hapi ngadalë portën e rëndë. Në fillim u duk paksa një majë hunde, pastaj një kokë e mbuluar me bombë, që rrotulloi sytë nëpër shesh e që shpejt dha siahariqin se Murroja kishte ikur. Kështu, në minutën tjetër ithtarët ishin mbledhur sërish nën ballkon dhe nga maja e ballkonit koka e vogël e prefektit tundej në ritmin e këtij betimi:

Unë, Zogu, mbreti i shqiptarëve, në çastin në të cilin po hudh kambën mbi thronin e mbretnisë shqiptare dhe po marr në duer pushtetin mbretnuer, betohem përpara fuqisë së zotit me...

— Rroftë e qoftë!...

— Ala-la-a!

Sërish u kthyen kokat, sërish kishte ndodhur diçka e re: kësaj radhe thirrjen e huaj e kishin shqiptuar jo një, por dy e më shumë zëra. Në çastin tjetër u sqarua se raporti në turmën e njëqind ithtarëve që ndarë



97 me 3. Kjo nuk qe e vështirë të kuptohej: vetëm 97 koka kishin lëvizur, kurse 3 nga të njëqindtat kishin mbetur të ngrira si koka shtatoresh. Por, në qoftë se dikush nga ju dëshiron të dijë gjendjen e vërtetë; duhet të themi se edhe kjo shifër nuk ishte plotësisht e saktë. Mëdis atij grushti njerëzish kishte edhe fashistë të tjerë, që akoma nuk e kishin zbuluar veten. Kishte pra edhe Veniamin Çekë (ai ishte aty me çadër mbi kokë, sepse po afrohej galopi i rrebeshit), që nuk thërritnin as «Rroftë e qoftë!» as «Ala-la-a!» Kishte pra. Aty ishin, por nuk zbuloheshin se ashtu ua donin punët (hëpërhë).

— ...mbajtë bashkësinë kombëtare, independen-  
cën e shtetit dhe tokat...

Hu-u-um, një e lehur e vetme e atij qeni që quhej Murro. Një e lehur, por efekti që bëri ajo qe shkatërrimtar. Kjo ndodhi, përveç të tjerave, edhe për faktin e thjeshtë se të lehurën e dëgjuan të gjithë, por Murron vetë askush nuk e pa, bile as siluetën e tij. Mister! Lexuesi mund ta marrë me mend skenën që u përsërit me ithtarët dhe me pjesëtarët e bandës muzikore. Ai mund ta marrë me mend, gjithashtu, se kësaj radhe porta e prefekturës u mbyll që të mos hapej për një kohë më të gjatë.

Një orë më vonë, kur u mor vesh dhe kur u vërtetua nga policia e bashkisë se as radhën e parë as të dytën nuk kishte qenë Murroja, se Murroja i vërtetë kishte ngordhur (nga tërbimi!), por kishte qenë një tjetër Murro, atëherë nëpër rrugët e qytetit u dëgjua sërisht një trumbetë, që u kthye shpejt në muzikë. Për më tepër, në qiell u ndezën edhe fishekzjarrë. Poshtë kakofoni tingujsh, sipër kakofoni fishekzjarrësh, kakofoni resh të ulëta e të zeza. Ashtu i zyrtë dhe i rëndë siç ishte qielli, i shpuar nga britma e nga fishekzjarrë, ai lëshonte trishtim mbi tokë dhe të ngjallte atë ndjenjë përdhosjeje që të ngjall një livadh (dikur i bukur) mbushur me bajga dhe shkelur nga potkonjtë e mijëra kuajve.



Por askush nuk doli rrugëve, as popull dhe askush përveç ithtarëve, sepse kush i siguronte njerëzit se edhe Murroja i ri nuk ishte i tërbuar, ndoshta më i tërbuar se i pari? E kush i siguronte ata se nuk ishte i njëjti Murro, por që fundja mund të kishte ndryshuar vetëm qimen?

E vërteta është se qyteti heshti përfundimisht dhe ai ishte dhe mbeti i tëri i mbyllur. As dyer të hapura, as dritë nëpër dritare, bile as fëmijët nuk u dukën prapa bandës, as lypsarët, as edhe Niagara e vogël, e padëmshme dhe e pafajshme e koneve të të gjitha racave. Dukej sikur jeta kishte marrë një tingëllim të shurdhër, të pakapshëm e të pakuptueshëm.

Rrebeshet shkuan dhe erdhën disa herë mbi qytet. Galopi i tyre rrihte tokën, kalldrëmet, çatitë dhe gjetet, pastaj largohet e zhvendosej me trokëllimë të mbytur e të nëndheshme. Në një nga ecejaket e rrebeshit ndodhi ajo që pritej e që s'ishte aspak e rastit, që mund të ishte jo vetëm e radhës, por ndoshta edhe e shpejtuar ose e diktuar nga tërë ato gjëmime, vetëtima e rrufe: shpikja e Edisonit, e vetmja zhurmë e epokës moderne që përkëdhelte qytetin N, gati si çdo mbrëmje e si çdo natë, e tradhtoi qytetin, por para se ta tradhtonte përfundimisht, centrali lëshoi fishkëllimën e tij të njohur, që ishte antipodi i zhurmës moderne e që për më tepër të kujtonte të ashtuquajturën këngë të mëllenjës sqepverdhë.

Quf-quf-quf...

Të themi të drejtën, ne nuk dimë se ç'bënte atë natë kombi mbarë, por nuk dimë as ç'do të bënte atë natë qyteti N, bie fjala, do t'i vinte në përdorim fenerët e vajgurit, apo do të preferonte të mbetej në errësirë. Kjo do të varej nga fakti, sa do t'ua mbante pajtimtarëve të bashkisë të dilnin rrugëve për t'i ndezur ata. He-he, Murroja, por edhe rrebeshet!...

Errësirë...



## XXVII

### NJERËZIT ME TË ZEZA

Atë natë askush nuk hyri dhe askush nuk doli nga dera e fshehtë. Por atje brenda, katërkëndëshkënd-drejti, që zhytej në gjysmërresirën e skuqur të llambës me vajguri, (kjo tregon se dritat elektrike nuk u ndezën), ky njeri prâ, me dy të çarat në vend të syve, lexoi diçka, përpunoi diçka, diktoi diçka, makina e shkrimit rrahu tastat, të gjitha sa u thanë e sa u shkruan u sistemuan në një dosje dhe dosja u titullua: GENC BOGA, CAÛSA PENDENTE. GENC BOGA, ÇËSHTJE E PAMBARUAR. Kaq. Pastaj nga një tjetër njeri, me të zeza edhe ai, që u fut si hije nga dera e brendshme, dosja u vendos në raftin për njoftim e për veprim.

## E P I L O G

### I

Në çastin kur ai vuri kurorën, këshilltari, si ta kishte kuptuar dëshirën e tij, i pëshpëriti:

— Monarkia është evolucioni i historisë shqiptare!

Mbretit të ri ia pati qejfi edhe t'i besonte edhe të mos i besonte këtij gjykimi e me këtë dyzim në shpirt e në mendje, ai mori rrugën e kthimit për në pallat, me fizionomi të mbushur plot kujtime e shqetësime. Por këtë as e dinin të gjithë, as e diktonin të gjithë. Këtë



mund ta dinte e mund ta diktonte vetëm këshilltari i tij, sepse vetëm ai kishte mundur të depërtonte sado-pak në sedrën dhe në ambiciet që përkëdhelnin mbretin tridhjetetrevjeçar, i cili përveç disa skemave të përpunuara në akademitë ushtarake turke e përveç intrigave politike e vrasjeve pas kurrizit — ku ai e kishte treguar veten mjeshtër të mbaruar — të gjithë pjesën tjetër të botës e shikonte akoma me syfë e një virgjiniteti djallëzor të padegraduar, aq sa primitiv aq edhe të egër. Duke e pasur përbri këshilltarin (çelësin e kohës), mbreti diç i pëshpëriti për shoqëritë koncesionare e për diçka tjetër akoma dhe që nga ai çast, derisa dolën jashtë parlamentit dhe hipën në makinë, këshilltarit sepse iu formua përshtypja se mbreti kishte ecur me kujdes të tepruar, si të kishte shkelur mbi disa bilance të koklavitura e mbi supet e gjithë atyre shoqërive që quheshin SVEA, EIAA dhe AIPA, e atyre *aziendave* minerare dhe Oil Kompanive etj. etj., mu sikur ato të ishin gurë, që shërbenin për të kaluar një va të rrezikshëm. Bile, deri buzëqeshjet e tij sikur nuk u qenë drejtuar parlamentarëve që, të rreshtuar në të dy anët e korridoreve, e duartrokitnin, por... vetëm disa objekteve pa jetë, siç mund të ishin, bie fjala, lireta italiane, lira angleze, dollari amerikan, frangu francez e zvicëran etj. Nuk është budalla jo, tha me vete këshilltari, duke çuar nëpër mend frazat që mbreti i kishte pëshpëritur në parlament për shoqëritë koncesionare, që duhej të bëheshin një nga burimet kryesore për të mbushur kuletën e thatë e të dobësuar të mbretit xhepshpuar. Kështu kishte thënë ai me shaka e me seriozitet. Do t'i keni të gjitha, i tha këshilltari kur ishin në makinë dhe mbreti i shtrengoi krahun me mirënjohje e buzëqeshje, gjë që ndodhte tepër rrallë tek ai, i cili vetëm një herë kishte mundur të fantazonte në jetë ashtu siç duhej dhe kjo kishte ndodhur kur i kishte lindur ideja për të krijuar nga hiçi dinastinë e vet mbretërore.

Kështu u kthye në pallat. Mbreti zuri kryet e vendit në darkën e parë mbretërore, pa e dhënë veten, sikur



çdo gjë të ishte zgjidhur një herë e përgjithmonë. Aty nga fundi i darkës, kur miqtë, të afërmit dhe autoritetet po tregonin shenja lodhjeje, kur vëmendja e të pranishmëve ishte shkëputur disi nga mbreti, kur ishin mbaruar buzëqeshjet dhe urimet, kur bisedat, që e kishin humbur karakterin e tyre të përgjithshëm, ishin shkërmotur e përqendruar në grupe të vogla, atëherë mbreti thirri këshilltarin, e uli pranë vetes dhe i tha:

— Nesër, pasi të kemi mbaruar audiencat me ambasadorët, e pasi të më informosh se si e ka pritur shtypi i huaj kurorën time, dua të më flasësh për bëmat e njërit prej mbretërve të lashtësisë!

— Naltmadhni, unë them të vazhdojmë mësimet e historisë sipas rendit kronologjik. Të gjithave do t'u vijë koha...

Mbreti ngriti sytë dhe e zhbanoi vetëm për një çast. (Ishte hera e parë që këshilltari e thërriste *Naltmadhni*.) Ai zhbanoi nuk kishte qenë i thjeshtë dhe as i pandërgjegjshëm, përkundrazi, ai ishte bërë nën pushtetin e plotë të një supersticioni: po të jefë duke më shikuar duart, siç e ka zakon, tha mbreti me vete, kjo do të thotë se dinastia ime do të trashëgohet brez pas brezi, po të jetë duke më shikuar në fytyrë, gjë që ndodh rrallë tek ai, mbretëria ime do ta ketë jetën fare të shkurtër. Këto mendoi e tha me vete mbreti. Ndodhi që këshilltari i shikoi edhe duart edhe fytyrën. I pushtuar nga një gjendje e papërcaktuar dhe e dyanshme, me inatin që i lëvriu në fytyrë e që ia zmadhoi tiparet si me lentë, mbreti e ndërpreu këshilltarin:

— Jo, nesër dua të më flasësh për një nga oborret mbretërore më të vjetra e më në zë. Mbreti jam unë dhe radhën e historisë e bëj unë!

— Atëherë ta fillojmë me Jul Cezarin!

— Jo! — ia priti mbreti aty për aty.

Këshilltari, që e dinte se çdo kundërshtim që mund t'i bëje, ai e krahasonte me një fyerje të madhe, nuk e përmendi më emrin e Cezarit.

— E dija, — tha mbreti, — se pikërisht për Cezarin



do të kishe dëshirë të më flitje. Nuk e kuptoj, pse të gjithë njerëzve të ditur u ka mbetur mendja vetëm te Cezari! Fundja, me, sa kam dëgjuar, atë e kanë vrarë me thikë në sy të të tjerëve!

— Po, naltmadhni!

— Ç'mbret e ç'perandor është ai, që lejon të tjerët ta vrasin me thikë?

— Atëherë të flasim për Aleksandrin e Madh që pushtoi gjithë botën e atëhershme!

— Jo, — tha mbreti, — edhe unë, po të kisha një ushtri sa të Aleksandrit, do ta pushtoja që sot botën!

Këshilltari mori guximin të pëshpëriste:

— Jeta e një mbreti ka shumë aspekte të tjera, si bie fjala, përse Aleksandri i Madh e vrau virtuozin Klito?... Kur ushtria kishte etje dhe kishte mbetur vetëm një broke me ujë për Aleksandrin, e dini ju, naltmadhni, ç'bëri ai?

— Jo, dhe as që dua...

— E derdhi broken në rërë!

— Budallai!

— Atëherë për Hanibalin, që përdori i pari në be-tejë elefantët!

— Ne s'kemi elefantë!

— Ndoshta për Pirron?

— Jo, — tha mbreti. — Megjithëse vdiq nga një tullë apo tjegull në kokë, kjo s'do të thotë se vdekja e tij nuk është qesharake!

— Për Xhinxhis Khanin. Kudo që i shkelte këmba linte prapa një shkretëtirë të verdhë aziatike, me duna rëre që ngriheshin njëra pas tjetrës, derisa humbisnin perspektivën. Të tilla ishin rrënojat dhe të tilla ishin të vrarët që ai linte nga prapa.

— Ky më pëlqen! — tha mbreti. — Nesër Xhinxhis Khani. Të ma tregosh bukur, siç e fillove. Po-o-o, — e zgjati mbreti zanoren o, si të ishte në mëndyshje për fillimin e një bisede tjetër, që sapo i ishte kujtuar e që këshilltari e lexoi menjëherë në sytë e tij të qartë, më të qartë sesa duhej e sesa ishin në të vërtetë. (Diçka do

të ndodhë, diçka e fortë, mendoj këshilltari: sytë e qartë.) — E kam fjalën për vilën e rrethuar në qytetin e mallkuar të qenve. Ç'u bë me të rrethuarit?

Këshilltari ngurroi të fliste menjëherë. Por sytë e mbretit po ndizeshin: më vonë do të ishte më keq.

Tha këshilltari:

— Askush nuk doli i gjallë nga vila e djegur!

— Je i sigurt?!

— Vetëm gruaja me tre fëmijët!

— Me top?

— Po!

— Shumë keq, me top që ditën e parë të kurorëzimit tim. Ata humbën jetën, por mbreti humbi diçka që vlen më shumë se jeta e tyre! Armiqtë tanë në Tiranë e kudo në Shqipëri, mund ta komentojnë këtë ngjarje si diçka simbolike.

Heshtje.

— Po festimet a u bënë në rregull të gjitha? — pyeti mbreti.

— Pak me vonesë, por u bënë.

— Ashtu, ë, edhe populli u mblodh?

— U-u-u mblodh!

— Po me komandantin e xhandarmërisë?

— Sipas urdhrit tuaj paraprak, u arrestua!

— Ta vrasim?

— Mund ta nxjerrim në gjyq e ta vrasim. Por s'duhet të harrojmë, ai ka dhënë prova besnikërie.

— Atëherë?

— Një vit burg. Nxirret para kohe dhe emërohet komandant në një qytet tjetër.

— Ç'je një ti! — tha mbreti. Tha prapë: — Të vritet. Autoriteti im ka më rëndësi se besnikëria e tij. Bile mua më pëlqen t'u fut dridhmën edhe besnikëve të mi!

— Si urdhëron!

— Dhe mos guxoni të më bëni apele për mëshirë e ku ta di unë!

— Si urdhëron!



— Kam edhe një çështje tjetër.

— Jam gati ta zbatoj, naltmadhni! — Dhe sytë e këshilltarit te duart e mbretit.

E fitoi këtë çështje, rrufjani, tha mbreti me vete. Kësaj radhe do t'ia bëj qejfin, përderisa dinastia ime do ta ketë jetën të gjatë.

— Më kanë lindur dyshime për oficerin e artilerisë që komandonte topin.

— Po, naltmadhni! — tha këshilltari me sytë te duart e mbretit. — Edhe mua më lindën dyshime dhe kërkova të më raportonin me hollësi. Ekspertët thonë se nuk ka asgjë për tu çuditur e për të dyshuar. Topi ka qenë i kalibrit të vogël.

— Por top! — nguli këmbë mbreti.

— Top, por s'ka hedhur më shumë se pesëmbëdhjetë predha. Topi ka arritur në mbrëmje dhe brenda njëzet minutash beteja mori fund, burrat u vranë, kurse grujat me tre fëmijët ngriti flamurin e bardhë.

— Po topi, a s'të duket se ka arritur vonë?

— Jo, naltmadhni. Ushtria ndodhej në fushim të largët.

— Vazhdo.

— Predhat e para kanë qenë paralajmëruese. Ishim ne të dy, naltmadhni, që urdhëruam të bëheshin përpjekje për t'i trembur rebelët, me qëllim që të dorëzoheshin të gjallë. Meqë beteja u zgjat përtej orës së kurorëzimit, atëherë menduam bashkërisht, të paktën të mos shkaktohej rrëmuje. Dhe i porositëm ata të artilerisë të shënonin drejt vetëm kur të hiqnin çdo shpresë.

— Sa predha ka hedhur drejt vilës?

— Më pak se gjysmat!

— Dhe nuk u bë shesh?

— Vila mori zjarr që në predhat paralajmëruese. E megjithëse ishte ndërtuar sipas traditës së qytetit, me mure të trasha prej guri, ajo u shkatërrua gati e gjitha. Oficeri veproi drejt.

— Ti sikur kërkon ta zbutësh dyshimin tim. Kurse unë, po të sigurohem që oficeri është treguar sadopak

i ngathët, do ta pushkatoj menjëherë, vetëm e vetëm për të shpëtuar qoftë edhe një qime nga dinjiteti i dinastisë sime. Dikujt duhet t'ia vëmë mbi kurriz këtë faj.

— Naltmadhni, në më keni këshilltar e në ju ka mbetur një fije besim tek unë, më lejoni t'ju them, se po të vrasim edhe oficerin e artilerisë, siç po vrasim kapitenin e xhandarmërisë, atëherë dinastisë suaj vërtet do ti vëmë vetulla, por do t'i nxjerrim sytë.

— Pse-e-e?! — pyeti e gati bërtiti mbreti i ri, ndër-  
sa sytë e tij të çelët jo vetëm ishin errësuar, por edhe  
zmadhuar, përsëri si me lentë.

— Sepse, po të dënojmë oficerin e artilerisë, do të  
lëmë përshtypjen sikur rebelët gëzojnë përkrahjen e  
ushtrisë, që do të ishte diçka e ngjashme me ç'na ndo-  
dhi disa muaj më parë rrëzë Maleve të Shqipërisë.

Një çast më vonë, pas një përplasjeje të cekët men-  
dimesh, që lëvrinë nëpër ballin e dystë të mbretit të  
ri, sytë e tij të çelët u mbyllën përgjysmë. Kjo ndodhte  
vetëm kur mbreti hiqte dorë nga hipotezat e veta dhe  
i jepte të drejtë palës tjetër.

— Po me gruan e me tre fëmijët ç'do të bëjmë?

— Mund ti burgosim, mund t'i internojmë, — tha  
këshilltari.

— Po mund edhe t'i zhdukim, — tha mbreti. — T'i  
mbytim të katër dhe të përhapim fjalën sikur gjoja u  
ra barku dhe vdiqën!

— Mund t'i zhdukim, — përsëriti këshilltari, po në  
qëndrimin e tij mbreti kishte vënë re një «por» të  
pashprehur.

— Por?... — pyeti mbreti.

— Opinioni, naltmadhni!

— Cili?

— Populli, ai është kudo i pranishëm! Përderisa është  
krejt e logjikshme që një mbret të jetojë mbi kurrizin  
e tij, është gjithashtu krejt e logjikshme që populli të  
nuhasë lëkundjet më të vogla të mbretit që mban mbi



kurris. Syri dhe veshi i popullit gjenden kudo, me dashje ose pa dashje.

— Ti më ke thënë se Napoleoni, për t'ua arritur qëllimeve të veta, nuk e kishte për gjë të shkelte mbi kufomat e të tjerëve!

— Kohët kanë ndryshuar, naltmadhni!

— Për këto dëngla që po më thua, mund të të heq kokën!

Këshilltari, megjithatë, nuk preferoi heshtjen:

— Të vrasim një nënë dhe tre fëmijë në ditët e para të mbretërisë, nuk do të jetë e udhës. Neve do të na duhej të shpiknim diçka të bukur për këto ditë. Unë them, pasi të kemi vrarë kapitenin, të lëvdojmë armën e xhandarmërisë. Të shkruajmë në shtyp se, kur xhandarët panë që rebelët ishin vrarë të gjithë dhe kuptuan se brenda ndodhej e gjallë vetëm gruaja me fëmijët, ata u hodhën përmes flakëve...

— Bukur! — tha mbreti me një buzëqeshje të fshehtë. — Të gjendet një gazetar e të shkruhet siç thua ti. Kështu ka një kuptim që gruaja me tre fëmijët të shpëtojë nga vdekja, po megjithatë unë dua të di se ç'do të bëjmë përfundimisht me ta.

— Naltmadhni (sytë e këshilltarit te duart e mbretit). ma lër mua këtë punë!

— Mirë, bëj si të duash, por më e pakta internimi!

Pas këtyre fjalëve u duk sikur kishte marrë fund çdo bisedë, po befas mbreti ktheu kokën me vrull nga këshilltari dhe e shpoi tejprtej me një nga vështrimet e tij policore, ku ai ndihej plotësisht në truallin e vet, plotësisht me të dyja këmbët mbi tokë. Tha:

— Ti gënjen!

Këshilltari ndjeu t'i ftoheshin faqet.

Tha mbreti:

— Dhe gënjeshttrat e tua po përsëriten. Dy javë më parë, me gjithë masat që morëm, deshe të më fshihje faktin se jo të gjithë zgjedhësit e dytë, të caktuar nga ne, morën numrin e nevojshëm të votave dhe jo të gjithë ata që u zgjodhën votuan për deputetët tanë. Bile në

ndonjë nënprefekturë në i humbëm fare votat. E harrove Kolonjën? Kurse tashti po më gënjen prapë. Ti e di fare mirë që rebelët nuk janë vrarë të gjithë! Nga organet përkatëse kam marrë personalisht një informacion që thotë se nuk është plotësisht e vërtetë, por është fare afër së vërtetës, që rebeli Genc Boga të jetë larguar me pamjen e një bariu, i ndjekur nga një dhi e një kec. Po kësaj ç'i thua ti? — Vështrimi i mbretit e kishte shpuar si turjelë në ballë. — Herë tjetër mos të të mbushet mendja të krijosh lodra fëmijësh rreth meje. Dhe mos pandeh se të gjitha fijet kalojnë vetëm përmes teje!

Këshilltari ndjeu t'i mblidhej gjaku në zemër.

— Kujdes, edhe një gënjeshtër tjetër dhe do të përfundosh në legenin me ujë. Unë s'kam ndër mend të merrem as me gijotinën franceze, as me sëpatën gjermane. Mua më pëlqen plumbi, bile, në raste kur nuk duhet bërë zhurmë, siç mund të jetë rasti yt, një legen i vogël me ujë, me anën e të cilit mund të zësh për flokësh një burrë si ti dhe ta mbytësh për tridhjetë sekonda, pastaj t'i shkosh familjes për ngushëllim.

Këshilltari lëpiu buzët e thara.

Tha mbreti:

— As populli nuk është mbledhur para prefekturës!

— Naltmadhni!

— Zhduku, sa për sonte mjaft!

Këshilltari u duk sikur u thinj brenda një çasti. U zmbrafs në majë të këmbëve, po zëri i mbretit e gozhdoi në vend:

— Megjithatë, nuk më the, pse t'u mbush mendja të më gënjeje sonte?

— Sepse... nuk i dhashë aq rëndësi ngjarjes së vilës!

— E besoj. — tha mbreti. — Për një burrë, që në moshën tënde gati të thyer peshon vetëm pesëdhjetë kilogramë, asgjë s'mund të ketë rëndësi!

Këshilltari tashmë ishte zmbrafsur dhe mund të themi se kishte dalë nga orbita e mbretit, kur përsëri



gishti tregues i këtij të fundit e ktheu si me magnet.

— Dëgjo, — tha mbreti me zë të ulët, sepse ndonjë apo disa nga të pranishmit kishin filluar përsëri të përqendronin vështrimet rreth figurës së tij. — Kurse unë i jap shumë rëndësi ngjarjes që ndodhi sot në vilë. Dhe nuk e kam fjalën për pushkën e tyre. Unë e di që kam armiq, e di që nuk i kam pushtuar e nuk i kam nënshtruar mendjet e njerëzve dhe kjo sigurisht më shqetëson. Megjithatë, mjafton të forcoj akoma armën e xhandarmërisë, mjafton të shtoj edhe disa kompani shëtitëse, siç i kanë quajtur dy anglezët Stërlingu dhe Persi dhe pushka e tyre të quhet gati e asgjësuar. Këtë unë do ta bëj. Nga pikëpamja e forcës sot për sot ata s'paraqitin rrezik. Por mua më shqetëson më shumë diçka tjetër, më shqetëson fakti se ajo që ndodhi në vilë si edhe ajo që ndodhi me votimet e fundit, dëshmojnë se idetë e Revolucionit famëkeq kanë mbetur gjallë e qarkullojnë. Dhe, janë këto ide që në një të ardhme mund ta bëjnë prapë të rrezikshme pushkën e tyre. Prandaj unë dua të më hartosh një program të gjerë e të thellë për shkëlqimin nga rrënjët të të gjitha ideve të reja. Aty ku s'do të jetë e mundur të shkulet e të zhduken, atëherë të përpiqemi t'i shtrembërojmë ato, t'i zbutim, t'i hedhim nga njëri krah në tjetrin, që do të thotë, t'u lejojmë ideve të reja të ruajnë pamjen e tyre të jashtme, po në fakt të vihen në shërbimin tonë dhe ta çojnë ujin plotësisht në mullirin tonë. A më kuptove?

Këto mendime që këshilltari ia kishte ngulitur vetë mbretit kohët e fundit, pasi bëri sikur i dëgjonte për herë të parë, tha me ngazëllim:

— Po, naltmadhni, sikur ta përmbledhim me një frazë planin tuaj të shkëlqyer, do të thosha, ideve të reja t'u kurdisim kurthe të vjetra! (Dhe me vete shtoi: harrove që të kam folur edhe për reformat, për tokën, për premtimet?)

— Bukur e the! — tha mbreti. Po më kanë lindur edhe disa ide të tjera!

— Jam gati t'i zbatoj, naltmadhni!

— Unë mendoj se duhet të merremi më seriozisht me çështjen e tokës. Ta mbajmë vazhdimisht të gjallë shpresën për një reformë agrare e... për njëqind re-forma të tjera. (Ekzakt, shprehja ime — këshilltari.) Pra, si përfundim, e para, çrrënjosje idesh, e dyta, përvetësim e shtrebbërim idesh, e treta premtime!

S'e luan topi, tha këshilltari me vete dhe shtoi (më se i ngazëllyer për mprehtësinë e mbretit):

— Premtimet më kujtojnë bombat e tymit, naltmadhni!

— Bukur e the! — tha mbreti.

Tashmë, kushedi për ç'arsye, vëmendja e miqve, autoriteteve dhe të afërmeve në darkën e parë mbretërore që përqendruar sërish rreth figurës së tij. Këtë rikthim ai e priti me një buzëqeshje engjëlllore, ndërsa këshilltarit i pëshpëriti:

— Mjaft për sonte!

Kështu medalja e vetme u nda më dysh: njëra faqe e saj, që përfaqësonte makinacionet policore, mbeti në krye të tavolinës (mbreti), tjetra, që mishëronte makinacionet politike dhe ideologjike (këshilltari) shkoi në fund të tavolinës, midis oborrtarëve të tjerë.

## II

Midis pemëve s'kishte mbetur gati asgjë nga nata. përveç ndonjë gjurme të errësirës, përveç vlagës e parfumeve të saj, që s'ishin zmbropsur e zëvendësuar ako-



ma plotësisht nga mëngjesi. Kishte mbetur edhe ndonjë dridhmë e zhurmë e dobësuar, që mund ta kishte burimin në putrat e një kafshe, tek hiqej zvarrë për të dalë nga strofulla, por edhe në fërfëllimin e krahëve të ndonjë shpendi nate, që kthehej në fole. Dalngadalë qielli u ndriçua nga një ndezje madhështore e në këtë madhështi të çlodhur e të përgjumur dëgjohej ndonjë krismë e veçuar, që s'mund të ishte tjetër veçse trashëgimi i betejës së djeshme.

Genc Boga, ulur rrëzë një lisi, mbirë midis të çarave të Gurit të Bardhë, shikonte pikërisht periferinë e sapozgjuar të qytetit, ku ngriheshin akoma fjolla tymi të zi nga vila e Dikëve. Nga sytë e tij, megjithëse pa gjumë, të skuqur e të mavijosur, dukej sikur çlirohej një forcë, rrënjët e së cilës mund të gjendeshin vetëm në moshën e rinisë.

Dhe ashtu ndenji. Ndenji gjatë. Ai e dinte se duhej të ngrihej, duhej të largohej, por e kishte vështirë të lëvizte, e kishte vështirë ta hiqte vështrimin nga qyteti, ku sapo pati lënë tre të vrrarë, si dhe një grua me tre fëmijë, fati i të cilëve ishte në pikëpyetje.

(Edhe dhia me kecin shikonin. Shikonin qetësisht. Por jo larg, si Genci, jo qytetin atje poshtë, por vetë Gencin, kurrizin e Gencit, ulur përpara tyre.)

...Ja monopetet që të çojnë drejt bregoreve, mendonte padashur Genc Boga, ku, sipas gojëdhënës, dikur kishte luftuar një njeri i vetëm kundër armiqve të huaj. Po nëpër ato bregore, shekuj më vonë kishin kaluar ushtritë e Skënderbeut dhe gati gjysmë shekulli më parë nga ky mëngjes, një çetë komitësh kishte ngritur aty flamurin kuqez dhe kishte bërë pushkë, kundër suvarinjve të Portës së Lartë. Ajo çetë kishte luftuar, siç u luftua dje në vilën e Dikëve, dhe në mbrëmje ishte tërhequr, siç u tërhoq ai vetë, drejt Gurit të Bardhë. Po atje mbi ato bregore, rrëzë të cilave gjarpëronte e vetmja rrugë që lidhte qytetin me pjesën tjetër të Shqipërisë e me pjesën tjetër të botës, po atje kishin luftuar së bashku fshatarë e qytetarë në



vitin 1910, kundër ushtrive të Shefqet Turgut pashës. Dy herë me radhë nga ato bregore ishin nisur muzikat dhe pas muzikave vullnetarët me pushkë, me guna e me opinga për të shkuar në Vlorë, ku do të ngriheshin flamurin e pavarësisë (1912) dhe pas tetë vjetve do të luftonin kundër pushtuesve të huaj (1920). Së fundi, katër vjet më parë prej aty kishte filluar një nga pikënisjet e marshimit të Revolucionit të Njëzetekatrës dhe i ati, me trastën e këpucarit në krah, kishte shkuar pas luftëtarëve. Sa njerëz kishin luftuar gjatë shekujve, sa njerëz ishin vrarë e varrosur në atë tokë të zhuritur, në ato bregore, që atë mëngjes duke shin sikur e prisnin lindjen e diellit me aq mospërfillje e qetësi të përfjetur. Ata ishin të gjithë aty, të shtrirë me shpatulla në tokë, me fytyrë nga qielli, të tretur deri në molekulën e fundit, të shkrirë njësh me baltën, të kthyer në dhé e në bar. Shumë të tjerë ishin akoma skelet. Dhe të tjerë — Mentar Dika, Folta Papi e Teli Bashari — s'ishin ftohur akoma. Të gjithë ata, të vjetër e të rinj ishin bërë pjesëtarë të një ushtrie, pjesëtarë të një arkivi, kishin hyrë në kronikë e në histori, pastaj do të hynin në gojëdhënë, dhe më vonë akoma do të ktheheshin në legjendë. Ata vinin e shkonin nga të gjitha anët, takoheshin e kryqëzoheshin si dhjetëra rrugë e rrugica, si dhjetëra monopate e vrraga, që lëviznin e zgjateshin para syve të Genc Bogës e që, duke shkuar larg e më larg, bëheshin aq të shumta, sa dukeshin pa kuptim, pa drejtim, pa krye, pa qëllim, herë-herë edhe të kundërta. Por pas këtyre ndeshjeve e shpleksjeve, një sy i stërvitur do të kuptonte sërish drejtimin e tyre, kuptimin e qëllimit e tyre dhe atëherë ato bëheshin prapë të afërta, të dashura, ato bëheshin rrugë jete, të vjetra e të reja, që arrinin deri te Mentar Dika, Folta Papi e Teli Bashari. Edhe ai vetë, edhe Lato Morina, Besnik Sazani e Kolë Papi (e shumë të tjerë para e pas tyre), duke ecur në gjurmët e të parëve do të hapnin gjurmë të reja, gjurmët e veta, të cilat do t'ua linin pastaj brezave të ardhshëm.



Tashmë të gjitha çfarë kishin ndodhur gjatë muajve të fundit, kishin mbetur prapa: ai ishte i lirë. Përpara kishte të nesërmen. (Gjithmonë ka një të nesërme.) Ç'pamje do të kishte ajo, Genc Boga nuk e dinte, ose më e shumta, e shikonte turbull, por ai dinte me siguri se kjo që ishte në fuqi nuk duhej të qëndronte, sepse qe vjetëruar, qe bërë e dëmshme, çoroditëse, parazitare dhe e egër. Ajo ishte kthyer në trill të çmendur dhe njerëzit e thjeshtë si ai i shikonin me pikëllim e me zemër të ndrydhur kllapitë e pasionit, tradhtitë, gënjeshtat, premtimet, shantazhet, korrupsionin, rrjetën e djallëzuar të shtypjes, të manovrimit për të rrëmbyer bukën, gjënë e tokat e të tjerëve, stolitë e çdo gjë të dobishme e të bukur dhe për t'ia arritur këtij qëllimi ata kishin shpikur dhe ngritur burgje, gjyqe dhe idera, çifligje, kafene, kumar, muzikë, këngë, raki e gra të bukura, të gjitha për vete, por edhe për të trullosur të tjerët me mbeturinat e orgjive të veta. Nga njëra anë uri, varfëri, zemërim e vetëvrasje, nga ana tjetër shkëlqim e fjalë tunduese. Nga njëra anë shpresë, përpjekje dhe luftë për të siguruar dhe ndryshuar jetën, nga ana tjetër shkallmim dhe rrënim. Revolucion dhe kundërevolucion.

Atyre atje, tha Genc Boga me vështrim të përqëndruar diku në një pikë të qytetit, nuk u pëlqen që ne të flasim për atdhe, për drejtësi, për tokë e për shumë gjëra të tjera. Ata na e kanë ndaluar të drejtën e fjalës e të punës, por të drejtën e plumbit nuk do të na e ndalojnë kurrë!

Diçka e fshehtë rrëshqiti brenda tij. Dhe ai vazhdoi të mendonte me shprehje të hidhëruar të fytyrës për të gjitha ç'kishin ndodhur e me shprehje çapkëne për të gjitha ç'do të ndodhnin me të e me shokët e tij të luftës. Duke menduar për këta shokë, përfytyroi Lato Morinën me hundën të theksuar mbi tiparet e tjera, që dukej si e montuar gabimisht në fytyrën muskuloze e kockëgjerë — i gjithë ky njeri i ngjeshur, katër vjet më parë kishte bubullirë, sikur Genci të qe ndodhur në shpatullën tjetër të një mali:

— Këtu qenke ti, çapaçul, pa hajde, afrohu! — dhe, pasi e shkundi për krah, pasi nxori nga brezi një copë letër të zhubrosur dhe një laps të shkurtër, ia dha Gencit për t'i shkruar së shoqës.

Moj shejtane (ai nuk e thërriste kurrë në emër gruan), hapi mirë veshët dhe dëgjo... (tashti fytyra i qe zbutur dhe i qe bërë më e ëmbël). Ti e di që unë zbrita në qytet në shtëpinë e mikut tonë, Jorgji Bogës, për të marrë vesh se ç'është kjo që po ndodh nëpër botë, se ç'është kjo që po zien si kazan me ujë të valuar. E merr dot me mend ti, që Jorgjit me një fije shpirt e me trastën e këpucëve në krah, si Teli Bashari që vjen në fshat e që na troket te pahia, këtij Jorgji pra, na i paska hipur në kokë të shkojë prapa ushtrisë së re që do të rrezojë bejlerë e efendilerë?! E di ti këtë? Jo thua, nuk e di! Atëherë mëso se edhe unë nuk po kthehem hëpërhë në fshat, po shkoj pas Jorgjit e pas ushtrisë dhe kur të dëgjosh se i kemi shkallmuar horrat, atëherë pritmë se u ktheva fluturim. T'i kam pasë thënë nja dy fjallë, por ti, shejtane, sikur harron shpejt. Tashti dëgjo prapë, merr fëmijët dhe, o burra, yrysh te babai yt, se nuk dihet çfarë mund të ndodhë. Atje më prit e mos lëviz pa ardhur unë se, ngado që të shkoj, prapë në fshat do të kthehem, tokë dua dhe jo grada. Hajt mirupafshim! Këtë letër e shkroi çuni i Jorgjit, Genci, ai çapaçuli që të erdhi një herë në fshat e t'i hëngri të gjithë fiqtë. Të kujtohet ai brekëgrisuri?...

Genc Boga i ndërpreu përfytyrimet dhe shikoi rrotull, si të kërkonte Lato Morinën aty pranë. Kurse tashti, mendoi Genci, me të ardhur këtu, do të nxjerrë prapë nga brezi letër të zhubrosur, do të nxjerrë lapsin e vogël, që e mban zakonisht në kutinë e duhanit e si atëherë do të më thotë: «Shkruaj!» Dhe me siguri



ka për t'i shkruar së shoqes që ajo të marrë fëmijët e të nisat përsëri tek i ati dhe kësaj radhe nuk do t'i shkruaj për Revolucionin e Njëzetekatrës, po për Mallet e Shqipës, ku do të jetë baza e çetës sonë!

M-m-m, dhia. Ajo përtypej krap-krap-krap dhe me sytë gurrkali në të gjelbër e në të verdhë shikonte përpara. Por jo larg, jo qytetin poshtë, ku rrezet e diellit, ku hijet dhe njollat (qielli ishte me re) luanin e vraponin nëpër çatitë e lara nga rrebeshi, por Gencin, atë shikonte ajo, kurrizin e Gencit. Kurse Genci nuk shikonte dhinë, nuk shikonte as qytetin, por mendimet e përfytyrimet e veta, që i vinin një nga një ose varg e varg, të gjitha së bashku e të gjitha menjëherë, ato shikonte Genci.

M-m-m, dhia. Ajo kishte kullotur pa aguar mirë. Tashti përtypej qetësisht krap-krap-krap...

Ë-ë-ë, keci. Ai lëpinte buzët dhe përkëdhelte turirin e zi pas qafës së bardhë të së ëmës, por edhe pas gjunjëve të Gencit.

Padashur Genci shikoi të qepurën me pe të zi në mëngoren e bardhë dhe tha se këtë dhi e këtë kec do tia dhuronte nënë Hyrijes, që rronte vetëm buzë një pylli e që tërë jetën s'kishte mundur të kursente veçse një frang e disa groshë, kurse për të blerë një dhi, do t'i duheshin të paktën pesë franga...

Tashmë kishte kaluar prej kohësh frymëmarrja që sjell me vete mëngjesi i parë e që zbon hijet e përgjurmura të natës. Kishin kaluar edhe feksjet bashkë me shkëlqimet e zbehta. Kishin kaluar çastet, kur rrezet e arta dynden nga majat e maleve, mbushin luginat e grykat dhe përmbytin tokën. Tashti dielli që ngritur lart dhe nga Guri i Bardhë kishin zënë të valëviteshin avuj të ngrohtë.

Befas, në monopatin poshtë, Genc Boga dëgjoi zhurmë. Ai shqoi, tek ecnin njëri pas tjetrit, me pushkët në dorë, Lato Morinën, Kolë Papin, të gjatë e hollak, pastaj njohu flokët e ashpër e të kreshpëruar si gjemba iriçi të Besnik Sazanit. Njohu edhe një të katërt: Habibin

nga Kosova, trupmadh si i ati, me qeleshe të bardhë si i ati dhe përfytyroi mjekrën e tij gati katrore si dhe damarët të fryrë në tëmtha e në ballë.

Genc. Boga, i priti katër shokët e vjetër e të rinj, si të kishte kaluar me ta një jetë të tërë prej komiti e si të ishte ndarë prej tyre vetëm një çast më parë.

### III

Pasi ishte shkruar letra: «Dëgjo, moj shejtane!...» e pasi Kola kishte ndezur një zjarr të madh mbi Gurin e Bardhë, parulla që kishin lënë me Foltën për t'i treguar se ishte bashkuar me shokët (Genci e pa të arsyeshme të heshte hëpërhë), ata u nisën të pestë përpjetë pyllit, të ndjekur nga dhia e nga keci.

Ishte gati mesditë, por rrezet e diellit binin të vrara mbi tokë. Kishte re. Dhe zagushi. Zagushi vjeshte.

Prapa tyre zjarri digjej e digjej...

Fund